

Bajram Kosumi



**FISHTA DHE LETËRSIA
SHQIPTARE E TRADITËS**

BAJRAM KOSUMI

FISHTA DHE LETËRSIA

SHQIPTARE E TRADITËS



BAJRAM KOSUMI

FISHTA DHE LETËRSIA SHQIPTARE E TRADITËS

Copyright © autori

Kolona: **Histori e letërsisë shqipe**

Design & Layout: **ORBIS, Prizren**

Ky libër është i formatit eBook.

Botimet Filozofia Urbane



ISBN: 978-9951-641-34-0

Prishtinë, 2013

www.filozofiaurbane.com

www.librariaelektronike.com

H Y R J E

Vepra letrare e Gjergj Fishtës ende nuk është shqyrtuar shterueshëm nga kritikët letrarë dhe nga historianët e letërsisë. Ka një mbushullim shqyrtimesh kritike të shkurtra në vitet 30-40 të shekullit XX, shumica e këtyre shkrimeve me vlerësime sipërfaqësore apo të bëra me rastin e vdekjes së poetit. Po edhe aty ka disa shqyrtime thelbësisht përcaktuese. Ka pastaj një histori të keqe të refuzimit politik të veprës së Fishtës e deri në ndalimin e plotë të saj, për t'u rizbuluar kjo vepër në vitet 90 të shekullit XX, për të vazhduar kritika letrare përsëri me bujshmërinë e cilësimeve madhore. Vetëm këto vitet e fundit ka filluar një shqyrtim më përmbajtësor dhe më detajizues i kësaj vepre.

Ende pa ndodhë ky shqyrtim, kritikët dhe lexuesit e veprës së Fishtës, duke parë vlerën e lartë të saj, kanë shtruar çështjen e vendit të Fishtës në historinë e letërsisë shqipe. Nga ana tjetër, vepra e Fishtës është e veçantë nga tradita letrare shqiptare, që në leximin e parë, së paku për tri qasje kryesore. Së pari, Fishta ka shkruar epin kombëtar shqiptar në frymën e romantizmit, atëherë kur romantizmi ishte çështje e historisë së letërsisë dhe atëherë kur shkrimi i epit, si formë letrare, konsiderohej po ashtu si punë e së kaluarës. Epi kombëtar shqiptar *Lahuta e Malcis* e Fishtës, është epi i fundit i një letërsie evropiane. Së dyti, vepra e Fishtës, në përgjithësi, ka një marrëdhënie të ngushtë me letërsinë popullore, aq sa në historinë e letërsisë shqipe është shtruar natyrshëm pyetja se a është Fishta poet origjinal apo poet-këngëtar popullor i eposit historik? Në të njëjtën

kohë, vepra e Fishtës, në çështje të metodës letrare, dallon thelbësisht nga letërsia e kohës së tij, aq shumë sa që këto dallime nuk mund të klasifikohen si çështje të stilit personal. Duke qenë e dallueshme nga letërsia tjetër, duke qenë e lidhur pothuajse organikisht me traditën popullore, duke qenë pothuajse e papritur si formë letrare, vepra letrare e Fishtës është përjetuar dhe ende vazhdon të përjetohet si një paradoks letrar në letërsinë shqipe.

Kjo veçanti e veprës së Fishtës, e cila mund të quhet edhe paradoks letrar, imponon një shqyrtim thelbësor të marrëdhënieve të kësaj vepre me traditën letrare shqiptare. Këtu ka lind ideja për temën e shqyrtimit tonë *Fishta dhe letërsia shqiptare e traditës*. Kur jemi përcaktuar për këtë temë kemi pasur parasysh një qëllim: shqyrtimin dhe zbulimin e lidhjeve, të ngjashmërive dhe të dallimeve, të veprës së Fishtës me gjithë traditën letrare shqiptare. Zbulimi i këtyre ngjashmërive dhe dallimeve, të cilat krijojnë veçantinë e kësaj vepre, paradoksin letrar me emrin Fishtë, do të na jepte Fishtën në dritën e vërtetë, jo vetëm nga prizmi i një lexuesi, por edhe nga prizmi i historisë së letërsisë shqiptare.

Po kështu, kur jemi përcaktuar për këtë temë kemi parandier prezinin e gjerësisë së temës në shqyrtim. Në historinë e letërsisë shqipe janë shkruar monografi të gjera për një poet, monografi për një periudhë letrare apo për një formë letrare, janë shkruar edhe histori për gjithë letërsinë shqipe, po nuk ka një studim të gjerë për marrëdhënien e një poeti të madh me krejt traditën letrare shqiptare. Si mund të konsiderohet e shkruar një histori e letërsisë shqipe nëse paraprakisht nuk ka studime krahasimtare brenda trungut letrar shqiptar? Kjo gjerësi e temës ka kushtëzuar edhe mënyrën e qasjes ndaj saj, e që është pjesë e metodologjisë studimore. Ka pasur dy rrugë: një, shqyrtimi veç e veç i

elementeve e parimeve të letërsisë së Fishtës, duke e krahasuar secilën prej tyre me gjithë traditën letrare shqiptare dhe dy, krahasimi i të gjitha elementeve e parimeve të letërsisë së Fishtës me çdo periudhë letrare të letërsisë shqipe, veç e veç. Metoda e parë do t'i jepte parësinë veprës së Fishtës, por do të ishte e njëanshme, sepse krahason vetëm ato elemente e parime që janë prezente në veprën e tij, por jo edhe ato që mungojnë te ai dhe janë prezente te autorë të tjerë. Në fund, qasja e parë do të rezultonte me një studim interesant dhe të pëlqyeshëm edhe për lexuesin. Metoda e dytë duket e afërt me studimet tradicionale shqiptare të letërsisë, aq sa mund të quhet edhe klasiciste, krijon situata të përsëritjeve nga kapitulli në kapitull, mirëpo, kjo metodë rezulton me një studim të saktë, më të plotë e më të përimtuar, më akademik dhe si rrjedhim, të mërzitshëm për lexuesin e zakonshëm të letërsisë, por me shumë interes për shkencën e letërsisë. Ne jemi përcaktuar për qasjen e dytë, duke rrezikuar nga pak tërësinë dhe unitetin e shqyrtimit në favor të studimit shterues të çdo detaji që e njëjtëson apo e dallon veprën e Fishtës nga tradita letrare shqiptare.

Qasja metodologjike ndaj temës në shqyrtim ka paracaktuar krahasimin si themel metodologjik në shqyrtimin e kësaj teme. Mbarë tema e shtruar këtu është një krahasim. Duke zbërthyer vetëm krahasimin ne do të zbërthejmë gjithë materien e saj.

Krahasimi, në këtë shqyrtim, përfshin një gamë të gjerë çështjesh, prej më të gjerave, si është krahasimi i burimeve të ndikimit kulturor në ndërtimin e figurës poetike (p.sh. areali kristian te De Rada, areali kristian+tradicional shqiptar te Fishta, areali Lindor+tradicional shqiptar te Naimi) e deri te më të imtat, siç është përdorimi i vargjeve të metrave të

ndryshëm. Krahasimet janë bërë sipas një rendi logjik, prej të përgjithshmes kah e veçanta, me ç'rast:

janë krahasuar ngjashmëritë, si p.sh. struktura ndërtimore e tekstit poetik në motivet e kundërshtimit midis prijësit dhe një luftëtari popullor, te Fishta dhe te Naimi është e ngjashme;

janë krahasuar përkimet, siç është vargu tetërrokësh i Fishtës dhe vargu tetërrokësh i Pjetër Budit, apo konceptet estetike të Fishtës të përkueshme me ato të Bogdanit;

janë krahasuar ndikimet e tërthorta, si p.sh. ndikimi i teorive romantike për letërsinë popullore te Fishta, që mund të vijë nga disa drejtime: nga letërsia proklasike shkodrane, nga romantizmi arbëresh, nga vetë romantikët italianë dhe nga romantikët sllavë;

janë krahasuar ndikimet e drejtpërdrejta, siç është ndikimi nga letërsia e autorëve të vjetër të Veriut për fjalët e vjetra shqipe, por edhe në mitet letrare si miti i gjuhës, i atdheut etj.;

janë shqyrtuar dallimet, si p.sh. hiperbola te Fishta, si figurë që shpreh madhështinë dhe litota te Naimi, si figurë që shpreh dashurinë;

është vazhduar me krahasimet e mungesave, sepse ka elemente letrare që qenësojnë te Fishta po nuk janë te autorët e tjerë, siç është boshti moral i gjithë veprës letrare të Fishtës, Atme e Fe, e po ashtu ka elemente letrare të rëndësishme për autorët e tjerë apo për një periudhë letrare, por të parëndësishme për Fishtën, si p.sh. tema e dashurisë për romantikët, apo motivi i natyrës për të gjithë poetët romantikë, i munguar te Fishta.

Po ashtu, materia letrare e krahasuar është e një game të gjerë: janë krahasuar idetë poetike, tematika, motivet, strukturat e tekstit letrar, teknikat e vargut e të strofës, teknikat krijuese e modelet e shkrimit letrar.

Në fund të hyrjes na mbetet të sqarojmë vetëm edhe elementet e krahasimit. Çdo krahasim ka dy elemente: i pari që është objekt i krahasimit, e në këtë rast është vepra e Fishtës dhe i dyti, që është objekti me të cilin bëhet krahasimi, e që është tërë tradita letrare shqiptare. Elementi i parë, vepra e Fishtës, këtu është gjithë ajo vepër që është botuar deri tash dhe e cila i është nënshtruar syrit të lexuesit. Këtu përfshihet jo vetëm vepra letrare, por edhe ajo estetike, publicistike etj. Elementi i dytë i krahasimit, tradita letrare shqiptare, është parë si në historinë tradicionale të letërsisë shqipe, e ndarë nëpër periudha letrare, si: autorët e vjetër të Veriut, letërsia e romantizmit, duke shtuar këtu edhe poetët e rrethit kulturor shkodranë, veçanërisht ata françeskanë, më shumë për shkak të lidhjeve që Fishta ka pasur gjatë gjithë jetës me këtë rreth prelatësh dhe shkrimtarësh.

Deri ku shkon kjo traditë? Për lexuesin e sotëm traditë letrare është edhe vetë Fishta, por për Fishtën traditë letrare ka qenë ajo letërsi që është bërë pjesë e historisë së letërsisë në kohën e tij. Duke u nisur nga ky konstatim vepra e Fishtës është parë në lidhje me atë që ai e ka konsideruar traditë letrare shqiptare. Kjo vepër nuk është shqyrtuar në lidhje me autorët që kanë bashkëjetuar me Fishtën, përveç në ndonjë rast të veçantë, siç është shqyrtimi i koncepteve estetike të Fishtës e të Faik Konicës.

Krahasimi kaq i gjerë, thelbësor, i tërësishëm dhe i përimituar do të mundësojë një gjykim të ri për veprën e Fishtës dhe për rolin e saj në historinë e letërsisë shqipe, në bazë të vetë elementeve, parimeve e të vlerave që ka kjo vepër.

Në fund, ky shqyrtim konsideroj se është një ndihmesë për studimet krahasimtare brenda trungut letrar shqiptar.

KREU I PARË

FISHTA DHE AUTORËT E VJETËR TË VERIUT

I. RRETHANAT E LINDJES SË LETËRSISË SË SHKRUAR SHQIPE

Historia e letërsisë shqipe nis me letërsinë filobiblrike të krijuar nga autorët e vjetër të Veriut, që jetonin kryesisht në tokat e veriut të Shqipërisë së sotme dhe në gjysmën jugore të Kosovës, hapësira të cilat mbanin të ngjitur për veten e tyre fshatra e qytete shqiptare të Mesjetës: nga jugu, kjo mbështetje, në malet shqiptare arrinte deri në Lezhë; nga perëndimi deri në Tivar; nga veriu deri në Janjevë dhe nga lindja deri në Shkup. Në këtë katërkëndësh gjeografik, i cili ishte në zemër të territorit dhe të etnikumit shqiptar, sipas të dhënave të derisotme historike, u fillua letërsia e shkruar shqipe. Kjo hapësirë përkon me kufijtë e mbetur të katolicizmit të shqiptarët, e që në aspektin e kulturës do të thotë latinitet, zonë e ndikimit kulturor evropian. Katolikët dhe misionarët e tyre, nën tryshninë e Kishës ortodokse serbe (Perandoria e Stefan Dushanit) dhe nën tryshninë e Islamit (Perandoria Osmane) për të ndërruar identitetin fetar, gjetën derën e mbijetesës: zhvilluan në kishat e tyre ligjërimin në gjuhën të cilën e kuptonin besimtarët, pra në shqip, përkthyen tekste fetare dhe liturgjike në shqip, përshtatën letërsinë fetare të autorëve të huaj në shqip, dhe së fundi shkruan letërsi autoriale fetare dhe laike në shqip. Ata shkruanin edhe në latinishte, por e çmonin si detyrë të rëndësishme shkrimin në shqipe. Këtë letërsi të shkruar në shqip Eqrem Çabej e quan Qarku i Veriut.¹ Ekzistenca e fakteve historike për këtë zhvillim është argumentuar.

1 Eqrem Çabej, Për gjenezën e literaturës shqipe (v. 1938), në Studime gjuhësore V, Rilindja, Prishtinë, 1975, fq. 101-134. Këtë temë e trajton edhe Oliver Jens Schmitt, duke e prapakthyer në shekujt XIV-XV ndarjen kulturore të arbërve në tri sfera kulturore: arbër-veriore (përzjerje arbër+roman+sllav-bizantinë), arbër-mesi (përzjerje arbër+ro-

Mirëpo, në historinë e letërsisë shqipe, por edhe në historinë shqiptare, në përgjithësi, ende nuk ka një informacion të saktë se çfarë ka pasur në hapësirën shqiptare, në lëmin e kulturës e të letërsisë, përpara veprës së parë të letërsisë shqipe *Mesharit* (1555) të Gjon Buzukut? Ende sot, me zjarr e patos, në çdo rast të dhënë, në shkencën humaniste shqiptare diskutohet për kuptimin e thënies së njohur të kryepeshkopit francez të Tivarit Gullielmus Adae, i njohur si Brocadus Monacus², në librin e tij *Directorium ad passagium facienda* (1332):

“Shqiptarët kanë një gjuhë krejt tjetër dhe të ndryshme nga latinishtja, megjithatë kanë alfabetin latin (*litteram latinam*) në përdorim dhe në tërë librat e tyre”³

Një grup studiuesish, që nga zbuluesja e kësaj fjalie, znj. Edit Durham, në vitin 1909, e deri te Çabej besojnë se shprehja *litteram latinam* paraqet shkrimin latin. Një grup tjetër studiuesish, që nga Skiroi Junior (v. 1959) e Selman Riza (v. 1961) e deri te Injac Zamputi e Dhimitër Shuteriqi, e vënë në dyshim interpretimin e mësipërm të fjalisë së Aadaes, duke argumentuar se shprehja *litteram latinam* në shekullin XIII e XIV ka paraqitur gjuhën latine. Selman Riza në veprën e tij *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe* (botuar së pari si doracak shkollor nga Universiteti Shtetëror i Tiranës më 1961), duke kundërshtuar interpretimin tradicional, përfundon se fjalia e Aadaes thotë kështu:

man+grek-bizant.+sllav-bizant.) dhe arbër-jugu (përzierje arbër+grek-bizant.). Shih Oliver Jens Schmitt, *Arbëria venedike 1392-1479*, K&B, Tiranë, 2007, fq. 85-91.

- 2 Në vitet e fundit në shkencën albanologjike është kontestuar autorësia e Brocadus Monacus-it, prandaj edhe ka filluar të shquhet si Pseudo Brocadus.
- 3 Sipas Dhimitër S. Shuteriqit, *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipës në vitet 879-1800*, ASHSH, Tiranë, 2005, fq. 39.

“Le të kenë shqiptarët një gjuhë krejt tjetër nga latinishtja e të tjetërlojshme, prapëseprapë (ata) gjuhën latine e kanë në përdorim e në të gjithë librat e vet”⁴

Dyshimi i Skiroit dhe përfundimi i Selman Rizës do të argumentohen më vonë nga Dhimitër Shuteriqi dhe Injac Zamputi.⁵

Edhe pse kjo temë nuk është konsumuar deri në fund nga shkenca shqiptare dhe ajo mund të ndryshojë mbase në favor të shkrimit edhe më të vjetër shqip sesa *Meshari* (1555) i Gjon Buzukut, në këtë interpretim të ri, një fakt theksohet: në të gjithë librat e tyre shqiptarët përdornin gjuhën latine. Ky fakt dëshmon për qenësimin e shtresës së inteligjencies shqiptare, e cila shkruante dhe botonte libra në latinishte, e që ishte në përputhje me zhvillimet kulturore në gjithë hapësirën evropiane, pasi gjuha e letërsisë dhe e kulturës ishte latinishtja, nga njëra anë, si dhe në përputhje me vendimet e Koncilit të Turit (v. 813) për ndalimin e predikimit kishtar në gjuhët vulgare.⁶ Në përputhje me këto konstatime janë edhe gjetjet e shkrimeve dhe mbishkrimeve të ndryshme në Shqipërinë e Veriut, nga shekujt XII e XIII, që janë në latinishte.⁷ Historia moderne e ka kthjelluar më shumë këtë kohë. Milan Shuflaj dhe Oliver J. Schmitt vërtetojnë se krahas alfabetit e gjuhës latine, në hapësirën shqiptare në shekujt XIII-XV janë përdorë njësoj edhe alfabeti e gjuha greke, përkatësisht sllave, varësisht prej zonave kulturore.⁸ Duhet marrë me rezervë mundësinë e zhvillimit të letër-

4 Selman Riza, *Vepra 4 / Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, ASHAK, Tiranë, 2004, fq. 240.

5 Dhimitër S. Shuteriqi, *Tekstet shqipe ...*, fq. 39-46.

6 Dhimitër S. Shuteriqi, *Tekstet shqipe...*, fq. 41.

7 Dhimitër S. Shuteriqi, *Tekstet shqipe...*, fq. 41.

8 Milan Shuflaj, *Serbët dhe Shqiptarët*, Toena, 2004, fq. 169; Oliver Jens Schmitt, *Arbëria venedike 1392-1479*, fq. 85-91.

sisë, në kuptimin e letërsisë së autorëve tanë të vjetër, edhe në kohën paraosmane. Oliver J. Schmitt thotë:

„Në Arbëri nuk ekzistonte një kulturë oborrtare më vete, si për shembull në Janinë dhe Artë, ku nxiteshin letrat e bukura e ku kronistët në vargje pak a shumë të ekzaltuara glorifikonin princat dhe mikprisnin me humor e fantazi udhëtarë të huaj.“⁹

Schmitt aludon për kronika si ajo e Janinës, e cila ruhet në Manastirin e Shën Pantelejmonit dhe përfshin ngjarjet e viteve 1355-1400, kur Janina ishte e banuar me grekë.¹⁰

Shtresa e inteligjencies për të cilën po flasim, ata që kanë botuar librat e tyre dhe kanë lexuar ata libra në latinisht, janë etërit kishtarë katolikë, familjet fisnike shqiptare, administratorët e ndryshëm etj. Fundja, kjo është në përputhje me faktin historikisht të dëshmuar se shoqëria shqiptare e këtyre shekujve kishte lindur shumë strategë të njohur të luftërave, prej të cilëve Gjergj Kastrioti me famë botërore, kishte lindur edhe shumë humanistë të shquar, prej të cilëve Marin Barleti me famë botërore. Qytetet shqiptare të Veriut, si Shkodra, Tivari, Lezha etj. mbanin lidhje të afërta e të drejtpërdrejta me vendet më të shquara evropiane të asaj kohe, si Roma, Venediku, Padova, Ragusa etj. Shumë fisnikë shqiptarë shkonin të studionin në universitetet më të famshme evropiane.

Të gjitha këto fakte, më në fund, plotësojnë mozaikun e shoqërisë shqiptare parabuzukiane dhe për më shumë, paraosmane. Pushtimi osman që përfundon me rënien e Krujës (16 qershor 1478), të Shkodrës (25 prill 1479) e të Durrësit (1501), e ndryshon paksa kursin historik të

9 Oliver Jens Schmitt, Arbëria venedike 1392-1479, fq. 194.

10 Milan Shuffaj, Serbët dhe Shqiptarët, fq. 89.

shoqërisë shqiptare. Pushtimi osman nuk kishte ardhur papritmas, por pas më shumë se një shekull koketimi e luftimi të princërve ballkanas me otomanët. Konvertimi i katolikëve vendës në fenë islame kishte filluar te shqiptarët para pushtimit të përgjithshëm të tokave shqiptare, në radhë të parë, te shtresat e aristokracisë. Poende, ndër të parët ishin disa pinjoj të familjeve fisnike, si nga Muzakajt, Zenebishët, Dukagjinastët etj.¹¹ Edhe pse në shekullin e parë të sundimit të osmanëve në Shqipëri islamizimi do të jetë një proces shumë i ngadalshëm, me faktin se shtresa e aristokracisë ishte goditur në palcë, ose kishte emigruar ose kishte pranuar fenë islame, kishte filluar dëmtimi i mozaikut paraosman të një shoqërie evropiane, ku njerëzit e ditur shkruanin dhe lexonin librat e tyre në gjuhën latine dhe ku fisnikët princëronin në principatat e tyre dhe i dërgonin bijtë e tyre të shkolloheshin në universitetet më të njohura të Evropës. Madje, mund të pohohet se për një shekull shqiptarët mbetën pa klasë të inteligjencies e të fisnikëve. Ky është shekulli XVI. Onufri, Barleti, Gjon Muzaka dhe Gjon Buzuku, jetonin dhe punonin ose të mërguar, ose në periferitë e atdheut, si Buzuku, i cili jo vetëm shkrimin e librit, por edhe jetën e bënte larg vëmendjes së Romës dhe të qeveritarëve osmanë. Ndërsa aristokratët e mbetur në Shqipëri, shumica e tyre kishin pranuar islamin dhe po natyralizoheshin, jo vetëm në rrethana të reja kulturore e fetare, por edhe në pushtetin e ri perandorak dhe në interesat e reja pronësore.

11 Historia e popullit shqiptar, I, ASHSH, Toena, Tiranë, 2002, fq. 587 dhe 589. Shih edhe: Oliver Jens Schmitt, Arbëria venedike 1392-1479; Milan Shufllaj, Serbët dhe Shqiptarët; Dr. Skender Rizaj, Dukagjini (1202-1462), Sanxhaku i Dukagjinit (1462-1846) dhe Sanxhaku i Pejës (1881-1912), në Vjetar XXII-XXVIII, Arkivi Kombëtar i Kosovës, 2002, fq. 227-310.

Pushtimi osman në shekullin e XV paraqiste dukshëm kërcënimin për shpërfytyrimin e identitetit shqiptar: në njërën anë ishte ndërpre-rë rrjedha e natyrshme e zhvillimit kulturor e letrar të shqiptarëve, përmes latinishtes në librat e tyre, ndërsa shqiptarët nuk kishin zhvil-luar kulturën dhe letërsinë e tyre në gjuhën shqipe, në anën tjetër dhe, si pasojë e këtij hendeku mbetej si zgjidhje, jo vetëm feja islame, por edhe kultura islame.

Ky kërcënim i këtyre rrethanave të pafavorshme për shqiptarët do ta ketë shtyrë Buzukun për ta shkruar në shqip një *Meshar* (1555). I njëjti kërcënim do ta shtyjë edhe Pjetër Budin të shkruajë libra shqip, edhe Frang Bardhin po ashtu, as Pjetër Bogdani nuk do të lirohet nga ky ankth historik.

Në anën tjetër, ky kërcënim ndikoi që në kulturën dhe letërsinë e shqiptarëve të shfaqen dukuri të reja ideologjike: përmasa kombëtare dhe atdhetare e letërsisë. Tash e tutje letërsia shkruhet edhe për motive fetare, edhe për motive atdhetare (etnikumi dhe gjuha shqipe).

I. 1. Autorët e vjetër të letërsisë shqipe dhe rrethanat kulturore e letrare në të cilat vepruan ata

Studiuesi i njohur Selman Riza e trajton gjerësisht një fakt në lidhje me botimin e *Mesharit* të Buzukut: a kishte Buzuku lejen nga Roma, poende autorizimin, për ta botuar *Mesharin*? Kisha Romake kishte kuptuar, pas Lëvizjes Luteriste, se botimi i teksteve në gjuhët e popujve të ndryshëm ishte një armë e fuqishme për t'i mbajtur ata popuj të lidhur për Kishën.¹² Në Koncilin e Pestë të Lateranit (1512-1517) u ven-

12 Eqrem Çabej, Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes / Romantizmi në Europë lin-dore e juglindore dhe në literaturën shqipe, Çabej MÇM, 2002, fq. 66.

dos që “shkrimi Shejtë apo libra të tjerë që trajtojnë gjëra feje e morali nuk mund të shtypeshin pa lejen e autoritetit kishtar”.¹³ Riza vjen në përfundim se për *Mesharin* e Buzukut një leje e tillë nga instancat eprore nuk ekzistonte, aq më pak një autorizim i tillë. Ai konsideron se Buzukut, një prifti të rangut të ulët, me njohuri modeste, me një përkthim shumë modest nga latinishtja, nuk do t’i besohej nga Kuria e Romës një punë aq e rëndësishme, si ishte përkthimi i teksteve liturgjike në shqip. Riza supozon t’i jetë dhënë ndonjë autorizim *in bianco* nga prefektët e Françeskanëve në Bosnjë apo në Kroaci, po meqenëse këtë supozim nuk e argumenton, mbetet të besohet se Buzuku e kishte botuar *Mesharin* e tij pothuajse me vetiniciativë, punë e cila, sipas Riza-jt, do të ketë qenë tepër e vështirë, duke filluar nga aspekti i legalitetit të botimit e deri te aspekti financiar.¹⁴

Në anën tjetër, në aspektin e ekzistimit të shtresës së intelektualëve, siç do të shohim më poshtë, të një shtrese të re patriotike të inteligjencies, shtrohet pyetja: si e pati atëherë Buzuku guximin, meqenëse ishte një punë fort e rëndë për individin pa një përkrahje të gjerë, t’i hyjë krye më vete një pune të tillë? Përgjigjen në këtë pyetje duhet kërkuar në një rrethanë tjetër: në fatin e vet librit *Meshari*. Është një fakt rastësor, po që mund të hedhë dritë mbi çështjen e shtruar. Në ledhoret e *Mesharit*, të vetmit ekzemplar të gjetur, ka disa anëshkrime, e të cilat supozohet të jenë të njerëzve që e kanë pasur në dorë ekzemplar in e *Mesharit* dhe sigurisht e kenë lexuar. Shuteriqi ka bërë një punë të mirë

13 Imzot Mark Sopi, *Koncilet Ekumenike*, Drita, Prizren, 2000, fq. 138. Këtë vendim e pati marrë Koncili i Lateranit si masë kundër shtypit heretik, i cili “filloi të përhapej me shpejtësi”. Në Koncilin e Trentos (1545-1563) u urdhërua hartimi i katalogut të ri me titujt e librave të ndaluar.

14 Selman Riza, *Vepra 4 / Pesë autorët më të vjetër...*, fq. 261-264.

në këtë drejtim, duke identifikuar anëshkrimet dhe autorët e tyre dhe ai ka ardhur në këto përfundime: në to gjejmë të paktën tre veta që e shkruajnë shqipen dhe “jo më pak se shtatë veta që e kanë pasur librin nëpër duar, pra që mund të thuhet se e lexonin atë dhe e përdornin sado kudo të shkruar”.¹⁵ Tash duhet të flasim për kohëzgjatjen e përdorimit të këtij ekzemplari, në mënyrë që të vijmë në përfundimin e dëshiruar.

Gjon Nikollë Kazazi (1702-1752), zbuluesi i *Mesharit*, sipas Mahmud Hysës, thotë se kopja e zbuluar ka qenë e grisur nga përdorimi i tepërt, ka shumë emra personalë të shkruar në ledhore, një provë alfabeti, shkrime të tjera etj.¹⁶ Ky fakt, i vërejtur prej Kazazit, dëshmon për përdorimin e madh të librit. Ta ndjekim tash kronologjinë e këtij ekzemplari:

më 1555 botohet libri;

më 1610 kryepeshkopi i Tivarit Marino Bici e gjen ekzemplar in e *Mesharit* në rrethin Laç-Kurbin-Muzhlli i Radonit dhe e konfiskon atë;

Marino Bici e dërgon ekzemplar in në Romë pas vitit 1611;

më 1740 e këtë ekzemplar gjen Gjon Nikollë Kazazi në Propagandën Fide.¹⁷

Siç shihet nga ky numërim i viteve, libri i zbuluar nga Gjon Nikollë Kazazi ka qarkulluar i lirë 55 vjet. Në këto pesëdhjetepesë vjet, e kanë pasur në dorë apo lexuar, së paku shtatë veta. Ne mund të supozojmë

15 Dhimitër S. Shuteriqi, *Tekstet shqipe...*, fq. 146.

16 Prof. Dr. Mahmud Hysa, *Hyrje në letërsinë shqiptare, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës*, 2000, fq. 137.

17 Viti 1740 në historinë shqiptare merret si vit i zbulimit të *Mesharit* prej Gjon Nikollë Kazazit, edhe pse studiuesi i tij Bardhyl Demiraj e konteston këtë vit duke caktuar vitin 1743. Shih: Bardhyl Demiraj, *Gjon Nikollë Kazazi dhe „Doktrina“ e tij*, ASHAK, Prishtinë, 2006, fq. 126-127.

sot se jo çdo lexues i këtij ekzemplari është nënshkruar ledhoreve të librit, pra mund të ketë pasur më shumë lexues të këtij ekzemplari.

Përmbyllje për lexuesit e parë të Mesharit:

Sidoqoftë, këto fakte dëshmojnë se libri i Buzukut ka qarkulluar nëpër lexuesit e vet, kryesisht priftërinj shqiptarë apo priftërinj që kanë shërbyer në tokat shqiptare. Vjetërsia e ekzemplarit të gjetur, përveç shkaqeve që përmend S. Riza¹⁸, në radhë të parë ka të bëjë me përdorimin e madh të tij, jo vetëm si libër për lexim, por edhe si tekst meshe në kishat katolike shqiptare. Lexuesit e parë të tekstit shqip, të deshifruar deri më tash janë: famullitari Dom Gjon i Laçit, vikari Dom Gjergj Bardhi, i mbiquajtur Maqedoni (dmth. Shqiptari, sipas kohës), Dom Primo Kola, Kola Kuçi dhe famullitarët Marku, Pjetri dhe Nikolla (të cilët, sipas një relacioni të Marino Bicit janë priftërinj të atyre rretheve).¹⁹

Emrat e deshifruar të lexuesve të parë të tekstit shqip dëshmojnë se në Shqipëri kishte një elitë lexuesish të teksteve, jo vetëm latinisht, por edhe shqip. Kjo elitë nuk ishte sikurse ajo e kohës paraosmane, ishte e një klase më të ulët, kryesisht klasë e priftërinjve, po është e rëndësishme se qenësonte dhe punonte, e kështu do ta mbajë të pashkëputur vazhdimësinë e literaturës shqipe, krijues i së cilës qe Dom Gjon Buzuku.

18 Vjetërsinë e Mesharit të Buzukut S. Riza e sheh ekskluzivisht si pasojë e moskujdesjes së Propagandës Fide ndaj ekzemplarit të gjetur, për shkak të botimit të saj pa autorizimin e Romës, e si pasojë ajo ishte marrë jo nga ndonjë bibliotekë manastiri, por nga ndonjë person privat. Shih: Selman Riza, Vepra 4 / Pesë autorët më të vjetër..., fq. 260 dhe 265.

19 Dhimitër S. Shuteriqi, Tekstet shqipe..., fq. 142-143.

I. 2. Autorët e vjetër dhe “elita” e inteligjencies

Buzuku e ka theksuar vetë, në fund të *Mesharit*, modestinë e tij në shkrimin e një libri. Ai thotë se shkroi “për sa mujta me ditunë” dhe

“në keshë kun mbë ndonjë vend fëjyem, u duo tuk të jetë fajtë, ai qi të jetë ma i ditëshim se u, ata faj e lus ta trajtonjë nde e mirë.”²⁰

Buzuku, i pari shkrimtar në shqip, na bën me dije, sado tërthorazi, se mund të ketë njerëz të tjerë më të ditur se ai në çështje të meshës e të përkthimit, në çështje të gjuhës shqipe etj., e të cilët mund të gjejnë gabimet e tij dhe u kërkon falje paraprakisht.

Pjetër Budi (1566-1622) ankohet në dy raste dhe akuzon tërthorazi ata që kanë mundur të shkruajnë libra shqip më mirë se ai, Budi, po nuk e kanë bërë atë:

“...e aqë ma tepërë do letërorë e të mëdhenjë dies që letërenë e dinë e pak frujt me ta kallëzonjënë; e se ndë dashnë ashtu gjakafshë me bam o me kallëzuom, e ata herë cë keqe cë tynet së banjënë ndonji qi të ban një e të shtij ndë det o të ndonjë tjetëri që të shpijte vobëzinë e vet me e falë ndë kurt të t’begatëvet, ke zyrë e nevojë s’ashtë as për nder s’i quhetë, e vëllazënitë e gjeninë e vet i le me u vdierrë n zie e unie e n githë duorshi cë nevojëvet.” (*Pasëqyra e t’Rëfyemit* (1621), Të rekomenduem e të porësitunë...) ²¹

Budi, pra, flet qartë për njerëz të ditur, më të ditur se vetë ai, e të cilët nuk prodhojnë letërsi (në kuptimin budian), por edhe nëse prodhojnë e bëjnë atë në gjuhë të huaja, duke u sjellë kështu të mira gjuhëve e popujve të tjerë, ku sështë nevoja dhe nuk kujdesen për të mirën e gjuhës shqipe, të kishës shqiptare e të popullit shqiptar. Këto fjalë

20 Eqrem Çabej, *Meshari i Gjon Buzukut*, II, botim kritik, USHT, Tiranë, 1968, fq. 387.

21 Selman Riza, *Vepra 4 / Krestomaci*, ASHAK, 2004, fq. 542.

Budi i ka shkruar në vitin 1621, në kohën kur inteligjencia shqiptare ishte rikrijuar, porse ende ndërdyhej midis latinitetit të kaluar, shqipes kërthi dhe osmanishtes si kërcënim.

Frang Bardhi (1606-1643) ankohet, po ashtu në intelektualët e kohës që mundën ta ndihmojnë gjuhën shqipe po nuk e bënë:

“Pëse veçë dy kafshë (të dashunitë e mi) më shtynë e më nxitnë me u fëdigunë e me nkëthyem këtë librëzë: e para kjo me shtim beleg gjithë atyne qi mundnjënë me nkëthyem ndonjë copë librë për ndimët të fesë e të dorësë sanë...” (*Dictionarium latino-epiroticum* (1635), *Gjithë atyne t'Arbëneshëve...*).²²

Edhe Frang Bardhi dëshmon se te shqiptarët kishte një klasë të inteligjencies, e cila nuk kujdesej sa duhet për nevojat e kishës shqiptare, të gjuhës shqipe e të atdheut. Me *Fjalorin* e tij, Bardhi i sfidon ata.

Me Pjetër Bogdanin (1630-1689) merr fund ky animozitet i elitës intelektuale ndaj rrezikimit të fesë katolike te shqiptarët, të gjuhës shqipe e të etnikumit shqiptar. Bogdani shkroi një libër, *Cuneus Prophetarum* (1675-1685), vepra e parë tërësisht origjinale, vepër e çmueshme, për kulturën shqiptare dhe për kulturën evropiane në përgjithësi.²³ Ai shkroi një vepër universale, sipas modelit të Biblës²⁴ dhe është krijuesi i cili tërë intelektin e tij të lartë e vuri në shërbim të fesë katolike e të popullit shqiptar.²⁵ Sipas dëshmisë së Dhimitër Shuteriqit, Bogdani i ka njohur të gjithë librat e botuar para tij në shqip, edhe më shumë

22 Franciscus Blanchus, *Dictionarium latino-epiroticum*, Me parathënie nga Mario Roques, Çabej, Tiranë, 2006, fq. VI. Këtu cituar sipas transkriptimit të S. Riza, Vepra 4 / Krestomaci, fq. 578.

23 Ibrahim Rugova, Vepra e Bogdanit, Rilindja, Prishtinë, 1990, fq. 66-67.

24 Ibrahim Rugova, Vepra e Bogdanit, fq. 75.

25 Ibrahim Rugova, Vepra e Bogdanit, fq. 83.

ai i ka propozuar Propagandës Fide për t'i ribotuar, mirëpo kjo nuk e kishte pranuar këtë ide.²⁶

Me Bogdanin ndodh edhe një kthesë tjetër e rëndësishme: është krijuesi i parë shqiptar që flet për gjuhën, jo vetëm si shenjë dalluese ideologjike e etnike, por edhe për përmasën e të bukurit të gjuhës shqipe. Në këtë kuptim, Bogdani është shkrimtari i parë shqiptar që shkruan, jo vetëm për nevoja të tjera jashtëletrare, por thjesht për shkak të bukurisë së gjuhës, të fjalëve dhe thërret lexuesin ta shijojë këtë bukuri të fjalës:

“Ashtu ende prej meje bukurijn’ e gjuhësë nuk’ e ke ndjerë nd’anet.”

Dhe

“...as gjan’ mangut t’lumit qi leu nde Grasht, e duiq mbe kryjt, nukë ka me i ndym mbarre, ende Arbenisht meu veshiune nde nji dhe te vobek, çperblem me gjak të vet të pa çmuemit.”²⁷

Në përputhje me këtë koncept për të bukurit e gjuhës, Bogdani është i pari shkrimtar shqiptar që flet për lexuesit e veprës. Shkrimtarët e mëhershëm shkruanin librat për nevojat e kishës e të popullit, ndërsa Bogdani, përveç këtyre nevojave, i drejtohet lexuesit, *xgedhësit*, dhe nevojave e kërkesave të mundshme të tyre për leximin e librit.

Mbi bazë të këtyre fakteve mund të përfundojmë:

Mbas përfundimit të shekullit të parë kritik të sundimit osman dhe shpërbërjes së ndjeshme të traditës latiniste gjatë shekullit XVI, në fund të këtij shekulli dhe në fillim të shekullit XVII inteligjencia shqiptare e orientimit perëndimor (katolik) rikonsolidon pozicionet e veta kulturore e sociale, edhe pse kurrë më si në periudhën paraosmane.

26 Dhimitër S. Shuteriqi, *Tekstet shqipe...*, fq. 108.

27 Pjetër Bogdani, *Çeta e Profetëve*, “Te primite perpara letterarit”, botim i Sedajt, Prishtinë, 1989, fq. 88.

Në shekullin XVII, jo vetëm që ka autorë shqiptarë, që shkruajnë libra shqip e latinisht (mbase edhe sllavisht, siç thotë në një vend Budi²⁸), por ka edhe lexues të shumtë të këtyre teksteve, që i përdorin ato, qoftë për nevoja të veta intelektuale e fetare, qoftë për nevoja të kishës shqiptare.

Kjo klasë e re e inteligjencies përbëhet kryesisht prej priftërinjve e nga radhët të tyre dalin autorët e parë të letërsisë shqipe dhe lexuesit e parë të saj. Letërsia e tyre është e motivuar nga shtytës fetarë e gjuhësorë-etnikë dhe nuk është letërsi sipas kuptimit të sotëm të kësaj fjale, por në pjesën më të madhe është në përputhje me kuptimin që ka pasë fjala letërsi në Mesjetë.

I. 3. Çështje të përkufizimit dhe të nocionit për letërsinë e autorëve të vjetër të Veriut

Eqrem Çabej e përkufizon letërsinë e autorëve të vjetër të Veriut si *lëvizje mendore*:

“Fakti që këta nuk janë një e dy, po përbëjnë një varg burrash të pendës, na dëshmon se aty nuk kemi një dukuri kulturore sporadike, po kemi të bëjmë me një lëvizje mendore”²⁹

Studiuesi i mirënjohur shqiptar Dhimitër Shuteriqi e quan *letërsi të vjetër*, duke përfshirë brenda këtij emërtimi edhe letërsinë e hershme të arbëreshëve të Italisë, letërsinë biblike të shekujve XVIII në Jug,

28 Pjetër Budi, Letër për Kardinalin Gocadinos, relacion i 15 shtatorit 1621 (cituar sipas Rexhep Ismajli, Tekste të vjetra, Dukagjini, Pejë, 2000, fq. 155.

29 Eqrem Çabej, Studime gjuhësore VI / Pjetër Budi dhe gjuha e tij, Rilindja, Prishtinë, 1977, fq. 315.

letërsinë e bejtexhinjve.³⁰ Studiuesi tjetër i kësaj letërsie Dr. Mahmud Hysa e emërton këtë periudhë si *neoklerikalizëm në letërsinë shqipe*, duke ndërlidhur me letërsinë klerikale në Evropë në shekujt II-XIV.³¹ Këtë veprimtari fetare e letrare të shkrimtarëve të vjetër katolikë Zija Xholi e quan *Lëvizje kulturore* “me tendenca humaniste e atdhetare”.³² Ndërsa studiuesi Sabri Hamiti, duke u nisur nga fakti se prodhimet letrare të Buzukut, të Budit, të Bardhit e të Bogdanit nuk janë thjesht dokumente letrare, porse vepra letrare, angazhohet që ky prodhim letrar dhe koha kur u shkruan ato të përkufizohet si periudhë letrare me një sistem të caktuar letrar.³³

Pa dashur të merremi me mungesën e një nocioni të qëndrueshëm në historinë e letërsisë shqipe rreth kësaj periudhe letrare, është e rëndësishme që studiuesit kryesor të kësaj letërsie pajtohen që, përveç dokument letrar, ky prodhim letrar, në radhë të parë është letërsi dhe së dyti, ky prodhim letrar, bashkë me kohën kur u shkrua dhe me autorët e saj, paraqet një periudhë letrare, me një sistem të caktuar letrar. Duhet vetëm të theksohet se janë tri emërtime më të përhapura e më të qëndrueshme për këtë letërsi:

Letërsia e Qarkut Katolik të Shqipërisë Veriore (Eqrem Çabej).³⁴

Letërsia e vjetër shqiptare (Historia e letërsisë shqiptare, 1983);

Letërsia filobiblike (Sabri Hamiti)

30 Dhimitër S. Shuteriqi te Historia e letërsisë shqiptare, (1983), cituar sipas botimit të Rilindjes të vitit 1989 dhe te Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 870-1800.

31 Dr. Mahmud Hysa, Hyrje në letërsinë shqiptare, fq. 131.

32 Zija Xholi, Pesë mendimtarët më të vjetër të kulturës sonë kombëtare, ASHSH, Tiranë, 2003, fq. 68.

33 Sabri Hamiti, Studime letrare, ASHAK, Prishtinë, 2003, fq. 53.

34 Eqrem Çabej, Studime gjuhësore V / Për gjenezën e literaturës shqipe, Rilindja, Prishtinë, 1975, fq. 135.

Emërtimi i Çabejt, më i vjetri (publikuar në *Hylli i Dritës*, në disa numra, 1938-1939, në studimin e njohur *Për gjenezën e literaturës shqipe*) shënjon strukturën e shoqërisë ku është krijuar dhe lexuar kjo letërsi (Qarku Katolik) dhe vendin gjeografik (Shqipëria Veriore). Që të dy këta shënjes janë qenësorë për këtë letërsi. Emërtimi që përdoret në *Historinë e letërsisë shqiptare* (ASHSH, 1983), **letërsia e vjetër shqiptare**, te pjesa me të njëjtin emër, e shkruar nga Ali Xhiku, nën redaktimin e Dhimitër Shuteriqit, ka vetëm një shënjes: kohën kur është krijuar kjo letërsi, kohë kjo e përdorur në marrëdhënie me letërsinë tjetër shqiptare. Emërtimi i tretë, **letërsi filobiblike**, i përdorur nga Sabri Hamiti ka një shënjes, shënjesin tematik të kësaj letërsie.

I. 4. Autorët e vjetër dhe ndikimi i tyre në rrjedhën e letërsisë shqipe

Shekujt XVII dhe XVIII. Zbulimi i *Mesharit* të Buzukut (1740) nga Gjon Nikoll[Kazazi (edhe pse disa arbëreshë, pohon Shuteriqi, kanë ditur për *Mesharin* edhe në shekullin XVII), i cili ia bëri këtë të njohur Giorgio Guzzettas (Sicili), heshtja e tij e sërishme dhe rizbulimi i sërishëm nga Xhuzepe Krispi më 1853, i cili e përmend letrën e Kazazit për Guzzettan dhe heshtja e sërishme, derisa më 1910 e rizbuloi Paolo Schiro dhe ia bëri të njohur botës shqiptare përmes një publikimi në gazetën shqiptare *Dielli* të Bostonit³⁵, tërë kjo histori zbulimesh e rizbulimesh dhe heshtjesh të sërishme kanë paragjykuar një farë besimi për fragmentarizmin e letërsisë së shekujve XVI e XVII. Dyshohet se ky fragmentarizim shtrihet edhe në planin kohor, pra se ka një shkëputje

35 Dhimitër S. Shuteriqi, *Tekstet shqipe...*, fq. 114.

në kontinuitetin e letërsisë shqiptare midis fillimit të saj dhe periudhës së famshme të Rilindjes Kombëtare.

Ky paragjykim bartë diçka të vërtetë në vete, po megjithatë, nuk mund të argumentohet asnjëherë si gjykim i drejtë. Në fillim të këtij kapitulli ne dëshmuam se qysh në gjysmën e dytë të shekullit XVI, jo vetëm që kishte shkrimtarë librash shqip, por kishte edhe lexues të tyre të shumtë. Nuk dimë nëse Budi ka pasur njohuri për *Mesharin*³⁶, por supozohet me të drejtë që Frang Bardhi, i cili kishte zëvendësuar Budin e ndjerë në Ipeshkëvinë e Sapës e të Sardës (Zadrime), duhej ta njihhte veprën e Budit. Frang Bardhi në apologjinë e vet për Skënderbeun (*Gjergj Kastrioti i Epirit, i quajtur përgjithësisht Skënderbe, vetë princi i fuqishëm e i pathyeshëm i Epirit i kthehet popullit dhe vendit të tij*, 1636) i citon Marin Barletin dhe Marin Beçikemin, ndërsa Bogdani është dëshmuar se njihnte të gjitha veprat e botuara në shqip përpara tij.³⁷

Gjithashtu, fatin e Mesharit nuk e kishin ndjekur librat e Budit, ato që janë botuar. *Doktrina e Kërshtenë* e tij u botua për herë të parë më 1618, u ribotua më 1636, u ribotua përsëri më 1664, për herë të katërt u botua më 1868 (nuk po përmendim botimet e shekullit XX e këndej). Plot dyqindpesëdhjetë vjet libri është botuar dhe ribotuar, është lexuar dhe, mbase është përdorur si libër shkollor për shkollat shqipe të misionarëve katolikë të veriut.³⁸ Po ashtu, edhe vepra e Bogdanit *Çeta e Profetëve* pati disa botime: u shkrua më 1675, ndërsa u botua më 1685,

36 Selman Riza konsideron se Budi është dashur ta njihnte veprën e Buzukut, pasi kishte shërbyer për shumë vite në Kosovë, ku kishte mundur ta gjente në ndonjë kishë. Këtë konsideratë Riza e mbështetë në faktin se Budi ndjek traditën e sistemit grafik latin për gjuhën shqipe të krijuar nga Buzuku. Shih më gjerësisht te vepra e S. Rizës *Vepra 4 / Pesë shkrimtarët më të vjetër...*, fq. 348-349.

37 Dhimitër S. Shuteriqi, *Tekstet shqipe...*, fq. 108.

38 Kështu mendojnë dhe argumentojnë shumë studiuesë, si Dh. Shuteriqi, Selman Riza, Stuart Man etj.

u botua për herë të dytë më 1691 dhe për herë të tretë më 1702 (nuk po përmendim botimet e shekullit XX e këndej).

Shtrohet pyetja: pse do të bëheshin gjitha këto botime po të mos kishte lexues që do t'i përdorte këta libra? Natyrisht që kjo letërsi ka pasur lexuesit e vet gjatë tërë kohës e deri në fillim të Rilindjes Kombëtare Shqiptare, kur u krijua letërsia kombëtare.

Shkollat e vjetra shqipe. Është një fakt tjetër që hedh dritë në leximin e kësaj letërsie gjatë shekujve: shkollat shqipe dhe mësimet e dogmës fetare nëpër kisha në gjuhën shqipe. Shuteriqi na njofton se në një relacion të njohur të vitit 1633, kryepeshkopi i Tivarit Pjetër Mazreku Plaku njoftonte eprorët e tij se

“këto tetë vjet, pra që më 1625, është dhënë (prej tij) urdhri, që famullitarët, secili në famullinë e vet, të kujdesen për t’u mësuar fëmijëve këndimin dhe të nxënë Doktrinën e Krishterë”. Ndër shqiptarët, vazhdon komentin Shuteriqi, mësimi duhej të bëhej me *Doktrinën* e botuar nga Pjetër Budi më 1618.³⁹

Po ashtu, Shuteriqi përmend shumë shkolla (fetare) ku mësimi është bërë në gjuhën shqipe, që nga Himara e Durrësi e deri te Janjeva, në kohë që nga viti 1629 (një shkollë e Benedetto Orsinit në Dioqezin e Lezhës). Nëpër këto shkolla shqipe supozohet me të drejtë se është mësuar kryesisht prej librave të Budit. Edhe Behar Gjoka, një studiues tjetër i Budit e trajton këtë çështje dhe vjen në të njëjtat përfundime.⁴⁰

Nga ky informacion i shumtë për mësimin në shqip të dogmës katolike nëpër shumë shkolla shqipe e në kishën katolike shqiptare, gjatë

39 Dhimitër S. Shuteriqi, *Tekstet shqipe...*, fq. 163-164.

40 Behar Gjoka, *Poetika e Budit, Albas, Tetovë-Tiranë*, 2002, fq. 183-190.

një periudhe kohore më shumë se dy shekuj, mund të përfundojmë me plot të drejtë se letërsia e shkrimtarëve katolikë të shekullit XVII, jo vetëm që nuk mbeti e fragmentuar, përkundrazi, ajo u botua disa herë dhe u lexua e u mësua në një pjesë të madhe të hapësirës gjeografike shqiptare, në strukturat katolike të shoqërisë. Por, mund të përmendim edhe një lloj tjetër të kufizimit të kësaj letërsie: ajo qarkullonte, lexohej e mësohej vetëm në strukturat katolike të shoqërisë shqiptare, deri te Rilindja Kombëtare, kur u bë e njohur dhe e absorbueshme prej gjithë shqiptarëve. Pavarësisht prej faktit se Bardhi dëshmon në një relacion të tij se “me predikimin e ipeshkvit në gjuhën epirote aty pranë popullit, ku shpesh merr pjesë një turmë e madhe turqish”⁴¹, që do të thotë se në meshë merrnin pjesë shpesh edhe shqiptarët e besimit islam, e si rrjedhim edhe ata kanë komunikuar në një mënyrë me këtë letërsi, megjithatë kufizimi i saj vetëm te struktura katolike e shoqërisë e përlligjë ndarjen që Çabej i bën historisë së zhvillimit të letërsisë shqipe në periudhën para Rilindjes Kombëtare.⁴²

Njohja e kësaj letërsie është dëshmuar shumë më fuqishëm në një korpus tjetër shqiptar: te arbëreshët e Italisë. Nilo Katalano (1637-1694), një nga leksikografët më të hershëm arbëreshë, autor i një fjalori italisht-shqip dhe shqip-italisht dhe mbledhës i parë i këngëve popullore arbëreshe, të njohura me emrin *Kënkëzë pleqrijsë* (midis viteve 1685-1693), jo vetëm që njihte veprat e shkrimtarëve të vjetër të Veriut, por edhe ndikohej prej tyre. Matteo Mandala thotë se fakti që Katalano përdorë fjalën *barkut sit* në kuptimin *pjella e saj* në vend të shprehjes

41 Frang Bardhi, *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shek. XVII*, cituar sipas Z. Xholit, *Pesë mendimtarët më të mëdhenj të kulturës sonë kombëtare*, fq. 130.

42 Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore, V / Për gjenezën e literaturës shqipe*, fq. 135.

shkëf-i, që është një fjalë tipike e ligjëritimit fetar-poetik arbëresh, tregon:

„...se sa shumë qe familjarizuar Katalano me veprat e autorëve të vjetër gegë. Kjo nga ana tjetër konfirmon faktin që njohja e shqipes nga Katalano varej shumë prej studimit të këtyre veprave e, në mënyrë të veçantë prej *Cuneus prophetarum* të Bogdanit, e cila, jo rastësisht, ngjalli një interesim të madh edhe tek autorët e tjerë sikulo-arbëreshë, mes të cilëve duhet përmendur pa tjetër Nikollë Keta.“⁴³

Shekujt XIX dhe XX. Në shekullin e XIX, me fillimin e Rilindjes Kombëtare kapërcehet kufiri katolik i letërsisë shqipe të shekujve XVI e XVII. Kjo letërsi absorbohet prej gjithë inteligjencies shqiptare, kudo që është. Sami Frashëri (1850-1904) i jep një vend të rëndësishëm në enciklopedinë e vet turqisht⁴⁴ Budit dhe Bogdanit, në fushën e shkrimit të gjuhës shqipe. Jani Vreto (1820-1900) në librin *Apologji* (Konstantinopojë, 1878) dhe në shkrimin *Udhë e të shkruarit të gluhësë shqip* (1879)⁴⁵, ku bën historikun e shkrimit shqip, një vend meritore ua jep veprave të Budit e të Bogdanit.⁴⁶ Shkrimtarët paralajmërues të Rilindjes Kombëtare, si quhen në *Historinë e letërsisë shqipe*, si Pjetër Zarishi, Leonard de Martino, Zef Jubani, Anton Santori e Zef Serembe, sjellin tema e motive të reja në letërsinë shqipe, “sado që edhe këta një këm-

43 Matteo Mandala, Gjurmime filologjike për letërsinë e vjetër arbëreshe, Çabej, Tiranë, 2006, fq. 358.

44 Enciklopedia është vepra kapitale e Sami Frashërit në turqisht dhe vepër kapitale për kulturën dhe historinë e Turqisë. Titulli i veprës është Kamus al ‘alam (Fjalor i botës), Konstantinopojë, 1889-1896.

45 Robert Elsie, Historia e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Pejë, 2001, fq. 188.

46 Zija Xholi, Pesë mendimtarët më të mëdhenj..., fq. 98.

bë e patën në traditën e letërsisë së vjetër”.⁴⁷ Çabej supozon se Naim Frashëri mund t’i ketë njohur poezitë e Budit⁴⁸ dhe, edhe ky, po edhe Rexhep Ismajli⁴⁹ e Behar Gjoka⁵⁰ thonë se tetërrokëshi i Budit është i afërt me atë të Naimit, po edhe gjashtëmbëdhjetërrokëshi i Budit është i afërt me atë të Naimit. Zija Xholi bën një lidhje më të gjatë ndikimesh: e vë Budin të ndikuar nga Barleti, ndërsa Naim Frashërin të ndikuar nga Budi.⁵¹ Ndërsa studiuesi i mirënjohur Sabri Hamiti, afrinë e Budit me De Radën përmes numërimit të zanoreve të gjata si dyrrrokësh dhe afrinë me Naimin përmes vendit të theksave tonikë në varg, të hetuar më herët nga Henrik Lacaj e Rexhep Ismajli, e quan ndikim:

“kjo do të thotë se praktika e tij krijuese u bë prodhuese dhe u trashëgua në poezinë shqipe”.⁵²

Ndërsa ndikimi i Bogdanit është shumë më i fuqishëm, veçanërisht te Lasgush Poradeci. Poezia *Vallja e përjetësisë* e Poradecit është e ndikuar nga *Krijimi i Rruzullimit* e Bogdanit, thotë Sabri Hamiti:

“Dhe në këtë kuptim, në çështjet e kosmogonisë poetike Lasgushi është poeti shqiptar, që lidhet drejtpërdrejt me Pjetër Bogdanin”.⁵³

Të njëjtin vlerësim për ndikimin e Bogdanit te Poradeci e ka edhe Ibrahim Rugova në veprën e vet për Bogdanin.⁵⁴

Siç shihet nga këto informacione, shkrimtarët dhe jo vetëm ata, por inteligjencia krijuese shqiptare në përgjithësi, kishte hapur dyert në

47 Historia e letërsisë shqipe, Rilindja, Prishtinë, 1989, fq. 112 (sipas botimit të ASH të RPS të Shqipërisë, 1983).

48 Eqrem Çabej, Studime gjuhësore VI, Rilindja, fq. 323.

49 Rexhep Ismajli, Tekste të vjetra, Dukagjini, Pejë, 2000, fq. 142.

50 Behar Gjoka, Poetika e Budit, fq. 135-141.

51 Zija Xholi, Pesë mendimtarët më të mëdhenj..., fq. 87.

52 Sabri Hamiti, Studime letrare, fq. 48.

53 Sabri Hamiti, Studime letrare, fq. 60.

54 Ibrahim Rugova, Vepra e Bogdanit, fq. 219 dhe 220.

letërsinë e shekujve XVI-XVII dhe kishte hyrë brenda saj, kishte filluar jo vetëm ta shijonte, po edhe të ndikohej prej saj. Ky fakt tregon më së miri rrezatimin e kësaj letërsie të vjetër e themeltare të letërsisë shqipe dhe ky fakt vetvetiu zhvleftësonte gjykimet jo të drejta dhe ideologjike për këtë letërsi, si në *Historinë e letërsisë shqipe* (1983), ku thuhet se vlera e kësaj letërsie është se luajti rolin e hallkës me Rilindjen Kombëtare në ruajtjen e gjuhës shqipe në kushtet e orvatjeve intensive asimiluese të pushtuesit osman.⁵⁵

Poende, kjo letërsi do të rrezatojë edhe më shumë në gjysmën e dytë të shekullit XX, atëherë kur studiuesit më eminentë shqiptarë e albanologë të huaj u morën me të, ndërsa shkrimtarët e poetët krijuan kultin për autorët tanë të vjetër dhe për veprat e tyre.

Paralajmëruesit e Rilindjes Kombëtare. Në librin e tij *Pesë mendimtarët më të vjetër të kulturës sonë kombëtare* (2003) Zija Xholi ka ritheksuar një fakt: me disa prej parimeve të tyre filozofike, morale e krijuese Barleti, Buzuku, Budi, Bardhi e Bogdani janë paralajmërues të Rilindjes Kombëtare. Sipas tij Barleti ka mbështetur vetëdijen dhe ndërdijen e shqiptarëve në disa premisa morale, sidomos në *Rrethimin e Shkodrës* (Venedik, 1504), si: formësimi i idesë së popullit shqiptar dhe i idesë së atdheut, lashtësia e etnikumit dhe origjina mitologjike e tij, njerëzit e shquar të së kaluarës, si Leka i Madh, Pirro etj., idealizimi i Shqipërisë (jo për mburrje) për të ngjallë dashurinë ndaj saj etj.⁵⁶ Buzuku, me idealet e tij krijuese, shkrimin e gjuhës shqipe dhe përhapjen e saj, arsimimi i shqiptarëve dhe shpëtimi i atdheut, “do të

55 Historia e letërsisë shqipe, botimi i Rilindjes, fq. 47.

56 Zija Xholi, *Pesë mendimtarët më të mëdhenj...*, fq. 43-49.

vërë bazën e çdo lëvizje kulturore të mëvonshme”.⁵⁷ Budi do të krijojë kultin për Patrian (Arbënia), kultin për fenë, kultin për gjuhën shqipe, idealizimin e natyrës së Shqipërisë, rikthimin e historisë së lavdishme, hapjen e shkollave shqipe etj.⁵⁸ Ndërsa Bogdani në këtë drejtim do të jetë më i frytshëm: vazhdoi me kultin e atdheut (Arbënia), kultin e dijes e përhapjes së saj, kultin e gjuhës, kultin për të kaluarën historike të shqiptarëve, krijimin e neologjizmave dhe gjetjen e fjalëve të vjetra shqipe, daljen jashtë rrethit të të folurit dialektor, vënien e teologjisë në shërbim të atdheut etj.⁵⁹

Zija Xholi e heton këtë lidhje, kryesisht të sferës filozofike, morale e krijuese, po ai nuk hulumton edhe lidhjet e teksteve letrare dhe kënaqet vetëm me konstatimin e këtyre lidhjeve. Pavarësisht nga mosthëllimi i Xholit në detajizimin e konstatimeve të tij, vënia e kësaj lidhjeje midis letërsisë së shekujve XVI-XVII dhe letërsisë së periudhës së Rilindjes Kombëtare është një zbulim i çmuar. Të gjithë historianët e letërsisë shqipe rikthimin e romantikëve në të kaluarën e lavdishme historike e kanë parë vetëm si ndikim nga romantizmi evropian. E vërteta është se të gjithë autorët e vjetër të Veriut kanë krijuar kultin për të kaluarën e lavdishme shqiptare (macedone, epirote) dhe se ky kult më shumë është trashëguar te rilindësit tanë prej tyre sesa prej romantizmit evropian.

Mirëpo për ne, në këtë shqyrtim, është me interes të konstatojmë lidhjet e letërsisë filobiblike me letërsinë e mëpastajme shqiptare (leximi i librave të autorëve tanë të vjetër dhe mësimi i tyre nëpër shkol-

57 Zija Xholi, Pesë mendimtarët më të mëdhenj..., fq. 71-73.

58 Zija Xholi, Pesë mendimtarët më të mëdhenj..., fq. 84-85, 94, 109, 115.

59 Zija Xholi, Pesë mendimtarët më të mëdhenj..., fq. 156, 157, 159, 161, 162, 189.

la e nëpër kisha), veçanërisht me letërsinë e periudhës së Rilindjes Kombëtare (shkrimtarët që qëndrojnë me një këmbë te letërsia filobiblike dhe me tjetrën te letërsia e Rilindjes, ndikimet e drejtpërdrejta te shkrimtarët e Rilindjes dhe ndikimet në sferën e filozofisë, në atë morale e krijuese te autorët e Rilindjes).

Sidoqoftë ne mund t'i konstatojmë këto lidhje te njëri prej poetëve më të mëdhenj të letërsisë shqipe, Gjergj Fishta.

II. NDIKIMET E SHKRIMTARËVE TË VJETËR TË VERIUT NË VEPRËN E FISHTËS

Pasi konstatuam ndikimin mjaft të gjerë të letërsisë së shkrimtarëve të vjetër katolikë në gjithë rrjedhën e letërsisë shqipe, fillimisht brenda strukturës katolike të shoqërisë shqiptare (gjysma e parë e shek. XVII, shek. XVIII dhe gjysma e parë e shek. XIX), e më pastaj në gjithë letërsinë shqiptare (letërsia e periudhës së Rilindjes Kombëtare dhe letërsia e mëpastajme), mund të hetojmë një ndikim shumë më të madh të Gjergj Fishta. Ky ndikim më i madh paragjykohet për dy arsye: së pari, vetë Fishta që prelat, i shkolluar për të shërbyer në kishën katolike shqiptare, po shkroi edhe për kishën edhe letërsi të mirëfilltë, njësoj si shkrimtarët e vjetër katolikë; së dyti, Fishta është një prej majave letrare shqiptare dhe si i tillë, ka absorbuar më shumë se të tjerët, jo vetëm nga letërsia e shkrimtarëve të vjetër katolikë, por edhe nga gjithë letërsia.

Lidhjen e veprës së Fishtës me letërsinë e autorëve tanë të vjetër e kanë vërejtur edhe studiues të tjerë. Me të drejtë Aurel Plasari konstaton:

“Kjo është arsyeja kryesore për të cilën ngulmoj se vepra shkrimtarore e Gjergj Fishtës nuk mund të kuptohet si duhet pa u inkuadruar së pari në këtë qark”.⁶⁰

60 Aurel Plasari, Gjergj Fishta dhe historia e letërsisë, në Hylli i Dritës, numër i posaqëm, Tiranë, 1996.

II. 1. Njohja e Fishtës me letërsinë e shkrimtarëve të vjetër të Veriut

Fishta nuk i ka lënë lexuesit të sotshëm të dhëna detajzuese në lidhje me letërsinë e shkrimtarëve të vjetër katolikë. Në disa shkrime të tij publicistike dhe letrare, në të cilat Fishta trajton çështje të ndryshme të kulturës, të letërsisë, të fesë e të politikës, ai përmend shkrimtarët e vjetër të Veriut dhe veprat e tyre.⁶¹ Afërmendsh se do t'i ketë njohur ato, përderisa bashkëkohësi i tij Lasgush Poradeci ngazëllehej me veprën e Bogdanit, poeude polemizonte me disa mendime të Bogdanit në shtypin e kohës.⁶² Nga ato shkrime shihet se Budin e njëjtte mirë Fishta, edhe pse nuk është i saktë për vitin e botimit të *Doktrinës së Kërshtenës*:

“...Pjeter Budi, veshë e stolisë me vjerrsha shqype të hiejshme disa ndolli ma në shej të historis Shejte e disa nder te verteta te fes kristjane, e i boton vjetin 1664-mos ma para”⁶³

Shihet se Fishta ka pasur në dorë botimin e *Doktrinës* të vitit 1664, porse ai hamendet mos libri ka pasur edhe ndonjë botim më të hershëm, por nuk di për botimin e 1618-tës. Por, është me rëndësi ndarja që Fishta u bën vjershave të Budit në vjersha me temë “disa ndolli ma në shej të historis Shejte” dhe në vjersha me temë “te verteta te fes kristjane”.⁶⁴ Në grupin e parë ai futë vjershat me temë të pastër biblike dhe në grupin e dytë vjershat personale dhe të rastit, ndarje e cila është prezente dhe e qëndrueshme në historinë e letërsisë shqipe. Edhe në

61 Shkrimi Nji atentat shurdhë, botuar në HYLLI I DRITËS, 1930, nr. 12, fq. 641-649; shkrimi Vjerrsha heroike shqyptare, botuar në HYLLI I DRITËS, 1935, nr. 4, fq. 142-152. Shih edhe: Fishta, Estetikë dhe kritikë (përgatitur nga Persida Asllani), HD&SHL, Tiranë, 1999.

62 Sipas S. Hamitit, Studime letrare, fq. 60.

63 Fishta, Estetikë e kritikë (Persida Asllani), HD&SHL, Tiranë, 1999, fq. 96.

64 Fishta, Estetikë e kritikë, fq. 96.

një rast tjetër, në shkrimin polemist *Vierrsha heroike shqiptare* Fishta diskuton për vargun tetërokësh të Budit.⁶⁵

Duket se Fishta e ka njohur më mirë dhe e ka pëlqyer më shumë veprën e Bogdanit. Nga shënimet që ka lënë, shihet se ai e ka përpunuar mjaft mirë veprën e Bogdanit dhe e çmon atë jo vetëm në aspektin shkencor e filozofik (“naltsija e argumentit”), po edhe në aspektin e universalizmit të saj (“hapsija e dijes e e njoftimevet të tija”), si dhe për vlerën gjuhësore e letrare (“patrija e gjuhës”, “hijeshia e thanjevet”, “përshtatja e fjalvet”, “ritmi e ndertimi estetik i periudhaves” etj.). Fishta bën, në fund të komentit të tij për Bogdanin, një përmbyllje lapidare:

Vepra e Bogdanit “...posë se dijenike, asht edhe letrare në kuptim të vërtetë të fjalës”.⁶⁶

II. 2. Ndikimet e letërsisë së shkrimtarëve të vjetër të Veriut në veprën e Fishtës

Vendi ku ka jetuar dhe ku ka shërbyer Fishta, veriu shqiptar, me përjashtim të Kosovës, është vatra e shkrimtarëve të vjetër katolikë. Edhe po të mos kishte qenë shkrimtar, Fishta, si çdo intelektual tjetër i kësaj strukture të shoqërisë shqiptare, do të ndikohej e prekej nga tradita e prelatëve shkrimtarë e mësues të popullit të para tre shekujve. Poende, Fishta duke qenë shkrimtar e poet, duke qenë prelat e patriot, do të jetë krijuar si i tillë edhe mbi bazën e asaj literature të pasur që ishte shkruar në shekujt XVI e XVII, prej njerëzve të mëdhenj të rrethit të tij gjeografik.

65 P. Gjergj Fishta O. F. M, Rivista e shtypit, “Vjerrsha heroike shqiptare”, HYLLI I DRITËS, 1935, nr. 3, fq. 145.

66 Fishta, Estetikë e kritikë, fq. 96-97.

Ndikimet e letërsisë së shkrimtarëve të vjetër të Veriut në veprën e Fishtës mund t'i klasifikojmë në tri grupe:

ndikime të sferës estetike-etike,

ndikime të koncepteve krijuese dhe të ideve letrare e poetike, dhe

ndikime tekstore-letrare.

Po, para se të flasim për secilën sferë të ndikimeve, duhet qartësuar përdorimin e nocionit **ndikim**, në këtë rast. Nocioni ndikim në marrëdhëniet e Fishtës me letërsinë e shkrimtarëve të vjetër katolikë kalon kufijtë kuptimorë të nocionit, sepse këtu merr edhe kuptimin e përkimit, njëllojshmërisë. Kjo do të thotë që, në studimin tonë kemi përkufizuar çështjet e njëjta, të përafërta apo të përkueshme midis Fishtës dhe letërsisë së shkrimtarëve të vjetër katolikë dhe këtë marrëdhënie e kemi përkufizuar si ndikim, për faktin se, sipas rrjedhës kohore, Fishta ka mundur të ndikohet prej Buzukut, Budit, Bardhit e Bogdanit dhe jo e kundërta. Por, ne nuk kemi ndjekur një çështje të përkueshme midis Fishtës dhe autorëve tanë të vjetër me fanatizëm, për të dëshmuar saktësisht nëse kemi të bëjmë me përkim, me ndikim të tërthortë apo me ndikim të drejtpërdrejtë. Ne jemi mjaftuar për të dëshmuar elementë të njëjtë në veprën e Fishtës dhe të autorëve tanë të vjetër, për të dëshmuar marrëdhëniet e veprës së Fishtës me ato vepra të hershme të shqipes.

II. 2. a. Ndikime të sferës estetike-etike

Kjo është fusha ku lidhshmëria e Fishtës me traditën e letërsisë filo-biblike veriore është më e forta.

Konceptet estetike të Bogdanit e të Fishtës. Bogdani nuk flet për koncepte estetike veçanërisht në veprën e tij, por shfaq aty-këtu disa

koncepte për të bukurën. Konceptet e tij mirëfilli përputhen me konceptet e estetikës kishtare mesjetare: e bukura e përkryer është vetë zoti dhe vepra e tij, rrethi i shekullit (rruzullimi, kozmosi), është njeriu (Virgjina Mri) dhe çdo vepër tjetër e tij.⁶⁷

Fishta në konceptet e veta estetike nuk është origjinal e as dogmatik. Ai e përkufizon të Bukurit njësoj sikur Bogdani, po me një dallim: Fishta e sheh të ndryshme të Bukurit e artistit nga të bukurit në natyrë. Sipas Fishtës Bukuria absolute është Zoti, po kjo e bukur as nuk mund të arrihet e as të përjetohet. Bota reale është hije e kësaj të Bukure. Artisti krijon të Bukurit që është midis Zotit dhe të Bukurit në natyrë.

Për dallim nga konceptet e tij estetike, në konceptet filozofike, etike dhe sociale Fishta është më i skajshëm. Ai është një dishepull i bindur i koncepteve mesjetare kishtare për idetë sociale, politike dhe fetare. Në këto të fundit, ai mbase është i ndikuar edhe nga idetë e kundërreformacionit, si në çështjen e fesë dhe të rolit të saj në shtet.⁶⁸

Derisa në konceptet estetike Fishta ka diçka të përbashkët me Bogdanin (zoti si krijuesi i të bukurës absolute), në konceptet etike, morale e filozofike ka më shumë të përbashkët, në konceptet metrike e letrare ka shumë më të përbashkët: edhe Fishta edhe Bogdani, shkruajnë vargun sipas rregullave të metrikës klasiciste. Këtë marrëdhënie të Fishtës me Bogdanin vetëm se po e identifikojmë si ndikim, por nuk do ta trajtojmë tash, sepse do ta trajtojmë në kapitullin e fundit për konceptet estetike të Fishtës dhe lidhshmërinë e tyre me ato të traditës.

67 Pjetër Bogdani, Çeta e Profetëve, fq. 159; Ibrahim Rugova, Vepra e Bogdanit, fq. 112-122.

68 Shih te shkrimet publicistike: Kisha Katolike ka trajtue kulturën oksidentale, në HYL-LI I DRITËS, 1923, nr. 4, 5, dhe 6; Arsim, apo luftë kundra katolikizmit në Shqipni?, në HYL-LI I DRITËS, 1923, nr. 7, etj.

Atme e Fe.⁶⁹ Ky binom paraqet bërthamën e koncepteve filozofike, morale, atdhetare e fetare të Fishtës. Në veprën e Fishtës ky binom paraqitet edhe si bërthamë historike e shqiptarëve, si parimi më i fuqishëm fuzionues i shqiptarëve, rreth të cilit dhe për të cilin janë zhvilluar luftërat për liri dhe janë ruajtur qenia dhe civilizimi shqiptar. Në disa vende Fishta e përdor edhe në formën Fe e Atdhe, por më e përhapur është në formën e parë, Atme e Fe.

Çabej vëren se Atdheu, Gjuha e Besimi është trinom i shenjtë, “visar etik” i tërë letërsisë së vjetër shqiptare.⁷⁰ Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani, e përtejdetit edhe Matrënga, priren nga ky trinom dhe këtë e thonë hapur në veprat e tyre. Edhe pse veprat e tyre janë tekste biblike ose filobiblike (S. Hamiti), këta autorë e mbitheksojnë gjuhën dhe atdheun (“bota” te Buzuku), e vetëm pastaj edhe besimin (fenë) si qëllim të krijimtarisë së tyre. Çabej e përmend në një vend tjetër edhe binomin Fe e Atdhe te autorët e vjetër⁷¹, prej ku, si duket, Fishta e ka absorbuar në formën Atme e Fe. Mbi këtë visar etik, politik e njerëzor, mendon Çabej, janë mbajtur edhe Kuvendi i Matit (1462), Kuvendi i Arbënit (1703), por edhe shumë kuvende kishtare-politike në Shqipërinë e Veriut.

Rexhep Qosja, duke theksuar antiklerikalizmin e romantizmit shqiptar dhe klerikalizmin e romantizmit evropian dhe të disa kombeve fqinjë, vjen në përfundim se Fishta konceptin Fe e ka marrë nga romantizmi evropian dhe nga ai i disa kombeve fqinjë.⁷² Çështje e vërteta, derisa romantizmi evropian është letërsi me themel të fortë kristian,

69 Shih edhe: Bajram Kosumi, *Lirika e Fishtës*, Toena, 2004, fq. 112-113

70 Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore VI*, (Pjetër Budi dhe gjuha e tij), fq.315.

71 Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore VI*, (Pjetër Budi dhe gjuha e tij), fq. 342.

72 Rexhep Qosja, *Romantizmi I*, Rilindja, Prishtinë, 1984, fq. 59.

romantizmi i disa kombeve fqinjë me shqiptarët është karakterizuar skajshmërisht nga prirjet e mbitheksuara fetare dhe klerikale, për shkak të gjendjes sociale të këtyre kombeve, kryesisht të robëruara dhe rolit progresiv të kishës, si forcë fuzionuese në këto periudha. Fishta, që nga rinia e hershme, e ka njohur romantizmin e këtyre kombeve.

Në *Lahutën e Malcis* Fishta i përdor edhe dy variacione të këtij binomi: “për Mbret e Atdhe” dhe “Mbret, Atdhe, Fe”.⁷³ Koncepti Mbret, si koncept i shenjtë, për të cilin shqiptarët e flijojnë edhe jetën, njësoj sikurse për atdheun e fenë, nuk haset më parë në kulturën shqiptare, por as në **Kanunin e Lekë Dukagjinit**. Si duket, vetë Fishta e ka stisur këtë koncept në binomin dhe trinomin e sipërpërmendur, sigurisht për arsye politike, edhe pse ai nuk ka qenë në marrëdhënie të mira me mbretin e shqiptarëve, Zogun e Parë, mirëpo koncepti sociopolitik i Fishtës i shprehur në shkrimet publicistike është në përputhje me monarkinë shqiptare.

Binomin Atme e Fe Fishta e ka marrë të gatshëm prej letërsisë së vjetër shqiptare. Në një shkrim të tij, Vinçenc Malaj citon P. Lorenzo da S. Croce, nga *Registro della Provincia osservante d'Albania* (1720)⁷⁴ të thotë se në një dokument të Arkivit të Kuvendit të Durrësit të vitit 1240, thuhet se në Durrës (Epidamnum) kanë ekzistuar dy kuvende, njëri i dominikanëve e tjetri i françeskanëve, prej të cilëve dolën shumë

73 Kjo formulë përdoret në forma të ndryshme, po mbizotëruese janë: “Ku i lypë Mbreti e i lypë Shqipnija”, “Per Mbret e per Atdhe”, ”Per Mbret e Troje t’veta”. Shih: Fishta, Lahuta e Malcis, Rilindja, 1997, Kangë e dytë, vargjet 51, 54, 60, 69.

74 Titulli i plotë i regjistrit është: Registro della Provinca Osservante d'Albania 1720- In temo del P. M. R. Lorenzo di Santa Croce, Ministro Provinciale l'anno 1720. Këtë burim e citon edhe Marin Sirdani dhe thotë se ky regjistër ruhet në Arkivin e Provincës Françeskane Shqiptare. Shih: Atë Marin Sirdani, Françeskanët në Shqypni dhe shqyptarët katolikë në lamë t'Atdhetaris, Shpresa, 2002, fq. 15, fusn. 8.

burra në zë dhe të meritueshëm për Fe e Atdhe.⁷⁵ Si duket, ky duhet të jetë dokumenti më i vjetër i shkruar në Shqipëri e ku të përdoret binomi Fe e Atdhe, i cili i shndërruar në koncept filozofik dhe etik do të bëhet koncept themelor i Fishtës në kryeveprën *Lahuta e Malcis*, por edhe në veprën e tij të përgjithshme. Edhe nëse ky binom nuk është i dokumentit të vitit 1240 (sepse nuk thuhet nëse janë fjalë të dokumentit apo të P. Lorenzo da S. Croce-s), ai është i vjetër, së paku dyqind vjet para Fishtës, gjë që është argument i paluajtshëm për zhvillimin e këtij koncepti në rrethet françeskane në Shqipëri për shekuj të tërë.

Meqenëse dominikanët dhe françeskanët e shekullit XIII ishin kryesisht të huaj të ardhur për të shërbyer në Shqipëri, atëherë rrënjën e binomit Fe e Atdhe duhet kërkuar edhe jashtë Shqipërisë, po gjithsesi brenda rrethit të kishës katolike. Buzuku nuk e përmend në mënyrë të drejtpërdrejtë, por feja, gjuha dhe atdheu janë tri shtyllat mbajtëse të veprës dhe punës së tij në të. Në parathënien e *Pasqyra e t'Rëfyemit Budi* e shprehë dashurinë e pamasë dhe punën e tij në të mirë të atdheut:

“...sa i madh ka qenë gjithëherë kujdesi e dëshiri i zemërësë sime për ndimë të Patries e të gjuhësë sanë...”⁷⁶

Po Budi e shpreh edhe në një varg të tij idealin e vet krijues: “Shqip të mundënj me rrëfyem”.⁷⁷ Ky varg emblemantik i Budit e shprehë atdheun, përmes gjuhës shqipe, dhe fenë e Budit, përmes rrëfimit, predikimit. Frang Bardhi në parathënien “Gjithë atyne t’Arbëneshëve...” të *Dictionarum*-it të vet thotë:

75 Vinçenc Malaj, Kontributi i Françeskanëve në letërsinë shqipe, në Letërsia si e tillë, Toena, 1996, fq. 173.

76 Selman Riza, Vepra 4 / Krestomaci, fq. 536.

77 Pjetër Budi, Poezi, vjersha XVI.

“Vullëndetnë e kujdesnë veçë Krijuesi i Qiellit ma di, vallazënitë e dashunë, si e kam pasunë, e si e këm ndë më rantë fuqia me dhanë dorënë e me ndimuem së pafatesë dorësë arbënesh.⁷⁸

Ndërsa, poeti Lukë Bogdani e shprehë këtë binom në një varg të poezisë së tij:

Ty lus o Shenë MRI
 Qi ri n’Kishë PRISEREND,
 Ban të dalë perserij,
 Kryq, e flamburë me rend.⁷⁹

Vargu i tretë shprehë një prej ambicieve letrare-politike të autorit, rikthimi i epokës skënderbegiane, që do të bëhet më vonë një prej parimeve krijuese të Rilindjes Kombëtare. Ndërsa vargu i katërt i strofës shprehë binomin Fe (kryq) e Atdhe (flamburë).

Se si dhe pse gjeti truall aq të pëlleshëm ky binom te shkrimtarët e vjetër katolikë shqiptarë këtu nuk është vendi të shpjegohet, vetëm se duhet shtuar se kjo pyetje mund ta ketë përgjigjen e plotë dhe të saktë nëse marrim parasysh gjendjen e fesë katolike në Shqipëri pas pushtimit osman dhe rolit të kishës katolike shqiptare, e përkrahur nga Roma, në ruajtjen e katolicizmit në Ballkan, që mund të bëhej vetëm me gjallimin e shqiptarëve si etnikum dhe i tokës së tyre.

Binomi etik, i shndërruar kështu nëpër veprat letrare të shkrimtarëve të vjetër katolikë edhe në binom letrar, është trashëguar edhe te Gjergj Fishta, me të njëjtin kuptim dhe me të njëjtin funksionalitet.

78 Franciscus Blanchus, *Dictionarium latino-epiroticum*, fq. VII. Këtu cituar sipas transkriptimit të S. Riza, *Vepra 4 / Krestomacia*, fq. 580.

79 Pjetër Bogdani, *Çeta e Profetëve*, fq. 154. Krahasuar me transliterimin të Ibrahim Rugova, *Vepra e Bogdanit* (1990), fq. 285. Shih edhe te Sabri Hamiti, *Studime letrare* (2003), fq. 68.

Fishta në gjithë veprën e tij e ngre këtë parim mbi çdo parim tjetër dhe e shndërron në një farë flamuri filozofik, etik dhe social për shqiptarin, ndërsa në veprën e tij, sidomos në lirikë dhe në epikë, e shndërron në bosht ideor rreth të cilit zhvillohen ngjarjet.

II. 2. b. Ndikime të koncepteve krijuese dhe të ideve letrare e poetike

Kulti për Gjuhën Shqipe. Kur flitet për letërsinë e shekujve XVI e XVII gjuha shqipe rri pranë binomit Fe e Atdhe dhe është pjesë e barabartë e trinomit. Këtë e thotë Çabej dhe të gjithë studiuesit e tjerë. Mirëpo, ne e veçnam këtu për shkak të statusit jo të njëjtë të gjuhës të shkrimtarët tanë të vjetër dhe të Fishta. Te të parët gjuha shqipe është parim ekzistencial, etik, politik, po edhe parim krijues. Të gjithë shkrimtarët e vjetër katolikë me dhimbje e dëshpërim flasin për rrezikimin e gjuhës shqipe nga pushtimi osman. Edhe sot tingëllojnë mallëngjyese thirrjet e tyre për gjuhën shqipe dhe për librat në shqip. Le të kujtojmë këtu lutjen që bëri Budi për librin e vet, mbas disa mundimeve të pafundme të atyre që nuk e ndihmonin dhe e pengonin që ai të botojë librin shqip, duke e munduar që të përgatisë deri edhe në tre libra për botim e duke mos i marrë parasysh:

“-O Zoti im, shum i ambli e i mesheriershimi, gazimendi i t’idhën-uomet e shpëresa e t’përmpkatnuomet, e ndima e forca e gjithë atyne qi me shpëresë mpshtettenë prej te, ti qi ende parëse janë bammirë i di e i njef gjithë kafshëtë, e aqq ma tepërë gjithë të kujtuometë e përm-brendshime e dëshiretë e mendse e të zemëresë sanë, të lus qi, nd’ashtë këjo vepërë për ndonjë ndimë o frujt të nmirë të shpirtit, t’ëmtë e t’ati populli, ndonëse u i padenjë, mos e harro e mos e shtie poçtë këtë fëdigënë teme, ashtu as mos e venë roe aqë ndjerë nd’anet të mangutë

e të padenjëtë tem, po të madhenë mesherierrë tande, e mëp aqë hir e gracie qi ndo ta mbaronj për ndimët të ati populli si kam nisunë, ndo të lirë ndë ment e zemërë teme me shkuom e me e lanë.”⁸⁰

Mirëpo, Pjetër Bogdani me veprën e tij, si duket, paraqet një kufi midis akceptimit të këtillë të gjuhës dhe akceptimit të mëvonshëm të gjuhës. Vepra e Bogdanit është një kufi dalës nga periudha ku luftohej me mund të madh gati deri në dëshpërim për ruajtjen dhe kultivimin e gjuhës shqipe. Edhe Bogdani e ka këtë hall, por ai ka në dorë disa libra të botuar shqip, është i sigurt për provat e vështira që i kishte kaluar gjuha shqipe dhe ai tashmë hedh shikimin përpara për të parë te gjuha jo vetëm elementin e shpëtimit etnik e fetar, por edhe artin e saj, bukurinë e fjalës shqipe, ta bëjë atë të tingëllojë bukur sikurse gjuha italiane⁸¹ etj.

Edhe te Fishta gjuha shqipe është një prej temave kryesore të veprës së tij letrare. Ai i ka kushtuar një poezi dehëse lirike, gjuhës shqipe dhe ky element nuk paraqitet si kusht ekzistencial, por si mundësi e pafundme për të krijuar artin dhe të bukurën. Ky është një evoluim i qind për qind i akceptimit të gjuhës në dy rrethana krejt të ndryshme.

Motivimi i letërsisë. Shkrimtarët e vjetër të Veriut shkruajnë për të shpëtuar gjuhën shqipe, fenë katolike te shqiptarët dhe për të shpëtuar shqiptarët nga shkombëtarizimi. Fishta shkruan për ta ngritur kombin e ri e të lirë shqiptar dhe për të krijuar artin. Midis autorëve të vjetër

80 Pjetër Budi, Pasqyra e t’Rëfyemit, parathënie Të rekomanduom e të porositunë upe-shkëpinjet e vikarinjet e gjithë sa tjerë prelatë gjindenë ndë gjuhut tanë t’Arbëneshë, cituar sipas Selman Riza, Vepra 4 / Krestomaci, fq. 538-539.

81 Pjetër Bogdani, Çeta e Profetëve, fq. 88.

dhe Fishtës rri Pjetër Bogdani, i cili në veprën e tij shfaq elementet e dy anëve.

Marrëdhënia me letërsinë popullore. Shkrimtarët e vjetër të Veriut kanë ndërtuar një marrëdhënie me letërsinë popullore, sado me një lidhje të dobët. Të gjithë, pa dallim, përdorin shprehje e fjalë të urta popullore, ndërsa Frang Bardhi futë në *Dictionarum...* mbi njëqind fjalë të urta popullore. Bardhi flet po ashtu për zakonet e shqiptarëve për të kënduar këngë për trimëritë e heronjve të tyre.⁸² Pjetër Budi përdorë vargum popullore tetërrokësh, në mbi tre mijë vargje poetike.

Nuk mund të pohojmë se Fishta u ndikua nga shkrimtarët e vjetër në marrëdhënien ndaj letërsisë popullore. Pavarësisht nga kjo, nga një marrëdhënie shumë e ngushtë, gati se organike e veprës së Fishtës me letërsinë popullore, këtu mund të veçojmë kultin e Fishtës ndaj fjalëve të urta popullore e ndaj frazeologjisë popullore, të përdorura shpesh në gjithë veprën e tij. Fishta përdorë aq shumë fjalët e urta popullore, sa që ka vende në *Lahutë të Malcis* ku një ide e tërë poetike është rrumbullakuar vetëm përmes fjalëve të urta (Shih librin tim *Fishta dhe letërsia popullore*).

Letërsia fetare. Shkrimtarët e vjetër të Veriut, në pjesën më të madhe, kanë shkruar tekste filobiblike, siç e shënjon dhe shpjegon Sabri Hamiti këtë letërsi. Nocioni filobiblik nënkupton letërsinë me temë e motive biblike. Në veprat e këtyre autorëve, sidomos te Bogdani, ka prozë laike e shkencore. Megjithatë, letërsia e këtyre autorëve trajton

82 Frang Bardhi, Relacion i v. 1637 (qershor), cituar sipas Dr. M. Hysës, Hyrje në letërsinë shqipe, fq. 197.

dy tema të mëdha: biblike dhe shqiptare. Buzuku e ka krijuar këtë traditë, e cila ka vazhduar fuqishëm edhe te poetët katolikë të veriut të njohur si pararendës të Rilindjes Kombëtare, si Pjetër Zarishi, Leonard de Martino, Anton Xanoni etj., si dhe te Anton Santori e Zef Serembe te arbëreshët në Itali.

Vazhdues i denjë i kësaj tradite është edhe Gjergj Fishta. Krahas poezisë së laike-patriotike Fishta ka shkruar dhe ka publikuar vazhdimisht edhe poezinë fetare, që nga viti 1902, kur boton një përshtatje në shqip të një poezie të Silvi Pellico *Zemrës së Zojës së Bekueme*⁸³ Veprën e parë *Lahuta e Malcis, Kangë Popullore*, Fishta e boton më 1905, e po në vitin 1905 boton edhe përmbledhjen e poezive fetare, të përshtatura e të përkthyer, *Vierrsha t'pershpirteshme*. Këtë rrugë dysore e ndjek Fishta deri në fund të jetës së tij. Ai shkruan jo vetëm poezi, por edhe tekste dramatike me motive biblike apo thjesht fetare, për qëllime edukative, pothuajse njësoj si paraardhësit e tij tre shekuj më herët.

Letërsia kryengritëse. Shkrimtarët e vjetër të Veriut janë, në të njëjtën kohë, edhe bashkëpjesëmarrës në veprimet e aristokracisë së mbetur shqiptare e ballkanase për çlirimin e vendit nga pushtuesi osman. Këtu dallohen sidomos Budi e Bogdani, por edhe Bardhi: të parin supozohet se e mbysin në kalim të Drinit, të dytin, mbasi vdes nga mortaja, qeveritarët osmanë ia masakrojnë trupin e pajetë. Po i përmendim këto fakte për të paralajmëruar se letërsia që kanë krijuar këta shkrimtarë, qoftë ajo e mirëfilltë apo e diskursit politik e kishtar, fund e krye është letërsi kryengritëse dhe luftarake. Këta prelatë jo vetëm

83 Poezia e u botua në të përkohshmen Elçija, 1902, nr. 7, fq. 163. Simbas Bibliografisë së Benedikt Demës.

që kanë hartuar plane veprimi kundër osmanëve, që kanë udhëhequr me shqiptarë të armatosur, që kanë bërë luftë kundër osmanëve, por edhe gjithë shkrimin e tyre e kanë vënë në shërbim të një qëllimi social e politik: çlirimin e shqiptarëve dhe të Ballkanit dhe shpëtimin nga islami.

Budi i lutet Shën Mërisë se si mund ta shkojë jetën pa bërë diçka për popullin dhe vendin e vet kur:

Tu' pam gjithë të keqtë
Aqë ishunë e helmuom
Ke nd'Arbënë shtiu leqtë
Djali i mallëkuom.⁸⁴

Ndërsa Frang Bardhi, në fjalët e urta futë edhe asi që janë politike dhe antiosmane, si “Ku Turku ve kambën, aty s'del bar.”⁸⁵ Bogdani në shumë vende në veprën e vet flet për trimërinë e shqiptarëve kundër osmanëve, duke nxitur kështu ndjenjat luftarake të shqiptarëve për t'u çliruar nga zgjedha osmane.

Duke folur për Budin studiuesi Zija Xholi thotë:

“Liri, trimëri, armë, kryengritje-ideale dhe arsyetime këto që nuk i gjejmë shpesh në gojën e një prifti, por që janë krejt të natyrshme për një atdhetar të asaj kohe, siç ishte Budi, një prift atdhetar.”⁸⁶

Para se të flasim për lidhshmërinë e natyrës kryengritëse të letërsisë së shkrimtarëve të vjetër të Veriut me Fishtën, duhet të themi se kjo shfaqje letrare nuk është e veçantë për një autor apo për një periudhë

84 Pjetër Budi, *Poezi*, fq. 241.

85 Franciscus Blanchus, *Dictionarium latino-epiroticum*, fq. 215. Këtu cituar sipas transkriptimit të Selman Riza, *Vepra 4 / Krestomacia*, fq. 587.

86 Zija Xholi, *Pesë mendimtarët më të mëdhenj...*, fq. 87.

letrare në historinë e letërsisë shqipe. Përkundrazi, kjo shfaqje letrare përshkon tërë letërsinë shqipe, madje me ndonjë përjashtim, deri në dekadat e fundit të shekullit XX.

Letërsia e Fishtës, më shumë se te shkrimtarët e tjerë, është letërsi kryengritëse. Lirikat e tij, bile edhe ato fetare, janë kryengritëse, janë kushtrime, janë himne dhe marshe, ose elegji për gjamet e kombit. *Lahuta e Malcis* zbulon qëndresën e shqiptarit nëpër shekuj te besimi në t'Parët, në Zotin dhe te lufta e pandërprerë për liri. Një prej kryeheronjve të saj, Marash Uci, tërë jetën e ka çuar në luftë, e cila iu ka shndërruar pothuajse në profesion. Tekstet dramatike, përveç disa teksteve didaktike, janë të përshkuara me tone kryengritëse. Juda Makabe, njëri prej heronjve të Fishtës në dramën me të njëjtin emër, hero i Biblës, është personifikim i shpirtit kryengritës nëpër shekuj.

Ligjërimi predikues. Poezia e Budit është tregim në vargje. Sabri Hamiti thotë se kjo është “mënyrë zotëruese e shkrimit” nga ai.⁸⁷ Si poezi-tregim (rrëfim) ajo është e paragjykuar për lexim në kishë apo edhe këndim me zë, që të mësojë të tjerët për historitë biblike.

N'dorë e merri, e këndoni
 Iu qi dini me kënduom,
 Vini veshët e ndëgjoni
 Iu qi dini me ndëgjuom.

Këto fjalë i ligjëroni
 Si kankë tue kënduom,

87 Sabri Hamiti, Studime letrare, fq. 39.

E me za t'i viershoni
 Fort t'ambëlë e të ngushëlluom.⁸⁸

Nga kjo vetëkuptohet edhe ligjërimi predikues në këtë poezi. Jo vetëm poezia e Budit po krejt letërsia e shkrimtarëve të vjetër të Veriut është e shkruar me një stil ligjërimor predikues, në harmoni me ligjërimin biblik.

Fishta e ka trashëguar këtë ligjërim nga autorët tanë të vjetër. Poezia lirike e Fishtës, por edhe tekstet e tij dramatike, kryesisht shfaqen në planin e ligjërimin si predikim. Dallon *Lahuta e Malcis* dhe pjesa më e madhe e poezisë satirike.

Kështu Budi e shndërron poezinë në predikim:

Të kërshenë, o ju, qi ini
 Nd'Arbenë të pagëzuom,
 Qi fenë mirë e dini
 Se u ashtë për të shëlbuom,

Këtë letër e përzini

Qi juve kam dërguom,

Gja kafshë n co të xini

Këtë jetë tue shkuom.⁸⁹

Po me të njëjtin ligjërim predikues Fishta u drejtohet shqiptarëve:

O ju t'gjith, qi n'Shqyptari

M'kater vend kryqin e bani,

Siellnju sod prej Zojet Mri

88 Pjetër Budi, Poezi, fq. 253

89 Pjetër Budi, Poezi, fq. 252-253.

E nji zemre edhe nji zani
Kangë a valle Asajë t'i kndoni,
Shpirt e zemer t'ia kushtoni.⁹⁰

Universalizmi i veprës së Bogdanit dhe universalizmi i veprës së Fishtës. Në orientimet e përgjithshme krijuese Fishta dhe Bogdani kanë të përbashkët orientimin për krijimin e veprës universale, thënë kushtimisht, veprës që shtjellon një temë a një ide, apo një qëllim, nga A deri te ZH. Bogdani e koncepton veprën e tij sipas modelit të Biblës⁹¹, e cila për nga universalizmi ia kalon çdo libri tjetër të trashëguar nga njerëzimi. Rugova përfundon duke thënë se vepra e Bogdanit është universale sepse përmban në vete “disa klasematika problemesh e çështjesh rreth një apo disa ideve qendrore e esenciale”⁹².

Vepra e Fishtës është universale në dy plane. Në planin e parë, si tërësi vepra e Fishtës është lirikë, epikë, satirikë dhe dramatikë, prandaj ajo është një gjithëpërfshirje e gjinive letrare. Në planin e dytë *Lahuta e Malcis* është një vepër universale për shqiptarin dhe lëvizjet e tij në shekullin XIX për krijimin e kombit të lirë e modern, në të gjitha aspektet filozofike, morale, sociale, individuale, letrare etj.

Nga kjo mund të përfundojmë se edhe Bogdani, por edhe Fishta, në qasjet e tyre ndaj letërsisë dhe ndaj veprës letrare, janë universalistë dhe punojnë sipas metodës sintetizuese: ata sistematizojnë dhe sintetizojnë idetë poetike, motivet, faktet letrare, temat dhe idealet letrare të mëparshme.

90 Atë Gjergj Fishta, Vallja e Parrizit, Kuvendi Françeskan, Gjakovë, 1995, fq. 27.

91 Ibrahim Rugova, Vepra e Bogdanit, fq. 75.

92 Ibrahim Rugova, Vepra e Bogdanit, fq. 83.

II. 2. c. Ndikime tekstore-letrare

Njëmbëdhjetërokëshi: vargu i Fishtës dhe vargu i Bogdanit. Në historinë e letërsisë shqipe është menduar se njëmbëdhjetërokëshin në shqip të parët e kanë përdorë pararendësit e rilindësve, më konkretisht Anton Xanoni, Pjetër Zarishi, Leonard de Martino, Ndue Bytyqi, e më vonë edhe Serembe, Fishta etj.⁹³ Në të vërtetë, poezia e parë njëmbëdhjetërokëshe është edhe poezia e parë shqipe, *Kancona spirituale* e Lekë Matrëngës.⁹⁴ Po meqenëse ajo është vetëm një poezi e shkurtër dhe e botuar vetëm më 1912 (e shkruar më 1492), ajo vetëm kushtimisht mund të trajtohet në këtë drejtim. Është një poet tjetër ai që ka përdorë njëmbëdhjetërokëshin në poezinë e vet, e ai është Pjetër Bogdani. Bogdani ka shkruar profecitë poetike të disa sibilave dhe i ka vargëzuar në njëmbëdhjetërokësh, të cilat studiuesit më të njohur të tij S. Riza⁹⁵ dhe I. Rugova⁹⁶ i marrin për origjinale. Po ashtu edhe stanca *Krijimi i Rruzullimit* (e titulluar nga I. Rugova) është njëmbëdhjetërokëshe. Poezia e Bogdanit ka rimën sipas skemës së stancës mesjetare italiane ABABABCC dhe është mjaft e pasur (përveç te *Krijimi i Rruzullimit*, ku Deti e Zjarmi tri herë rimojnë me veten, për shkak të shpërndërimit të vendeve të tyre nëpër vargje). Ja disa vargje të poezisë *Sibila Delfika* dhe struktura metrike e tyre:

Vajtonj un' e mjera një te madhe gjamë,

Se Krishnë mbë Kryjt rafunë e keq shemtuem:

Shëplaka, Grushta, helm, e ufullë dhanë;

93 Dhimitër S. Shuteriqi, *Metrika shqipe*, Prishtinë, 1968, fq. 42-44; E. Koliqi, *Fishta interpret i shpirtit shqiptar*, Gjakovë, 1997, fq. 34; R. Qosja, *Romantizmi I*, fq. 334; B. Kosumi, *Lirika e Fishtës*, fq. 136-137.

94 Shih te Rexhep Ismajli, *Tekste të vjetra*, fq. 101-104.

95 Selman Riza, *Vepra 4 / Pesë autorët më të vjetër...*, fq. 398.

96 Ibrahim Rugova në *Vepra e Bogdanit*, fq. 169-182 dhe fq. 259.

Pergjegjunë shtatnë Plagesh e irënuem:
 Israeli mbë Dhet keq, nuk la pa i banë:
 Patershanë ende mbë Kryjt depertuem:
 Dvekun s'Amesie mbë Prehenë ja dhanë:
 Zemërënë tu i shituem anë e pranë.⁹⁷

1. U/-U/-U // -U/-U/-U
2. U-U/U- // -U/U-/U-
3. U-U/-U // -U/-UU/-U
4. U-U/-U // -U/UU-
5. -U/-U/U-U // U-/U/-U
6. -U/-U // -U/U- // -U/-U
7. -U/-U // -U/-UU/U-U
8. -UUU/-U/U- // -U/-U

Te Bogdani diftongjet ue (si te: shemtuem, idhnuem, depërtuem) numërohen një rrokje. Shumica e vargjeve mbarojnë me një rrokje femërore, e cila po ashtu duhet shënuar, po nuk numërohet. Katër vargjet e para fillojnë me jambin, e katër të dytat me trokeun. Cezura nuk është stabile: herë është pas rrokjes së pestë, herë pas rrokjes së shtatë, ndërsa në vargun e gjashtë cezura ndërron ritmin e vargut, duke e prerë atë në dy vende, pas rrokjes katër dhe pas rrokjes së tetë.

Fishta është mjeshtër e njëmbëdhjetërrrokëshit. Ai e përdorë atë në disa prej lirikave të tij më të mira, si te *Nji lule vjeshtet, Nji gjamë desprimit!...*, *28 Nandor 1913, Sugrite, mortui!, Diten e të shuemvet, Burrija*, te tri sonetet etj.

97 Pjetër Bogdani, Çeta e Profetëve, fq. 490.

Struktura metrike e fillimit të poezisë *Diten e të shuemvet* duket kështu:

I kuj do t'jet njai vorr, mbi t'cillin mvaret
 Kunorë lulësh e blerët e qi madhnueshëm
 Zotnon mbi fang t'mjeruem, porsì shatorrja
 E njaj Tyrani zemer-gur, i cilli,
 5. Mbi shegj Persijet pa kujdes pështetun,
 Nder kandje t'prujtna të ksaj jete kndellet,
 Mjesa besniku ushtari i tij nen t'randin
 Hekur t'anmikut rrokullohet dekun
 E zhytet n'gjak?...

U -/U -/U -//U -/U - U	2.6./10
U -/U -/U - U//U -/U - U	2.6./11
U -/U -/U -//- U/U - U	2.6./10
U -/U -/U -/U -//U - U	4.8./10
U -/U -/U -//U -/U - U	2.4./10
U -/U -/U -//- U/- U	2.4./7.10
U -/U -//U -/U -//U - U	4./6.8./10 (dy sinalefa)
- U/U - U//UU -U/- U	1.4./8.10
U -/U -/ ...	2.4/

Njëmbëdhjetërrokëshi i Fishtës është kryesisht jambik, e kjo krijon ritmin vajtues, prandaj poezitë e tij në këtë varg janë kryesisht vajtime. Në këtë strofë pos vargut të tetë, të gjitha të tjerat fillojnë me jambe dhe, pos vargjeve 8 dhe 6, të gjithë përfundojnë me amfibrak. Cezura është në rrokjet 6-8 ose 4-8. Duhet vërejtur se asnjë varg nuk përfundon me

fjalë paroksite, dmth. përfundon me rrokje të patheksuar e, po ashtu, fillon me rrokje të patheksuar.

E afërt me poezinë e Bogdanit, stancë njëmbëdhjetërrokëshe, me rimën ABABABCC, është strofa e epit satirik *Palokë Cuca*, një prej strofave më të fuqishme të epeve evropiane të Mesjetës së vonshme.

Vargu i Fishtës është më i diciplinar dhe më i rregullt se ai i Bogdanit. Por, edhe pse njëmbëdhjetërrokëshi i Fishtës nuk ka shumë të përbashkëta me atë të Bogdanit, është i mjaftueshëm fakti se janë vargje të përafërta, e në këtë rast mund të flasim edhe për ndikim, sepse Fishta e njëjtte veprën e Bogdanit shumë mirë. Kjo mund të dëshmohet edhe me dy vargje të Bogdanit, në vjershën hyrëse për Sibilat:

Posi vjolleza ndë dimenë pa mardhë

Ndershen: e si Njegullatë palë, palë⁹⁸

Janë këto dy vargje të njëjta edhe në planin kuptimor edhe në strukturën ndërtimore sintaksore me vargjet e Fishtës në poezinë *Gjuha Shqype*. Bile, edhe në planin metrik është strukturë plotësisht identike me atë të Fishtës, nëse dy vargjeve ua heqim nga dy rrokje:

Posi vjollza n'dimen pa mardhë

E si Njegullat' palë, palë⁹⁹

Me këtë ndryshim, këto dy vargje më shumë janë të Fishtës, ngjashëm me ato të *Gjuhës Shqype*:

Porsi kanga e zogut t'veres,

Qi vallzon n'blerim të Prillit;

Porsi i ambli fllad i eres,

Qi lmon gjit e drandofillit.¹⁰⁰

98 Pjetër Bogdani, *Çeta e Profetëve*, fq. 476.

99 Pjetër Bogdani, *Çeta e Profetëve*, fq. 476.

100 Gjergj Fishta, *Lirika, Rilindja, Prishtinë, 1997*, fq. 43.

Gegnishtja letrare e autorëve të vjetër dhe rrudhja dialektore e poetëve shkodranë të shekullit XX. Pjetër Bogdani, në hyrje të librit të vet *Të primite perpara letterarit* flet për vështirësitë që i ka pasur në shkrimin e shqipes, nga aspekti dialektor:

Ashtu ende prej meje bukurijn' e gjiuhese nuk' e ke ndjer ndanet; perse tue kjanë une prej Guri ndë Hast', Sanxhakijet së Dukagjinit, Di-oqesit së Preserend; m'anshtë dashun me djersë të mëdha shumë fjalë me ndërequnë ndë dheete Skodersë.¹⁰¹

Bogdani rrëfen se si iu ka dashur ta përmirësojë gjuhën e vet me të folmen e Shkodrës, e cila kishte një ndikim e shtrirje më të gjerë. Këtë e bën Bogdani edhe për fjalësin sigurisht më të zhvilluar të shkodranishtes (në krahasim me të folmen e Gurit të Hasit) po edhe për shkak të shkrimit në një të folme më të zgjeruar, për ta kuptuar pa vështirësi sa më shumë lexues. Selman Riza e shquan “gegnishte letrare” këtë shkodranishte që e kishte përvetësuar Bogdani, në kuptimin e shkodranishtes të kultivuar në shkrim.¹⁰² Këtë shfaqje gjuhësore te shkrimtarët e vjetër të Veriut e vëren Eqrem Çabej:

Me ç'u tha këtu për dialektet e gegnishtes nuk do menduar se këta autorë kanë shkruar në dialekt. (...) Dialekti regjional prej të cilit rrjedhin përbën bazën, nga ku ata u ngritën në një gjuhë shkrimi mbidialektore. Kjo është edhe e natyrshme për ta, sepse ata janë të vetëdijshëm që shkrimet e tyre janë të caktuara për krahina më të hapëta e për shtresa më të gjëra të popullit. Kështu gjuha e tyre vërtet ruan disa tipare të një dialekti të veçantë dhe me këtë kallëzon proveniencën kra-

101 Pjetër Bogdani, *Çeta e Profetëve*, fq. 88.

102 Selman Riza, *Vepra 4 / Pesë autorët më të vjetër...*, fq. 400.

hinore të çdo autori, po mbetet prapë një farë koineje e shkrimit, një gjuhë e kuptueshme për të gjithë.”¹⁰³

Duke folur për këtë çështje studiuesi i kësaj letërsie, Selman Riza, konstaton:

“Pjetër Budi shkroi një shqipe pa krahasim më unidialektore e më idiomatike sesa Gjon Buzuku e Pjetër Bogdani.”¹⁰⁴

Edhe studiues të tjerë të historisë së gjuhës, si Justin Rrota e Rexhep Ismajli, pavarësisht nga mendimet e ndryshme prej Skender Rizës për gjuhën e Bogdanit, pajtohen në ecjen e saj mbidialektore:

“...gjuha e Bogdanit do parë si fenomen pak më i rëndësishëm pikërisht për shkak të rrugëve dhe të proceseve që kishte nisur në drejtim të kapërcimit të kufijve të mundshëm midis variacioneve lokale.”¹⁰⁵

Ky diskutim i studiuesve të kësaj letërsie, si në planin letrar, ashtu edhe në atë gjuhësor, sjell argumente të mjaftueshme për të pranuar historia e letërsisë shqipe përfundimin se shkrimtarët e vjetër katolikë, pavarësisht nga cila krahinë vinin dhe çfarë të folme kishin përdorur në jetë, në veprat e shkruara, jo vetëm që u përpoqën vetëdijshëm, por edhe ia arritën qëllimit të shkruajnë një gegnishte mbidialektore, të kuptueshme prej të gjithëve. Edhe pse këta studiues nuk e shquajnë këtë gjuhë të shkruar si gegnishte letrare, ne besojmë se mund të shquhet ashtu, me një ndajshesë, si gegnishte letrare e shekujve XVI-XVIII.

Në një drejtim të kundërt kanë shkuar zhvillimet gjuhësore në rrethin e shkrimtarëve të shkollës proklasike shkodrane, si i kemi shënuar shkrimtarët katolikë të veriut në fund të shekullit XIX e në fillim

103 Eqrem Çabej, Studime gjuhësore VI, (Pjetër Budi dhe gjuha e tij), fq. 320-321.

104 Selman Riza, Vepra 4 / Pesë autorët më të vjetër..., fq. 357.

105 Rexhep Ismajli, Tekste të vjetra, fq. 289.

të atij XX. Si ka përfunduar Ernest Koliqi, në fund të shekullit XIX këta shkrimtarë e gjuhëtarë zbuluan rrënjët ilire të shqipes dhe u dhanë pas vjetërsisë së gjuhës, pas fjalëve të vjetra shqipe dhe funksionalizimit të tyre. Mirëpo, meqenëse ata ishin klasikë të vërtetë në parimet letrare, përmbysën sintaksën shqipe në vargun poetik dhe për hir të rregullave të metrikës klasiciste shkuan deri te “shtrembërimi i panevojshëm i gjymtyrëve të fjalisë dhe prishja e rendit të natyrshëm të fjalive në periudhë”.¹⁰⁶ Duke komentuar dhjetë vargje të përkthimit të *Eneidës* së Virgilit nga Anton Xanonin, Koliqi tërheq vëmendjen:

“Të vihet roe mungesa e frazeologjisë shqipe, tue përjashtue vetëm thanjen “me ndjellë gjumin”.¹⁰⁷

Ndërsa, po sipas Koliqit, shkrimtarët e shkollës françeskane zbuluan gjuhën e folur të popullit dhe folklorin e tij dhe atë gjuhë e folklor e vunë për bazë të letërsisë së tyre. Të prirë nga ky qëllim, ky rreth i shkrimtarëve, aq sa ndihmuan gjuhën e shkruar me sjelljen e fjalësit, sintaksës e të frazeologjisë popullore në letërsinë e shkruar, po aq e dëmtuan veprën e tyre duke ecur në gjuhë drejt të folmes krahinore apo nëndialektore. Kjo vlen veçanërisht për Fishtën, vepra e të cilit lëngon nga të folmet krahinore e nëndialektore. Kjo është një shfaqje gjuhësore e vërejtur me kohë prej studiuesve të Fishtës (Asdreni

106 Ernest Koliqi, *Dy shkollat letrare shkodrane*, Kisha e Shën Ndoit, Prishtinë, 1998, fq. 36-37.

107 Ernest. Koliqi, *Dy shkollat letrare shkodrane*, fq. 37

dhe studentë shqiptarë në Rumani ankohen në pakuftueshmërinë e gjuhës¹⁰⁸, Vehbi Bala¹⁰⁹, Tahir Kolgjini¹¹⁰, Pal Dukagjini¹¹¹ etj.)¹¹²

Duke vërejtur prirjet e kundërta midis shkrimtarëve të vjetër katolikë të shekujve XVI-XVIII dhe shkrimtarëve të fundshekullit XIX e fillimshekullit XX, Selman Riza përfundonte me dëshpërim:

“Kështu Bogdani u bë konsolidues i autoritetshëm e lëvrues i mëtejshëm i traditës letrare të Buzukut, Budit e Bardhit, traditë kulturore e paçmueshme kjo, të cilën vërtet të mëvonshmit klerikë katolikë më së forti joshqiptarë do ta këpusin brutalisht me shkarravitjet e tyre në shkodrançen e kohës, por të cilën më në fund do ta rimëkëmbë pjesërisht babai merituarazi famëmadh i mbarë filologjisë shqipe: Konstandin Kristoforidhi, Ebasanasi.”¹¹³

Në kë mendonte S. Riza kur thoshte “klerikë katolikë më së forti joshqiptarë” ai nuk e thotë. Në Leonard de Martinon dhe sintaksën e tij joshqipe? Në Anton Xanonin (shqiptar) të cilin e kritikon ashpër edhe për librin e tij *Gramatika shqyp* (Shkodër, 1909).¹¹⁴ Për të zbuluar këtë duhet një shqyrtim tjetër, i cili del jashtë kufijve të këtij studimi.

Në përmbyllje të kësaj teme, gëgnishtes letrare të autorëve të vjetër dhe rrudhjes nëndialektore të shkrimtarëve katolikë të fundshekullit

108 Rexhep Qosja, Asdreni, Rilindja, Prishtinë, 1987, fq. 159-160.

109 Vehbi Bala, Gjergj Fishta-jeta dhe vepra, Ombra GVG, Tiranë, 1998, fq. 157.

110 Tahir Kolgjini, Shpalime rreth Lahutës, Istanbul, 1969, fq. VII.

111 Pal Duka-Gjini, Gjergj Fishta/Jeta dhe veprat, Provinça Françeskanë Shqiptare, 1992 (pa vend të botimit), fq. 227.

112 Shih Bajram Kosumi, Lirika e Fishtës, fq. 94-98.

113 Selman Riza, Vepra 4 / Pesë autorët më të vjetër..., fq. 400.

114 Selman Riza në studimin Historiku e kritika e trajtimeve të dertanishme të nyjave të shqipes nga gramatikanët përshkrues thotë: “Prandaj për kapitullin e Xanonit “Përmbii artikullin” mund të thuhet se ai më së forti nuk është asgjë tjetër veçse një riprodhim pasiv, herë shtrembërues herë përgjysmues, i tekstit të Samiut (Frashërit, plotësim imi, B. K.) mbi “Nyjetë”.

Shih te Selman Riza, Vepra 4, fq. 73.

XIX e fillim shekullit XX, ne do të veçojmë faktin e vetëdijes së lartë intelektuale të autorëve tanë të vjetër për të krijuar një gëgnishte letrare të kuptueshme prej të gjithëve dhe prirjen degraduese të dy shekujve më vonë që, në emër të zbulimit të gjuhës së gjallë të popullit, shkrimtarët të mbyllen në kullat e të folurit nëndialektor dhe në emër të rregullave klasiciste shkrimtarët të përmbysin sintaksën e shqipes deri në çoroditje. Robert Elsie me të drejtë përfundon kapitullin për Bogdanin në *Historinë e letërsisë shqiptare* me fjalët: “Kësisoj, ai e meriton të mbajë cilësimin e babait të prozës shqipe.”¹¹⁵

Fjalësi në letërsinë e vjetër të Veriut dhe fjalësi i Fishtës. Një shfaqje gjuhësore e letrare që dallon Fishtën nga të gjithë shkrimtarët e vjetër katolikë është fjalësi i tij. Në fjalësin e Fishtës ka shumë fjalë turke e arabe, derisa në fjalësin e autorëve të vjetër nuk gjen asnjë ose tepër rrallë ndonjë. Ndryshimi qëndron edhe në konceptin ndaj kësaj çështjeje: derisa autorët e vjetër zbulonin fjalët e vjetra shqipe ose i krijojnë të reja dhe ky ishte koncepti gjuhësor i tyre, Fishta, bashkë me gjuhën e folur sillte në veprën letrare edhe shumë turqizma e arabizma, duke arsyetuar edhe konceptualisht se “Ka’j fjalë turqe ban lazem.”¹¹⁶

Dy poezitë e Budit dhe dy të Fishtës për vdekjen. Është për t’u theksuar se Budi, sado me motiv biblik, ka dy poezi me temë vdekjen. Janë dy poezitë e para, për të cilat Budi thotë se i ka shtuar e përmirësuar e se janë të Palit prej Hasit. Derisa e para ka të bëjë me motivin biblik të Ditës së Gjyqit, e dyta është më tepër e sferës metafizike, një meditim

115 Robert Elsie, *Historia e letërsisë shqiptare*, fq. 56.

116 Ernest Koliqi, *Dy shkollat letrare shkodrane*, fq. 63.

për vdekjen absolute dhe pafuqinë e njeriut ndaj saj. Në gjashtë strofa të saj¹¹⁷ poeti përballë fuqinë e njeriut në të gjitha aspektet (njerëzit e ditur, të rinjtë e bukur, të pasurit, perandorët, gratë sqimatore) përballë vdekjes që i rrënon të gjitha këto fuqi e cilësi njerëzore. Këto strofa, ndër më të mirat në poezinë e Budit, janë të ngjashme në aspektin semantik me hyrjen në poezinë *Ditën e të shuemvet* të Fishtës po edhe me poezinë *Nji lule vjeshtet*.

Zana e Lukë Bogdanit dhe Zana e Fishtës. Në katër strofat e para të poezisë së vetme, të cilën mund ta titullojmë sipas vargut të parë „Duel n’Gurit bukuria“¹¹⁸, Lukë Bogdani paraqet artin e të kënduarit, përmes “Djelz’ e Vashaz’ edhe Gra” që i shërbejnë Zanës dhe këndojnë këngë historike për lavdet e trimave të mëdhenj. Poezia fillon me një si invokacion për Zanën:

Duel n’Gurit bukuria,
Zana si nji sut’ e naltë
Qi s’kish mbreda VENECIA
Të PESHTRIKUT muer maltë.¹¹⁹

Kjo Zanë, në malet e Pashtrikut, së cilës i rrinë pranë djem e vasha dhe gra e këndojnë bashkërisht është figura më autoritative mitologjike shqiptare e Veriut, të cilën Fishta, edhe në këtë mision po edhe në të tjera misione, e aktivizon pothuajse në të gjitha veprat e veta. Të kujtojmë këtu rolin aktiv që kanë zanat shqiptare, po edhe ato të sllavëve, në epin nacional *Lahuta e Malcis*.

117 Pjetër Budi, Poezi, vjersha XVIII, fq. 73.

118 Kështu bën edhe Ibrahim Rugova në *Vepra e Bogdanit*, fq. 184.

119 Pjetër Bogdani, *Çeta e Profetëve*, fq. 149.

Invokacioni. Një element tjetër poetik, i filluar prej Budit dhe i trashëguar prej shumë poetëve të mëvonshëm shqiptarë është invokacioni.

I madhi zot qofsh lëvduom : për gjithë kaqë të mirë,
 Qi s'kam u merituom : me ndonjë shërbëtyre
 Këtë kafshë me mbaruom : zemëra më gjet të lirë.¹²⁰

Naim Frashëri e nis *Istorinë e Skënderbeut* me invokacionin: „Këndo, ëngjëll, urtësinë“, ndërsa Fishta e nis *Lahutën e Malcis* me „Ndihamo, Zot, si m'ke ndihmue!“ Po ashtu, poemën heroiko-komike *Palok Cuca*, Fishta e fillon me invokacionin

Oi Zanë, mbi shekull sod per ty perflitet,
 Se shum, me gjasë, po kish' ti dokrra e fjalë.

Këtë shfaqje poetike te Budi dhe ndikimin e saj e vëren edhe Sabri Hamiti në studimin për Budin.¹²¹

Proza shkencore, morale dhe fetare. Një pjesë e mirë e letërsisë së shkrimtarëve të vjetër të Veriut është prozë shkencore, filozofike, morale e fetare. Përveç *Mesharit* të Buzukut, që ishte botuar pa ndonjë autorizim të veçantë nga Propaganda Fide, kjo e fundit lejonte që në gjuhët vullgare të botoheshin libra fetarë me përmbajtje katekizmi apo me histori të ndryshme biblike. Kjo është edhe arsyeja pse autorët tanë të vjetër kanë mundur të botojnë disa libra të vlefshëm. Përveç kësaj, prelatët e lartë, peshkopët e kryepeshkopët, kanë pasur për rregull të dërgojnë informacione për gjendjen në dioqezat e tyre. Këto relacione, të shkruara latinisht, paraqesin mjaft interes për historinë e Shqipërisë.

120 Pjetër Budi, Poezi, fq. 281.

121 Shih Sabri Hamiti, Studime letrare, fq. 46.

Këto shkrime shqip, që nuk janë letërsi e mirëfilltë, kanë krijuar një traditë e cila ka vazhduar edhe me bashkëkohësit e Fishtës, pra edhe me vetë Fishtën. Këtu nuk mund të flasim për stil shkrimi e gjëra të ngjashme, po kur themi traditë kemi parasysh shkrimin, që ne sot e quajmë publicistik, pra, shkrimet publicistike fetare e morale. Fishta është mjaft i njohur me këtë lloj shkrimi. Edhe në to, bile më shumë se në poezi, mbizotëron stili i tij i pakompromis dhe polemist. Në këto shkrime, sidomos në ato me karakter fetar, apo ato që trajtojnë marrëdhëniet fe-shtet, Fishta është më shumë se askund nën ndikimin e filozofisë fetare mesjetare dhe, kjo ka bërë që në syrin e historianëve dhe të kritikëve, jo vetëm të atyre të ideologjizuar, ai të duket anakronik dhe dogmatist.

Kulti për fjalët e vjetra dhe burimore shqipe. Një çështje tjetër që e lidh Fishtën me Budin është kulti ndaj fjalësit popullor. Budi dallohet nga shkrimtarët e vjetër për fjalësin e pasur, apo më drejt për pasurimin e fjalësit të shqipes me shumë fjalë të shënuara nga ai për herë të parë. Çabej numëron dhjetëra fjalë të tilla të reja.¹²²

Këtë pasion të Budit e kanë vazhduar me të madhe të gjithë shkrimtarët, minorë a madhorë, të romantizmit, nën kërkesën e ringjalljes së gjithçkaje që është shqiptare. Veçanërisht, Fishta dallohet për përdorimin mjeshtëror të frazeologjisë drejtpërdrejt nga gjuha e folur e popullit, e folur në Gropën e Shkodrës.¹²³ Ana e shndritshme e kësaj prirjeje të Fishtës është se ai pasuroi fjalësin e shqipes me fjalë të përdorura në këtë krahinë, sidomos me frazeologji tipike shqipe.

122 Eqrem Çabej, Studime gjuhësore VI, (Pjetër Budi dhe gjuha e tij).

123 Vehbi Bala, Gjergj Fishta – jeta dhe veprat, fq. 157.

Tetërrokëshi popullor. Vargun më të famshëm në poezinë shqipe, tetërrokëshin, i krijuar dhe strukturuar fillimisht në letërsinë popullore, pikërisht në këngët popullore historike, të lindura diku midis shekujve X e XV, e ka përdorur edhe poeti i parë shqiptar, Pjetër Budi, në më se tre mijë vargje të tij, edhe pse H. Lacaj, R. Ismajli e S. Hamiti kanë vënë re disa dallime midis tetërrokëshit të Budit dhe atij popullor.¹²⁴ Pas tij e përdorë edhe Lukë Bogdani, në një poezi të vetme të ruajtur në librin e Bogdanit. Në pjesën më të madhe të poezisë së vet edhe Fishta e përdorë tetërrokëshin popullor. Më parë se nga poetët e vjetër të Veriut, Fishta e ka marrë tetërrokëshin nga letërsia popullore, poende, përdorimi i tij nuk paraqiste ndonjë veçanti sepse pothuajse të gjithë poetët shqiptarë e kanë përdorur më pak ose më shumë tetërrokëshin popullor. Tetërrokëshi i Budit dhe i Lukë Bogdanit është më i afërt me tetërrokëshin e lirikës së Fishtës, por edhe me lirikën e Naimit e të Mjedes.

Shumë studiues e lidhin edhe gjashtëmbëdhjetërrokëshin e Budit me atë të Naimit në *Bagëti e Bujqësi*. Budi ka përdorë këtë varg vetëm në poezinë XXIII (sipas numërimit të R. Ismajlit në librin e *Poezi të Budit*). Këtë lidhshmëri e bëjnë edhe R. Ismajli¹²⁵, B. Xhoka¹²⁶ etj. Këtë përfundim duhet marrë me dyshime, sepse vargu i Budit në këtë vjershë nuk është i njëjtë me atë të Naimit në *Bagëti e Bujqësi*, për këto arsye:

124 Sabri Hamiti vëren se Budi ka thyer tetërrokëshin trokaik popullor, duke futë theksin tonik në rrokjen e dytë e herë-herë edhe në të parën, pastaj me numërimin si dyërrokësh të zanoreve të gjata. Shih Sabri Hamiti, Studime letrare, fq. 47-48.

125 Rexhep Ismajli, Tekste të vjetra, fq. 142.

126 Behar Gjoka, Poetika e Budit, fq. 135-141.

Vargu i Budit ka dy rima: të parën te rrokja e tetë, ndërsa të dytën te rrokja e gjashtëmbëdhjetë; vargu i Naimit ka një rimë në rrokjen e gjashtëmbëdhjetë;

vargu i Budit është i ndarë në mes edhe semantikisht, edhe grafikisht (me dy pika, që shënojnë përfundimin e vargut tetërrokësh); kjo shfaqje nuk hetohet te Naimi, jo më grafikisht, por as semantikisht, përveç ndonjë rasti të rrallë;

hemistiku i parë i vargut të Budit është pjesa kryesore e vargut (kryefjala), derisa hemistiku i dytë është vetëm plotësim i të parit (plotës semantik i kryefjalës); te Naimi nuk është ky fenomen;

te Budi vjersha ka kuptim të plotë edhe nëse lexohet vetëm në hemistikët e parë të vargjeve; te Naimi s'është përsëri ky fenomen.

Gjashtëmbëdhjetërrokëshi i Budit në fakt është varg tetërrokësh, në përputhje të plotë me tetërrokëshin e tij në gjithë vjershat e tij, të ndër-tuar sipas skemës:

Vargu i I: kuptimi themelor;

Vargu i II: plotësim i kuptimit themelor;

Vargu i III: kuptimi themelor;

Vargu i IV: plotësim i kuptimit themelor.

Psh. vjershën II (fq. 73):

Ku janë ata pleq bujarë

Qi qenë përpara ne

E ata trima sqimatarë

Të çpejtë si rrufe?

Po qe se shtrihet kjo stofë tetëshe në dy vargje gjashtëmbëdhjetëshe vargjet do të dukeshin kështu:

Ku janë ata pleq bujarë: *Qi qenë përpara ne*

E ata trima sqimatarë: *Të çpejtë si rrufe?*

Një dëshmi më e plotë: dy vargjet e para të poezisë XXIII janë të njëjtë me katër vargjet e para të poezisë XIX, por te kjo e fundit nuk janë gjashtëmbëdhjetë po tetërrokësh. Katër vargjet vijuese të vjershës XXIII janë dy strofa katërshe të vjershës XXII, po tash tetërrokëshe.

Se pse e bëri Budi këtë dyzim të vargut tetërrokësh mund vetëm të paragjykohet, por duket se nuk e bëri për të krijuar gjashtëmbëdhjetërrokësh (po ta kishte këtë synim nuk do ta bënte vetëm në një vjershë dhe nuk do t'i ndante vargjet me dy pika në mes, një fakt i panatyrshëm për një varg!), por për ndonjë arsye praktike, si psh. mungesë faqesh në libër për ta mbarështruar vjershën tetërrokëshe.

PËRFUNDIME

Edhe pse historianët e letërsisë shqipe kanë paragjykuar një zbrastësi midis letërsisë së autorëve të vjetër të Veriut dhe letërsisë së mëvonshme shqiptare, Fishta është një prej dëshmimeve se jo vetëm ka një kontinuitet të zhvillimit të letërsisë shqiptare, po edhe ka një ndikim të fuqishëm të autorëve të vjetër në letërsinë e mëvonshme. Në këtë kapitull ne zgjeruam fushën e shqyrtimit tonë me rrethanat e lindjes së letërsisë shqiptare për të krijuar një mozaik më të qartë edhe për kontinuitetin e saj deri te romantizmi.

Fishta, jo vetëm që i ka njohur mirë veprat e disa prej autorëve të vjetër, si Budi e Bogdani, por edhe është ndikuar prej tyre. Këto ndikime nisin prej atyre më të gjera, si ndikime të sferës estetiko-etike, kalojnë kah ndikimet e sferës së koncepteve krijuese letrare dhe të ideve poetike, e deri te ndikimet e drejtpërdrejta tekstore letrare. Në shtresën e parë të gjerë të ndikimeve kemi dalluar përkimet e koncepteve estetike të Fishtës me ato të Bogdanit, përkim i cili nuk është ndikim i drejtpërdrejtë, por ndikim nga i njëjti burim. Që të dy, edhe Fishta edhe Bogdani ushqehen me estetikën mesjetare të Shën Augustinit e të Toma Akunit, e këta dy të fundit janë vetëm shkallë të avancuara të estetit të fundit pagan Plotinit. Por edhe këtu shfaqet një dallim i madh: Fishta i ka harmonizuar këto koncepte estetike me disa prej koncepteve themelore estetike të Hegelit, siç është Gjeniu krijues. Në ndikimet etike kemi veçuar konceptin Atme e Fe, i cili është boshti etik i gjithë veprës së Fishtës, e që origjinalisht vjen prej kulturës françeskanë, përmes autorëve tanë të vjetër dhe shkrimtarëve françeskanë shqiptarë. Nën

ndikimin e autorëve tanë të vjetër është edhe Miti i t'Parve, një prej parimeve etike të epikës popullore dhe të veprës së Fishtës.

Nga ndikimet e koncepteve letrare e të ideve e miteve letrare kemi veçuar kultin letrar për gjuhën shqipe, shkrimin e letërsisë fetare, shpirtin kryengritës të letërsisë dhe ligjërimin predikues si mënyrë e shprehjes letrare.

Ndërsa nga ndikimet e drejtpërdrejta letrare kemi shqyrtuar gegnishten letrare të Bogdanit e të Fishtës dhe kemi ardhur në përfundim për dy lëvizje të kundërta: Bogdani e lë gegnishten provinciale të Hasit dhe e përdorë në veprën e tij gegnishten më të zhvilluar të Shkodrës, e cila ishte kryeqendra e Shqipërisë Veriore, në mënyrë që ta kuptojë një rreth sa më i gjerë i lexuesve. Ndërsa Fishta e përdorë gegnishten e rrudhur nëndialektore. Këtu duhet dalluar kthimin e Fishtës te fjalësi i letërsisë së autorëve tanë të vjetër, si tendencë për kthim kah fjalësi burimor shqiptar.

Këto marrëdhënie të veprës së Fishtës me letërsinë e vjetër të Veriut, të vlerësuara si përkime apo ndikime janë dëshmitë më të mëdha për kontinuitetin e letërsisë shqiptare që nga Buzuku e deri te romantizmi dhe për rolin ndikues të letërsisë së vjetër mbi Fishtën.

KREU I DYTË

FISHTA DHE SHKOLLA PROKLASIKE SHKODRANE

I. LETËRSIA E VJETËR E VERIUT DHE FRANÇESKANËT

Një lidhje me letërsinë e autorëve të vjetër të Veriut, por e hapur ndaj rrymave të reja letrare dhe ndaj ideve të reja letrare, në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe në dy dekadat e para të shekullit XX është zhvilluar një tërësi më e vogël letrare shqiptare, me qendër në Shkodër, të cilën historianët e letërsisë ende nuk e kanë pagëzuar, poende nuk e pranojnë njëzëri si tërësi letrare më vete. Kjo letërsi shpesh quhet letërsi e françeskanëve (e parapëlqejnë shumë studiues françeskanë), ose shkollë Shkodrane (përfshirë këtu edhe letërsinë e ashtuquajtur françeskane dhe atë të jezuitëve, bile-bile edhe të gjithë shkrimtarët katolikë të Shkodrës, siç bën Ernest Koliqi, Stuart Man) apo edhe letërsi katolike shkodrane (siç bën Robert Elsie). *Historia e letërsisë shqipe* (1983) nuk e pranon këtë shfaqje letrare si një entitet, po krijuesit e kësaj letërsie i fut ose te pararendësit e letërsisë së Rilindjes Kombëtare (Pjetër Zarishi, Leonardo de Martino, Preng Doçi), ose disa të tjerë i lë te letërsia e Rilindjes Kombëtare (Mjeda) apo te Letërsia shqiptare e periudhës 1912-1939.¹²⁷ Rexhep Qosja, po ashtu, nuk e trajton këtë shfaqje letrare si tërësi më vete. Njërin prej poetëve minorë të këtij rrethi, Ndue Bytyçin, Qosja e trajton më vete, në kuadër të poetëve romantikë, por tërë kohës i dalin përpara argumente kundër romantizmit të Ndue Bytyçit, prandaj Qosja e quan “romantiku i veçuar”.¹²⁸ Edhe pse historianët nuk e kanë trajtuar si entitet letrar, shfaqja e një letërsie e shkruar nga shkrimtarët-priftërinj katolikë të Veriut, po edhe

127 *Historia e letërsisë shqiptare*, (ASH e RPS të Shqipërisë, 1983), Rilindja, Prishtinë, 1989.

128 Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe*, Romantizmi III, Rilindja, Prishtinë, 1986.

nga shkrimtarë laikë të Shkodrës, letërsi e cila në disa elemente është si një vazhdimësi e letërsisë së vjetër filobiblike të shkrimtarëve të Veriut, në njërin anë, po ka elemente të përbashkëta edhe me letërsinë bashkëkohore që krijohej në atë kohë në shqip, në anën tjetër, ndërsa për kah shkolla letrare është shumë e afërt me klasicizmin, kjo shfaqje pra është një fakt i pamohueshëm, prandaj edhe duhet të trajtohet si e tillë.

Ernest Koliqi ka bërë përkufizimin interesant të kësaj shfaqjeje letrare. Ai ka shkruar një studim më të gjerë për këtë fenomen letrar¹²⁹ dhe ka përkufizuar dy shkolla letrare në Shkodër në këtë periudhë: shkollën letrare jezuite dhe atë françeskane. Shkolla letrare françeskane, sipas Koliqit, mbështetet në disa parime krijuese: françeskanët zbuluan vlerën e lartë të gjuhës shqipe dhe fjalën e saj burimore, frazeologjinë e pasur dhe sintaksën solemne të të folurit shqip; zbuluan modelin e shqiptarit, ideal-jetën arkaike të malësorëve shqiptarë, shpirtin patriarkal, solemn e të rrëmbyeshëm të malësorit; ata morën nga malësorët jo vetëm gjuhën dhe shëmbëllimin ideal të shqiptarit, po edhe bëmat e tyre, të mira e të këqija. Këtë botë të re për shkrimtarin shqiptar, autorët françeskanë e bartën në letërsi të shkruar. Por, Koliqi, përveç përkufizimit të faktit të ekzistimit të dy shkollave më vete, nuk bën asnjë përafrim të këtyre dy shkollave me letërsinë tjetër shqiptare, qoftë të traditës apo edhe bashkëkohëse. Edhe historianë të tjerë të mëvonshëm janë marrë me këtë shfaqje si Vinçenc Malaj, Angela Cirrincione etj, por të gjithë kanë ecur gjurmëve të përkufizimeve të Koliqit.

Vlen të theksohet se vetë këta autorë, ata të dy dekadave të para të shekullit XX, me dëshirë e shquanin veten si poetë françeskanë, apo si letrarë katolikë. Revista e famshme HYLLI I DRITËS ka qenë e përm-

129 Ernest Koliqi, *Dy shkollat letrare shkodrane*, Kisha e Shën Ndout, Prishtinë, 1998.

bushur me nocione të tilla, të cilat sinjalizonin jo vetëm letërsinë, por një veprimtari më të gjerë, si: letërsia e katolikëve, shkollë françeskane apo jezuite, letërsi e gegëve etj.; apo shkrime si: *Skanderbegu e Françeskajt*¹³⁰, *Veper arsimore e Françeskajve në Shqypni në shekullin XVII*¹³¹, *Kontributi i elementit Katolik shqiptar*¹³², *Vepra kulturore e elementit katolik në Shqypni*¹³³ etj.

Edhe pse këta shkrimtarë nuk mund të shquhen fund e krye si klasikist. Por nëse në letërsinë shqipe dikush është më i afërt me klasikistët, atëherë është ky rreth i shkrimtarëve, rrethi i shkrimtarëve shkodranë të fundshekullit XIX dhe fillimshekullit XX. Por, duke qenë vazhdimësi e traditës së letërsisë filobiblike të shkrimtarëve të Veriut, në njërin kënd, duke qenë pjesë e idealeve letrare të romantizmit, në këndin e dytë, dhe duke zbuluar mundësi të reja krijuese të gjuhës shqipe dhe duke zbuluar figurën e malësorit shqiptar, kjo letërsi e krijuar nga priftërinj-shkrimtarë katolikë, mund të shquhet si shkollë letrare, sipas përkufizimit të Koliqit, e cila qëndron si një territor ndërmjetës midis mbretërisë së letërsisë filobiblike dhe mbretërisë së letërsisë romantike. Kjo pozitë e kësaj letërsie legjitimohet vetëm nga parimet letrare të letërsisë së tyre, por jo edhe në aspektin kohor. Lidhjen e kësaj letërsie me periudhën pasuese të romantizmit shqiptar e dëshmon edhe vetë

130 P. Antonin Fishta, *Skanderbegu e Françeskajt*, HYLLI I DRITËS, 1930, nr. 7-8, fq. 366-376.

131 P. Atanaz Gegaj O. F. M, *Veper arsimore e Françeskajvet në Shqypni në shekullin XVII*, HYLLI I DRITËS, 1932, nr. 3, fq. 135-138.

132 P. Marin Sirdani, *Kontributi i elementit katolik shqiptar në lamë t'Atdhetaris që prej kohve të vjetra deri në kohën e Turqve të Ri*, HYLLI I DRITËS, 1933, nr. 7-8, fq. 327-351.

133 P. Donat Kurti O. F. M, *Vepra Kulturore e Elementit Katolik në Shqypni*, HYLLI I DRITËS, 1933, nr. 5-6, fq. 234-261.

kryepoeti i këtij rrethi, Gjergj Fishta, i cili në një letër për E. Frashërin në vitin 1922 thotë:

“Por, ma teper, kurrkush s’i ka dhanë shkas ma të fortë literatyres kombtare se na Françeskajt e Shqypnis, të cillen punë, ma mirë se kurgja tjetër, na e ban dishmi kombi, i cilli veprat tona letrare i di mendesh e i perdoron si “fjalë të vjetra” nder shkrime e bisedime të veta...”¹³⁴

Edhe kjo letërsi, sikurse e gjithë letërsia e Qarkut të Veriut është e lidhur ngushtë me kulturën kristiane perëndimore, pra me latinitetin dhe sidomos me lëvizjet e shkollat e reja të latinitetit, si renesansa, klasicizmi etj.

Duke qenë Gjergj Fishta, edhe si njeri, edhe si poet, edhe si prift, i lidhur ngushtë me këtë rreth letrarësh e prelatësh-letrarë, vepra e tij duhet studiuar e vlerësuar në marrëdhënie me letërsinë e këtij rrethi.

Mbase, përimitet e Koliqit për dy shkolla letrare në Shkodër në fund të shek. XIX dhe në çerekun e parë të shek. XX, është i tepërt. Po ashtu, tendenca që të gjithë shkrimtarët katolikë të Shkodrës të përmblidhen literarisht nën shënjuetin **letërsi katolike shkodrane** është e njëanshme dhe e paqëndrueshme. U mbetet historianëve të letërsisë për ta përkufizuar këtë fenomen letrar, mirëpo fakti që është krijuar një letërsi shqiptare, me substrat latinitetin, sipas modelit klasik, mbështetur në letërsinë popullore shqiptare dhe me frymë të idealeve të Rilindjes Kombëtare, është më se e vërtetë dhe më se inicuese.

Është edhe një emërtim tjetër që mund t’i shkojë për shtati kësaj letërsie: **letërsi pararomantike**. Ky është emërtim i pastër letrar dhe nuk paragjykon struktura fetare e rajonale, nënkupton qenësimin e el-

134 Gjergj Fishta, Estetikë dhe kritikë, përgatitur nga Persida Asllani, Hylli i Dritës & Shtëpia e Librit, Tiranë, 1999, fq. 203.

ementeve klasiciste dhe romantike në këtë letërsi (si një letërsi që rri midis letërsisë klasiciste dhe romantike dhe mban lidhje me të dyja këto), çfarë në të vërtetë edhe është kjo letërsi. Problemi me këtë emërtim qëndron sepse ai nuk paragjykon asgjë përmbajtjesore në lidhje me këtë letërsi: as tematikën, as format poetike e as modelet letrare. Poende, e shënjon këtë letërsi të lidhur me romantizmin, si kryetra, e kjo nuk i përgjigjet kësaj letërsie.

Ndoshta më së miri kjo letërsi mund të emërtohet si **shkolla proklasike shkodrane** dhe përfshin shkrimtarët shkodranë, prelatë e laikë, që nga Pjetër Zarishi (1806-1866) e Leonardo de Martini (1830-1923) e deri te Ndre Mjeda (1866-1937) e Gjergj Fishta (1871-1940).

Ky emërtim duhet të argumentohet shkurtimisht.

Pse shkollë?

Edhe pse ky rreth i shkrimtarëve nuk ka një program letrar, megjithatë ka disa rregulla të përbashkëta poetike, të marra prej klasicizmit, si metrika klasiciste dhe format poetike klasiciste. Ka edhe disa tema poetike të përbashkëta: tema fetare, tema patriotike etj. Ka edhe disa karakteristika të tjera letrare të përbashkëta, si: fryma popullore e letërsisë, përdorimi i fjalëve të vjetra shqipe, përdorimi i frazeologjisë popullore, kultivimi i letërsisë satirike etj.

Pse proklasike?

Sepse kjo letërsi nuk është pastërtisht letërsi klasiciste, për shkak të tematikës moderne dhe kombëtare dhe ndërthurjen e kësaj letërsie me letërsinë popullore dhe frazeologjinë popullore, e të gjitha këto blasfemi për klasicistin e vërtetë si Boalo. Por, kjo letërsi është klasiciste në rregullat metrike dhe në format poetike. Është klasiciste sepse është e ndërlidhur me arealin e latinitetit. Është klasiciste sepse është

e ndërlidhur me idealet kristiane, ashtu siç është tërë letërsia klasiciste evropiane.

Pse shkodrane?

Sepse Shkodra qe qendra e këtyre shkrimtarëve, edhe në aspektin gjeografi, edhe në atë kulturor. Shkodra, si qendër e rëndësishme iliro-shqiptare kishte pasur përherë kontakte me botën e latinitetit, që është substrati i këtyre shkrimtarëve.

Pse kjo letërsi nuk mund të njëjtësohet me Qarku katolik të Veriut, ashtu si e ka përkufizuar atë Çabej?

Sepse kjo letërsi dallon shumë nga letërsia filobiblrike e autorëve të vjetër, edhe në shkallën e literaritetit edhe në format poetike, po edhe në tematikë e në idetë poetike.

Pse nuk është i plotë emërtimi “shkrimtarë katolikë të Veriut”, apo “shkrimtarë katolikë të Shkodrës”?

Sepse disa shkrimtarë që janë pjesë e kësaj shkolle, si Luigj Gurakuqi, Kolë Thaçi etj., nuk e kanë kultivuar letërsinë fetare që të mund të quhen “shkrimtarë katolikë”, ndërsa disa shkrimtarë të tjerë shkodranë të besimit katolik, si Hilë Mosi, nuk i përkasin kësaj shkolle letrare.

Pse nuk është i plotë emërtimi “shkollë françeskanë” apo “shkollë jezuite”?

Sepse elementi dallues i këtyre dy shkollave bartet te elementet jo-letrare, përkatësisht te përkatësia e autorëve të kësaj letërsie në njërin prej rrethesh katolike të shqiptarët. Letërsia e krijuar edhe prej etërve françeskanë, edhe prej etërve jezuitë, po edhe prej disa poetëve laikë shkodranë, ka të përbashkëta disa elemente letrare dhe kulturore, dhe janë pikërisht këto elemente letrare e kulturore që e bëjnë të mundur përkufizimin e kësaj letërsie si entitet letrar më vete. Përkatësia fetare

e autorit nuk e paragjykon vetë letërsinë, edhe pse mund ta ndikojë, sepse atëherë letërsia romantike evropiane do të duhej të ndahej në letërsi romantike katolike, në letërsi romantike protestante, në letërsi romantike ortodokse e kështu me radhë.

Prandaj, ne besojmë se emërtimi *shkollë proklasike shkodrane* e përkufizon më së miri, më saktë dhe më përmbledhshëm, shfaqjen letrare shkodrane të fundit të shekullit XIX dhe e fillimit të shekullit XX, e cila në parimet letrare, e jo në kohë, rri midis klasicizmit dhe romanizimit. Mund të kemi një pajtim me Ernest Koliqin dhe shumë studiues të tjerë se brenda këtij rrethi letrarësh ka rrethe e grupe letrarësh me ndonjë karakteristikë të veçantë, si rrethi i letrarëve françeskanë, rrethi i letrarëve jezuitë, mirëpo të gjithë këta, bashkë me shkrimtarët laikë, kanë të përbashkëta ato karakteristika dhe elemente letrare, të cilat e bëjnë të mundshme t'i shquajmë si një shkollë letrare apo si një rreth unik letrar. Në shqyrtimin tonë ne do ta përdorim këtë emërtim.

II. FISHTA DHE SHKOLLA PROKLASIKE SHKODRANE (MARRJET)

Sado që përkufizimet e historianëve të letërsisë nuk janë të plota e të argumentueshme deri në fund për letrarët shkodranë, kryesisht etër françeskanë e jezuitë, fakti që këta etër kanë prodhuar letërsi, qoftë në fushën e gjuhësisë, në fushën e mbledhjes, të sistemimit dhe të studimit të letërsisë popullore, kanë botuar revistat e tyre dhe kanë njohur jo vetëm veprat e njëri tjetrit, por edhe veprat e traditës së letërsisë së shkrimtarëve të Veriut, këto fakte janë të mjaftueshme për të pranuar mundësinë e ndikimeve letrare nga njëri te tjetri krijues. Është tipik ndikimi i Pjetër Zarishit dhe i Leonardo de Martinos në metrikën e poetëve të tjerë të shkollës proklasike shkodrane: të gjithë poetët e këtij rrethi, përveç kur shkruajnë tetërrokëshin tradicional shqiptar, i përmbahen me rreptësi metrikës klasiciste dhe vargjeve tradicionale klasiciste. Studiuesi i kësaj letërsie Tonin Çobani kështu thotë për këto ndikime:

„Vepra e Pjetër Zarishit, megjithëse u botua vetëm pjesërisht dhe pas vdekjes së poetit (sepse u zhduk ose u mbajt fshehur), u përhap në popull gojë më gojë, duke ushtruar, kësaj, një ndikim të pandërpreë te poetët e mëvonshëm të Veriut, si Leonardo de Martino (1830-1923), Ndre Mjedja (1866-1937), Gjergj Fishta (1871-1940) etj., të cilët i kaluan nëpër duar dorëshkrimet e poezive të tij.“¹³⁵

Meqenëse ky kapitull synon të hedh dritë mbi marrëdhëniet letrare të Fishtës me shkrimtarët e tjerë shkodranë, atëherë ndikimet e

135 Tonin Çobani, Pjetër Zarishi dhe Krijimi i Rruzullimit, Botimet Toena, Tiranë, 2007, fq. 10.

brendshme letrare të rrethit të poetëve proklasikë do t'i kërkojmë në këtë relacion: sa është ndikuar Fishta në fillimet e veta letrare apo më vonë nga parimet dhe qëllimet letrare që i ka kultivuar ky rreth i poetëve proklasikë dhe sa i ka ndikuar vetë Fishta krijuesit e mëvonshëm të kësaj shkolle?

Kjo pyetje është kuptimplote kur të kihen parasysht tri fakte.

Fakti i pari ka të bëjë me jetën e Fishtës. Katundi ku lindi Fishta dhe rrethi i tij, me qendër në Troshan, ishte i lidhur me shekuj për traditën françeskane.

“Mbi Shkrep të Troshanit gjinden edhe sot rrenojat e një mungadje jetike, ku françeskanët dikurë kishin ndejen...”¹³⁶

Fishtën e ka pagëzuar me emrin Zef françeskani Atë Leonardo de Martino, poet me ndikim dhe përkthyes. Si fëmijë, Fishta bëri shkollë në Shkodër (1877) e në Troshan (1880), në të dy rastet në shkollat e etërve françeskanë, i shtyrë dhe i ndihmuar nga Atë Mariani nga Palmanova, një misionar françeskan nga Venediku, i njohur në Kosovë si Marian Pasha. Ai pati për mësues etërit françeskanë e edhe bashkënxënësit e tij do të jenë më vonë etër françeskanë apo edhe shkrimtarë, sikurse edhe vetë Fishta. Në vitin 1886, sipas kërkesës së Atë Bernardini da Portogruaro, kryetar i Urdhërit Françeskan, një numër i vogël i nxënësve të Troshanit caktohen t'i kryejnë studimet në Provincën Françeskane të Bosnjës, pikërisht në manastirin e Guca Gorës afër Travnikut (viti i provës), pastaj në Kuvendin Sutiska (mësimet e filozofisë) dhe në fund edhe në Livno (mësimet e teologjisë). Në mesin e këtyre studentëve janë edhe Gjergj Fishta, Pashkë Bardhi etj. Disa vjet

136 Pal Duka-Gjini, Gjergj Fishta/jeta dhe veprat, 1992, Provinça Françeskane Shqiptare, 1992 (pa vend të botimit) fq. 20; Duka-Gjini citon Fabianich: Storia dei Frati Minori in Dalmazia e Bosnia II.

pasi kthehet në Shqipëri, më 1902, emërohet drejtor i shkollës frat-nore (françeskane) të Shkodrës. Tërë jeta e më pastajme e Fishtës do të jetë e lidhur me françeskanët, me kishën e tyre, me hallet dhe problemet e tyre.¹³⁷ Më 1921 Fishta themelon dhe bëhet drejtori i parë i gjimnazit Illuricum (1921-1947, me ndërprerje). Më 1935 emërohet Provincial i Françeskanëve të Shqipërisë, shkalla më e lartë në hierarkinë e Françeskanëve në Shqipëri. Kjo lidhje e përjetshme e Fishtës me françeskanët s'ka se si të mos hetohet edhe në veprën e tij.

Fakti i dytë ka të bëjë me revistën *Albania* të Faik Konicës dhe me një revistë françeskane. Poezitë e tij të para Fishta i ka botuar te *Albania* e Faik Konicës. Prej vitit 1899 kur Fishta boton te *Albania* vjershën e parë *Z. Anselmit Lorocchio në Vienë* e deri në vitin 1905 ai boton dhjetëra poezi dhe këngë popullore. Poezitë origjinale janë kryesisht satirike. Fishta e ka krijuar emrin e vet poetik në *Albania* të Faik Konicës.¹³⁸ Vetëm tri vjet më vonë, më 1908, në vitin e Kongresit të Manastirit, ku Fishta luajti një rol thelbësor, ai kishte emër të rëndësishëm në letërsinë shqipe. Pal Duka-Gjini thotë:

“Tashma Fishta njihej e çmohej prej tanë Shqipnis posi ma i madhi shkrimtar i gjuhës e i letrave arbnore”.¹³⁹

137 Të dhënat biografike janë përdorë kryesisht nga biografi i Fishtës Pal Duka-Gjini, Gjergj Fishta/jeta dhe veprat.

138 Faik Konica e botoi *Albania*-n në Bruksel më 25 mars 1897 dhe e mbylli në Londër më 1909. Vlerësimi për rolin e Albanias në zhvillimet kulturore dhe politike shqiptare në kapërcyell të dy shekujve ende nuk është i qëndrueshëm dhe ndryshon nga vlerësimi “një nga organet kryesore të shtypit shqiptar të Rilindjes” (në *Historia e popullit shqiptar*, II, Tiranë, 2002, fq. 345), deri te “organi më i rëndësishëm i shtypit shqiptar në zgrip të shekullit” (Robert Elsie, *Historia e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Pejë, 2001, fq. 270).

139 Pal Duka-Gjini, *Gjergj Fishta/Jeta dhe veprat*, fq. 63.

Duke pasur parasysh patosin dhe subjektivitetin e Pal Duka-Gjinit në vlerësimin dhe cilësimin e rolit të Fishtës në shumë veprimtari letrare e joletrare, ne mund ta relativizojmë pak vlerësimin e tij, mirëpo megjithatë mbetet fakti se qysh në atë kohë Fishta kishte bërë emër të rëndësishëm në letërsinë shqipe.

Ndërsa në të njëjtën kohë Fishta do të botojë lirikat e tij fetare në revistën *Elçija e zemrës së Krishtit*, që nga viti 1902 e deri në vitin 1913, një revistë françeskane e njohur vetëm në rrethet françeskane. Pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë Fishta do të themelojë revistën *Hylli i Dritës* (1913-1940), në të cilën do t'i botojë të gjitha këngët e reja të *Lahutës së Malcis*, pothuajse të gjitha shkrimet e tij të diskursit politik, social, fetar dhe kulturor, disa nga tekstet dramatike si dhe disa nga lirikat e tij. Lirikat fetare dhe disa shkrime me diskurs fetar do të vazhdojë t'i botojë në *Zani i Shna Ndout* (1914-1938).

Botimi i shkrimeve të para poetike të *Albania* e Faik Konicës, revista më e famshme kulturore e shqiptarëve në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX, mund të jetë rastësi, apo i ndikuar nga autoriteti i revistës, të cilin e ka lakmuar çdo fillestar i poezisë. Por, shikuar nga prizmi i marrëdhënieve të krijuesit me lexuesin, Fishta vazhdonte letërsinë e tij në dy binarë, ashtu sikurse e kishte vënë vetë jetën e tij: letërsinë fetare e publikonte në një revistë fetare të njohur për një rreth të ngushtë lexuesish, përderisa letërsinë satirike dhe lirikat e tij i botoonte në revistën më të famshme shqiptare, duke i tejkaluar kufijtë e ngushtë të rrethit të shkrimtarëve katolikë të Shkodrës dhe duke bërë emër në të gjitha qarqet kulturore shqiptare të kohës.

Fakti i parë, vetë jeta e Fishtës brenda rrethit françeskan dhe fakti i dytë, komunikimi letrar me tërë shoqërinë shqiptare nuk e kundër-

shtojnë njëri-tjetrin, por krijojnë binomin që përmban fenomenin Fishtë: gjatë tërë jetës së tij Fishta do të jetë edhe prift dhe do të shkruajë shkrime letrare dhe akademike e publicistike për fenë dhe çështje që kanë të bëjnë me fenë, e të cilat shkrime do të kenë rol të rëndësishëm vetëm brenda rrethit françeskan, si dhe do të shkruajë letërsi të mirëfilltë, lirika, poezi satirike, drama dhe epin nacional, të cilat do të kenë rëndësinë e tyre, jo vetëm për lexuesin shqiptar, por edhe për idealin kombëtar të shqiptarëve.

Fakti i tretë ka të bëjë me shkrimin e poezisë fetare dhe të poezisë satirike. Shkrimi i poezisë fetare, kryesisht lirike, ishte traditë letrarro-fetare e poetëve të shkollës proklasike shkodrane, punë të cilën e bëri edhe Fishta. Ndërsa poezinë satirike e nisi Leonardo de Martino, e pritur mjaft mirë në rrethet françeskane, të cilën punë po ashtu e vazhdoi Fishta.

Në dritë të këtyre fakteve Fishta, si poet, në radhë të parë, po edhe si njeri i angazhuar në institucionet e në jetën fetare, në jetën kulturore e politike, nuk mund të mos ishte i ndikuar nga parimet, idetë dhe vlerat që qarkullonin, ose konsideroheshin të rëndësishme nga minoriteti françeskan. Në anën tjetër, ai nuk mund të vetëngujohej në kështjellën françeskane, sepse ai dëshironte të jetë gjithë kohën poeti i kombit shqiptar.

Ndikimet nga letërsia që kultivohej në rrethet e poetëve shkodranë Fishta i absorboi nga disa drejtime: në çështje të metrikës klasiciste, në shkrimin e poezisë satirike, në trajtimin e temave të përjetshme klasiciste (jeta, vdekja, misioni i njeriut), në dashurinë për gjuhën e folur të popullit dhe futjen e saj në letërsi, në rikëndimin e letërsisë popullore, në shkrimin e poezisë fetare dhe në frymën patriotike të artit, e cila

nuk ishte në përputhje me klasicizmin, po ishte në përputhje me rolin e kishës katolike në Shqipëri dhe me letërsinë e romantizmit.

II. 1. Metrika klasiciste

Rrethi i shkrimtarëve proklasikë të Shkodrës të fundshekullit XIX, Pjetër Zarishi, Leonardo de Martino, Anton Xanoni, Kolë Thaçi etj. sollën me vrull në letërsinë shqipe parimet, rregullat dhe metrikën klasiciste. Ata shkruan vargje të përkryera nga aspekti i metrikës. Disa nga këta poetë shkojnë aq skajshëm në klasicizmin e tyre sa që edhe sintaksën e gjuhës shqipe e përmbysin për t'ia përshtatur, qoftë rregullave metrike, qoftë parimeve të klasicizmit. Duke shkruar për nxënësit e Xanonit, Ernest Koliçi thotë:

“nji tjetër karakteristikë e mënyrës së shkrimit të nxansavet të Xanonit, sidomos në hartime poetike, qe shtrembërimi i panevojshëm i gjymtyrvet të fjalës dhe prishja e rendit të natyrshëm të fjalëve në periudhë. Ky cenim shpesh tepër i guximshëm bëhej për t'i dhanë vjershës një farë tonaliteti klasik”.¹⁴⁰

Dy prej këtyre shkrimtarëve kanë shkruar edhe doracakë metrikë: i pari Luigj Gurakuqi ka botuar *Vargnimi në gjuhën shqype* (1906), të parin doracak për metrikën shqipe në letërsinë shqipe, ndërsa i dyti, Anton Xanoni ka botuar *Prisi në lamë të letratyrës* (1911-1912).

Pastaj, këta shkrimtarë iu kthyen librave të Budit e të Bogdanit për të gjetur fjalët e vjetra shqipe, një pjesë e tyre u bënë puristë të skajshëm në gjuhën poetike, përdorën vargje të reja, si njëmbëdhjetërokëshi, Pjetër Zarishi lavdërohet si “njëri nga nismëtarët dhe risimtarët e krijimit të sonetit në poezinë shqipe, sepse ai e promovoi edhe ciklin e

140 Ernest Koliçi, *Dy shkollat letrare shkodrane*, fq. 36-37.

soneteve, si një tërësi më e madhe poetike¹⁴¹, Leonardo de Martino lavdërohet për përdorimin risimtar në shqip të vargjeve jambike dhe të formave të ndryshme risimtare të strofës poetike.¹⁴²

Këta shkrimtarë krijuan rregull në vargun shqip, në kuptimin e rregullave metrike klasiciste. Ndërhynë në sintaksën e shqipes, edhe atëherë kur dëmtohej ajo, vetëm për ta përshtatur me rregullat e metrikës klasiciste. Krijuan në shqip, sipas ndonjë modeli klasik, këmbë, vargje e strofa të reja. Përkthyen në shqip disa nga kryeveprat e letërsisë botërore, si *Iliada*, *Vilhelm Teli* etj. Edhe atëherë kur idetë poetike të ndonjërit prej tyre janë të varfra, si te Kolë Thaçi, vargu i tij që shkëlqyes në harmoninë e tij metrike.

Fishta ka vazhduar këtë traditë të kultivimit të metrikës klasiciste, jo vetëm nën ndikimin e poetëve proklasikë shkodranë, por edhe nën ndikimin e latinitetit në përgjithësi. Lirikat e tij satirike, patriotike, mendimtare dhe ajo fetare janë shkruar me vargje sipas metrikës klasiciste. Fishta është i disiplinuar në respektimin e rregullave të kësaj metrike. Ashtu siç bënin sivëllezërit e tij poetë, rrezikonin sintaksën e shqipes për hir të parimeve metrike klasiciste, edhe Fishta do të rrezikojë lexueshmërinë dhe tingëllimin e vargjeve të tij lirike për shkak të përdorimit të rreptë të metrikës klasiciste.¹⁴³ Edhe ndërtimi i strofave të Fishta është po ashtu sipas modelit të metrikës klasiciste. Është për t'u dalluar këtu njëmbëdhjetërokëshi i mrekullueshëm i Fishtës në poemën heroike-komike *Palokë Cuca*, ndoshta kryevepra satirike shqipe (edhe pse e papërfunduar), në të cilën Fishta ka dëshmuar fuqinë e

141 Dr. Milazim Krasniqi, *Soneti në poezinë shqipe*, PEN Qendra e Kosovës, Prishtinë, 2005, fq. 42.

142 *Historia e letërsisë shqiptare* (1989), fq. 145-146.

143 Shih Bajram Kosumi, *Lirika e Fishtës*, Botimet Toena, Tiranë, 2004, fq. 94-106.

madhe shprehëse të shqipes në njëmbëdhjetërokëshin e tipit italian, të sjellë në Shqipëri vetëm disa dekada më parë.¹⁴⁴ Poema është shkruar në vitin 1922, në kohën më ideale të pjekurisë së poetit dhe të pëlleshmërisë së tij letrare. Por edhe në poemën satirike *Bujari*, e shkruar më 1907, me vargje të përziera, njëmbëdhjetërokëshi, shtatërokëshi dhe pesërokëshi janë mjaft shprehës dhe harmonikë. Në të njëjtën kohë, në lirikat patriotike ose mendimtare e fetare të poetit shfaqet fakti i përkufizuar si “vështirësi e leximit” të tekstit të Fishtës. Ky fenomen shfaqet më pak te poezia satirike. Për dallim nga lirikat e tjera, në të cilat mendimi dhe figura e Fishtës i nënshtrohet metrikës klasiciste, në poezinë satirike metrika klasiciste i nënshtrohet mendimit dhe figurës së Fishtës. Do të thotë, përdorimi funksional apo jo-funksional i metrikës klasiciste nuk lidhet me kohën apo me pjekurinë e poetit, po me zhanrin në të cilin shkruan poeti. Kjo është dëshmia më e sigurt se Fishta në fakt ishte një poet satirik i lindur, në çka edhe ai vetë besonte në fillimet e tij letrare.

Në tre numra të *Hyllit të Dritës* Fishta botoi përkthimin e një teksti metrik latin, të quajtur *Prozodi latine/ Rregulla të përgjithta mbi shkurt-si e gjatsi të rrokjevet*¹⁴⁵ e të shkruar në vargje. Kjo prozodi paraqet një argument të mirë për të kuptuar rëndësinë që Fishta i jepte metrikës klasiciste. Themë këtë për arsye se kjo prozodi në vetvete nuk paraqiste ndonjë interes për metrikën shqipe e as për poetët e kritikët e poezisë shqipe. Në të ka rregulla të metrikës latine, të cilat si të tilla nuk u hynin në punë poetëve shqiptarë. Kështu, rregullat metrike:

144 Ernest Koliqi, *Fishta interpret e shpirtit shqiptar*, Kuvendi Françeskan, Gjakovë, 1997, fq. 34; Rexhep Qosja, *Histori e letërsisë shqipe - Romantizmi I*, 1984, fq. 334.

145 P. Gjergj Fishta O. F. M., *Prozodi latine/Rregulla të përgjithta mbi shkurt-si e gjatsi të rrokjevet*, HYLLI I DRITËS, 1923, nr. 2, 3 dhe 7.

Kshtu gjatë shqyptohet **Aer e Thalia**,
 Si edhe **Corea, Dia, Cytherea**;
 Por n'vjershtë e shkurtë gjithmon del **Symphonia**.
 Veç shka se n' **Cythorea** e në **Corea**
 Shumë herë vjerrshtori zanin e perdini,
 Si edhe prej t'gjatës aj zuer dy rrokje t'rea.¹⁴⁶

nuk u hyjnë në punë përveç se studiuesve të poezisë latine, studentë apo historianë të letërsisë. Por Fishta e përkthen këtë prozodi, në vargje, e kjo do t'i ketë shkaktuar mjaft vështirësi dhe e boton në tri vazhdimë të *Hyllit të Dritës*, e gjithë këtë punë nuk do ta kishte bërë kot së koti. Ne besojmë se Fishta nuk e bëri këtë përkthim vetëm për studiuesit e poezisë latine, por edhe për vetë poetët shqiptarë, sa do që këta të fundit shkruanin shqip e jo latinisht, për të vënë në pah rëndësinë e madhe që poetët latinë me famë botërore i kushtonin prozodisë, përdorimit të rrokjeve të gjata e të shkurtra, përdorimit të zanoreve të shkurtra e të gjata dhe të rregullave të tjera metrike. Me këtë *Prozodi latine* Fishta sillte një argument më shumë për metrikën e tij klasiciste dhe për shkrimin e poezisë shqipe sipas rregullave të kësaj metrike.

II. 2. Poezia satirike

Në kulturën helene poezia satirike (komedia) ka lindur pas epitet dhe tragjedisë. Ky fakt nuk është një rregull i shkruar, por është një rend i krijuar, mund të themi historikisht, në zhvillimin e një letërsie. Kur një letërsi ndjehet e ngopur me vetveten, lind

146 P. Gjergj Fishta O. F. M., *Prozodi latine/Rregulla të përgjithta mbi shkurtsi e gjatsi të rrokjevet, HYLLI I DRITËS*, 1923, nr. 2, fq. 71.

satira me fëmijët e vet: ironinë dhe sarkazmin. Vetë fjala *satirë*, në etimologjinë e saj koincidon me fatin historik të lindjes së satirës, atëherë kur letërsia ndjehet e ngopur. Fjala *satira* rrjedh prej fjalës latine *satur*, që d.t.th. i mbushur, i ngopur, i mbushulluar.¹⁴⁷ Në historinë e letërsisë shqipe satira lind pas veprës së Naim Frashërit. Fishta dhe Çajupi janë dy patrikët e vërtetë të poezisë satirike në shqip, edhe pse disa nga bejtexhinjtë kanë shkruar edhe ndonjë poezi satirike.¹⁴⁸ Po ashtu edhe një romantik tjetër, Françesk Anton Santori (1819-1894) ka shkruar me sukses fabula dhe vjersha satiriko-humoristike.¹⁴⁹ Mirëpo këto shkrime, sikurse edhe të tjerat të Santorit nuk kanë komunikuar deri vonë me lexuesin në Shqipëri, i cili vend është mjedisi kulturor shqiptar, atëherë edhe ndikimi i kësaj poezie në rrjedhën e poezisë shqipe, konkretisht në poezinë satirike, është më se i kufizuar.

Në fillimet e tij letrare, deri kah fundi i dekadës së parë të shekullit XX Fishta ishte i bindur se delli i tij poetik shfaqej në poezinë satirike. Satira e Fishtës shfaqej krejt ndryshe nga satira e bejtexhinjve, po ndryshe edhe nga pjesa më e madhe e satirës së Çajupit. Satira e Fishtës ishte më intelektuale, më sarkastike, më literare dhe më sociale. Përveç dallimeve në idetë poetike, satira e Fishtës dallonte edhe në vargun përsosmërisht të kultivuar sipas metrikës klasiciste. Fishta në satirën e vet nuk shfaqej si një poet në krijim, po si një poet i përfunduar. Kështu përfundon edhe studiuesi i hershëm i tij, Vehbi Bala:

147 Recnik knjizevnih termina, Nolit, Beograd, 1992, fq. 744.

148 Dr. Mahmud Hysa, Hyrje në letërsinë shqiptare, ETMM të Kosovës, Prishtinë, 2000, fq. 362, thotë: "Hasan Z. Kamberi (1743-1810) me disa poezi të tij inauguron në mënyrë implicite poezinë satirike në letërsinë tonë...".

149 Rexhep Qosja, Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi II, Prishtinë, 1984, fq. 198.

“Një nga manifestimet më të fuqishme të gjeniut Fishtë është padyshim krijimtaria e tij satirike.”

Dhe më tej:

“...vepra Palokë Cuca është kulmi artistik i Fishtës, veçanërisht në satirë. (...) Asnjë nga veprat e tij nuk ka më pak dobësi artistike sesa kjo vepër, e cila e ruan ende sot aktualitetin e valabilitetin e vet.”¹⁵⁰

Ku e morri Fishta këtë përkushtim intelektual e letrar për satirën dhe këtë guxim për të besuar se mund të mbërrinte kurorën e artë të poetit me shkrimin e satirës?

Edhe Ernest Koliqi, edhe Pal Duka-Gjini edhe Alfred Çapaliku përmendin poezinë shpotitëse popullore që këndohej nëpër malësi dhe poezinë satirike qytetare shkodrane si burim i mundshëm i dellit satirik të Fishtës. Koliqi përmend lojën e kapuçave dhe këngët që këndonte fituesi për palën humbëse, si një burim ku mund të jetë frymëzuar ndjenja satirike e Fishtës:

“Shqiptari mendje-shquet, i pakënaqun e shpesh herë i zemruem për punët e këtij shekulli, dy mënyrë përdori për të shfryem ngashrimin e ndiesivet qi i grumbulloheshin të turrshme përmbrenda: armën ndër rasa ekstreme e talljen ndër tjerat”¹⁵¹.

Sigurisht që ky qe një burim frymëzimi për gjeniun krijues të Fishtës, por një burim tjetër më me ndikim qe padyshim letërsia antike greke e romake, të cilën Fishta e adhuronte. Vetë fakti se shumë tituj e nëntituj të veprave të tij satirike korrespondojnë me tituj të veprave antike greke e romake, si *Gomari i babatasit*, *Metamorphosis* etj., apo thjesht janë shkruar në latinisht, si *Jus Gentium*, *Epitalamion*, *Exodon*

150 Vehbi Bala, Gjergj Fishta-jeta dhe vepra, Tiranë, 1998, fq. 88 dhe 97-98.

151 Ernest Koliqi, Fishta intepret i shpirtit shqiptar, fq. 23.

etj., dëshmon këtë konstatim. Por, është edhe një mësues tjetër që hapi rrugën për poezinë satirike në shkollën proklasike shkodrane: është poeti arbëresh i shqiptarizuar Atë Leonardo de Martino. Ky Atë kaloi shumë kohë në Kuvendin e Troshanit dhe u dha mësimet e para shumë etërve të mëvonshëm françeskanë, si Fishta, Gjeçovi, Prennushi, Anton Harapi, Pashko Bardhi¹⁵² etj. Sipas Koliqit, de Martino që njohës i shkëlqyeshëm i letërsisë klasiciste, shkruante vjersha në italisht e në shqip, në vjershat e tij futi në përdorim një fjalës tepër të gjerë, trajta të ndërlikuara metrike të italishtes i shartoi në shqip dhe bëri përkthimin e disa autorëve të mëdhenj italianë. Mirëpo, thekson Koliqi, se “ku spikatë origjinaliteti i De Martinit asht në vjerrshat gaztore”¹⁵³

Fishta do të ketë mësuar nga Atë Leonardo de Martino në çështje të poezisë satirike. Koliqi dëshmon se de Martino është i pari poet shqiptar i cili me fjalë të përditshme nga të folurit shqip përshkruante në hollësi një zakon shqiptar, të cilin përfundim po t’ia mballosnim Fishtës do të delte kështu: Fishta është i pari poet shqiptar, i cili me fjalë nga gjuha e përditshme e shqiptarit shfaqti ndjenjat e idetë, dhe figurat më të larta poetike në poezinë satirike.

Në veprën e tij të vetme *L’Arpa d’un Italo-Albanese* (1881) është e botuar vetëm një vjershë satirike: *Kang Llafegjore*, prej 23 strofave treshe. Po ajo që dallon në këtë vjershë është teknika ndërtimore e afërt me poezinë popullore dhe rrjedhshmëria e fjalëve e vargjeve të poezisë. Poezia përfundon me vargje pothuajse të ngjashme nga poezia popullore:

Borxhin tem, un’ qe, e marova;

152 Ernest Koliqi, Dy shkollat letrare shkodrane, fq. 61-62.

153 Ernest Koliqi, Dy shkollat letrare shkodrane, fq. 63.

Mir o keq, ket ket kang ta çova;

Tash po m'fal, se të shurdhova.¹⁵⁴

Me vetëm një poezi satirike vështirë është të besohet se De Martino ka krijuar autoritetin e poetit të madh satirik. Mbase poezi të tjera satirike janë humbur ose ende nuk njihen. Por, supozimi se Fishta ka mundur të ndikohet prej De Martinos në satirë mund të konsiderohet i vërtetë, së paku për dy arsye:

së pari, vetë fakti që De Martino ka kultivuar poezinë satirike në një rreth poetësh që nuk e kultivojnë atë, është ndikues te të tjerët;

së dyti, strukturat tekstore sikur popullore të kësaj poezie janë të afërta me ato të Fishtës, e kjo e bën të mundshme të flitet për ndikime.

II. 3. Poezia fetare

Shkrimi i poezisë me temë fetare është një fakt i përbashkët për krejt letërsitë evropiane, sidomos në Mesjetë deri te humanizmi dhe renesanca evropiane. Edhe në letërsinë shqiptare është kultivuar ky lloj i letërsisë në të gjitha qarqet letrare¹⁵⁵ para letërsisë së periudhës së Rilindjes Kombëtare. Te qarku i shkrimtarëve katolikë të Veriut Pjetër Budi (në mos Pali i Hasit?) është poeti i parë që shkroi vjersha fetare, dhe do të përcillet prej Pjetër Bogdanit e deri te poetët e shkollës proklasike shkodrane, shumica e të cilëve, krahas letërsisë laike kanë kultivuar edhe letërsinë fetare, veçanërisht poezinë. Në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe sidomos në dekadat e para të shekullit XX, atëherë kur kushtet e zhvillimit të fesë katolike në trevat shqiptare u përmirësuan dukshëm, shkrimtarët nga radhët e kishës katolike botuan edhe

154 Atë Leonardo De Martini, Harpa Arbnore, Shpresa & Faik Konica, 2002, fq. 126.

155 Përkufizim i njohur i Eqrem Çabejt, në Studime gjuhësore V / Për gjenezën e literaturës shqipe, Rilindja, Prishtinë, 1975, fq. 101-135.

revistat e tyre, në të cilat u botua pjesa më e madhe e letërsisë fetare. Edhe etërit françeskanë bënë po kështu, poende prinë në disa drejtime, për shkak të gatishmërisë së tyre për të ndihmuar çlirimin e kombit shqiptar nga zgjedha osmane. Më të njohura nga të përkohshmet e françeskanëve janë *Elçija e zemres së Krishtit*, më vonë u bë *Lajmtari i zemres së Krishtit*, *Zani i Shma Ndout* etj.

Prijatarët e kësaj shkolle, Pjetër Zarishi dhe Leonardo De Martino kanë shkruar kryesisht poezinë fetare dhe fare pak atë laike. Poezia e Pjetër Zarishit, ajo që njihet sot, veçanërisht trembëdhjetë tingëllimet e *Krijimit të Rruzullimit* janë poezi fetare, por jo nga ato që shkruhen për përdorim në mesha e në festa kishtare, pra kalojnë kufijtë e poezisë didaktike dhe arrijnë sferën e poezisë metafizike për kah tema dhe alegorike për kah struktura ligjërimore.

Ishte gjithmonë Zoti i pafill e i vetun:

Tjetër, posë mqymit, hiq kush s'u diftote;

Ishte kush ishte vetvedi i pështetun,

Plot e kundent me vete, veten gzote.¹⁵⁶

Tema metafizike-fetare, ligjërimi alegorik dhe metrika klasiciste e veçojnë poezinë e Pjetër Zarishit, ndërsa e afrojnë me poezinë e Sibillave të Bogdanit dhe me poezinë e Fishtës si *Gurrave të Jordanit*.

Për dallim nga Zarishi, Leonardo De Martino shkruan poezinë fetare sipas modelit të poezisë popullore dhe me stil ligjërimi të përditshëm. Poezia e tij merr formën e lutjes fetare, të himnit fetar ose të tekstit didaktik fetar.

De Martino shkruan kësi vargje:

Falemi, Regjinesha-Ama e mishirmshme,

156 Tonin Çobani, Pjetër Zarishi dhe krijimi i rruzullimit, 2007, fq. 82.

Jeta, ambelsimi,-shpnesa e dobishme;

Falemi, o Mri!¹⁵⁷

Mirëpo, De Martino na ka lënë edhe vargje antologjike, si ato të poezisë *O Jezu i ambel, aq fort je për m'u dasht*¹⁵⁸:

Aq fort e me gjith shpirt un' Ty po t'due,

O Jezu i ambel, aq fort je për m'u dasht,

Qi vehten për Ty dojshim më harxhue

Masi për mue Ti deken së ke drasht.

Për Ty nuk jam, e ti s'je ma për mue,

O djall, o mish, o shekull i rrejshëm e i mbrapsht...

Nji Zot-Femi mue zemren ma zптоi,

E unë aq fort po e due qi s'un kallzoi!¹⁵⁹

Fishta nuk iu ka ndarë kësaj tradite disa shekullore. Që në fillimet e tij letrare ai ka shkruar poezi fetare. Në vitin 1905, i cili mund të merret si vit i fillimit të madh për Fishtën në letërsi, ai botoi pesë këngët e para të *Lahutës së Malcis*, mirëpo po në të njëjtin vit ai botoi edhe një përmbledhje me vjersha fetare të përkthyer në shqip nga ai vetë, *Vierrsha t'pershpirtshme/t'kthyem shcyp*, Shkoder, Shtypshkronja e së Paperlyemes. Katër vjet më vonë, më 1909, ai boton në Zadër librin e parë me lirika fetare origjinale *Pika voëset*, i cila përmban poezi të botuara më herët në revistat fetare të françeskanëve. Nga këta dy libra do të dalë në dritë libri përfundimtar me poezi fetare *Vallja e Parrizit, Vjerrsha lirike e dramatike*, botuar në Shkodër, më 1925.

157 Atë Leonardo De Martini, Harpa Arbnore, fq. 33.

158 Titulli i poezisë nuk është original, pasi ajo është pa titull. Ne po e përdorim këtë titull, që është vargu i dytë i poezisë, të vënë nga transkriptuesi i poezive të De Martinos, Anton Nikë Berisha. Shih: Atë Leonardo De Martini, Harpa Arbnore, fq. 132.

159 Atë Leonardo De Martini, Harpa Arbnore, fq. 113.

Poezia fetare e Fishtës, edhe pse e shkruar për nevoja dhe ndjesi të kishës e të besimtarëve, së paku një pjesë e mirë e saj, shpërthen muret e kishave dhe nevojat e besimtarëve, si poezia *Gurravet të Jordanit*, e cila është poezi e pastër meditative për jetën e vdekjen, duke i dhënë letërsisë shqipe vlera antologjike.

Jo vetëm në poezinë fetare po edhe në tekstet dramatike me temë fetare Fishta ka vazhduar traditën e etërve katolikë-shkrimtarë. Etërit katolikë shkruanin tekste dramatike me temë fetare, për qëllime didaktike, të cilat i shfaqnin nëpër shkollat e tyre në raste festash. Të parën shfaqje të tillë e ka bërë Atë Leonardo de Martino. Sipas Pal Duka-Gjinit, shumë vjet më përpara se Fishta, më 1880 Leonardo De Martino kishte shfaqur në Troshan melodramën *Barit e Betlemit*. Ai thotë se kjo ishte shfaqja e parë e një melodrame në shqip në tokat shqiptare, e cila fascinoi publikun.¹⁶⁰ Shfaqjen e melodramës e dëshmojnë edhe burime të tjera¹⁶¹, por titulli i saj nuk është *Barit e Betlemit* por, si është botuar edhe në veprën e De Martinos, ajo titullohet *Nata e Këshnellave*.¹⁶² Ky tekst i De Martinos më shumë se melodramë apo çfarëdo teksti dramatik mund t'i afrohet një recitali, sepse i tëri është deklamim e nuk ka veprim, e si i tillë, nuk mund të ketë pasur tjetër

160 Pal Duka-Gjini, Gjergj Fishta/jeta dhe veprat, fq. 199 dhe fq. 211.

161 Ribotuesi i veprës së Leonardo De Martinos Harpa Arbnore (2002), në fjalën hyrëse thotë: "Atë Leonardi është ndër autorët e parë që në trojet shqiptare (i pari matanë Adriatikut është Françesk Anton Santori) shkroi shqip pjesë teatrale, ndër të cilat Nata e Këshnellave, shfaqur në Shkodër qysh më 1880...". Atë Leonardo De Martini, Harpa Arbnore, fq. 8-9.

162 Në të vërtetë, teksti dramatik i Leonardo De Martinos ka titullin Nata e Këshnellave/-Drama e çobanëve, dhe është shfaqur nga nxënësit e shkollës popullore në kishën Frati Minori, në Shkodër, në Natën e Këshnellave. Shih: Atë Leonardo De Martini, Harpa Arbnore, fq. 93.

ndikim në rrjedhën e dramës shqipe, përveç faktit historik se është shfaqur më 1880.

Fishta ka shkruar disa tekste të tilla dramatike me temë fetare si *Sh'Françesku i Asizit*, e shkruar sipas “ravës së melodramit në prozë t’ A. Ugheti-t”, dymbëdhjetë ditë pas shfaqjes së origjinalit në Shkollën Fretnore të Shkodrës, më 1909, *Shqyptari i gjytetnuem*, shfaqur në vitin 1911, me rastin e pesëdhjetëvjetorit të ndërtimit të Shkollës Françeskane në Shkodër, *Shqyptarja e qytetnueme* (1929). Në vitin 1925 Fishta do të shkruajë një tekst tjetër dramatik, me të njëjtën përmbajtje dhe të njëjtin emër, *Barit e Betlemit*, sikurse vepra e shfaqur e Leonardo de Martinos.¹⁶³

II. 4. Zbulimi i letërsisë popullore

Shumë studiues të Fishtës, duke filluar që nga studiuesi i parë serioz i tij, Eqrem Çabej, theksojnë ndikimin që pësoi Fishta nga poetët epikë kroatë, si Andria Kaçiq-Mioshiq (1704-1769) me veprën e tij të njohur dhe me ndikim gati se dyqindvjeçar në letërsinë e sllavëve të jugut, *Razgovor ugodni naroda slovinskoga* (1756), pastaj nga Gërگا Martiq (1822-1905), me veprën e tij të vjetruar dhe pa ndonjë vlerë letrare *Osvetnici* (1861) dhe nga Ivan Mazhuraniqi (1814-1890), me veprën e tij *Smrt Smail age Çengjiqa* (1846), kryevepër e letërsisë kroate, të cilën Fishta e dinte përmendësh dhe e citonte. Çabej përmend bile edhe faktin se nuk është rastësi që fjala **mal** është në titullin e veprës së Fishtës ashtu sikurse edhe në titullin e kryeveprës së Petar Petroviq

163 *Barit e Betlemit* e Fishtës është po ashtu melodramë dhe ajo është shfaqur në Shkodër më 1917 dhe është shkruar sipas modelit të dramaturgut italian A. F. S. Rondina, S. J.

Njegoshit (1813-1851) *Gorski vijenac* (1847), poetit nacional malazias.¹⁶⁴ Një studiues tjetër i Fishtës, Dr. Safet Hoxha, në një shkrim rasti për këtë çështje kundërshton të gjithë ata që e vënë Fishtën në lidhje me cilindo poet sllav dhe për këtë tezë të veten përdorë argumente të paqëndrueshme si, p.sh. paraqitja e figurës së Gjergj Kastriotit nga poeti Andria Kaçiç-Miushiç është në shpërputhje me konceptin e Fishtës për Skënderbeun, prandaj ai nuk ka mundur të ndikohet prej poetit kroat¹⁶⁵ etj.

Pa u ndalur shumë në këtë çështje të ndikimit të Fishtës nga poetët kroatë, nuk mund të mohohet çdo lloj ndikimi i Fishtës nga ata poetë, të gjithë françeskanë, njërin prej të cilëve, Grga Martiçin, Fishta e njo-hu personalisht gjatë studimeve në Kreshevo, ndërsa tjetrin, Mazhuranin, e dinte përmendësh dhe e citonte shpesh. Tema që na intereson neve në këtë marrëdhënie është fakti se këta poetë kroatë kishin një marrëdhënie të veçantë me letërsinë popullore, analoge me marrëdhënien e romantikëve evropianë Makferson, Herder etj., që e pohojnë shumë studiues, Fishta e mësoi prej tyre dhe ai u kthye në atdhe të bënte në letërsi po atë që kishin bërë këta poetë në vendet e tyre me letërsinë popullore dhe me malësorët e tyre.¹⁶⁶ Me siguri që Fishta do të jetë ndikuar nga këta poetë edhe nga marrëdhëniet e tyre të veçanta ndaj letërsisë popullore. Ata të gjithë kanë shkruar kryeveprat e tyre në dhjetërrokëshin tradicional sllav, kanë kënduar për ndodhi të vërteta dhe

164 Eqrem Çabej, Epika e Gjergj Fishtës, në Jeta e re, nr. 11-12, 1990, Prishtinë, fq. 1444-1455.

165 Dr. Safet Hoxha, Çështje të marrëdhënieve të Fishtës me disa poetë kroato-dalmatinë e boshnjakë, në At Gjergj Fishta/Komb-Letërsi-Gjuhë, Universiteti L. G. i Shkodrës, 1997, fq. 20-25.

166 Eqrem Çabej, Epika e Gjergj Fishtës, në Jeta e re, nr. 11-12, 1990, Prishtinë, fq. 1444-1455; Ernest Koliqi, Dy shkollat letrare shkodrane, fq. 35 dhe 66-67; Robert Elsie, Introduction, në Gjergj Fishta, The Highland Lute, London, 2005.

të sapo ndodhura të luftës së trimave sllavë kundër pushtuesve osmanë në Bosnjë, ndërsa Kaçiq-Miushiq ka shkruar në një zhanër të veçantë përzierjesh poezie epike e proze. Por, ajo që duhet të theksohet në këtë çështje është fakti se për Fishtën nuk kanë qenë të panjohura të gjitha këto risi letrare, me burim nga romantizmi evropian. Qysh në gjysmën e dytë të shekullit XIX letrarët e shkollës proklasike shkodrane kishin zbuluar gjenium popullor dhe kishin filluar të interesoheshin për të. Në vitin 1865 një poet prift, Leonardo de Martino (1830-1923), arbëresh nga Greci e Puljes, po shkelte tokën amtare me misionin e priftit. Ai poet-prift, me një kulturë të gjerë klasiciste, do të fus në poezitë e veta frazeologjinë popullore dhe shprehshmërinë e letërsisë popullore.¹⁶⁷

Kur del vera e lulzon Prilli
 E Natyra mbarë përtrihet,
 Aq për-mall këndon bylbyli
 Qi tuë ndije zemra shkrihet.¹⁶⁸

Këto vargje janë krijuar sipas modelit popullor dhe janë autoriale. Ky model shkrimi, por sipas një gjedhe popullore, do ta ndikojë Gjergj Fishtën.

Përveç kësaj, ky poet vinte nga vendi ku rreth tridhjetë vjet më parë poeti i madh Jeronim de Rada kishte botuar librin *Këngët e Milosaut* (1836), me këngë për të cilat thoshte se ishin popullore, edhe pse i kishte shkruar vetë, duke u bërë kështu imituesi i parë në letërsinë shqipe i Xhejms Mekfersonit (1736-1796) dhe veprës së tij *Fragmente nga poezia e lashtë e mbledhur në Malësinë e Skocisë* (1760), edhe këto këngë gjoja të kënduara nga rapsodi legjendar kelt Osian.¹⁶⁹ Këtë risi le-

167 Ernest Koliqi, Dy shkollat letrare shkodrane, fq. 62.

168 Atë Leonardo de Martini, Harpa Arbnore, fq. 84.

169 Robert Elsie, Historia e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Pejë, 2001, fq. 131.

trare do ta vazhdojë edhe poeti tjetër arbëresh Gavriil Dara i Riu (1826-1885). Eqrem Çabej thotë se me këta dy poetë letërsia shqipe u kyç në rrjedhën e romantizmit evropian, ashtu sikur edhe popujt e tjerë të juglindjes që bënë një brez më vonë.¹⁷⁰ Ndërsa një bashkëvendës tjetër, Zef Jubani (1818-1880), në vitin 1871, pothuajse njëqind vjet pas botimit të librit të Herderit *Këngë popullore* (1878-79), i cili përmbloodhi në një libër këngë popullore të shumë vendeve e të shumë popujve, botoi një përmbledhje të vogël me këngë popullore *Përmbledhje këngësh popullore e rapsodish shqiptare*.¹⁷¹ Mirëpo, kulti ndaj letërsisë popullore në shkrimin shqip del më i hershëm se libri i Jubanit dhe këngët e botuara nga albanologë të huaj si Johan Georg fon Han (1811-1869), i cili botoi në Jena të Gjermanisë përmbledhjen e parë të letërsisë popullore shqiptare *Studime shqiptare* (1854). Një shkrimtar-prift arbëresh, Nilo Katalano, para vitit 1694 do të ketë shënuar këngët e para popullore arbëreshe, ndër të cilat edhe *Kënka e Pal Golemit*.

Nilo Katalano (1637-1694) kishte shërbyer si prift në Sicili, pastaj qe emëruar si vikar apostolik i Himares (1693), ku edhe vdes më 1694. Është varrosur në Sacta Sactorum të Kishës së Shën Thanasit në Dhërmi të Himarës. Ka plot dëshmi (Nikollë Filja, Xhuzepe Krispi, Zef Skiroi etj.) se Katalano është autor i një fjalori italisht-shqip e shqip-italisht, i një sprove gramatike të gjuhës shqipe dhe një tufë këngësh popullore arbëreshe.¹⁷² Në *Dorëshkrimin e Kieutit* (1736) autori Nikollë Filja ka

170 Eqrem Çabej, Shqiptarët midis Perëndimit e Lindjes, Çabej MÇM, Tiranë, fq. 67.

171 Titulli origjinal: Racconti di canti popolari e rapsodie di poemi albanesi, Trieste, 1871; Robert Elsi thotë: “Ky libër përbën përmbledhjen e parë me këngë popullore gegnishte, madje vepra e parë folklorike e botuar nga një shqiptar për vetë Shqipërinë”. Shih te: Robert Elsie, Historia e letërsisë shqiptare, fq. 218.

172 Për Nilo Katalanon shih te: Dhimitër Shuteriqi, Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes 879-1800, ASHSH, Tiranë, 2005, fq. 211-216; Matteo Mandala, Gjurmime filologjike/Për letërsinë e vjetër arbëreshe, Çabej, Tiranë, 2006, fq. 352-354.

shënuar përmbledhjen e parë të këngëve popullore arbëreshe, e njohur si *Kënkëzë pleqrijsë*. Matteo Mandala thotë:

„Nga këto të fundit nuk harroi (ai, Nikollë Filja, plotësim imi, B. K.) të rikopjonte edhe disa këngë , tri për të qenë të saktë, të titulluara *Kënkëzë t'Arbreshja*, për të cilat pohoi shkoqur se i kishte „nxjerrë kaha Monsinjur Nili që kla abat S[hënç Basiljit horësë Munxifsit“.¹⁷³

Dëshminë e Nikollë Filjes e vërtetojnë më vonë edhe Gjuzepe Krispi si dhe Zef Skiroi, i cili e pati i fundit këtë dorëshkrim, sigurisht në vitin 1918, prej ku i humbin gjurmët. Te *Dorëshkrimi i Kieutit* është edhe *Kënka e Pal Golemit* bashkë me 17 këngë popullore arbëreshe të tjera, ndërsa mu për këtë këngë Zef Skiroi thotë në përshkrimin e tij për dorëshkrimin e Katalanos se është te Katalano, bashkë me disa këngë të tjera, po të shkruara me alfabetin grek. Nuk ka dyshim se përmbledhja në dorëshkrim tash për tash e humbur, por e njohur dhe e dëshmuar, e Nilo Katalanos, e ruajtur përmes tri këngëve, e quajtur nga Nikollë Filja *Kënkëzë t'Arbreshja* është përmbledhja e parë shqip me këngë popullore. Për rapsodinë *Kënka e Pal Golemit* A. N. Berisha thotë:

“është dëshmia e parë e poezisë gojore arbëreshe, që është gjetur në formë të shkruar në fjalorin dorëshkrim të shekullit XVII”.¹⁷⁴

Kjo këngë është edhe kënga e parë shqipe e shënuar dhe e ruajtur. Është e pranishme, pas *Dorëshkrimit të Kieutit* në të gjitha botimet e rëndësishme të poezisë popullore të arbëreshe të Italisë që u bënë nga autorë të ndryshëm në shekujt XIX dhe XX. Dorëshkrimi *Kënkëzë t'Arbreshja* është shkruar gjithsesi para vitit 1694, vit kur vdes Nilo Katalano, ndërsa Matteo Mandala e vendos midis viteve 1685 e 1693.

173 Matteo Mandala, *Gjurmime filologjike/ Për letërsinë e vjetër arbëreshe*, fq. 354.

174 Anton N. Berisha, *Qasje të poetikës së letërsisë gojore shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1998, fq. 66)

Dorëshkrimi i Nikollë Filjes, të cilin Dhimitër Shuteriqi e quan *Kodiku i Kieutit*, ndërsa në historinë e letërsisë shqipe është i njohur si *Dorëshkrimi i Kieutit*, ka në një kapitull më vete 18 këngë popullore, të mbiquajtura *Kënkëzë të Pleqrijsë*, të mbledhura nga autorë të ndryshëm, e ku bën pjesë edhe *Kënga e Pal Golemit* e Nilo Katalanos, në fakt, është e para përmbledhje këngësh popullore në shqip, prej së cilës janë ruajtur shumë pjesë, e shkrimin e së cilës studiuesit e vendosin para vitit 1737.¹⁷⁵

Më vonë, një tjetër folklorist arbëresh nga Maki i Kozencës, Françesko Abate (1717-1800) ka shkruar në një fletore të tij disa këngë arbëreshe dhe kjo fletore është ruajtur në Seminarin Arbëresh të Palermos,

“...deri kur Dhimitër Kamarda, i emëruar më 1845 prift në Napoli, e mori me vete në syrgjynin e tij të gjatë dhe më vonë ia dha dorëshkrimin Jeronim De Radës, i cili ishte po ashtu i Makit.¹⁷⁶

Folkloristët e hershëm shqiptarë, mbase jo për të njëjtat motive, sikurse romantikët evropianë, kishin filluar qëmoti ta çmonin, ta regjistronin dhe ta ruanin letërsinë popullore. Nën ndikimin e romantikëve evropianë romantikët shqiptarë pastaj u ndikuan prej kësaj letërsie. Puna e De Radës, e Jubanit e të tjerëve, ishte në rrjedhë të letërsisë romantike evropiane me një vonesë të vogël. Kjo përvojë e letërsisë shqipe që në kohën kur Fishta ishte ende fëmijë do të ketë jehuar shumë më fuqishëm e më gjatë në mendjen e fëmijës Fishtë. Përfundimisht,

175 Dhimitër S. Shuteriqi, Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800, fq. 254 dhe 258.

176 Jeronim De Rada, Autobiografia, përkthyer nga Jup Kastrati, cituar nga De Rada, Vepra, 7, Rilindja, 1988, fq. 337; Dhimitër Shuteriqi, Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800, fq. 271-273; Matteo Mandala, Gjurmime filologjike/ Për letërsinë e vjetër arbëreshe, fq. 359-367.

para se Fishta të hynte në letërsinë shqipe, në rrethin e shkrimtarëve proklasikë shkodranë po fillonte lulëzimi i një letërsie, me bazë në letërsinë popullore dhe po lulëzonte studimi i gjuhës popullore shqipe dhe letërsia që e çmonte deri në shejtni fjalën burimore shqipe. Fishta është rritur në fëmijërinë e tij të hershme brenda këtyre rretheve dhe është kthyer në rrethin e françeskanëve sapo ka përfunduar studimet në Bosnjë. Dashurinë e parë për letërsinë popullore Fishta nuk ka si të mos e kishte ndjerë në një rreth të tillë. Po ashtu, kjo është koha kur lahutari dhe kënga e kënduar trimërie ishte një lloj shenjti në çdo kullë shqiptare. Në rrethet e letrarëve françeskanë u botuan më vonë, si libra më vete apo si periodikë letrarë, disa prej botimeve kapitale për letërsinë popullore shqiptare, si: *HYLLI I DRITËS* (1913-1940), *Visaret e Kombit* (me disa vëllime) në vitet '30 të shekullit XX, *Kanuni i Lekë Dukagjinit* (1933) etj. Kjo ka ndodhur pas një pune të gjatë të tyre dhe pas një kohe të gjatë të marrjes me letërsinë popullore. Ky është rrethi kulturor ku jetoi Fishta, ku u ndikua dhe ku ndikoi.

Interesimin e tij për letërsinë popullore, për këngët e vjetra shqiptare, për gjuhën e virgjër malësore Fishta do ta ketë trashëguar nga mësuesit e tij françeskanë dhe nga rrethi kulturor ku është rritur. Mbase Fishta do të jetë magjepsur me aftësinë e poetëve kroatë për ta përdorur letërsinë popullore në veprat e tyre të reja, duke krijuar kështu kryevepra nacionale sipas gjedhes së letërsisë popullore. Kjo ka mundur ta nxisë frymëzimin e Fishtës që dashurinë e vjetër ndaj letërsisë popullore, të kultivuar në rrethin kulturor shkodran të gjysmës së dytë të shekullit XIX, ta zhvillojë në një shkallë tjetër, në shkallën e përdorimit mjeshtëror të saj për kryevepra të reja. Vetë Fishta në një intervistë në daktiloshkrim rrëfen për ndikimet e tij nga letërsia pop-

ullore gjatë takimeve dhe jetës së përbashkët me malësorët shqiptarë, të cilët e kultivonin shejtnisht këtë letërsi:

“(...) m’ka ndihmue mjaft qindresa eme per disa vjet n’Abaci t’Mir-dites, ku tue u ndodhë n’kontakt t’drejtperdrejtë me popullin, m’kje ma e lehtë t’kuptojshe shpyrtin shqiptar dhe bukurin e pasunin e gjuhës kombtare.”¹⁷⁷

II. 5. Temat e përjetshme

Një ndikim tjetër i shkollës proklasike shkodrane te Fishta mund të hetohet edhe te trajtimi i temave të përjetshme në letërsi, si tema e jetës, tema e vdekjes, misioni i njeriut, marrëdhënia e njeriut me Zotin, tema e dhembjes etj. Këto tema janë të përjetshme dhe të përhershme, por ishin prej temave bazike të klasikëve evropianë. Këto tema poetët katolikë shkodranë i kanë trajtuar shpesh në shkrimet e tyre, kryesisht të ndikuar nga letërsia italiane. Siç e pamë më lart, disa prej këtyre temave janë trajtuar në lirikën fetare të të gjithë krijuesit e saj. Jo vetëm në lirikën fetare, por edhe në poezitë e tjera, këto tema kanë qarkulluar nga njëri te tjetri poet. Jo të gjithë ata poetë që kanë shkruar lirikën fetare kanë arritur të kalojnë kufijtë e letërsisë pragmatiste. Po, nuk ka dyshim se disa prej këtyre poetëve me lirikën e tyre fetare kanë krijuar tekste universale, qoftë metafizike apo alegorike dhe janë të denjë për të qenë prijës të Fishtës, si Bogdani, Pjetër Zarishi, Leonardo De Martino etj.

177 Fishta, Estetikë dhe Kritikë, 1991, fq. 191.

II. 6. Fryma patriotike e artit

Françeskanët janë shfaqur në tokat shqiptare që në zanafillën e tyre. Urdhri Françeskan në Shqipëri, sipas gojëdhënës, u krijua nga vetë Shën Françesku i Asizit, themeluesi i françeskanëve, i cili mendohet të ketë qëndruar në tokat shqiptare rreth vitit 1214¹⁷⁸, sipas të gjitha gjasave në Lezhë.¹⁷⁹ Duke e përfolur këtë gojëdhënë Marin Sirdani thotë se duke u kthyer prej Sirisë, në vitin 1219, Shën Françesku i Asizit qëndroi në Lezhë, ku u mirëprit nga populli dhe fitoi zemrën e famullitarit të Lezhës, Dom Lleshit, i cili më vonë ndërtoi një kishë, sipas udhëzimeve të vetë Shën Françeskut të Asizit, në vendin të cilin ai e kishte shënuar, duke mbjell një dru, për ekzistencën e të cilit dëshmon edhe Marin Sirdani në kohën e tij.¹⁸⁰ Në këtë kishë ekziston edhe sot mbishkrimi: HOC TEMPLUM FRATRUM MINORUM AEDIFICATUM EST ANNO MCCXL (që në shqip d.t.th. Kjo kishë e Fretërve të Vegjël¹⁸¹ është ndërtuar më 1240).¹⁸² Në një dokument të vitit 1283

178 Të dhënat historike për françeskanët janë marrë nga shumë burime, po në veçanti: Atë Marin Sirdani, Françeskanët në Shqypni dhe shqyphtarët katolikë në lamë t'Atdhetaris, Shpresa, 2002; P. Atanaz Gegaj O. F. M, Veper arsimore e Françeskajvet në Shqypni në shekullin XVII, HYLLI I DRITËS, 1932, nr. 3; P. Marin Sirdani, Kontributi i elementit katolik shqyphtar në lamë t'Atdhetaris që prej kohve të vjetra deri në kohën e Turqve të Ri, HYLLI I DRITËS, 1933, nr. 7-8; P. Donat Kurti O. F. M, Vepra Kulturele e Elementit Katolik në Shqypni, HYLLI I DRITËS, 1933, nr. 5-6; Vinçenc Malaj, Kontributi i Françeskanëve në Letërsinë shqipe, në Letërsia si e tillë, ASHSH, Toena, 1996.

179 Pater Daniel Gjeçaj, Frati shqiptar, në Simpoziumi Fishta dhe Françeskanët, Botimet Françeskane, 2003, fq. 18.

180 Atë Marin Sirdani, Françeskanët në Shqypni dhe shqyphtarët katolikë në lamë t'Atdhetaris, Shpresa, 2002, fq. 12.

181 OFM- Opus Fratrum Minorum, d.t.th. Rendi (urdhri, shoqëria) e Vëllezërve të Vegjël, ky është emri zyrtar i françeskanëve.

182 Marin Sirdani dyshon se ky mbishkrim është i vitit 1240. Ai citon P. Lorencin prej Santa Croce, provincial i Provincës Françeskane Shqiptare, i cili në vitin 1720 i pari e përmend shkrimin, e thotë se shkrimi shumë kohë më herët ishte në greqisht, por më vonë është shndërruar në latinisht. Shih: Atë Marin Sirdani, Françeskanët në Shqypni

përmenden edhe kuvendet françeskane në Tivar, Ulqin e Durrës.¹⁸³ Françeskanët e parë erdhën prej Italie dhe ata zëvendësuan benediktinët e domenikanët që ishin në tërheqje e sipër. Sikurse edhe pjesa tjetër e kishës katolike, edhe françeskanët patën një jetë të vështirë nën Perandorinë Osmane. Të ndjekur nga pushteti osman e të ndjekur nga kisha ortodokse, në një rën anë, ndërsa shqiptarët pas pushtimit osman të lënë keq e të pashkollë, në anën tjetër, etërit françeskanë i kthehen gjuhës së popullit dhe kulturës e letërsisë së tij, për ta mbajtur gjallë shpirtin e tij dhe të popullit shqiptar. I pari françeskan që la të shkruar në shqip qe Pali prej Hasit, rreth vitit 1599, poezitë e të cilit *Dita e gjygyjit* dhe *Për mortjen* janë botuar prej Pjetër Budit në veprën kapitale të tij *Dottrina christiana* (1618). Në gjysmën e dytë të shekullit XIX, Provinca Françeskane në Shqipëri kishte filluar ta marrë veten pas një periudhe të vështirë deri buzë shkatërrimit në gjysmën e parë të shekullit XVIII.¹⁸⁴ Shumica dërrmuese e etërve françeskanë ishin shqiptarë, që dallonte prej faktit se shumica e etërve jezuitë ishin të huaj. Edhe ky fakt, krahas atij të parit, kthimit kah gjuha e popullit dhe letërsia popullore, do ta bëjnë letërsinë e krijuar nga françeskanët të angazhuar në kuptimin e atdheut, të lirisë e të fesë. Letërsia e shkruar nga françeskanët dallohet për nga fuqia dhe motivimi patriotik e fetar. Ata edhe vetë, etërit françeskanë, marrin pjesë në proceset shoqërore e politike të fundshekullit XIX dhe fillimshekullit XX. Marin

dhe shqypetarët katolikë në lamë t'Atdhetaris, fq. 14-15. Edhe Vinçenc Malaj nuk është i sigurtë nëse ky shkrim është origjinal, i vitit 1240.

183 Zef Mirdita, Krishtenizmi ndër shqiptarë, Drita & Misioni Katolik Shqiptar në Zagreb, Prizren-Zagreb, 1998, fq. 261.

184 Atë Marin Sirdani, Françeskanët në Shqypni dhe shqypetarët katolikë në lamë t'Atdhetaris, fq. 47.

Sirdani e zgjeron edhe më shumë këtë fushëveprim dhe kohëveprim të françeskanëve. Ai thotë:

“Historija na dishmon se nuk u ba një levizje kombëtare në Shqypni, në daç me pendë po edhe me armë, ku Françeskani mos të mirrte pjesë aktive për djeri ku këto levizje mund të perkojshin me program të jetës e të historis së tij. (...)

Prandej një histori e pa-anëshme e Shqypnis nuk ka me mujtë kurr me e ba në sedije djersen, mundin e gjakun qi i u desht birve të këtij Urdhni me derdhë për me i sjellë vedit aureolen e lumnis në Shqypni.”¹⁸⁵

Ata shpesh herë janë të ndjekur, të dënuar e të ekzekutuar, qoftë nga pushteti osman, qoftë nga pushteti serb, e më vonë edhe nga pushteti komunist në Shqipëri, mu për shkak të ndërhyrjes të tyre të drejtpërdrejtë në zhvillimet patriotike e politike. Por, kjo ndërhyrje e tyre edhe fizike në këto zhvillime shkon krahas artit të tyre të angazhuar fuqishëm në çështjen e atdheut, të lirisë e të fesë. Koncepti jetësor Fe e Atdhe është zhvilluar në rrethet françeskane për shekuj të tërë. Frati shqiptar “U rrit, u edukue e jetoi për “Fe e Atdhe”.¹⁸⁶ Pretendimi i Tonin Çobanit se te Pjetër Zarishi

„zë fill motivimi i normave të moralit të krishterë si bazë e moralit atdhetar shqiptar, që më vonë te Gjergj Fishta do të formulohet si binom i shqiptarizms: Atme e Fe”¹⁸⁷

185 Atë Marin Sirdani, Françeskanët në Shqypni dhe shqyptarët katolikë në lamë t’Atdhetaris, fq. 53.

186 Pater Daniel Gjeçaj, Frati shqiptar, në Simpoziumi Fishta dhe Françeskanët, BF, 2003, fq. 18.

187 Tonin Çobani, Pjetër Zarishi dhe krijimi i rruzullimit, fq. 54.

nuk mund të qëndrojë përballë fakteve historike të zhvillimit të këtij binomi në qarqet françeskane dhe katolike përgjithësisht në Shqipëri. Fryma patriotike, fetare e morale të shqiptarët, e artikuluar me konceptin Fe-Atdhe, zë fill në shekullin XII e këndeje dhe është e përkrahur edhe nga Vatikani. Pse ndodhë kjo lidhje Fe-Atdhe duhet shikuar faktet historike në Shqipërinë paraturke dhe pasturke.¹⁸⁸

Letërsia e krijuar nga etërit françeskanë është e lidhur ngushtë me fatin e kombit dhe të fesë në tokat shqiptare. Jo vetëm në letërsinë origjinale, por edhe në mbledhjen e folklorit shqiptar edhe në studimin e gjuhës popullore shqipe qëndronin argumente patriotike e fetare. Në

188 Pas shpalljes së Kishës Autoqefale Serbe (1219), katolicizmi shqiptar, i njohur nga të tjerët edhe në kohën e Pjetër Bogdanit si „arbanashka vera“ gjendet përballë presionit të fortë të kësaj kisha dhe të Mitropolisë Autoqefale të Ohrit (kisha greke) për konvertim në ortodoksizëm. Problemi pleksej nga fakti se këto dy kisha fenë e lidhnin me shtetin, prandaj konvertimi fetar parakuptonte edhe atë etnik. Mbas pushtimi osman të Shqipërisë gjendja u rëndua edhe më shumë, qoftë në favor të muhamedanizmit apo edhe të ortodoksizmit, e ky i fundit ishte në marrëdhënie të mira me Portën e Lartë. Françeskanët, për t'i shpëtuar këtij presioni tri anësh, sikurse dikur Benediktinët, ndëruan ose riparuan kuvendet e vjetra benediktine në zona të thella malore të banuara me shqiptarë, sa më larg trysnive të huaja. Në këtë mënyrë, ata lidhën fatin e misionit të tyre dhe të fesë së tyre me fatin e popullit. (shih: Atë Marin Sirdani, Françeskanët në Shqypni dhe shqyptarët katolikë në lamë t'Atdhetarisë, Shpresa, 2002, fq. 54-62). Kjo veprimtari e françeskanëve shqiptarë ishte në përputhje me parimet fetare e morale të vet themeluesit të rendit, Shën Françeskut të Asizit, për të cilin thuhet se qe „ma shejti nder italyanë, e ma italyani nder shejten“. (shih: Atë Marin Sirdani, Françeskanët në Shqypni dhe shqyptarët katolikë në lamë t'Atdhetarisë, Shpresa, 2002, fq. 52). Marin Sirdani, nga ana e tij, konceptin Fe-Atdhe e quan si program të françeskanëve, i nxitur edhe nga vetë Papa i Romës. (shih: Atë Marin Sirdani, Françeskanët në Shqypni dhe shqyptarët katolikë në lamë t'Atdhetarisë, Shpresa, 2002, fq. 65). Këtë aktivitet fetar e atdhetar të françeskanëve dhe klerit katolik në përgjithësi e dëshmojnë edhe shumë kuvende të mëvonshme të shqiptarëve e të popujve tjerë të Ballkanit kundër pushtimit osman, e ku françeskanët kanë pasur role të rëndësishme. Le të kujtojmë këtu Kuvendin shqiptar në Shën Llesh në Dukagjin (1602), Kuvendin e krerëve të Ballkanit në Kuç (1614), ku një farë Pater Gjoni luajti rol të rëndësishëm, Kuvendin e krerëv të Ballkanit në Beograd (1620), kryengritjen e vitit 1649 dhe rolin e kryepeshkopit të Tivarit Imzot Gjergji prej Sape, rolin e Pjetër Budit e të Pjetër Bogdanit në çështje të atdhetarisë etj. (shih: Historia e popullit shqiptar I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë/Instituti i Historisë, Botimet Toena, 2002, fq. 565-569 etj.).

përgjithësi, një motiv (dhe motivim) i tillë nuk është aspak i huaj për krejt letërsinë shqipe, që nga Buzuku e tutje, por te françeskanët ky motiv (dhe motivim) është shumë më i fuqishëm dhe më i skajshëm.

Gjergj Fishta është ndikuar fund e krye nga kjo prirje e poetëve proklasikë shkodranë. Letërsia artistike e Fishtës, qoftë lirikë, epikë apo dramatikë, është trumbetë kushtrimi për luftë e liri, për Fe e Atdhe. Këtë prirje themelore të letërsisë së rrethit të françeskanëve Fishta do ta ndërlihdhë me filozofinë e Rilindjes Kombëtare dhe te këto parime do të gjejë vazhdimësinë më sublime për atdhetarizmin e etërve françeskanë.

Ky ndikim ka bërë që letërsia e Fishtës të jetë aq shumë e angazhuar në kuptimin e Atdheut, Lirisë e të Fesë, saqë një pjesë e kësaj letërsie shikohet si pjesë e pandashme e luftës për liri e pavarësi të Shqipërisë.

II. 8. Atë Leonardo De Martino dhe Atë Gjergj Fishta

Edhe pse nuk mund të dëshmohet saktësisht nga ato që ka lënë të shkruara, poeti i parë i kohës së re Atë Leonardo De Martino duket se ka ndikuar gjithë rrethin e poetëve e të letrarëve të shkollës proklasike shkodrane. Nëse Rexhep Qosja mund të thotë se vargu vlerësues i Ndue Bytyçit „Ndër bejtagjitë, Bejtagji ma i par.“¹⁸⁹ nuk është ekuivalenti i vërtetë për De Martinon, por tregon mosnjohjen e traditës nga ana e Ndue Bytyçit¹⁹⁰, nuk mund të thuhet kështu për njërin prej njohësve të shkëlqyeshëm jo vetëm të traditës letrare, por të gjithë historisë së kulturës shqiptare, Atë Marin Sirdanin, i cili në shkrimin historik *Shqyp-tarët e hartet*¹⁹¹ shprehet kështu për De Martinon:

189 Atë Leonardi De Martini, Harpa Arbnore, fq. 23.

190 Rexhep Qosja, Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi III, fq. 296.

191 A. Marin Sirdani O. F. M., Shqyp-tarët e hartet, HYLLI I DRITËS, 1921, nr. 4, 7; 1922, nr. 2, 4, 11, 12; 1923, nr. 5.

„Shka kje per itali-shqyptar De Rada, kje per Toskë Naim be Frashri, e per Gegë P. Leonardo De Martino...”¹⁹²

Ne mund të kemi parasysh në këtë vlerësim të Sirdanit prirjen e françeskanëve për ta ngritur veten e tyre lart e më lart, por sido që të jetë, ndikimi i De Martinos është i pamohueshëm. Atëherë duhet kërkuar këto ndikime në vetë tekstin poetik të De Martinos dhe të Fishtës, përveç ndikimit me poezinë satirike dhe afrisë së përbashkët me letërsinë popullore, të cilat tashmë i kemi shqyrtuar.

Në ndikimet tematike duhet të jemi të njëanshëm: me ndonjë përjashtim të rrallë De Martino ka trajtuar vetëm temën fetare, në motive të ndryshme, në këtë aspekt Fishta është afër tij me librin *Vallja e Parrizit*. Janë shumë afër njëra tjetrës vjersha e De Martinos *Kang*¹⁹³ dhe ajo e Fishtës *Njij misjonari Françiskan*.¹⁹⁴ Në të dy poezitë përshkruhet fati, krenaria dhe mundimi i një misionari në misionin e tij fetar, dalton vetëm elementi shqiptar te Fishta.

Në format poetike De Martino shkruan himnin, i cili merr edhe formën e poezisë-lutje fetare, oden fetare, një vajtim (që është përshtatje nga italishtja), ndërsa bën prova edhe në tekste dramatike, por ka rezultuar pasuksesshëm. Fishta shkruan kryesisht himnin, oden dhe elegjinë, e po ashtu ka trajtuar gjerësisht temat fetare në tekste dramatike. Në format poetike De Martino është mjeshtri i parë në letërsinë shqipe. Para tij kanë shkruar tingëllima mjeshtërore Pjetër Bogdani dhe Pjetër Zarishi, por De Martino nuk mbetet prapa tyre në këtë poezi. Fishta nuk ka shkruar shumë tingëllima dhe nuk e ka arritur mjeshtërinë poetike të pararendësve të tij. Edhe në përdorimin e trajtave të ndryshme

192 A. Marin Sirdani O. F. M., Shqyptarët e hartet, HYLLI I DRITËS, 1922, nr. 12, fq. 572.

193 Atë Leonard De Martini, Harpa Arbnore, fq. 44-48.

194 Gjergj Fishta, Lirika/Mrizi i Zanavet, Rilindja, Prishtinë, 1997, fq. 144-148.

të strofave De Martino është i pasur. Strofa e tij tetëshe në *Pater Noster*¹⁹⁵ është e afërt, po me një ritëm më të përpiktë, me tetëvargëshin e Fishtës në *Shën Françesku i Asizit* dhe *Emni i Jezus*.¹⁹⁶

Është edhe një shfaqje tjetër poetike në të cilën De Martino rri më lart se Fishta: është lirizmi i tij. De Martino është thelbësisht lirik dhe ai në poezinë e tij krijon situata lirike, e nuk përshkruan situata lirike, siç bën Fishta. Por, në anën tjetër, ai shumë rrallë arrin të krijojë situata lirike dramatike si bën Fishta.

Në fund duhet të flasim për modelin më të preferuar të Fishtës në figurën poetike. Si do të shohim më vonë, figura e zgjeruar, qoftë ajo krahasim, metaforë, metonimi, hiperbolë etj., është figura më e arrirë e Fishtës. Këtë figurë të zgjeruar Fishta e përdorë njësoj, si në lirikë, si në epikë, si në satirikë. Por, në poezinë shqipe para tij e ka kultivuar në të njëjtin model De Martino. Të shohim fillimin e poezisë *Këshnellat*:

Si gur ai a shkep prej kulmit
 Njaj malit nalt me shkrep
 E shtyn teposht dermorja,
 E tuj platos ndër thepa
 Ban token me shungullue,
 Vjen vrap tuj rrokullue,
 Bjen malit n'fund e rri;

Atje, ku ra, pa-lujtun
 Rri dekun e i randuemun;
 Për sa mij vjet koptisin

195 Atë Leonardi De Martini, Harpa Arbnore, 2002, fq. 34.

196 Gjergj Fishta, Lirika/Vallja e Parrizit, Rilindja, Prishtinë, 1997, fq. 271 dhe 283.

Ma s'mundet me shikjuemun
Vendin kah u da i shkreti,
Pa i ardh një ndim prej njeti
Me u njit prap nalt nuk di.

Njashtu po rrite i vorfëni
Bir i gabimit par...¹⁹⁷

Ja si e ndërton Fishta një figurë të zgjeruar:
Me ndollë puna se n'lisni
Turr prej shkujkut me furi
Lshohet luani m'nji kapruell
Qi n'kullosë t'i dalë kundruell;
E se, para se m'i u hullë,
Fulikare per poshtë trollit
Po i bje tigma atij kaprollit:
Harrue luani aty at shkerbe,
Tigres m'shpinë lshohet rrufe.
Edhe at herë bishat perlahen,
Idhtë shoqe me shoqe hahen:
E dermishen e shkelvishen
Me do dham porsi kortela.
Do çapoj thue janë çengela;
E ka' ungrojnë, kah ulurojn,
Lvisin bollat zhgjetë nper fusha,
Kapë perpjetë malin harusha,

197 Atë Leonard De Martini, Harpa Arbnore, 2002, fq. 114.

Hikin derrat, marrin ferrat:

Kshtu Gjetë Gega u lshue mbi shkja.¹⁹⁸

Është e dukshme se te De Martino ka një thjeshtësi më të madhe të situatës poetike, të fjalësit, të dramacitetit poetik e deri te thjeshtësia e idesë poetike, ndërsa në vargjet e Fishtës është krejt e kundërta, mirëpo modeli mbi të cilin ndërtohet figura është i njëjtë, si në rastin e parë edhe në të dytin. Konstatimi i fundit nuk do të thotë apriori se Fishta ka mësuar nga De Martino, mund të jetë që të dy kanë mësuar nga poezia klasiciste, të cilën e kanë njohur mirë, por nëse Fishta e ka njohur poezinë e De Martinos, për çka nuk ka dyshim, atëherë mund të vihet një lidhmëni midis figurës së zgjeruar të tij me modelin e De Martinos. Benedikt Dema, një studiues i njohur i Fishtës, në një bibliografi për shtypin françeskan thotë:

„P. De Martinokje ma i pari qi punoi vjerrsha në gjuhë shqype mbas metrikës moderne; njijheri kje edhe udhëhieksi i Poetit t'onë kombtar A. Gj. Fishtës nder vjetët e para të punimevet të tija poetike.“¹⁹⁹

II. 9. Miti për Fishtën

Një temë tjetër e cila duhet të përmendet sipërfaqësisht, e që është shumë e rëndësishme për marrëdhënien e Fishtës me rrethin e françeskanëve shqiptarë, është miti për Fishtën. Për mitin dhe antimitin e Fishtës kanë folur tashmë disa studiues, për më tepër kjo është një temë që del edhe jashtë interesimeve letrare, megjithatë duhet vërejtur se është pikërisht rrethi i françeskanëve shqiptarë ai që punoi, mbase sipas një strategjie të caktuar, për krijimin e mitit për Fishtën.

198 Gjergj Fishta, Lahuta e Malcis / Ke tbanat e Curr Ules, vargjet 126-144, Rilindja, 1997.
199 Benedikt Dema, Shtypi françeskan në Shqipni, HYLLI I DRITËS, 1941, nr. 3-5, fq. 612.

Janë rrethet françeskane dhe botimet e tyre të parat që do të flasin për Fishtën me epitete të larta, do t'i përdorin ato epitete gjithmonë sa herë përdorej emri i Fishtës. Ky adhurim për Fishtën dhe sforcimi i këtij adhurimi në fjalën e shkruar, në çfarëdo zhanri shkrimor qoftë, ka vazhduar edhe shumë vjet më vonë te shkrimtarët françeskanë. Njëri prej biografëve të Fishtës, Pal Duka-Gjini, edhe vetë françeskan, është shembulli ideal se si e sforcon mitin për Fishtën në librin e tij *Gjergj Fishta/jeta dhe veprat* (1992).

III. FISHTA DHE PASUESIT

Siç u pa deri tash, Fishta është ndikuar nga rrethi i shkrimtarëve të shkollës proklasike shkodrane, veçanërisht nga shkrimtarët françeskanë, në disa prej orientimeve themelore letrare, si vokacioni klasik, prirja për letërsinë popullore, tradita e shkrimit të poezisë fetare dhe të poezisë satirike, temat e përrjetshme dhe fryma patriotike e letërsisë. Mirëpo, përveç këtyre orientimeve themelore, tradita letrare shkodrane nuk ka pasur më parë një autoritet të fortë letrar apo një maje letrare për ta ushqyer Fishtën me vepra letrare, me motive, ide poetike apo figura poetike. Shkolla proklasike shkodrane nuk ka pasur më parë një emër të madh poeti, që do të kishte shërbyer më vonë si model te nxënësit e tij, sado Pjetër Zarishi dhe sidomos Leonardo De Martino kanë gëzuar një autoritet letrar te të gjithë pasuesit e shkollës proklasike shkodrane. Pavarësisht nga ky autoritet letrar, vepra e poetëve proklasikë para Fishtës, si ajo e Pjetër Zarishit, Leonardo de Martinos, Ndue Bytyçit, Preng Doçit, Anton Xanonit, Kolë Thaçit etj., nuk përmbushnin as për së afërmi aspiratat letrare dhe prirjet poetike të Fishtës, e lëre më që ai të ndiqte shembullin e tyre.

Shkrimtarët proklasikë shkodranë kishin krijuar disa parime letrare shumë të vlefshme, kishin krijuar shumë vepra të vlefshme letrare, folkloristike e gjuhësore, po ata nuk kishin një strumbullar, një kryepoet ku mund të mbështeteshin dhe i cili mund të ishte sublimim i të gjitha parimeve krijuese të shkollës së tyre, sublimim i ideve poetike, gjuhësore, folkloristike, sociale e fetare të letërsisë së tyre. Këtë zbrazëti të këtij rrethi letrarësh e mbushulloi Fishta. Ai u bë trangu i rrethit të krijuesve françeskanë dhe bashkë me Ndre Mjedën, ata u bënë shem-

bulli prej të cilit do të mësojnë poetët e tjerë. Fishta u bë kulmi i atij rrethi letrar, nën strehët e të cilit do të gjëllinjë edhe disa krijues të tjerë françeskanë deri te vitet katërdhjetë të shekullit XX.

Studiuesit e letërsisë proklasike shkodrane përmendin tre emra si vazhduesit më të denjë të veprës së Fishtës: Shtjefën Gjeçovi, Bernardin Palaj, Marin Sirdani.²⁰⁰

SHTJEFËN GJEÇOVI (1874-1929) vazhdoi punën e nisur në mbledhjen e letërsisë popullore, por u përqendrua në mbledhjen e ligjeve malësore, të përmbledhura në *Kanunin e Lekë Dukagjinit* (1913-1924, botuar i plotë p.v. 1933), një prej kryeveprave të letërsisë dhe të historisë shqiptare. Po ashtu, një prej veprave të tij kryesore *Agimi i gjytetnisi* (1910) është e mbushur me citate nga lirika e Fishtës, gjë që dëshmon për autoritetin e Fishtës mbi shkrimtarë të tjerë françeskanë që në dekadën e parë të shekullit XX, mirëpo nuk dëshmon ndikimin e Fishtës te ai. Mund të përfundojmë se ndikimi i Fishtës te Gjeçovi mund të jetë vetëm i përgjithshëm, në kuptimin e mbledhjes së letërsisë dhe kulturës së ruajtur popullore, po jo edhe në kuptimin e ngushtë letrar.

BERNARDIN PALAJ (1894-1949) përzgjedhi antologjinë e parë të këngëve të kreshnikëve, *Visaret e Kombit/Kangë Kreshnikësh dhe legjenda* (1937), e cila edhe sot vazhdon të mbetet përmbledhja më autoritative e *Eposit të Kreshnikëve*. Ai vuri dorën e tij prej poeti në pesë prej tyre (1. *Martesa*, 2. *Muji te Mbreti*, 3. *Martesa e Halilit*, 4. *Gjergj Elez Alia*, dhe 5. *Muji e Behuri*), duke u dhënë atyre një shprehshmëri më të lartë²⁰¹, edhe pse në njërin prej tyre, *Muji te Mbreti*, këndohet një motiv që qenëson jashtë kuadrit të kreshnikëve, matja e Mujit me

200 Angela Cirrincione, Hymje, në At Bernardin Palaj, Vepra, Shkodër, 2005, fq. VI.

201 P. Fulv Cordignano S. J., „Kangë kreshnikësh“ në Shqypnin e Verit, HYLLI I DRITËS, 1941, nr. 3-5, fq. 147-154.

Mbretin e Stambollit dhe nuk paraqet vlerë letrare. Kjo mund të vlejë si dëshmi se Bernardin Palaj që në origjinë poet epik, po ai nuk shkroi një ep vetëm për shkak të respektit të madh që kishte ndaj mësuesit të tij, Gjergj Fishtës.²⁰² Lirika e Bernardin Palajt, me pretendime të një lirike mendimtare, në të vërtetë mbetet një lirikë pa frymëzim dhe pa shkëlqimin lirik. Ajo është e përkryer në planin e ndërtimit metrik, por bën kërcime skandaloze nga një lirikë mendimtare në një lirikë skajshëm pragmatiste e politike. Si e tillë ajo edhe një herë dëshmon prirjen e Palajt kah poezia epike, po në anën tjetër, edhe si e tillë, ajo është në vazhden e dy botëve të Fishtës në lirikën e tij: bota e po-së dhe e jo-së, bota e pohimit dhe bota e mohimit, bota e këngës dhe bota e vajit. Te Bernardin Palaj mund të gjejmë edhe ndonjë varg të ngjashëm me ato të Fishtës, e që argumentojnë për një ndikim të stilit fishtian mbi poetin:

E u ba zot shpije prap mbi komb t'vet,
 Pa i la kuj t'dhetë, pa njoftë as krajl as mbret.²⁰³
 Avitu, Zanë, pra, sot nji herë ngiat meje²⁰⁴
 Eni, moj Zana, pra, e Shtojzovalle²⁰⁵

MARIN SIRDANI (1887-1962) është i njohur më tepër si historian e publicist, autor i shkrimeve jokonvencionale, si *Nji rival i Skanderbeut*²⁰⁶, apo edhe i shkrimeve historiko-enciklopedike, si *Shqyphtarët e hartet*²⁰⁷, po edhe i shkrimeve të tjera historike për françeskanët dhe rolin

202 Angela Cirrincione, Hymje, në At Bernardin Palaj, fq. VI.

203 At Bernardin Palaj, Vepra, vëllimi I, (nën kujdesin e Angela Cirrincione-s), Botimet Françeskane, Shkodër, 2005, poezia Vorreve të Flamurit, fq. 164.

204 At Bernardin Palaj, Vepra, vëllimi I, fq. 164.

205 At Bernardin Palaj, Vepra, vëllimi I, fq. 174.

206 P. Marin Sirdani, Nji rival i Skanderbegut, HYLLI I DRITËS, 1932, nr. 7-8, 9, 12.

207 A. Marin Sirdani O. F. M., Shqyphtarët e hartet, HYLLI I DRITËS, 1921, nr. 4, 7; 1922, nr. 2, 4, 11, 12; 1923, nr. 5.

e tyre në historinë shqiptare. Sikurse edhe te Gjeçovi, edhe te Marin Sirdani nuk shihet një ndikim i Fishtës, në kuptimin e ngushtë të fjalës. Shumë më tepër mund të flasim për ndikim te D. Aleksandër Sirdani, i cili shkruan ndonjë vjershë, plotësisht sipas modelit të Fishtës²⁰⁸, por nuk njohim diçka më shumë prej tij.

Një tjetër studiues i letërsisë shqipe, Robert Elsie, dallon ndikimin e Fishtës te një rreth më i gjerë krijuesish, si te: Pashk Bardhi (1870-1948), Shtjefën Gjeçovi (1874-1929), Pal Dodaj (1880-1948), Vinçenc Prennushi (1885-1949), Marin Sirdani (1885-1962), Anton Harapi (1888-1946), Justin Rrota (1889-1964), Bernardin Palaj (1894-1947), Donat Kurti (1903-1969), Benedikt Dema (1904-1960) dhe Gjon Shllaku (1907-1946).²⁰⁹ Duket se Elsie, kur ka bërë një përkufizim të këtillë të qarkut ku është ndjerë ndikimi i Fishtës, ka pasur parasysh ndikimin e përgjithshëm dhe jo një ndikim konkret në veprën e këtyre shkrimtarëve dhe në një farë mënyre ai ka futur nën ndikimin e Fishtës të gjithë shkrimtarët e “shkollës katolike të Shkodrës”, si shprehet ai, bashkëkohës dhe më të vonshëm se Fishta. Por, ky ndikim i përgjithshëm është ndryshe nga ndikimi letrar, për të cilin ne jemi të interesuar dhe të cilin e kemi për studim në këtë kapitull. Rrethi i shkrimtarëve françeskanë, në veprat e të cilëve shihet ndikimi i Fishtës, është shumë më i vogël nga ata që përmend Elsie.

208 D. Aleksander Sirdani, Frati Shqyphtar, vjershë, HYLLI I DRITËS, 1937, nr. 1, fq. 41-42; Lauta Brideshe/Pater Nđou, këngë epike, HYLLI I DRITËS, 1937, nr. 7-8, fq. 373-374.

209 Robert Elsie, Historia e letërsisë shqiptare, fq. 302.

PËRFUNDIME

Duke përfunduar shtjellimin e marrëdhënieve të Fishtës me shkrimtarët e shkollës proklasike shkodrane, veçanërisht me rrethin e shkrimtarëve françeskanë shqiptarë, si në dimensionin marrës, ashtu edhe në atë dhënë, mund të përfundojmë me disa vlerësime gjykuese:

Fishta është ndikuar nga rrethi i shkrimtarëve proklasikë shkodranë në disa prej parimeve të përgjithshme krijuese, të cilat ai do t'i absorbojë, do t'i shndërrojë në vlera të veta dhe mbi to do të krijojë për katërdhjetë vjet letërsinë. Me këta letrarë ai ka të përbashkët vokacionin klasik, prirjen për letërsinë popullore, traditën e shkrimit të poezisë fetare dhe të poezisë satirike, temat e përgjithshme në letërsi dhe frymën patriotike të letërsisë.

Fishta nuk ka pasur një vepër apo disa sosh të traditës letrare shkodrane prej së cilës apo prej së cilave është ndikuar fuqishëm dhe të cilën apo të cilat është munduar t'i ndjekë. Ka munguar një vepër e tillë në rrethin e shkrimtarëve proklasikë dhe këtë mungesë e ka mbushur Fishta, duke u shndërruar kështu, vetë ai, në model të cilin do ta ndjekin krijues të tjerë.

Shkrimtarët e mëvonshëm françeskanë që e kanë ndjekur modelin e Fishtës janë të paktë.

Traditën letrare proklasike shkodrane të fundshekullit XIX dhe gjysmës së parë të shekullit XX, mund ta ndajmë në tri periudha:

Periudha e parë (parafishtiane) me Pjetër Zarishin, Leonardo De Martinin, Ndue Bytyçin, Anton Xanonin, Preng Doçin, Kolë Thaçin etj.;

Periudha e dytë përfshin Gjergj Fishtën, Ndre Mjedën, Luigj Gurakuqin etj.;

Periudha e tretë (pasfishtiane), përfshin shkrimtarët e krijuar nën hijen e Fishtës, si Pashko Bardhi, Shtjefën Gjeçovi, Pal Dodaj, Vinçenc Prennushi, Lazër Shantoja, Bernardin Palaj, Donat Kurti, Marin Sirdani, Anton Harapi, Benedikt Dema, Gjon Shllaku etj.

Maja e të tri këtyre periudhave është Fishta. Ai nuk ka marrë shumë prej të parëve, por edhe nuk është ndjekur shumë nga të tretët. Ai qëndron në mesin e dy anëve, si dielli të cilit nuk mund t'i afrohesh, po as nuk mund t'i largohesh.

Pse nuk u ndikua shumë nga tradita letrare shkodrane tashmë u dëshmuua për shkak të varfërisë së kësaj tradite. Pse Fishta nuk arriti të ndikojë poetë të tjerë të këtij rrethi ta ndjekin shembullin e tij në letërsi, sa do që ai gëzonte adhurimin e tyre, shpjegohet edhe me faktin se vepra e Fishtës që vetë një sintezë e krejt traditës letrare shqipe, pra edhe e traditës letrare shkodrane, prandaj, si sintezë që ishte nuk mund të ndikonte të tjerët. Sintetizuesi në një model mund të jetë vetëm një.

Kjo marrëdhënie e Fishtës me poetët e shkollës proklasike shkodrane para dhe mbas tij është si një majë mali që fillon nga pika zero, arrin majën më të lartë në pikën x dhe zbret tatëpjetë në pikën y. Në majën më të lartë, pranë Fishtës rri edhe një poet tjetër i kësaj shkolle: Ndre Mjeda. Meqenëse ai që bashkëkohës i Fishtës nuk i kemi shqyrtuar marrëdhëniet letrare të këtyre dy poetëve të mëdhenj shqiptarë.

KREU I TRETË

FISHTA DHE ROMANTIZMI

SHQYRTIM HYRËS

Derisa marrëdhënia e veprës së Fishtës me letërsinë popullore është shumë e kthjellët sepse ka një marrëdhënie të pastër marrje-dhënie, marrëdhënia e Fishtës dhe veprës së tij me romantizmin shqiptar është më komplekse, sepse ka një marrëdhënie përkimi, ngjashmërie apo dallimi, marrëdhënie ndikimi nga i njëjti burim etj. Edhe Fishta edhe romantikët e mëdhenj shqiptarë, si De Rada e Naimi, janë ushqyer nga të njëjtat ideale politike e kombëtare, që kanë vulosur artin e tyre. Për këtë arsye në këtë temë nuk mund të flitet për marrëdhënie ndikimi të ndërsjellë, për marrje-dhënie midis Fishtës e romantikëve shqiptarë. Për këtë arsye në këtë kapitull duhet të shqyrtojmë ngjashmëritë dhe dallimet midis veprës së Fishtës dhe romantizmit shqiptar. Në anën tjetër, derisa marrëdhënia e veprës së Fishtës, veçanërisht e epikës heroike, me letërsinë popullore është thelbësore, jo vetëm për faktin se Fishta, jo vetëm që merr struktura të gjera e të shkurtra të tekstit poetik popullor dhe i vendos në tekstin e vet poetik, por edhe për faktin se ai tekstin e vet poetik e ndërton mbi modelin e tekstit poetik të këngës popullore historike, marrëdhënia e veprës së Fishtës me romantizmin shqiptar nuk është e kësaj thellësie: Fishta ka të përbashkët me romantikët parimet e përgjithshme të marrëdhënieve arti-kombi, pastaj idetë kryesore poetike dhe tematikën, por jo edhe strukturat poetike, modelin e shkrimit apo edhe porosinë poetike. Ky fakti i fundit e bën Fishtën të jetë i lidhur jo me një apo me disa romantikë shqiptarë, por lidhjet e tij me romantizmin janë lidhje të natyrës së përgjithshme, lidhje apo ndikime nga fryma romantike, e cila mbizotëroi gati se gjithë periudhën e Rilindjes Kombëtare shqiptare.

Kështu, duke bërë krahasime midis veprës së Fishtës dhe asaj të romantikëve shqiptarë ne mund të sipërfaqësojmë ngjashmëritë dhe dallimet. Për këtë qëllim ne nuk do ta krahasojmë veprën e Fishtës me secilin poet romantik, se kjo edhe do të ishte një punë tepër e vështirë dhe e padobishme për temën që po e shqyrtojmë, por do ta krahasojmë me dy majat e romantizmit shqiptar: me Jeronim De Radën (1814-1903) dhe me Naim Frashërin (1846-1900). De Rada është romantiku i parë shqiptar, i cili jo vetëm botoi veprën e parë romantike, njëherazi kryevepra e parë e letërsisë artistike shqipe²¹⁰ *Këngët e Milosaos* (1836), por edhe krijoi gjedhen për shumë tema, ide poetike, heronj letrarë e modele shkrimi për romantikët e mëvonshëm.²¹¹ Në anën tjetër, Naim Frashëri kishte krijuar majat e letërsisë romantike shqiptare, duke ngritur në pedestal atë që kishte nisur De Rada, por gjithsesi në një formë krejt origjinale, duke krijuar me veprën e tij kryevepra letrare shqipe, sidomos me *Bagëti e Bujqësija* (1886), me rëndësi “historike në jetën e kombit”.²¹² Dy poetët e mëdhenj romantikë, në dy skaje kohore të romantizmit, në dy skajet gjeografike ku gravitonin shqiptarët, i pari De Rada e kishte hapur shtegun për një lëvizje të re letrare, romantizmin, ndërsa Animi po e përmbyllte këtë lëvizje, duke arritur bashkë me shkrimtarë të tjerë të krijojnë letërsinë kombëtare shqiptare. Krahasimi

210 Historia e letërsisë shqiptare, Rilindja, Prishtinë, 1989, (botuar nga ASH e RPS të Shqipërisë, 1983), fq. 255; Jup Kastrioti, Studime për De Radën, Gjonlekaç, NY, 2003, fq. 236.

211 De Rada është i pari poet shqiptar që futi në poezi figurën e Gjergj Kastriotit Skënderbeut dhe e trajtoi gjerësisht, duke e ndikuar kështu krejt poezinë shqipe deri në ditët e sotme. Është i pari poet shqiptar që krijoi kultin për epokën e Skënderbeut, i pari poet që krijoi një marrëdhënie të veçantë marrjeje nga letërsia popullore etj. Shih: Jup Kastrioti, Studime për De Radën, fq. 253 etj.

212 Historia e letërsisë shqiptare (1989), fq. 175.

i Fishtës me këto dy maja është krahasimi më kuptimplotë i veprës së Fishtës me romantizmin shqiptar.

Duke qenë se romantizmi shqiptar është i lidhur ngushtë me Rilindjen Kombëtare shqiptare, sa herë flitet për romantizmin flitet edhe për idealet politike, kulturore e kombëtare të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Në traditën e mendimit historik për romantizmin shqiptar është ngulitur mendimi se romantizmi buron nga Rilindja Kombëtare Shqiptare.²¹³ Duke dyshuar në saktësinë e këtij pohimi tradicional, duhet të theksohet se romantizmi në letërsinë shqipe fillon me *Këngët e Milosaos*, të botuar më 1836, në kohën kur ende nuk mund të flitet për Rilindje Kombëtare të vërtetë. Naum Veqilharxhi do të botojë *Evëtarin* (Abetare), më 1844 ndërsa *Enqiklikën* (Qarkore) më 1846, dokument ky i njohur nga historia e letërsisë dhe historia shqiptare si artikulimi i parë i idealeve të Rilindjes Kombëtare.²¹⁴ Pa u marrë më

213 Në Historinë e letërsisë shqiptare (1989), as që trajtohet romantizmi si drejtim letrar. Kjo letërsi emërtohet si “Letërsi e Rilindjes Kombëtare” dhe thuhet se “ajo lindë si letërsi e lëvizjes kombëtare” (fq. 114). Përmendet skutave edhe romantizmi, si “në kuptimin e metodës artistike letërsia e rilindjes ishte kryesisht romantike.” Dhe se ai romantizëm “lind prej vetë kushteve historike të periudhës” (fq. 116). Ndërsa në Historia e popullit shqiptar, II, shkruar nga grup autorësh nën redaktimin e Prof. Dr. Kristaq Priftit, botim i TOENA-s, 2002, thuhet se prej Rilindjes Kombëtare „lindi shkolla e romantizmit shqiptar të shek. XIX...“ (fq. 352). Ndërsa Rexhep Qosja, duke dalluar qartë romantizmin nga Rilindja Kombëtare shqiptare, saktëson: „mund të besohet se romantizmi shqiptar aq sa është i nxitur prej pozitës historike të shqiptarëve dhe prej gjendjes së kulturës së tyre-që i përcaktojnë karakteristikat e tij origjinale, po aq është i nxitur edhe prej lidhjeve me letërsitë romantike të disa vendeve evropiane-që i përcaktojnë shëmbëllesat e tij me to.“

(në Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi I, 1984, fq. 348).

Kur flet për këto lidhje të romantizmit shqiptar me romantizmin evropian, Qosja duhet ta ketë pasur parasysh në radhë të parë De Radën dhe ndikimet e tij nga romantizmi italian e francez, e që do të rezultojnë me botimin e veprës së parë romantike *Këngët e Milosaos* në vitin 1836.

214 “Në një Qarkore (“Enqiklikë”) që përhapte më 1846, patrioti Naum Veqilharxhi formulonte për herë të parë kërkesat kulturore të lëvizjes së çlirimit, duke i dhënë rëndësi themelore mesimit të gjuhës dhe ngritjes së kulturë kombëtare, si mjete për shpëtimin

tutje me dilemat rreth kësaj çështjeje, është katërcipërisht e saktë se duke shqyrtuar veprën e një romantiku detyrimisht duhet shqyrtuar edhe idealet e Rilindjes Kombëtare, ashtu si është bërë tradicionalisht në historinë e letërsisë shqipe. Edhe në këtë studim, duke shqyrtuar marrëdhëniet e Fishtës me romantizmin detyrimisht duhet të nisemi nga marrëdhënia e Fishtës me disa prej idealeve të Rilindjes Kombëtare, si është për shembull ideali i rilindësve për letërsinë. Kjo qasje e nxjerr temën pak jashtë letërsisë, por letërsia e romantikëve ka qenë origjinalisht e lidhur, më herët apo më vonë, me ideale jashtëletrare të Rilindjes Kombëtare, prandaj historianët e letërsisë e kanë pranuar dhe e kanë trajtuar si të tillë.

Shqyrtimi i këtyre përkimeve apo dallimeve të Fishtës me romantikët shqiptarë ka për qëllim zbardhjen e dy çështjeve: së pari, përimtimin e mëtejme të vlerave letrare, kulturore e estetike të veprës së Fishtës dhe, së dyti, gjetjen e përgjigjes në pyetjen se a është Fishta romantik dhe a është ndikuar prej romantikëve shqiptarë, përkatësisht se sa është ndikuar prej idealeve të Rilindjes Kombëtare shqiptare?

Për të arritur këtë do të nisemi nga shqyrtimi i marrëdhënieve të veprës së Fishtës ndaj parimeve themelore letrare të romantikëve, për të vazhduar me tematikën, motivet e figuracionin poetik dhe për të përfunduar me krahasimin e modeleve të shkrimit të Fishtës me ato të romantikëve.

e vendit dhe për vënien e atdheut në radhën e vendeve të qytetëruara. Qarkorja është vështruar si manifesti i parë i lëvizjes sonë kombëtare, si një program pune për të.“ (Historia e letërsisë shqiptare (1989), fq. 137). Shih edhe Historia e popullit shqiptar, II, ASHSH, Botimet Toena, Tiranë, 2002, fq. 100.

I. MISIONI I LETËRSISË

I.1. Ngjashmëritë e Fishtës me romantizmin

I.1.a. Letërsia dhe ideali nacional

Derisa romantikët evropianë hoqën dorë nga parimi i klasicistëve se arti është për elitën e shoqërisë dhe besuan se duhet të krijohet arti për masat e gjera të shoqërisë, prandaj iu drejtuan letërsisë dhe gjuhës popullore, si një burim i pashtershëm i veprës së tyre, e në fund, deri sa thyen traditën klasiciste se arti është kozmopolit dhe se mbështetja në traditën letrare nacionale është provincializëm i pafalshëm (Alexander Pope) dhe u mbështetën tërësisht në traditën nacionale si kopshtin më të mirë për krijuesin (Shlegel)²¹⁵, romantikët evropianë hapën shtegun për krijimin e letërsive nacionale në kuptimin e vërtetë të fjalës. Kësh-tu, historianët e letërsisë flasin për romantizmin gjerman, anglez, rus etj., duke i vendosur të gjithë mbi disa parime themelore të përbashkë-ta që paraqesin themelet e kësaj rryme letrare dhe njëkohësisht duke i dhënë secilit veçantitë e veta karakteristike. Eqrem Çabej në studimin e tij të njohur *Romantizmi në Evropë juglindore e lindore e në literaturën shqiptare* (1945) e ndërlidhë romantizmin gjerman me botën e brendshme të individit (“nuk ndodh më kot që vepra më e madhe poetike e gjermanëve, Fausti i Gothes, është tragjedia e individit.”²¹⁶), ndërsa romantizmin francez e ndërlidhë me idetë sociale dhe politike (“Të shikuar nga kjo pikëpamje, të gjithë këta poetë (poetët romantikë

215 Cituar sipas Povijest knjizevnih teorija, përgatitur nga Miroslav Beker, SNL, Zagreb, 1979, fq.215.

216 Eqrem Çabej, Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes / Romantizmi në Evropë lindore e juglindore dhe në letërsinë shqipe, MÇM, Tiranë, 2002, fq. 71.

francezë, shënim i B.K.) janë Napoleonidë, epigonë letrarë të kësaj figure historike të madhe.²¹⁷). Duke folur për romantizmin në Evropën lindore dhe në atë juglindore, në këtë kontekst edhe për romantizmin shqiptar, Çabej gjen aq shumë dallime nga romantizmi evropian sa që me të drejtë shtron pyetjen “a mund të flitet më këtu për romantizëm?”²¹⁸ Duke dhënë një përgjigje pozitive, pavarësisht nga dallimet, Çabej gjen karakteristikën tjetër që i dha romantizmit juglindor vulën kryesore: ideja nacionale.²¹⁹ Kombet e Ballkanit, që jetonin prej shekujsh nën sundimin osman dhe që kishin zhvilluar hapat e parë të lëvizjeve nacionale për çlirim gjetën te parimet e romantizmit mundësinë për ta ndihmuar luftën e tyre çlirimtare edhe përmes artit e letërsisë. Kështu ndodhi edhe me romantizmin shqiptar.

Romantikët shqiptarë e vunë artin e tyre në lidhje të plotë me idenë nacionale. Nga ky pikëvështrim, romantizmi për kulturën dhe letërsinë shqiptare nuk ishte vetëm një rrymë letrare, ishte shumë më tepër: ishte agim i letërsisë (vetëm me romantizmin krijohet letërsia kombëtare shqiptare): ringjallje e letërsisë popullore; ngritje e gjuhës popullore në gjuhë letrare; shkollë e edukim kombëtar dhe ishte krenari për të kaluarën kombëtare. Në traditën e mendimit historik për romantizmin kjo lidhje e romantizmit me idenë nacionale ka mbetur e patrajtuar sa duhet, ose e trajtuar njëanshëm: romantizmi është trajtuar si letërsi në shërbim të idesë nacionale dhe të politikës nacionale për çlirim. Në *Historinë e letërsisë shqiptare* (1983), e që ishte historia më autoritative në studimet letrare shqiptare në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore e deri në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit XX, letërsia e Rilindjes

217 Eqrem Çabej, Shqiptarët midis Perëndimit dhe.../ Romantizmi në..., fq. 71.

218 Eqrem Çabej, Shqiptarët midis Perëndimit dhe.../ Romantizmi në..., fq. 75.

219 Eqrem Çabej, Shqiptarët midis Perëndimit dhe.../ Romantizmi në..., fq. 75.

Kombëtare merr kuptimin e një letërsie që është në shërbim të idesë nacionale dhe të ideve politike të Rilindjes Kombëtare. Ndërsa Rexhep Qosja e çon deri në skaj këtë pikëvështrim të mjegulluar të kritikës shqiptare:

“Letërsia për ta është më parë një mjet i luftës sesa krijimtari e lirë artistike; nuk është e çuditshme, prandaj, pse disa prej tyre do të jenë në gjendje të zëvendësojnë penën me armë”.²²⁰

Mosdallimi i qartë i poetit nga ideologu dhe i poezisë nga ideja nacionale ka shkaktuar pështjellim në historinë e letërsisë shqipe. Studentët që kanë mësuar nga librat historikë për De Radën apo Naim Frashërin, kurrë nuk e kanë kuptuar se a ishin ata më të rëndësishëm si poetë apo si ideologë kombëtarë? Edhe vetë studiuesit më të famshëm të letërsisë kanë rënë në këtë kurth. Eqrem Çabej në studimin e tij *Për gjenezën e literaturës shqipe* (1938-39), njëjtëson poetin dhe ideologun, por gjithnjë poeti është parësori:

“Këtij brezi, ashtu siç ndodhi në gjithë Evropën e Juglindjes dhe në kuptimin që përmendëm më lart, i ra përsipër një detyrë e shumëfishtë: të dalin përpara si poetë dhe si patriotë, të shpallin idenë e lirisë nacionale dhe të bëhen me shkrimet e tyre edukatorët e kombit.”²²¹

Ndërsa po Çabej, në studimin *Romantizmi në Europë lindore e juglindore dhe në literaturën shqiptare* (shkruar më 1945), thotë:

“Animi është para së gjithash edukator. Poeti qëndron pas patriotit. Idealet artistike ia sakrifikoi kryesisht përpjekjes nacionale-politike. Do të pranojmë se me përjashtim të disa pak vjershave vlera letrare e

220 Rexhep Qosja, *Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi, I, Rilindja, Prishtinë, 1984, fq. 352.*

221 Eqrem Çabej, *Shqiptarët midis Perëndimit dhe.../ Romantizmi në..., Çabej, fq. 98.*

poezisë së tij është e pakët. Sepse veprat e tij më fort se qëllim estetik i shërbenin një qëllimi etik.”²²²

Përfundimisht historia e letërsisë shqipe duhet të ndryshojë qasjen ndaj kësaj çështjeje. Duke e lidhur letërsinë e tyre me idenë nacionale dhe me qëllimet politike të Rilindjes Kombëtare Shqiptare me ndërgjegje të plotë, romantikët shqiptarë nuk e shndërruan letërsinë në propagandë nacionale, siç pohohet tradicionalisht në historinë e letërsisë shqipe. Ata bënë ndryshe: idenë nacionale e ngritën në mit dhe pastaj këtë mit e bënë temë të letërsisë së tyre. Duke trajtuar mitin kombëtar, mitin për gjuhën, mitin për t’Parët, mitin për epokën e ndritshme të Skënderbeut etj., letërsia dhe ideja nacionale njëjtësoheshin, pa e humbur letërsia mëvetësinë letrare dhe vlerën estetike. Rexhep Qosja e konfirmon krijimin e miteve nga romantikët, por nuk e konfirmon trajtimin e këtyre miteve nga po ata romantikë:

“Domethënë: duke shkruar aq shpesh, me një gjuhë zmadhuese, për origjinën, të kaluarën dhe shëmbëlltyrat historike kombëtare, duke e sjellë historinë në kufi të krijimtarisë imagjinare, kurse krijimtarinë imagjinare në kufi të historisë, romantikët tanë mitizojnë historinë kombëtare dhe shëmbëlltyrat e saj të shquara. Përsëritja dhe përsëritja me gjuhën panegjirike, bëhet mjet i mitizimit të të shkUARës historike në romantizmin shqiptar. Romantikët shqiptarë, pra, krijojnë mite më parë se ç’trajtojnë mite.”²²³

Romantikët shqiptarë, krijojnë mitet nacionale, jo vetëm ato historike dhe i trajtojnë pashkëputshëm ato mite. Këtu qëndron dallimi i një letërsie në shërbim të një ideje joletrare dhe të letërsisë që është

222 Eqrem Çabej, Shqiptarët midis Perëndimit dhe.../ Romantizmi në..., Çabej, fq. 107.

223 Rexhep Qosja, Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi, I, fq.173.

letërsi para së gjithash dhe vetëm më pastaj edhe armë për një qëllim jashtëletrar. Letërsia e majave romantike është e tillë: ajo është letërsi që kishte krijuar mite nga ideja nacionale dhe më pastaj i trajtonte vetë ato mite, pa e humbur mëvetësinë letrare.

Poema *Bagëti e Bujqësija* (1886) është një strukturë e mrekullueshme gjuhësore e poetike, në radhë të parë, e vetëm më pastaj edhe një thirrje ideologjike e patriotike për atdheun e shqiptarëve. Nuk është parësish e rëndësishme se cili ka qenë qëllimi apo misioni i Naimit me këtë poemë? Ka plot shembuj në letërsinë botërore, po edhe në letërsinë tonë, kur qëllimi i poetit dhe misioni i veprës së tij janë të ndryshëm. Që prej përfundimit të kritikës biografike të Sent Bevit (1804-1869)²²⁴ dhe mplakjes së ideve pozitiviste të Ogyst Kontit (1798-1857)²²⁵, historia e letërsisë merret parësish me veprën letrare dhe jo me autorin apo qëllimet e tij.

Një shembull të mirë për kapërcimin e këtij gjykimi (mbase edhe paragjykimi) letrar mund të na japin vlerësimet që janë bërë tradicionalisht për poezitë me temë për gjuhën shqipe. Poezi për gjuhën shqipe kanë shkruar shumë poetë romantikë dhe pasromantikë. Kanë shkruar vetë Animi e më vonë edhe Fishta. Në historinë tradicionale të letërsisë këto poezi janë konsideruar si poezi ideologjike, pasi kanë madhëruar një prej elementeve themelore të idesë nacionale, gjuhën shqipe, si bazën më të fortë ku bashkoheshin të gjithë shqiptarët, kudo qofshin ata.

224 Povijest knjizevnih teorija, përgatitur dhe me parathënie të Miroslav Beker, SNL, Zagreb, 1979, fq. 230-231 dhe fq. 341-343. Shih edhe IKU u Beogradu, Recnik knjizevnih termina, Nolit, Beograd, 1992, fq. 90. Shih Agim Vinca, Kurs i teorive letrare, Libri Shkollor, Prishtinë, 2002, fq. 147-149.

225 Samuel Enoch Stumpf, Filozofia, historia dhe problemet, Botimet Toena, Tiranë, pa vit botimi, fq. 326-334. Shih edhe Shih edhe IKU u Beogradu, Recnik knjizevnih termina, Nolit, Beograd, 1992, fq. 632.

“Për të zgjuar krenarinë kombëtare të lexuesve, poeti (Naim Frashëri, sqarim i B.K), përveç motivit historik, i këndoi veçanërisht gjuhës shqipe, shënjës së parë të kombësisë...”²²⁶

Këtë fakt, më vonë, e thekson edhe Rexhep Qosja, kur thotë se romantikët i vunë vetes për detyrë:

“ta nxjerrin gjuhën shqipe prej pozitës nënçmuese në të cilën gjendej disa shekuj, ta kthejnë besimin e shqiptarëve në mundësitë, në traditën dhe në ardhmërinë e saj...”²²⁷

Mirëpo, duke u ndodhur përballë besimit në bukurinë shprehëse të gjuhës, si p.sh. te lirika *Gjuha jonë* dhe te *Korça* e romantikut Naim Frashëri, apo edhe përballë lirikës *Gjuha Shqype* e pasromantikut Gjergj Fishta, kritikët nuk kanë mundur të mos e vërejnë faktin se më shumë se ideologji, këto lirika janë himne për mundësitë shprehëse të gjuhës shqipe dhe më tej, janë adhurim i fjalës së bukur. I pari e thekson këtë fakt Namik Resuli në një studim autoritativ për gjuhën e Fishtës *Gjergj Fishta dhe gjuha shqipe*²²⁸, pastaj edhe në vetë *Historinë e letërsisë shqiptare* të sipërcituar vërehet ky fakt:

“Ata (Animi, Mjeda etj.) i kënduan me zjarr të zemrës bukurisë, gjerësisë, pasurisë dhe ëmbëlsisë së gjuhës shqipe. (...) ata vunë në pah pasurinë dhe vlerat e mëdha të gjuhës së popullit, treguan në krijimet poetike se sa bukur tingëllonte shqipja si gjuhë e aftë për të shprehur fërgëllimet më të thella të ndjenjave, nuancat më të holla të mendimit.”²²⁹

226 Historia e letërsisë shqiptare (1989), fq. 194.

227 Rexhep Qosja, Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi, I, fq. 133.

228 Namik Resuli, Gjergj Fishta dhe gjuha shqipe, te Jeta e re, nr. 11-12, 1990.

229 Historia e letërsisë shqiptare (1989), fq. 101.

Mbi tezën e Namik Resulit, në vitet '90 të shekullit XX, Dr. Ardian Marashi e ngrit në kult gjuhën shqipe të disa poezive të poetëve shqiptarë, si te Animi e te Fishta, po tashmë jo një kult ideologjik, por një kult estetik.²³⁰ Në të vërtetë nuk mund të interpretohen ndryshe, përveç se himn për gjuhën si mundësi shprehëse e jo si mundësi identifikuese, vargje si këto të Naimit në poezinë *Fjalët e Qiririt*:

E ku shkruhenë në kartë

Fjalët e gjuhësë Zjartë?²³¹

Shikimi i kontinuitetit të pikëpamjeve të kritikës shqipe për një prej miteve të poezisë romantike, gjuhës shqipe, duke potencuar këtu ndryshimet e këtyre pikëpamjeve, argumenton fuqishëm se romantikët shqiptarë, sado që e kanë lidhur pashkëputshëm letërsinë e tyre me idealet e Rilindjes Kombëtare shqiptare, ata nuk e zgjodhën rrugën e lehtë, të provuar në Mesjetë kur artet ishin shërbëtore të teologjisë, po zgjodhën rrugën e re të krijimit të miteve moderne nacionale dhe trajtimit të këtyre miteve në letërsinë e tyre.

Mbi këtë përvojë letrare të romantikëve shqiptarë e krijon letërsinë e vet edhe Gjergj Fishta. Vepra e Fishtës ka një mision kombëtar e shoqëror. Po ngjashëm me disa prej majave të romantizmit, vepra e tij ka para së gjithash mision letrar e estetik. Vepra e Fishtës është e lidhur pashkëputshëm me idealet e Rilindjes Kombëtare shqiptare, por edhe me idetë sociale e politike të hershme apo të mëvonshme, të pas Rilindjes. Po të provohet t'i hiqen veprës së Fishtës këto ideale, gjë që nuk mund të bëhet, nuk do të mbetej asgjë nga kjo vepër.

230 Ardian Marashi, *Konsiderata mbi gjuhën artistike të Fishtës*.

231 Naim Frashëri, *Vepra 2 / Vjersha për mësonjëtoret të para*, Rilindja, Prishtinë, 1978, fq. 11.

Lirikat e Fishtës, sidomos ato patriotike, nuk dallojnë aspak në temat e motivet e tyre nga ato të romantikëve. Edhe Fishta u këndon miteve të idealit nacional: atdheut, gjuhës shqipe, flamurit, heroit kombëtar etj. dhe u këndon për të njëjtat qëllime sociale e estetike sikurse edhe ata. Prandaj, te lirika e Fishtës mbizotëron ligjërimi thirror, ai himnizues e predikues²³² dhe kjo është në përputhje me mesazhin e tekstit poetik. Vetëm te lirika fetare e Fishtës ka një shkallë më të lartë të misionit ideologjik e social të artit, po edhe aty nganjëherë arti e mund misionin ideologjik, si te poezia *Gurravet të Jordanit*.

Tekstet dramatike të Fishtës janë shumë më tepër me mision. Disa prej këtyre teksteve kanë mision edukativ, arsimues ose fetar, si *Shqyptari i gjytnuem*, *Shqiptarja e qytetnueme*, *Barit e Betlemit*, *Sh'Françesku i Asizit* dhe *Sh. Luigji Gonzaga*. Në këto tekste dramatike Fishta është më shumë edukator e predikues sesa poet. Mirëpo, në tekste të tjera dramatike, si *Juda Makabe* dhe *Ifigenija n'Aulli*, e para dramë tërësisht romantike dhe e dyta tërësisht klasiciste, misioni estetik dhe misioni kombëtar e filozofik janë të njëjtësuar.

Satira e Fishtës, gjinia ku pena e Fishtës bëhet mbretërore, në përputhje edhe me vetë misionin e satirës në letërsi, është me mision social, kombëtar e politik.²³³

Epi i Fishtës *Lahuta e Malcis* paraqet shembullin më të mirë të misionit të letërsisë, sipas konceptit romantik. Nëse jo prej fillimit, para vitit 1905 kur janë botuar pesë këngët e para, së paku shumë para përfundimit të *Lahutës së Malcis*, Fishta e ka konceptuar atë si një ep

232 Bajram Kosumi, *Lirika e Fishtës*, Toena, Tiranë, 2004, fq. 81-84.

233 Qëllimi themelor i satirës është "të tregojë dobësitë shoqërore apo morale, veset e të këqijat, t'ua nënshtrorë këto shpottitjes dhe ironisë, dhe në këtë mënyrë të ndihmojë në mënjanimin e tyre." Shih te: Recnik knjizevnih termina (1992), fq. 744.

nacional. Vetë ky fakt paragjykon, jo vetëm formën letrare të veprës dhe disa parime të tjera letrare karakteristike për epin, por edhe marrëdhëniet e një vepre të tillë me etnikumin. Studiuesi kroat Pavao Pavlicic ka përshkruar parakushtet shoqërore për lindjen e këngës epike dhe lidhmëninë e kësaj kënge me shoqërinë. Këto kushtëzime, sipas tij, janë:

kënga epike flet në emër të gjithë bashkësisë që i përket;

kënga epike flet për gjërat që janë jetësishme të rëndësishme për gjithë bashkësinë së cilës i përket;

kënga epike në mënyrën më të drejtpërdrejtë e përpunon atë pikëpamje (koncept, filozofi) ndaj botës, në të cilën mbështetet bashkësia si organizëm shoqëror;

për shkak të lidhjeve të tilla me bashkësinë, kënga epike krijohet vetëm në disa rrethana historike dhe vetëm në disa tipe të situatave shoqërore.²³⁴

Siç shihet, për nga vetë natyra e saj, kënga epike ka një mision të lartë në shoqëri. Fishta ka shkruar epin e vet mbi temën e luftës së shqiptarëve për integritetin e trojeve etnike dhe për formimin e shtetit kombëtar shqiptar. Këto ngjarje kanë qenë vendimtare për të ardhmen e shqiptarëve. Në këtë mënyrë, përveç se është autor e këngëtar i këngës epike, Fishta me *Lahutën e Malcis* është në një farë mënyre edhe krijues i kësaj të ardhme, krijues i Shqipërisë së re dhe kombit të lirë shqiptar. Ernest Koliqi thotë se:

“para se të krijohej politikisht, Shqipëria u krijua prej “poetënvet në shpirt të Shqiptarvet me kangë qi ngjallshin afshin për liri e mandej u

234 Pavao Pavlicic, Epsko pjesništvo, në Uvod u knjizevnost (përgatitur nga Z. Shkreb/A. Shtamac), Globus, Zagreb, 1986, fq. 413-414.

shugurue me gjak të dëshmorvet të shtymum m'u ba flije prej atyne kangve.”²³⁵

Duke rezymuar atë që u tha deri më tash për marrëdhëniet e Fishtës me romantizmin në lidhje me letërsinë dhe marrëdhënien e saj me idenë nacionale, mund të përfundojmë se në veprën e tij epike dhe në atë dramatike, pjesërisht edhe në lirikë, Fishta mbështetet në të njëjtat parime letrare sikurse romantikët e mëhershëm shqiptarë, që nga De Rada e deri te Animi. Në këtë drejtim, kjo pjesë e veprës së Fishtës është pashkëputshëm e lidhur me idealin nacional të Rilindjes Kombëtare, ajo ka karakter politik dhe patriotik, shpesh shndërrohet në mjet lufte për realizimin e këtij ideali nacional, por në përgjithësi ajo nuk është shërbëtoare e idealeve jashtëletrare, përkundrazi, ajo i krijon dhe i trajton mitet moderne nacionale dhe duke i krijuar e trajtuar këto mite, si letërsi, ajo kryen edhe një mision jashtëletrar: misionin nacional për krijimin e kombit të lirë e të shtetit shqiptar.

I.1.b. Karakteri arsimor dhe edukativ i letërsisë

Një mision tjetër i letërsisë romantike shqiptare është misioni arsimor (iluminist) dhe edukativ i shtresave të gjëra popullore. Ky iluminizëm, i zhvilluar mbi idealet e Rilindjes Kombëtare, dallon nga iluminizmi i një shekulli më parë, ku nëpër qendrat iluministe mësohej në njërën nga tri gjuhët e huaja (greqisht, latinisht, turqisht), e vetëm aty këtu shqip, por edhe atëherë me alfabet arab²³⁶, apo në ndonjë alfabet tjetër. Poetët romantikë do të shkruajnë vetë libra shkollorë, si bëri Naim Frashëri. Animi ka botuar në prozë shkencore²³⁷ *Istori e pëg-*

235 Ernest Koliqi, Fishta interpret i shpirtit shqiptar, fq. 52.

236 Rexhep Qosja, Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi, I, fq. 48.

237 Rexhep Qosja pohon se këto proza shkencore, pavarësisht se janë të tilla dhe janë shkruar për qëllime edukative të shkollave shqipe “ato janë vepra që sot lexohen më

jithshme për mësonjëtoret të para (v. 1886), *Dituritë për mësonjëtoret e para* (v. 1888), *Istori e Shqipërisë* (v. 1899). Përveç librave të diskursit shkencor, Animi ka botuar edhe prozë e poezi edukative e arsimore për fëmijë: *Vjersha për mësonjëtoret e para* (v. 1886), *E këndimit çunavet (këndonjëtoreja)* (v. 1886), *Parajsa dhe fjala fluturake* (v. 1894). Për këto proza dhe poezi për fëmijë të Naimit Rexhep Qosja thotë:

“Të gjitha poezitë dhe prozat e Naim Frashërit për fëmijë i nënsht-rohen një qëllimi themelor: edukimit të fëmijëve.”²³⁸

Ky qëllim e ka shtyrë poetin e madh ta sakrifikojë artin për t’ua bërë sa më të qartë porosinë arsimore e edukative atyre që ua dedikon. Për këtë arsye shumica e poezive të tilla përfundojnë me gjykime fabula-tive, si:

Qysh munt të mbetet i gjallë

Ëngjelli bashkë me djallë?

Botënë mos e gjykoni

Me fjalëtë q’u dëgjoni,

Mos u shikoni ç’tregojnë,

Po vini re ç’gjë punojnë.²³⁹

Kur historianët e letërsisë flasin për karakterin iluminist e edukativ të letërsisë romantike nuk mendojnë vetëm në librat e diskursit akademi-k apo edhe vetëm në tekstet letrare, por me qëllime iluministe e edu-kative. Karakteri arsimor i letërsisë romantike është më i thellë, është një prej parimeve themelore të kësaj letërsie dhe e gjen, qoftë si shfaqje të hapur, qoftë si tendim, në çdo varg e në çdo rresht të teksteve letrare

parë si shkrime letrare se sa si shkrime thjeshtë diturore.” Shih në Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi III, Rilindja, 1986, fq. 140.

238 Rexhep Qosja, Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi, III, Rilindja, 1986, fq. 160.

239 Naim Frashëri, Vepra 2 / Vjersha për mësonjëtoret të para, fq.53.

romantike. Pranë një strofe të pastër poetike për mundësitë shprehëse të gjuhës shqipe (strofa 10 në poezinë *Korça*), Naimi do të vërë edhe një strofë krejt didaktike:

S'jemi Grekër as Bullgarë,
As gjë tjetër nukë jemi,
Jemi vetëm Shqipëtarë,
Një kët' emër nder' e kemi.²⁴⁰

Ky është karakteri arsimor e edukativ i letërsisë romantike shqiptare, i shfaqur në të gjitha thellësitë dhe në të gjitha gjerësitë e veta.

Fishta nuk ka hequr dorë nga karakteri arsimor e edukativ i artit në një pjesë të madhe të veprës së tij. Tashmë kemi përmendur tekstet dramatike edukative e arsimore, si: *Shqyptari i gjyvetnuem*, *Shqiptarja e qytetnueme*, *Barit e Betlemit*, *Sh'Françesku i Asizit* dhe *Sh. Luigji Gonzaga*. Fishta i shkruan këto tekste dramatike jo për të bartur një mesazh letrar e estetik, por për të bartur një a më shumë porosi edukative e arsimore, me përmbajtje nacionale, sociale apo fetare. Kështu, personazhet e tekstit dramatik *Shqyptari i gjyvetnuem*, e shfaqur më 19 dhjetor 1911 në Shkollën Françeskane në Shkodër, janë: Shqyptari, Feja, Hartet, Geni, Vallja, Poezija, Piktura, Muzika, Arkitektura, Skulptura, Elokuenca, Vagneri. Protagonisti është pa dyshim Shqyptari ndërsa të gjithë personazhet e tjerë tregojnë të arriturat e Shqyptarit dhe ndihmën që do t'ia japin në të ardhmen. Teksti dramatik është ndërtuar tërësisht si mësim shkolle:

YANKU

Po, a thue, din mue me m'kallzue
Se sa vjet mund t'ken kalue

240 Naim Frashëri, *Vepra 1 / Lulet e verësë*, Rilindja, Prishtinë, 1986, fq.189.

Q'se n'Shqypni shkollët kan fillue?

SHQYPTARI

Se sa vjet munden me kenë,
 Po ta them un tash pa rrenë,
 Si nder në gjithkush e di.
 N'mitetqindgjashtdhetenji
 Françeskajt e Shqyptaris
 Me ndimë t'Zotit e t'Austris,
 E me lmoshë t'bamirsvet t'Shkodres,
 Pa tan-tanë e krisme t'lodres,-
 Çilen n'Shkoder, t'thuesh, ndo ksolla
 N'Gjuhadol, ma të parat shkolla-
 T'parat shkolla popullore,
 Ku, pa pare e dhanti dore,
 Zu Shqyptarvet me u dhanë msimi
 Per kah Feja e Gjytetnimi.
 E nuk dij se per sa vjet
 Jo veç n'Shkoder, ktu n'gjytet,
 por mund t'thuesh, per Shqypni mbarë
 kjo pat kenë shkolla ma e parë ²⁴¹

Në këtë tekst dhe në tekste të ngjashme arti fle. Kështu ndodhë vetëm edhe te një pjesë e lirikës fetare. Në lirikën patriotike hasim këtë karakteristikë të artit fishtian, si në poezinë *Gjuha Shqype*, pranë vargjeve antologjike krahasuese, të nisura me pjesëzën kra-

241 Gjergj Fishta, Dramatika / Shqyptari i gjytetnuem, Rilindja, Prishtinë, 1997, fq. 137-138.

hasuese “porsi” në modelin e anaforës, poeti vë edhe porosinë edukative:

Pra, Shqyptarë, çdo fes’ qi t’jini,
Gegë e Toskë, malci e qyteta,
gjuhen t’uej kurr mos t’a lini,
mos t’a lini sa t’jetë jeta, ²⁴²

Në poezinë satirike, aty ku pena e Fishtës shkëlqen, janë vetëm dy tekste satirike-dramatike me karakter edukativ *Gjuha e mësimit* (v. 1908) dhe *Nevoja e mësimit* (v. 1908). Në veprën tjetër satirike Fishta godet, ironizon, përqesh, satirizon, po nuk edukon dhe nuk arsimon, nëse e lëmë anash karakterin edukues të satirës.

Në *Lahutën e Malcis* Fishta vazhdon me traditën romantike për karakterin arsimor e edukues të letërsisë. Këtu nuk do të merremi me faktin se epi nacional gjithmonë ka në thelbin e vet edhe karakterin edukues, por në *Lahutën e Malcis* ka mjaft pjesë ku karakteri edukativ shfaqet hapur, sidomos në ato raste kur autori ndërhyt në rrjedhën e rrëfimit dhe shfaq opinionin e vet për këtë apo atë ngjarje, personazh apo zhvillim:

Shqyptarët, po, t’u vra n’mjet veti,
Per nji Pashë qi çueka Mbreti.
Eh atë Zoti m’a marroftë!
Perse i huej, kushdo qi kjoftë.
Aj gjithmonë a augur i zi
Per te mjeren moj Shqypni,
Si njaj korbi qi ndiell zi ²⁴³

242 Gjergj Fishta, *Lirika / Mrizi i Zanavet*, Rilindja, Prishtinë, 1997, fq. 46.

243 Gjergj Fishta, *Lahuta e Malcis*, Rilindja, Prishtinë, 1997, Kangë X, vargjet 314-320.

Karakter i iluminist e edukativ i artit të Fishtës është i qëllimshëm. Fishta është krenar për misionin edukativ të veprës së tij. Në një letër për Atë Pal Dodajn të vitit 1912 Fishta e thotë shprehimisht këtë koncept të tij për artin edukativ:

„Me gjith kta, po them se nuk ia vlen t’kerkosh bukurit poetike n’ket punë (në tekstin dramatik *Shqyptari i gjytetnuem*, plotësim imi, B. K.), perse t’duhet ma fort t’i marrish me mend se t’i zbulosh. Mue më mjafton qi mundi i em t’i ketë mbërritë qëllimit, d.m.th. me edukue publikun tue e nxitë kah perparimi e atdhedashtnijë.“²⁴⁴

Duke rezytuar atë që u tha për karakterin iluminist dhe edukativ në veprën e Fishtës, e që është e ndikuar drejtpërdrejt nga letërsia romantike shqiptare, duhet të theksohet fakti se ky karakter i letërsisë është i pranishëm në literaturën shqipe edhe para romantikëve: ka filluar me shkrimtarët e vjetër të Veriut, ka lulëzuar sidomos në qendrat kulturore shqiptare të shekullit XVIII, si është Voskopoja. Por, iluminizmi i Fishtës është i njëjtë me iluminizmin e romantikëve, një iluminizëm për kulturën kombëtare shqiptare, për dallim nga iluminizmi i shekullit XVIII që kishte karakter shkencor dhe fetar dhe bëhej pothuajse ekskluzivisht në gjuhë të huaja.²⁴⁵

I.1.c. Marrëdhënia e letërsisë së shkruar me letërsinë popullore në periudhën e romantizmit shqiptar

Marrëdhëniet e Fishtës me letërsinë popullore trajtohen shterueshëm në një kapitull të veçantë të këtij studimi. Ajo që do të bëjmë në këtë pjesë është të argumentojmë se ajo marrëdhënie e Fishtës me

244 Gjergj Fishta, Estetikë dhe kritikë, përgatitur për shtyp nga Persida Asllani, Hylli i Dritës & Shtëpia e Librit, fq. 197-198.

245 Rexhep Qosja, Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi, I, fq. 48.

letërsinë popullore, në qasje, nuk është origjinalisht e Fishtës, por e ndikuar nga fryma popullore e letërsisë romantike dhe pararomantike. Fishta, në këtë qasje të veten ndaj letërsisë popullore, do të jetë ndikuar, si kemi përmendur më herët, edhe prej sivëllezërve të tij françeskanë, pastaj edhe nga disa poetë kroatë, por shumë më tepër do të jetë ndikuar nga qasja e poetëve romantikë ndaj letërsisë popullore.

Qasjen e re të romantikëve ndaj letërsisë popullore e ka nisur vetë romantiku i parë shqiptar Jeronim De Rada, që në moshën fare të re.

“Në korrik të vitit 1833 e lashë kolegjin. (...) Në shtator më erdhi prej Kozencës letra e avokatit të përmendur Rafael Valentini, i cili më vonë, në moshë të shtyrë, u bë kryetar i pushtetit ekzekutiv të kryengritësve të Kalabrisë më 1848. më kërkonte këngë popullore të kolonive tona. Shkova në Shën Kozmo te nënëdaja e këtu, një plakë, me emrin Tortoshëlja, më recitoi të parat këngë, ndërmjet të cilave ato të Dedë Skurës, Milo Shinit e Radavanit. Në Shën Mitër pata pjesët e shumë këngëve nga Oricia, gjyshja nëntëdhjetëvjeçare e Dhimitër Strigarit.

Pastaj vazhdoja të dëgjoja gratë e fshatit, prej të cilave mësova këngë të tjera. Mbledhjen e dërgova në Kozencë. Nga shoqëria me vajzat dhe nga thjeshtësia e shqiptimit të atyre këngëve lindi historia e parash-trimi i legjendës së Milosaos.²⁴⁶

Asnjëherë De Rada nuk do të ndahet, qoftë nga mbledhja e folklorit, qoftë nga shkrimi i letërsisë autoriale mbi bazë të letërsisë popullore. Më 1848 ai e humbet një përmbledhje të përgatitur me këngë popullore. Më 1866 botoi përmbledhjen e famshme të këngëve popullore

246 Jeronim De Rada, *Vepra*, 7 / Autobiografia, përkth. nga Jup Kastrati, Rilindja, 1988, fq. 302-303.

*Rapsodi të një poeme shqiptare, të cilën e ribotoi te Fiamuri i Arbërit më 1883 me titullin Rapsodi kombëtare.*²⁴⁷

Mbledhja e letërsisë popullore kishte një traditë shumë më të hershme të Arbëreshët e Italisë, që datonte që nga fundi i shekullit XVII. Në kohën kur De Rada shkoi të mblidhte këngët e para kishte parë në bibliotekën e Flumine Toçit në Shën Kozmos një libër të Françesk Abatit (1717-1800) me këngë popullore arbëreshe.²⁴⁸ Mirëpo, te arbëreshët ishte shumë e njohur përmbledhja në dorëshkrim me 18 këngë popullore e Nikollë Filjes (1691-1769) me titull *Kënkëzë pleqrijsë* (1736).²⁴⁹

Studiuesi më autoritativ i De Radës, Jup Kastrati, e quan atë “më i madhi folklorist arbëresh”.²⁵⁰ Kastrati nuk i jep këtë epitet De Radës për shkak të mbledhjes së folklorit, por për shkak të përdorimit dendurak të folklorit në veprën e tij letrare. *Këngët e Milosaos* janë shkruar në gjedhë të këngës popullore arbëreshe: përshkrimet e shumta të natyrës, fjalësi, dialogët dhe disa forma të jashtme poetike si vallja, janë të ndikuara prej rapsodive popullore. Sipas Qemal Haxhihasanit kangjelet IV, IX, XV, XVIII, XX, XXIX pjesërisht e kanë burimin nga këngët popullore.²⁵¹

Me *Këngët e Milosaos* De Rada e kishte hapur një shteg të ri në letërsinë shqipe: përdorimin e pakufizuar të letërsisë popullore në letërsinë autoriale. Ai kishte përdoruar letërsinë popullore si një autor veprën e vet: ka renditur këngët në *Rapsodi të një poeme shqiptare* sipas një rendi logjik e historik të motiveve, ka marrë prej këngëve popullore

247 Jup Kastrati, Studime për De Radën, fq. 180-189.

248 Jeronim De Rada, Vepra, 7 / Autobiografia, fq. 337.

249 Matteo Mandala, Gjurmime filologjike/ Për letërsinë e vjetër arbëreshe, Çabej, Tiranë, 2006, fq. 348.

250 Jup Kastrati, Studime për De Radën, fq. 173.

251 Cituar sipas J. Kastratit, Studime për De Radën, fq. 239.

për veprat e veta motive, figura, personazhe dhe teknika ndërtimi të tekstit poetik. Ai madje ka pasur guximin të vërë dorën në to²⁵² dhe të shtojë ndonjë varg për të mbushur zbrazëtitë në këngë, sipas përfytyrimit të tij se këto këngë ishin mbetje të një epepeje të vjetër shqiptare. Ky koncept krijues letrar i De Radës i ndikuar nga J. G. Herder (1744-1803), J. Makferson (1736-1789) etj., jo vetëm që ka ndikuar letërsinë e arbëreshëve fund e krye, atë romantike dhe pasromantike, por edhe ka përligjur estetika shumë autorë të tjerë e veprat e tyre, madje deri në fund të gjysmës së parë të shekullit XX, si Fishta, Kuteli²⁵³ etj. Të tjerë romantikë shqiptarë kanë ecur brenda këtyre kufijve letrarë të vendosur prej De Radës, prandaj nuk do të trajtojmë ndonjë shembull tjetër.

Ku konvergjojnë Fishta dhe De Rada në përdorimin e letërsisë popullore?

Fishta ka përdorur letërsinë popullore në veprën e tij autoriale mbi të njëjtat koncepte sikurse edhe De Rada, e ka përdorur sikur të ishte ajo vetë vepër e tij: është ndikuar prej saj, ka marrë prej saj fjalë, figura, fjalë të urta, frazeologji shqipe, mite, heronj, motive, ide poetike, tema, vargje të tëra, pjesë të tëra të tekstit poetik, modele shkrimi, si modeli

252 Jup Kastrati, Studime për De Radën, fq. 175.

253 Mbase Mitrush Kuteli është poeti i fundit shqiptar që shkroi një vepër autoriale mbi tekstin letrar krejtësisht popullor: në vitin 1965 ai botoi librin Tregime të moçme shqiptare, një variant kutelian në prozë i Eposit të Kreshnikëve. Edhe pse ato janë bërë edhe për qëllime edukative e arsimore për lexuesin e moshës së re, në radhë të parë këto tregime janë krijime poetike, ose më drejt rikrijimi mbi bazën e Eposit të Kreshnikëve. Studiuesi i Kutelit Dr. Sali Bashota shpreh me një fije dyshimi efektin letrar të këtyre tregimeve:

Me këto tregime “duke dhënë disa shpjegime konkrete në fillim me Parafjalën e botimit të tyre, pastaj veç e veç për disa nga to, Kuteli sikur e thëllon, e zgjeron dhe e frymëzon përfytyrimin dhe bindjen e lexuesit për vlerat e artit gojor dhe ndikimin e tij të përgjithshëm në letërsinë e shkruar.”

Shih: Dr. Sali Bashota, *Kuteli prozator, poet, kritik*, Rilindja, Prishtinë, 1999, fq. 104.

i dyluftimeve i marrë nga *Eposi i Kreshnikëve* etj. Po, ndikimin më të madh Fishta e ka shfaqur në *Lahutën e Malcis*, duke e ndërtuar epin nacional shqiptar mbi teknikën e modelin e shkrimit të këngëve popullore historike shqiptare. Mbi këtë model dhe me këtë teknikë shkrimi Fishta ka krijuar njërën prej kryeveprave të letërsisë shqipe.

Nga ky aspekt, nga mënyra e përdorimit të letërsisë popullore si një gurrë e pashuar për poetin dhe veprën autoriale, si dhe shkrimi i letërsisë autoriale sipas modelit të letërsisë popullore e bën Fishtën, jo vetëm të ndikuar, por edhe shumë të afërt me romantikët e tjerë shqiptarë.

I.2. Dallimet e Fishtës nga romantikët

I.2.a. Karakteri kritikues i letërsisë së Fishtës

Në letërsinë e romantikëve tanë rrallëherë mund të gjejmë mendimin dhe gjuhën kritike. Stili i tyre ligjërues është kryesisht himnizues. Me veprat e tij më kryesore, si *Këngët e Milosaos* (1836), *Serafina Topia* (1839), *Skënderbeu i pafat* (1872) dhe me përmbledhjen e këngëve popullore *Rapsodi të një poeme shqiptare* (1866) De Rada himnizon shekullin e Skënderbeut në të gjitha aspektet e tij dhe arrin të krijojë imazhin për një shekull ideal shqiptar. Duke folur për ndikimin që pati *Rapsodi e një poeme shqiptare*, studiuesi deradian Jup Kastrati thotë:

„Botimi i Rapsodive popullarizoi epokën e madhe heroike të Skënderbeut, që u bë edhe tematika kryesore e gjithë letërsisë arbëreshe.“²⁵⁴

Naim Frashëri idealizon natyrën shqiptare dhe njerëzit e punët që bëhen në Shqipëri, duke krijuar kështu idealin e përsosmërisë së at-

254 Jup Kastrati, Studime për De Radën, fq. 183.

dheut shqiptar. Po Animi nuk kufizohet vetëm në botën shqiptare, ai himnizon edhe vlera universale si dashuria, mirësia, bukuria etj. Sabri Hamiti e vëren himnizimin si stil ligjërimit, si një prej karakteristikave themelore të Naimit:

„...himmizimi është proces dominues në veprat e tij poetike më të njohura: Bagëti e Bujqësija, 1886, Bukurija, 1890 dhe Histori e Sklënderbeut, 1898. kjo mënyrë e këndimit nëpërmjet lavdit, apo e ndërtimit të lavdit nëpërmjet të poezisë, do të hetohet edhe në poezi të veçanta të tij, që lidhen ose me jetën përgjithësisht, ose me gjuhën apo me ndonjë shenjë themelore të identitetit kombëtar.²⁵⁵

Një pjesë e romantikëve janë afruar edhe me stilin ligjërues vlerësues, duke i lejuar vetes që në veprën letrare të japin gjykimin e prerë se çka është e mirë e çka është e keqe²⁵⁶, mirëpo, nuk kalohet përtej këtyre kufijve. Sabri Hamiti, duke trajtuar himnizimin si prosede krijues, vëren rrënjët e tij te letërsia e autorëve të vjetër dhe ndikimin e tij e shtrin deri në dekadën e dytë të shekullit XX, deri aty ku fillon Noli e Migjeni.²⁵⁷

Vetëm Pashko Vasa me vjershën e njohur *Mori Shqypni, e mjera Shqypni!* (1880) krijon një disakord me prosedeun himnizues të romantikëve. Në këtë poezi Pashko Vasa, pasi himnizon të kaluarën e lirë shqiptare, bën një kthesë të prerë me vargun pyetës *Por sot, Shqypni, pa më thuej si je?*²⁵⁸, për të vazhduar pastaj me një prosede tjetër gjuhësor,

255 Sabri Hamiti, Studime letrare, ASHAK, Prishtinë, 2003, fq. 143.

256 Rexhep Qosja, Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi, I, fq. 258.

257 Sabri Hamiti, Studime letrare, fq. 159-160.

258 Pashko Vasa, Vepra 1, përgatitur për shtyp nga Fahredin Gunga, Rilindja, Prishtinë, 1989, fq. 74.

me gjuhën kritikuese për gjendjen e shqiptarëve dhe të Shqipërisë në kohën e sundimit osman.

Në një pjesë të veprës së tij Gjergj Fishta, duke qenë sikur romantikët shqiptarë një udhëtar i idealit nacional, nuk mund t'i ikën ligjërimit himnizues. Himnizimi si prosede gjuhësor është romantik sidomos te një pjesë e poezisë lirike, po shumë më i fuqishëm te *Lahuta e Malcis*. Në këto vepra Fishta himnizon botën shqiptare, në veçanti karakterin e shqiptarit, duke e idealizuar atë përmes figurës së malësorit shqiptar. Ai i kishte hapur botës, përmes himnizimit, karakterin e shqiptarit dhe kjo ka ndikuar Ernest Koliqin që ta quajë atë “interpret të shpirtit shqiptar”:

„Kështu qi mund të thuhet se vepra e Fishtës asht përpjekja ma vigane qi shqiptari bani deri tash për t'ia zbuluem vetvehtes botën e vet.“²⁵⁹

Mirëpo, Fishta është mjaft i njohur për karakterin kritikues të veprës së tij. Po me atë zjarr që himnizon gjuhën shqipe Fishta mallkon ata që përbuzin këtë gjuhë (në poezinë *Gjuha Shqype*). Po me atë gjuhë emocionale që lavdëron luftëtarët malësorë ndër beteja me trimat malazezë Fishta kritikon e shanë shqiptarët pse lanë të shkëputet Kosova dhe shumë territore etnike shqiptare nga trangu shqiptar më 1912:

Ehu! shka do t'bajn, thue, tash Shqyptarët e shkretët:

Ata, qi m'vedi pasë e kanë kanun:

Ata, qi n'dej kanë gjak të Skanderbeut:

Qi sheklli mbajtë i ka per burra t'dheut?-

5. Shka bajn Shqyptarët?...Han fiq e kastraveca:

259 Ernest Koliqi, *Fishta interpret i shpirtit shqiptar*, Kuvendi Françeskan, Gjakovë, 1997, fq. 26.

E pijnë mastikë, e qesin petlla n'uej;
 E ngrihen rrugës e fryhen si gjeldeca;
 E rrijn tue kqyrun udhës ushtarët e huej
 Pale a kanë ksulen qyp ase kapelë,
 a e ka uficiali kalin at a pelë.²⁶⁰

Është bërë pothuajse proverbial vargu i Fishtës *Oj Zanë, t'këndojm...t'vajtojm, deshta me thanun* nga poezia 28 *Nanduer 1913*, e që paraqet dy stilet ligjëruese të Fishtës, atë himnizues dhe atë kritikues.

Forcën e vet kritikuese gjuha e Fishtës e shfaq në poezinë satirike. Aty Fishta është i pamëshirë, jo veç kritikues, por edhe sarkastik deri në fund. Dhe, në shënjestër të kësaj gjuhe nuk janë vetëm disa individë, por struktura të tëra të shoqërisë shqiptare e të qeverisë, letrarë, poetë, kritikë, tregtarë, qytetarë të shkolluar, botues librash, deputetë, politikanë etj., për të shkëlqyer në epin heroiko-komik *Palokë Cuca* (1922), në të cilën poeti godet pamëshirshëm mendësinë qytetare shqiptare të fillimit të periudhës së pavarësisë së Shqipërisë:

Jo, po, moj Zanë, kam da veti me veti,
 Me tjerrun tortë sivjet nji kangë të re,
 Qi kur der m'sod s'kje ndie n'Shqypni as njeit,
 Por, qi do t'ndihet larg, shpresoj, mbi dhe,
 Por, n'kjoftë se ka me m'mbajt mue jeta e shndeti:
 Kam da me kndue per t'kshtenë, per turq e shkje
 Si Palokë Cuca leu, si rnoi, si diq,
 Si per Atdhe guksoi, si u orvat per...fiq.²⁶¹

260 Gjergj Fishta, *Lirika / Mrizi i Zanavet*, fq. 90.

261 Gjergj Fishta, *Satirika / Palokë Cuca*, Rilindja, 1997, Kanga e parë, 3.

Duke përmbyllur shqyrtimin për karakterin kritikues të veprës së Fishtës, mund të përfundojmë se sado në një pjesë të veprës së tij Fishta vazhdon traditën himnizuese letrare, në pjesën tjetër ai bën një prerje të kësaj tradite dhe është ndër të parët poetë shqiptarë që filluan pro-sedeun gjuhësor kritik në letërsi. Fishta, bashkë me Çajupin, po shumë më afër me Nolin, Migjenin e Kutelin e mëvonshëm, janë baballarët e letërsisë që kritikon dhe nuk himnizon tematikën apo heronjtë e vet. Në këtë pikë, Fishta në njërin anë, dhe De Rada e Animi, në anën tjetër, janë si dy botë të ndryshme: De Rada e Animi krijojnë letërsinë mbi ligjërimin himnizues, duke krijuar kulte e mite eterike, ndërsa Fishta krijon letërsinë mbi ligjërimin kritikues dhe vepra letrare nuk ka asnjë tabu.

Letërsia himnizuese e Fishtës (*Lahuta e Malcis*, një pjesë e lirikës patriotike dhe lirika fetare) dhe letërsia satirike e Fishtës (përmbledhja *Anzat e Parnasit*, *Gomari i Babatasit*, *Visku i Babatasit* etj.) janë dy anët e ndryshme të poetit dhe të veprës së tij, po në misionin e letërsisë në shoqëri janë të ngjashme ose të njëjta. Nëse flasim me gjuhën e romantikëve për misionin e letërsisë në shoqëri, atë që krijoi Fishta me *Lahutën e Malcis*, atdheun dhe kombin e lirë shqiptar, e sulmoi deri në kulm me satirën e vet të ashpër, po përsëri për të njëjtin qëllim: për ta kultivuar më tej veprën e krijuar në *Lahutë të Malcis*. *Lahutën e Malcis* e shkruan Fishta idealist e ëndërrues, ndërsa *Palokë Cucën* e shkruan idealisti i zhgënjyer Fishtë.

I.2.b. Fryma klerikale e letërsisë së Fishtës

Gjatë Mesjetës së vonshme dhe në kohën e re shoqëria shqiptare është zhvilluar, nën ndikimin e religjionit, si një shoqëri centripetal-

iste.²⁶² Institucionet fetare shqiptare, duke tërhequr drejt qendrave të tyre (për myslimanët qendër ishte Porta e Stambollit dhe bota turko-arabe; për ortodoksët Patrikana e Stambollit dhe bota greko-bizantine dhe për katolikët Papa në Romë dhe bota evropiane perëndimore) tërhiqnin, nën ndikimin e këtyre qendrave, edhe kah kultura, mendësia, gjuha dhe politikat e tyre. Kjo tërheqje drejt, së paku, tri qendrave të huaja kulturore, fetare e politike, e cila nuk mund të lidhet vetëm me nocionin diversitet, ishte pengesë thelbësore në zhvillimin e idesë nacionale në Rilindjen Kombëtare dhe në zhvillimin e vet kombit shqiptar. Prandaj, rilindësit shqiptarë, bashkë me ta edhe romantikët, e rikthyen religjionin në pozitën origjinale dhe të vërtetë në shoqëri, pra e rikthyen në çështje individuale, në çështje të besimit të individit dhe në masë përcaktuese individuale e jo shoqërore. Sipas këtij koncepti modern, në përputhje me idealet e Revolucionit Borgjez Francez, shqiptarët (si shoqëri) ishin vetëm shqiptarë, ndërsa një shqiptar (si individ) mund të ishte mysliman, ortodoks apo katolik. Ky ndryshim në qasjen ndaj fesë bëri që të zbehet roli i qendrave tërheqëse kulturore, fetare e politike, duke i lëshuar vendin krijimit të një qendre tërheqëse shqiptare, që nuk është e shprehur përmes një qyteti a një krahine, por përmes idealit nacional. Kjo bëri që gjatë Rilindjes Kombëtare të bëhen proverbiale vargjet e poemës *Mori Shqypni, e mjera Shqypni* (1880) të

262 Nocioni centripetal për këtë fenomen është përdorur nga Eqrem Çabej në studimin Për gjenezën e literaturës shqipe, por kur ai flet aty për fuqitë centripale në zhvillimin e etnikumit shqiptar ka parasysh pozitën gjeografike të udhëkryqit të territorit shqiptar dhe dyndjet e mëdha që nga mesjeta e hershme e deri në ditët e vonshme të mbas pushtimit osman (fq. 21). Ndërsa Rexhep Qosja në Historinë e letërsisë shqipe, Romantizmi, I, (1984) flet për religjionin dhe institucionet fetare shqiptare si fuqi përcarëse në zhvillimin e idealit nacional (fq. 51-52).

poetit shkodran Pashko Vasa, të cilat i afrohen idealit për krijimin e një feje origjinale shqiptare:

Çoniu, o shqyphtarë, prej gjumit çoniu,
të gjithë si vllazën në një besë shtërngoniu,
edhe mos shikoni kisha e xhamia,
fe e Shqyphtarit asht Shqypitaria.²⁶³

Njëri prej këtyre ideologëve, Sami Frashëri, në veprën e tij *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë* (1899), pa dyshim njërën prej kryeveprave të literaturës shqiptare, shkruan:

“Mos vështroni bes’ e fe; myslimanë, katolikë, orthodoxë, gjithë shqiptarëtë, sa jan’ e tek janë, janë vëllezër. Gjithë duhet të bashkohen nënë fjamurit të shenjtëruar të Shqipërisë!”²⁶⁴

Rilindësit dhe romantikët shqiptarë patën sukses të madh në këtë mision të tyre të ripërkufizimit të marrëdhënieve shqiptari (nacioni)-feja. Studiuesi i marrëdhënieve feja-kombi te shqiptarët, Roberto Maroco dela Roka, edhe pse shpesh i njëanshëm, konstaton se:

“Për shqiptarët nacionalizmi ishte pasioni i vetëm i madh i jetës publike. Ishte një ideal gjithpërfshirës, i plotë, pa kompromise.”²⁶⁵

Në veprën e Gjergj Fishtës, jo vetëm nuk qenëson ky ideal i romantikëve shqiptarë, por në ndonjë pjesë të saj ndodhë e kundërta. Heroi i Fishtës në *Lahutën e Malcis* aspak nuk i përngjan Pashko Vasës dhe vargjeve të tij, por është një hero që lufton për Atdhe-Mbret e Fe, janë prifti e hoxha, ata që i nxisin shqiptarët të luftojnë për atdhe. Edhe në lirikën e tij është njësoj: patrioti shqiptar dhe feja janë të ngjizura. Në

263 Pashko Vasa, Vepra 1, fq. 77.

264 Sami Frashëri, Vepra 2 / Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë, fq. 77.

265 R. M. dela Roka, Kombi dhe feja në Shqipëri 1920-1944, Elena Gjika, Tiranë, pa vit botimi, fq. 10.

shkrimet publicistike ky fenomen shndërrohet në koncept: Fishta angazhohet për një shtet shqiptar, në të cilin feja do të luajë rol parësor, madje ai zhvillon koncepte për një shtet pothuajse fetar dhe, nga ky prizëm akuzon shtetet laike perëndimore si Franca etj. dhe krijuesit e këtij koncepti, si Volteri²⁶⁶ etj.

Në vitin 1913 Fishta thotë:

“Prandej detyrët qi nieri ka per t’vu mbi shekull janë kto: *Feja, Atdheu, Gjindja, e Dija*.”²⁶⁷

Shumë vite më vonë, më 1923, në shkrimet e diskursit publicistik, Fishta do ta shtrojë edhe një herë pyetjen, të cilën tashmë e kishin zgjidhur kaherë rilindësit shqiptarë, duke e ndarë fenë nga kombi dhe duke e lënë në çështje të besimit individual: kombi dhe shteti shqiptar a duhet të zhvillohet sipas “sistemit” aziatik apo atij oksidental, e që në fakt derivon të jetë zgjidhje midis kristianizmit (perëndimi) dhe myslimanizmit (lindja)? Duke e pohuar kundërshtimin e papajtueshëm të këtyre dy sistemeve Fishta pohon se nuk mund të ketë një zgjidhje kompromisi, duhej marrë njëri e duhej hedhur tjetri sistem: duhej hedhë sistemi aziatik, të cilin e urrenin shqiptarët, por kjo nuk mund të bëhej lehtë për shkak të fesë myslimane që përfaqësonte shumica e shqiptarëve. Zhvillimi i këtyre teorive, në këtë mënyrë të gabuar, e çuan Fishtën edhe në përfundime tejet johistorike dhe në kundërshtim të plotë me idealet e Rilindjes Kombëtare, në ndarjen e territorit shqiptar në kantone mbi baza fetare.²⁶⁸ Vetëm dy vjet më vonë idetë

266 Gjergj Fishta, Kisha Katolike ka trajtue kulturen oksidentale, HYLLI I DRITËS, 1923, nr. 4, 5 dhe 6. Njësoj edhe te: Fishta, Përndritje, publicistikë, Lajmëtari, Tiranë, 2000, fq.188,

267 Gjergj Fishta, Përndritje, (Përlimi i përkohshmes), Lajmëtari, Tiranë, 2000, fq. 11.

268 Gjergj Fishta, Arsim, apo luftë kundra katoliqizmit në Shqipëri?, HYLLI I DRITËS, 1923, nr. 7. Aty Fishta, ndër të tjera thotë:

për kantonet mbi bazat fetare marrin karakter të pastër politik dhe diskutohen në qarqet e ndryshme politike, të brendshme dhe të huaja. Në një Raport të konsullit të përgjithshëm italian në Shqipëri Koch, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme në Romë, ai përmend se Patër Fishta i kishte bërë propozimin si zgjidhje të mundshme të amullisë së Shqipërisë ndarjen administrative të Shqipërisë në tri kantone.²⁶⁹

Në shkrimet e këtij diskursi Fishta për ligj idealin fetar të futur në veprën e tij letrare:

“E pse na Shqypnin nuk e kemi dishrue veç sa me ju peshue shqypnarve dhetë herë buka thatë, para se me e hanger: sa per nji zhel m’shtat, e sa per me pasë kah nji mehmur m’qafë, per më majë me rroga n’ar, por edhe per triumf t’idealeve tona, nder të cillat, padyshim, zen vendin e parë ideali fetar. Po; per triumf të ktij ideali të Parët tonë kan pasë lshue arët e veta, megjjet e veta e shka kan pasë vithna e pleme e gji-me t’eger

“Do t’ishite mujtë, ndoshta, me u zhdrivillue ky problem-deri diku edhe me dobi të komit- a tuj decentralizue autoritetin nder “kantone autonome”, e se tuj vendue qi perfaqsuest e komit t’u dergojshin në Parlament, jo mbas proporcionit të numrit t’elektorve, por mbas nji shifret të caktueme sa per shumicën aq per elementat e tjerë: ka 50% per të dyja lagjet.” (Shih edhe: Përndritje, publicistikë, Lajmëtari, 2000, fq.206.)

Se kishte ide të tilla në mendimin politik e fetar shqiptar të asaj kohe, bile edhe më radikale, dëshmon fakti se në vitet ’20 të shekullit XX një komision katolikësh shqiptarë “tuj u pershkue neper Jugoslavi, shkote në Gjenevë, e aty, para “Lidhjes s’Komeve, lypte, qi katolikt t’u shkepshin prej sundimit të Qeverisë s’Tiranës, per arsye qi kristjan e muhamedan nuk mund t’jetojshin bashkë...”, të cilën nismë Episkopati Katolik i Shqypnisë e përgënjeshtronte. (Shih po aty, fq. 223).

269 Mediha Shuteriqi dhe Dhimitër Andoni, Veprimtaria antikombëtare e klerit katolik të Shqipërisë në shërbim të fashizmit italian, në STUDIME HISTORIKE, nr. 2, Tiranë, 1968, fq. 181. Aty thuhet, ndër të tjera:

“Mund të shpresohet një rezultat më i mirë-tha ai (Fishta, plotësim i B.K.)-nëse vendi do të ishte ndarë në tre kantone, Veriu katolik, Qendra muslimane dhe Jugu orthodoks, seicili me autonomi të vet, nën një pushtet qendror, ku do të përfaqësoheshin që të tre.”

e të butë, e kan dalë në mal, tue jetue-ata edhe na-mi rrasë të gjallë, si ato bishat e shkerbet e egra, pa kurrnji të mirë nen ket Zot.²⁷⁰

Fatmirësisht në veprën letrare të Fishtës nuk zhvillohen koncepte radikale fetare, madje ndodhë e kundërta: aty ka një harmoni ndër-fetare dhe shqiptarët luftojnë bashkërisht kundër sunduesve osmanë dhe armiqtë të rinj sllavë. Vetëm në një këngë të *Lahutës së Malcis*, Kanga XXVIII *Dedë Gjo' Luli* ndodhë një beteje fetare ndërsqiptare, ndërmjet muhamedanëve të Shkodrës dhe katolikëve të Malcis të prirë nga Dedë Gjo' Luli.

Falë i kjoshin t' Madhit Zot!

Kur janë lshue Grudë edhe Hot

N'at Dinoshë m' bashibuzukë,

250 Ç'ka ushtue mal e ç'a trandë sukë,

Edhe toka ç't'ka bumllue:

Kaq permnershëm t' janë perla,

Si me u gri Turku me shkja:

Jo ma t'gjith Shqypitar-nji vlla!

255 Shoq me shoq miq e kumarë,

T'gjithë bujarë, t'gjithë pushkatarë,

Kundra shkjaut qi sa e sa herë

Krah per krah kan rra n'poterë,

E s'bashku kan derdhun gjak,

260 Tuj u gri me Karadak.²⁷¹

270 Fishta, Arsim, apo luftë kundra katolikizmit në Shqypni?. Shih edhe: Fishta, Përndritje, fq. 216-217.

271 Fishta, Lahuta e Malcis, Kangë XXVIII.

Është edhe një tekst paraletrar me këto ide, dedikimi (shkruar më 1926) në poezinë satirike *Nikolejda*, të shkruar më herët, më 1901, por që nuk paraqet kurrfarë rëndësie.²⁷²

Si kam vërejtur edhe më heret²⁷³, këtë karakter fetar të letërsisë së tij e nxitë dhe e krijon vetë ai, autori, Gjergj Fishta e jo heronjtë e tij. Ndryshe nga Fishta, heronjtë e tij në *Lahutën e Malcis* e definojnë idealin nacional pikë për pikë sikurse rilindësit kombëtar. Motivet e vërteta të luftës së Mar Lulës, Bajraktar i Shalës, në Kangën IX *Lidhja e Prizrendit të Lahutës së Malcis*, kundër forcave osmane dhe sllave janë: atdheu, liria, erzi, giuha, t'Partë, doke e kanu.²⁷⁴ Ky është një prej fakteve të shumta se në *Lahutën e Malcis* ka triumfuar poeti Fishtë mbi priftin Fishtë.

Kur flasim për karakterin fetar të letërsisë së Fishtës duhet veçuar një çështje: këtu nuk flasim për lirikat e tij fetare dhe për tekstet dramatike fetare. Ato trajtohen më vete, sipas gjinisë letrare apo sipas tematikës. Në këtë nënkapitull ne trajtuam karakterin fetar të veprës jofetare të Fishtës, për të vënë theksin te dallimet në këtë çështje midis tij e të gjithë romantikëve të tjerë shqiptarë.

272 Fishta, *Satirika / Nikolejda*, Rilindja, Prishtinë, 1997, fq. 427. Shih edhe B. Kosumi, *Lirika e Fishtës*, fusnota në fq. 67-68.

273 Bajram Kosumi, në librin *Lirika e Fishtës*.

274 Bajram Kosumi, *Lirika e Fishtës*, fq. 116-117.

II. TEMATIKA DHE MOTIVET

II.1. Ngjashmëritë e Fishtës me romantikët

Në veprën e tij Fishta trajton tema që janë trajtuar edhe më parë në letërsinë e romantikëve shqiptarë. Disa prej tyre, si e kemi theksuar në kapitujt e mëparshëm, janë trajtuar edhe para romantikëve, nga shkrimtarët e vjetër të Veriut. Gjuha shqipe ka qenë e shndërruar në temë letrare, që nga shkrimtarët e vjetër të Veriut. Po ashtu edhe çlirimi i shqiptarëve nga sundimi osman. Romantikët i kishin zhvilluar më tutje këto tema, duke i shndërruar në mite letrare. Duke folur për tematikën shqiptare Sabri Hamiti i futë në kategorinë e *temave të përhershme* temat si gjuha Shqipe.²⁷⁵ Këto tema ishin në përputhje të plotë me idealet e Rilindjes Kombëtare dhe me idealet letrare të romantikëve shqiptarë. Në përgjithësi, romantikët trajtuan temat, të cilat lidheshin në një mënyrë me idealin nacional të Rilindjes Kombëtare. Ata trajtuan edhe tema universale, si tema filozofike apo ekzistenciale, mirëpo strumbullari i tematikës së tyre janë disa tema që lidhen funksionalisht me idealin nacional. Këto mund të përdalohen në këto grupe:

Tema e atdheut me format e ndryshme, si: tema e mërgimit; e dashurisë në lidhje me atdheun; e vdekjes për atdheun; e çlirimit nga sunduesi osman; e luftërave heroike për atdheun; e mallit për atdheun etj.;

Tema e gjuhës shqipe, e cila nuk ka forma të ndryshme.

275 Sabri Hamiti, *Tematologjia*, ASHAK, Prishtinë, 2005, fq. 22.

Tema historike shqiptare me format e ndryshme, si: temat e shekullit XV (shekulli i Skënderbeut) ose Moti i Madh si e quajten arbëreshët kohën e Skënderbeut; tema ilire-pellasgjike si sfond etj.

Tema universale si: tema fetare; filozofike e ekzistenciale; e vdekjes; e dashurisë; e moralit etj. Këto tema shpesh lidhen me temën e parë, atë të atdheut.

De Rada në veprat e tij pati për kryetëmë shekullin XV, Shekullin e Skënderbeut dhe brenda saj trajtoi shumë edhe tema të tjera e motive të ndryshme, si:

malli për atdheun e largët, që është e pranishme në çdo vepër të tij; tema erotike, e ndërthurur me motive sociale te *Këngët e Milosaos*, apo e ndërthurur me motive politike si te *Këngë të Serafina Topisë*;

tema historike shqiptare te: *Këngë të Srafinë Topisë*, princeshë e Zadrimes, në shekullin XV (1843)²⁷⁶, në të cilën autori shtjellon jetën e shqiptarëve dhe pjesërisht edhe luftën e tyre kundër osmanëve në shekullin XV, por të gjitha këto të ndërthurura me idealin e lirisë së Shqipërisë, bile edhe dashurinë e saj ndaj fisnikut Bozdar Stresit protagonistja e poemës, Serafina Topia nga Arta, e sakrifikon për t'u martuar me princin Nikollë Dukagjini, vetëm e vetëm për të bashkuar Jugun dhe Veriun shqiptar; *Histori e Shqipërisë*, ose *Shqipëria* nga viti 1460 deri më 1485 (1847), në të cilin tri poemat e para „shprehin trilogjinë tragjike të shtëpisë së Arianit Komnen Topisë“²⁷⁷; te *Skënderbeu i pafat* (1872-1884) përsëri De Rada shtjellon luftërat shqiptare kundër osmanëve në shekullin e Skënderbeut.

²⁷⁶ Poema ishte e gatshme më 1839, por derisa ishte në shtyp, me titullin *Këngë historike shqiptare të Serafina Topisë*, grua e princit Nikollë Dukagjinit, censura e ndaloi botimin dhe qarkullimin e saj. Shih te: Jup Kastrati, *Studime për De Radën*, fq. 242.

²⁷⁷ Jup Kastrati, *Studime për De Radën*, 2003, fq. 247.

Këto tema të De Radës ndikuan përfundimisht jo vetëm letërsinë arbëreshe, por krejt letërsinë shqiptare²⁷⁸, duke u bërë pjesë të përhershme të interesimit të poetëve shqiptarë edhe tej kufijve të romantizmit.

Te Naim Frashëri kemi një larmi më të madhe temash, si:

te *Bagëti e Bujqësija* poeti trajton temën e atdheut, e formuluar përmes natyrës, botës bimore e shtazore dhe përmes njerëzve të atdheut;

te *Lulet e verësë* poeti trajton tema e motive të larmishme, të lidhura për atdheun, arsimimin e kombit, temën e gjuhës shqipe dhe tema filozofike e ekzistencialiste, si koncepti naimian për mirësinë, vdekja etj;

te *Bukurija* tema e bukurisë femërore dhe temën e erotizmit;

te *Istori e Skënderbeut* poeti trajton temën e mirënjohur romantike-shekullin e Skënderbeut dhe luftën e shqiptarëve e të Skënderbeut kundër osmanëve;

te *Qerbelaja* poeti trajton temën fetare përmes një lufte tragjike fetare të shekulli XII, midis sekteve të ndryshme islame.

Këto tema romantikët i trajtuan thellësisht dhe gjerësisht dhe arritën që me to të ushtrojnë ndikimin e tyre të fuqishëm, jo vetëm te bashkëkohësit, por edhe deri në fund të shekullit XX letërsia shqipe nuk arriti të lirohet nga ndikimi i këtyre temave. Nisur nga kjo, romantizmi shqiptar është lëvizja më e fortë letrare në letërsinë shqipe.

I vetmi romantik, i cili nuk do të kufizohet vetëm te temat historike shqiptare, po do të trajtojë edhe tema bashkëkohore, me motive të luftës së shqiptarëve kundër sunduesve osman, është Zef Skiroi. Skiroi, sikurse këndoi për Motin e Madh, me të njëjtën gjedhe shkrimi trajtoi

278 Në Historinë e letërsisë shqiptare (1989) thuhet për veprën e De Radës: “Veprat e tij patën rëndësi për zhvillimin e mbarë letërsisë shqiptare” (fq. 285).

edhe luftërat e reja të shqiptarëve kundër sundimit osman dhe personazhe të kohës së autorit, si Esat Toptani, Hasan Riza Begu, Dervish Pasha, Hodo Begu, Haxhi Zeka, Preng Bibë Doda, Ali Pashë Tebelena, Vasiliqia etj. Poezia epike e Skiroit theu traditën e krijuar prej De Radës për të shtjelluar vetëm tema të shekullit XV. Në poemën epike *Te dheu i huaj* (1900, 1940) poeti trajton, krahas ngjarjeve e personazheve të shekullit XV edhe ngjarje dhe personazhe të shekullit XIX, si Ali Pashë Tebelena, Marko Boçari, Lleshi i Zi, Ibrahim Pashë Begolli, Mahmut Pashë Shkodrani (Bushatliu), Ismail Qemal Vlora, Vasiliqia, Omer Pasha Vrioni etj.²⁷⁹ Këtë tematikë të re e hasim mbizotëruese në poemën epike *Këthimi*.²⁸⁰ Në këtë poemë poeti këndon për luftën e përfunduar me sunduesit osman, me fitoren dhe shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë dhe me rreziqet e reja nga invazioni sllav, luftën për Shkodrën etj. Është interesant se epika e Skiroit ka afërsi me epikën e Fishtës, përveç në tematikën dhe në personazhet letrare, të cilët edhe Skiroi edhe Fishta i marrin nga koha e tyre dhe nga e kaluara historike, por edhe në vetë shprehësinë gjuhësore të ngjashme me këngën popullore:

Kërset pushka në Shën Gjin
 edhe kodrashit për qark
 çohet tymi ndë të kalthër
 e te gufat te katre anët;
 gjëmon era pa të ndalur
 e përpiqen brimë t' larta

279 Zef Skiroi, *Vepra 2, Te dheu i huaj*, botim i v. 1940, Faik Konica, Prishtinë, 2001.

280 Poema është e papërfunduar, me disa fletë të humbura, është shkruar në vitet 1916-1917, përmendet për herë të parë nga Gaetano Petrota më 1927, por është botuar për herë të parë në vitin 1965, nën përkujdesjen e Xhuzepe Skiro-Klesit. Shih te shënimet hyrëse në: Zef Skiroi, *Vepra 3*, Faik Konica, 2001, fq. 11-15.

mal më mal. (...)
 (...) Ah të qëndroni
 burra t'fortë, te shpit e bardha
 mos ju paft i biri i shkinës
 i pashpyrti që te gjaku
 gjen ushqim! (...) ²⁸¹

Ndërsa lirikat e tij patriotike dallojnë nga të gjithë poetët e tjerë arbëreshë në temat që trajtojnë: ato shtjellojnë tema të ditës nga lufta e shqiptarëve për komb të lirë, si thirrjet e poetit për shqiptarët e Moresë që të mos greqizohen, poezi për Marko Boçarin, elegji për vrasjen e Papa Kristo Negovanit, vajtim për Kapidan Lleshin nga Dera e Gjon Markut, poezi për Plakun e Math të Shqypëris etj.²⁸² Te Skiroi një pjesë e madhe e veprës së tij rri shumë më afër me lirikën patriotike të Naim-it, të Pashko Vasës, të Gjergj Fishtës sesa me poezinë e De Radës, të Gavrill Darës së Ri etj. Aty mund të gjesh edhe vargje krejt propaganduese, të ngjashme me shumë syresh të poetëve minorë romantikë, të botuara nëpër shtypin e kohës:

O Mirditasit e mi,
 Përse rrini ndër të zi?
 Ngrëhij gjith, o trimëri,
 Bëni Turqish maqili.
 E ti tundu o Toskëri,
 Mos mëno ti Labëri,
 Bëni gjak; Liri, liri!
 Rroftë e lira Shqipëri!

281 Zef Skiroi, Vepra 3, Këthimi, XXXIX, vargjet 1-17, Faik Konica, Prishtinë, 2001, fq. 158.

282 Zef Skiroi, Vepra 4, XI. Lirika të shpërndara, Faik Konica, Prishtinë, 2001.

Mula Zeka i pari dolli

E gjithë trimavet i foli.²⁸³

Edhe Fishta i absorbon në veprën e tij temat e mëdha të romanizimit shqiptar, por jo të gjitha. Fishta trajton temën e mirënjohur të gjuhës shqipe (poezia *Gjuha Shype*), temën e atdheut (poezitë: *Shqypnija*, *Shqypnis*, *Atdheut*, *Shqypnija e lirë*, *Hymni i Flamurit Kombtar* etj.), temën e mërgimit nga atdheu (poezia *I dbuemi*), temën e luftërave shqiptare kundër sundimit osman dhe kundër pushtuesëve sllavë (epi *Lahuta e Malcis*, poezitë *Surgite, mortui!*, *Ni gjamë desprimit*), temën e arsimimit të shqiptarëve (tekstet dramatiko-edukative: *Shqiptari i gjytetnuem* dhe *Shqiptarja e qytetnueme*), temën e luftës për atdhe (teksti dramatik *Juda Makabe*) etj.

Ka shumë pak motive dhe struktura tekstore të Fishtës që mund të krahasohen, për nga ngjashmëria, me ato të romantikëve. Një krahasim i tillë mund të bëhet midis Kangës IX, *Lidhja e Prizrendit* dhe këngës së parë të *Istori e Skënderbeut*, përkatësisht motivit të kundërshtimit të Mar Lulës te e para dhe motivit të kundërshtimit të Kamanit te e dyta. Ja tekstet poetike me këtë motiv te dy këngët e përmendura:

Në këto dy motive poetike të dy poetëve të mëdhenj është i ngjashëm prosedeu krijues:

në të dy tekstet, së pari, flet Prijësi (Mbreti i vjetër te Animi dhe Abdul Frasheri te Fishta) dhe që të dy rrëfejnë një rrethanë jo shumë të favorshme për popullin shqiptar dhe nxisin ndryshimin e asaj rrethane;

në të dy rastet ngrihet njëri prej trimave, më i njohuri dhe më i respektuari (Kamani te Animi e Mar Lula te Fishta) dhe mbajnë nga një ligjëratë;

283 Zef Skiroi, *Vepra 4*, XI. Lirika të shpërndara, fq. 296.

ligjërata e dy trimave është e ndërtuar si një mohim tekstor (te Animi Kamani „ngriti gishtin dhe tha: „Kurrë!/Kurrë s’trëmbet Shqipëria“, ndërsa te Fishta Mar Lula „I a pret fjalën n’ log t’ kuvendit:/Se ti, pasha at Sh’ Marrabe!/Sa per t’ dalun zot un vendit,/Me m’ qortue nevojë nuk ke.”;

pavarësisht nga struktura formale, në të dy rastet ligjërata nga aspekti përmbajtësor është pohim, pajtim dhe nxitje e mëtejme e qëndrimeve që kanë thënë Prijësit;

në të dy rastet ligjërata përfundon me thirrje pohuese për luftën e shqiptarëve për liri.

Në trajtimin e temave të njëjta Fishta nuk dallon, në idenë poetike, nga romantikët e tjerë. Ai i këndon Shqipërisë me të njëjtin himnizim e dashuri, sikurse Naimi, i këndon gjuhës shqipe, me të njëjtin zjarr dhe me të njëjtin qëllim, sikurse Naimi, po ashtu sikurse Naimi ka shkruar tekste letrare-arsimore. Edhe me *Lahutën e Malcis* është e njëjta gjë: qëllimi i epit është krijimi i Shqipërisë së pavarur dhe i kombit të lirë shqiptar, që është ideal i përgjithshëm i të gjithë romantikëve shqiptarë. Në trajtimin e këtyre temave e motiveve Fishta dallon nga romantikët në prozedun krijues, edhe pse ka shembuj të ngjashmërive edhe në këtë segment, si atë që sollëm më lart dhe në shprehësinë e fjalës, por jo në idetë poetike të këtyre temave.

II.2. Dallimet e Fishtës nga romantikët

Në fushën e marrëdhënieve tematike të Fishtës me romantikët shqiptarë deri tash pamë ngjashmëritë, po më shumë mund të flasim për dallimet. Në veprën e Fishtës ka një gamë më të gjerë temash e motivesh se sa te cili do romantik. Prandaj ne mund të flasim për temat

e motivet e Fishtës që mungojnë te romantikët, po edhe për temat e motivet romantike që mungojnë te Fishta.

Prej temave e motiveve të mëdha romantike që mungojnë te Fishta dy janë më kryesoret: mungesa e temës së dashurisë dhe mungesa e motiveve të natyrës.

Mungesa e temës së dashurisë. Te romantikët shqiptarë dashuria ka qenë njëra prej dy kryetemave letrare. Poetët romantikë i kanë kënduar dashurisë si kuptim i përgjithshëm, po fuqimisht i kanë kënduar edhe dashurisë për femrën. Dashuria ndaj femrës është temë shumë e njohur në letërsinë popullore, prej nga e ka marrë edhe De Rada, poeti që i pari e futi temën e dashurisë në letërsinë e shkruar shqipe. De Rada e trajtoi këtë temë në të gjitha veprat e tij, duke e ngritur në nivelin e kryetemës, e cila bashkë me temën e Skënderbeut bëjnë kryboshtin e letërsisë deradiane. Tema e dashurisë e trajtuar nga De Rada ishte në gjedhen e letërsisë popullore: ishte një dashuri tokësore, dashuri ndaj femrës tokësore, dashuri ndaj bukurisë së saj fizike e shpirtërore:

Një hare më rodhi kurmit,
si hareja kur te shtrati,
mbrëmanet, vajza e ngrohtë
ndien për të parëzën
sisët që m'i fryhen.²⁸⁴

Naim Frashëri ka shkruar për bukurinë e femrës një prej krijimeve të tij më të bukura, poemën *Bukurija*. Studiuesi Sabri Hamiti e quan këtë poemë „poezia më e fuqishme e Naim Frashërit“.²⁸⁵ Hamiti vëren

284 Jeronim De Rada, Vepra 3, Këngët e Milosaos, Kënga I, vargjet 31-35, përgatitur dhe përshtatur në gjuhën e sotme nga Dhimitër S. Shuteriqi, Rilindja, Prishtinë, 1988.

285 Sabri Hamiti, Studime letrare, fq. 149.

më tej se poezinë kritika letrare e ka interpretuar në dy mënyra: si hyjnore përgjithësuese apo si jetësore, për të përfunduar se poezia është ndërtuar ndërmjet kësaj dysie.²⁸⁶ Sido që të jetë, dashuri si koncept filozofik, dashuri platonike apo dashuri jetësore e reale ndaj femrës, në poemën *Bukurija* Animi i këndon më fuqishëm se çdo poet tjetër i romantizmit dashurisë ndaj femrës dhe kjo poezi edhe sot mbetet një prej poezive antologjike shqiptare për dashurinë ndaj femrës.

Pavarësisht nga trajtimi kaq i fuqishëm dhe kaq thelbësor i temës së dashurisë ndaj femrës në poezinë romantike, në veprën e Fishtës mungon kjo temë. Kjo mungesë është e theksueshme kur të kihet parasysh fakti se me *Lahutën e Malcis* Fishta kishte trajtuar botën dhe shpirtin shqiptar të Malësisë në fundshekullin XIX dhe në fillimshkullin XX. Nëse vepra e Fishtës është një sintezë e letërsisë shqipe, asaj gojore dhe asaj të shkruar²⁸⁷, atëherë në këtë sintezë ndihet fuqishëm mungesa e temës dhe motiveve të dashurisë, në veçanti dashurisë ndaj femrës, e cila është fuqimisht prezente në tërë traditën letrare popullore dhe në gjithë traditën romantike.

Poezia e Fishtës *Nji lule vjeshtet*, një prej lirikave më të mira të Fishtës, në mos më e mira²⁸⁸, ka ngjallur disa reagime dhe interpretime të ndryshme, nisur nga pyetja se a është kjo poezi një lirikë mendimtare për jetën e kalueshme dhe vdekjen e përhershme, apo është një poezi dashurie për një person të dashur e të vdekur para kohe, apo është një poezi personale e Fishtës dhe ka të bëjë me një person konkret, një

286 Sabri Hamiti, Studime letrare, fq. 153.

287 Bajram Kosumi, *Lirika e Fishtës*, fq. 177.

288 Sabri Hamiti, Studime letrare, fq. 234, thotë se kjo poezi është "lirika më e fuqishme personale, madje poezia më e mirë lirike e tij..." (e Fishtës, plotësim imi, B. K.).

femër, të cilën Fishta e paskësh dashuruar dhe e cila ka vdekur para kohe. Kjo pyetja e fundit e ka shtyrë studiuesin Aurel Plasari të shkruajë një ese të gjatë me titullin pretencioz *Fishta i dashuruari* (1996), në të cilin përfundon se *Nji lule vjeshet* është lirikë personale dhe ka të bëjë me nja femër konkrete, mund të jetë e quajtur Diellë, e dashuruar prej Fishtës²⁸⁹ etj. Me këtë fakt të presupozuar Fishta do të merrej për poet që ka shkruar një prej poezive më të mira në letërsinë shqipe me temën e dashurisë ndaj femrës. Pavarësisht nga kjo aventurë e Plasarit, eseu i të cilit mbetet në nivelin e një interpretimi të lirë e të shkujdesshëm, në veprën e Fishtës rëndon mungesa e temës erotike, temë kjo e trajtuar mbushullueshëm në letërsinë popullore shqiptare dhe prej poetëve romantikë shqiptarë.

Por, në pak poezi Fishta shtjellon temën e bukurisë së gruas. Kjo i mjafton Mark Ndojës për të thënë gojën plot:

“Ky ideal (ideali i dashurisë për gruan, plotësim imi, B. K.) te poezia e Fishtës asht realizue; dhe asht realizue pa pasë farë nevoje Fishta për një Beatrice, o për një Laurë, së cilës me i kushtue tingëllime, ballada e kangëz. Ai asht realizue tue iu referue idesë bukuri...”²⁹⁰

Është një fenomen interesant te Fishta, i vërejtur edhe në studimin tim për lirikën e tij fetare, se në përshkrimin e figurës së Shën Mërisë Fishta largohet nga tradita biblike sepse:

“e përshkruan Shën Mërinë me fjalë sensuale dhe në aspekte sensuale. Në përshkrimin e saj krijohet imazhi i bukurisë para imazhit të

289 Aurel Plasari, *Fishta i dashuruari*, botim i autorit, 1996.

290 Mark Ndoja, *Kritika klasike dhe leksione greko romake*, Arbëria, Tiranë, 2003, fq. 21.

shenjtëreshës, krijohet imazhi i gruas së bukur para imazhit të nënës së djalit-zot.²⁹¹

2. Po thonë Anës e Joakimit

Se 'i hyll vajze u paska le,

Si ajo drita prej agimit,

Si ajo voesa e nadjes s're:

Syni i sajë një rreze di'llit,

Shtati i sajë gjeth drandofillit:

Nji Prandverë n'blerim të vet!

3. Kur po i qeshka syni e ftyra

Neper rreze te bindueshme,

Thue po u ndeka atë herë pasqyra,²⁹²

Edhe pse në këtë pjesë Fishta këndon për Shën Mërinë ferishte ai e bën përshkrimin e trupit të saj me krahasime që spikasin bukurinë trupore të femrës, të denja për trupin e një vashe tepër sensuale.

Më shumë se askund tjetër, në poemën dramatike *Jerina ase Mbretnesha e Lulevet* (1940), Fishta përshkruan bukurinë e femrës. Në tri vende të kësaj poeme përshkruhet bukuria e Jerinës, mbretëreshës së luleve, e cila është një vajzë shqiptare. Në njërin vend²⁹³ për bukurinë trupore të Jerinës flasin Zanat dhe Orët, ndërsa në dy vendet e tjera²⁹⁴ janë katër pjesë të cilat këndohen, sipas modelit të dramës antike, nga Vallja, e që paraqesin fjalët e popullit, mendimin e popullit. Tri prej këtyre janë rikëndime të këngëve popullore (nëse vargun e parë e mar-

291 Bajram Kosumi, *Lirika e Fishtës*, fq. 65; Shih edhe poezinë *Të xanunt e pafaj të së Lumes Virgjines Mri, te Atë Gjergj Fishta, Vallja e Parrizit, Kuvendi Françeskan, Gjakovë, 1995, fq. 13.*

292 *Atë Gjergj Fishta, Vallja e Parrizit (1995), fq. 16.*

293 *Gjergj Fishta, Dramatika / Jerina ase Mbretnesha e Luleve, Të kunoruemt, fq. 240-242.*

294 *Gjergj Fishta, Dramatika / Jerina ase Mbretnesha e Luleve, Të kunoruemt, fq. 247-252.*

rim për titull: Vallja I: *Sa e bukur na duel Mbretnesha*, Vallja II: *Shkapërceva dy tri male*, Vallja III: *Mori e mira nen kunorë*²⁹⁵). Edhe në këto vende kur flet për bukurinë e femrës Fishta i vë ato përshkrime në gojën e popullit. Bile edhe vetë struktura e valleve është identike me strukturën e këngëve popullore.

Në këto pjesë të tekstit poetik Fishta shtjellon temën e bukurisë. Në lirikën fetare figurat poetike me të cilat shpreh bukurinë janë eterike dhe të arealit të shenjtë, ndërsa në vallet te Jerina... janë thjesht popullore. Por, tema e bukurisë, sado e afërt, nuk është një me temën e dashurisë, në veçanti me dashurinë ndaj femrës.

Mungesa e natyrës dhe e peizazhit në veprën e Fishtës. Natyra në poezinë romantike është një prej elementeve themelore poetike. Kjo jo vetëm pse Animi ka shkruar njërin prej kryeveprave të letërsisë shqipe, *Bagëti e Bujqësija* (1886), pikërisht me temën e natyrës, atë të Shqipërisë, por edhe për faktin se te të gjithë poetët e romantizmit, sidomos te De Rada e te Animi, natyra, përshkrimi i natyrës, peizazhi, pjesëmarrja e natyrës në temat e motivet e letërsisë etj, është element themelor letrar. Naimi e ngrit në kult natyrën shqiptare, Malin e Tomorrit e ngrit në vendlindje të perëndive. De Rada e fillon *Këngët e Milosaos* me natyrën:

Bota kish ndërruar lisa,
Uji i ri në det
Kaltëronte nditn e re,²⁹⁶

295 Shih për këtë te nënkapitulli Vepra e Fishtës dhe lirika popullore (marrje) të kreut të katërt të këtij punimi.

296 Jeronim De Rada, *Këngët e Milosaos*, Argeta LMG, Tiranë, 2002, kënga I, vargjet 1-3.

Gavrill Dara i Riu, pas hyrjes thirrore në tri vargjet e para të poemës së tij *Kënga e sprasme e Balës* (1900), e që duhet të merren vetëm si invokacion poetik, teksti i vërtetë i poemës fillon prej vargut të katërt, me natyrën:

Ja mjegulla e errët
 Rrokulliset mal më mal.
 Diellit lindur nga mal i Gropës
 Tundet, qesh pyll i thellë
 Po si ti i bardhë; i kthjellët,
 Veli i qiellit shtrihet
 Me një rreth të pasosur
 Porsi ninëza jote e kaltër.²⁹⁷

Ky përshkrim i natyrës te Gavrill Dara i Riu vazhdon deri në vargun 18-të. Pothuajse çdo këngë e poemës së Darës fillon me një përshkrim natyre.

Në veprën e Fishtës natyra nuk e zë këtë vend, si në veprën e romantikëve tanë. “Fishtën nuk e interesojnë pamjet natyrore”, thotë prerazi Ernest Koliqi.²⁹⁸ Fishta ndërton heroin e vet, karakterin e tij dhe pastaj edhe veprimet e tij. Por atë nuk e intereson natyra përreth heroit, përveçse shkarazi: me një varg, si në Kangë IX, *Lidhja e Prizerendit*, ai jep vetëtimthi natyrën „Shkrepi dielli buzës s’Cukalit“, për të kaluar menjëherë te veprimet e heronjve të tij. Mbase një përjashtim të vogël bën Kanga III, *Preja*, në të cilën dhjetë vargjet e para ndërlidhin natyrën me fatin e individit:

Vall, kush din mue me m’kallxue,

297 Gavrill Dara i Riu, *Kënga e sprasme e Balës*, Argeta LMG, Tiranë, 2006. Pjesa e parë, I. Bala.

298 Ernest Koliqi, *Fishta interpret i shpirtit shqiptar*, fq. 36.

Pse kjo qyqja, zog i true,
 Si mos kurrë asht tue vajtue,
 N'at Vraninë, n'at t'zezë krahinë,
 5. M'breg t'Liqenit, n'at kodrinë?

A mos kjanë hallet e veta,
 Perse zi i shkon moti e jeta,
 Bir as bi pa rrit e shkreta?
 Qyqja vehten s'asht tue kja,
 10. Bir as bi pse e mjera s'ka;
 Por po kjanë ajo nji moter,
 Qi ka mbetë sod qyqe n'voter,
 Sod qi kputë i asht kulmi i shpis:
 Kjan qat motren e ati Avdis!²⁹⁹

Kjo hyrje në këngën e tretë, që është pyetje epike antitezë, e ndërtuar sipas një kënge epike sllave³⁰⁰, është rast i rrallë në veprën e Fishtës. Ernest Koliqi konstaton me të drejtë:

„Fishta, jo, nuk ven roe kurgja rreth e rrotull, pamjet e natyrës nuk i a tërheqin shikimin, mendja e tij nuk habitet mbas panoramit. Me dy

299 Gjergj Fishta, Lahuta e Malcis, Kangë III.

300 Kënga boshnjake Kladushanin Mujo i Kostresh Harambasha fillon me këto vargje:

Zakukala kukavica sinja
 u Kunari na visokoj grani,
 ona kuka kad joj vakta nema,
 usred zime, kad joj nije vr'jeme.

A to nije kukavica sinja
 veçe mati Bojiqiç Alije.
 Dovikuje Bojiqiça sina
 na mezaru, jer joj poginuo:
 „Jesu li ti shimshir-tahte teshke?

Shih te: Epska tradicija Boshnjaka, Udruženje “Bosna”, Frederksberg, Danska, 2000.

fjalë të thata mriz, lejthi na difton vendin e kalon pertej sepse ka teper ngut me na paraqit herojin e vet.³⁰¹

Shumë më tepër se për mungesën e temave e të motiveve të romantikëve në veprën e Fishtës mund të flasim për tema të reja në veprën e tij, të patrajuara më herët nga romantikët. Kjo, natyrisht, është pjesa më interesante e marrëdhënieve të Fishtës me romantikët në fushën e tematikës, sepse pikërisht këto tema të reja e dallojnë atë nga romantikët.

Tema e jetës së malësorit shqiptar. Në kryeveprën e tij *Lahuta e Malcis* Fishta trajtoi luftërat e shqiptarëve për pavarësi kombëtare dhe ruajtjen e territorit etnik shqiptar, në fundshekullin XIX dhe fillimshkullin XX. Kjo është tema bosht, rreth së cilës është ndërtuar tema e jetës së malësorit shqiptar të Veriut në këtë periudhë, ku janë përfshirë: jeta, fizikumi, familja, parimet morale e fetare, e kaluara e trashëguar në të cilën ai beson paluhatshëm, bindjet politike, karakteri dhe anë të ndryshme të këtij karakteri, ligjësia që vepron si një rregullator i jetës së tyre fizike e morale, e që është Kanuni i Lekë Dukagjinit etj. Fishta e portretizon malësorin shqiptar të kësaj periudhe më mirë e më fuqishëm se asnjë poet tjetër shqiptar. Portreti i tij, fizik dhe moral, është i përkryer. Fishta himnizon malësorin shqiptar: ai është fisnik si racë, si fizikum, si shpirt. Ai portretizoi fisnikun malësor, si: Ali Pashë Gucia (udhëheqës i Plavës e Gucisë), Mar Lula (bajraktar i Shkrelit), Çun Mula (bajraktar i Hotit), Marash Vata (bajraktar i Shkrelit), Llesh Gjoni i Gjomarkajve etj.; malësorin bari, po strateg në luftëra, si Marash Uci; malësorin gjeneral, strateg të luftës, si Oso Kuka, Ali Pashë Gucia,

301 Ernest Koliqi, *Fishta interpret i shpirtit shqiptar*, fq. 36.

Hodo Begu, Dedë Gjo Luli, Haxhi Zeka etj.; malësorin klerik, si Pater Gjoni; malësoren shqiptare, e denjë si nënë, si motër dhe si atdhetare, si motra e Oso Kukës, Tringa- motra e Curr Ulës; dhjetëra luftëtarë malësorë, si Rrustem Uka i Zhuk Kabashit, Zhuk Isufi, Man Sela, Nel Bishe, Rrahman Duli, Tahir Gjeli, Alush Smajli i Smajl Hasanit etj.; ri-portretizoi dhjetëra luftëtarë të epikës historike shqiptare, si Isuf Pula, Marka Kuli, Xhem Sadrija, Prelë Tuli etj.; më në fund Fishta futi në veprën e tij dhe portretizoi shumë Zana shqiptare, të cilat sipas besimit të vetë malësorëve, ishin një botë tjetër nga kjo e njeriut, por e lidhur ngushtë me njeriun. Duke i portretizuar këto personazhe, fizikumin dhe karakterin e tyre, parimet morale e shoqërore mbi të cilat qenëson- te jeta e tyre, Fishta ka portretizuar edhe bëmat e tyre, bëmat e fundit epike të një populli në Evropë. Fishta ka paraqitur jetën e malësorit shqiptar në tërësinë e tij, nga lindja deri në vdekje.

Një studim për Fishtën Ernest Koliqi e titullon *Fishta interpret i shpirtit shqiptar* (1941) dhe veprën e tij e shquan si përpjekjen më vigane që bëri shqiptari për t'ia zbuluar vetvetes botën e vet.³⁰²

Fishta zgjodhi malësin shqiptar për heroin e epitet të tij me një arsye të kristaltë: ai, malësi, kishte ruajtur më shumë se çdo farë tjetër e shqiptarit, racën e pastër ilire-shqiptare edhe gjatë pesë shekujve të sundimit osman dhe të procesit të përhershëm të ndërrimit të fesë së vjetër krishtere në fenë e sunduesit, myslimane. Këta malësorë, të cilët kishin qenë në një luftë të përhershme me sunduesin osman për pesë shekuj, nuk ishin përzierë me sunduesit, nuk e kishin përzierë gjakun me ta, edhe atëherë kur e kishin ndërruar fenë kishin vazhduar të jetonin tradicionalisht si malësorët. Këta malësorë, të cilët besonin në

302 Ernest Koliqi, *Fishta interpret i shpirtit shqiptar*, fq. 26.

mitin e t'Parëve, besonin në Zana, betoheshin në Diell e Hanë, nënshtroheshin padiskutueshëm ndaj rregullave të Kanunit të Lekë Dukagjinit (ligj i pashkruar i maleve), kishin trashëguar dhe ruajtur origjinalitetin shqiptar, përballë rrezikut të ngjizjes fetare, kulturore e gjenetike shqiptaro-turke, si pasojë e sundimit pesëshekullor; këta malësorë që kishin trashëguar edhe epikën e tyre heroike (*Eposi i Kreshnikëve*) dhe epikën historike, e mbushur përplot beteja e luftëra kundër sunduesit osman, kundër armiqve sllavë dhe për nder e besë, e për të cilat Fishta dyshonte (sikurse De Rada gati njëqind vjet më herët) mos ishin pjesë të një epi të vjetër shqiptar³⁰³; këta malësorë ishin prototipi më interesant për heroin e një epi kombëtar, ku tema kryesore do të ishte çlirimi i shqiptarëve nga sunduesi osman dhe ruajtja e tokave shqiptare nga pushtuesi i ri sllav. Fishta nuk do të kishte gjetur një tip më të përshtatshëm të shqiptarit për t'ia paraqitur botës shqiptare si dëshmi, si fakt dhe si vizion për botën shqiptare sesa tipin e malësorit. Përballë realitetit të dhimbshëm të evoluimeve fetare e kulturore të shqiptarëve gjatë pesë shekujve, Fishta po vinte një realitet tjetër, të panjohur deri atëherë, botën e malësorit shqiptar, i cili kishte ruajtur një pjesë shumë

303 Letër e Gjergj Fishtës për Norbert Joklin e vitit 1926, cituar sipas Dr. Petrit Kotorri, Dy letra të pabotuara të At Gjergj Fishtës për albanologun e shquar austriak, Norbert Jokli. Ja një pjesë e tekstit:

„Sikurë keni mujtë me pa „Hylli i Dritës“ vjetin 1924 ka botuar disa rapsodi të maleve tona. Disa nder to-b.f. „Martesa e Mujit“, „Martesa e Halilit“, „Gjergj Elez Alija“, „Muj e Behuri“-mbas mendimit tem, nen çdo pikpamje kan nji randsi të madhe fort e meritojnë me kenë studjue e kthellue sa ma mirë. (...) Në Malci të Madhe gjindet nji malcuer, i cili-posë sa tjerash-din 63 rapsodija mbi Mujon e Halilin, e thotë se të gjitha kanë nji lidhni ndermjet vedit. A mos gjindemi para cykilit rapsodijash mbetë prej ndonji poemit të madh të vjetër...”

Shih në revistën At Gjergj Fishta/Komb-Letërsi-Gjuhë, Universiteti i Shkodrës, 1997, fq. 155-156.

të madhe të trashëgimisë së vjetër ilire-shqiptare. Studiuesi më i njohur i kësaj teme Ernest Koliqi thotë:

“Mbas disa përpjekjeve letrare pa qellim të caktuem, si përkthime edhe shërbime odesh e melodramesh, të cilat për poetin përbajshin si një farë ushtrimi, Fishta gjet menjherë botën e vet poetike. Syni i tij i mprehët zbuloi jetën ma karakteristike shqiptare: jetën e Malsorvet. Ai vuni si shembull e model të shqiptarizmës Shqiptarin deri atëherë të panjoftun të malevet e të fushavet. Ai na paraqiti si objekt poezije Shqipnin e bukës së misrit, e cila nën një vobsi të përjashtme rrejti ndër shekuj visare virtytësh çuditnisht fisnike.”³⁰⁴

Pikërisht kjo temë e Fishtës, me motivet e heronjtë e saj, e pritur mirë në kohën e shkrimit dhe të publikimit të saj, do të ngjallë reagime e kundërshtime, deri në mospranim të veprës së Fishtës nga kritika e historianët e letërsisë shqipe pas Luftës së Dytë Botërore. Vepra e tij do të quhet „antipopullore, pikërisht sepse ishte në kundërshtim me aspiratat themelore të masave, në kundërshtimin me demokratizmin e tyre.”³⁰⁵ Dr. Sefedin Fetiu mendon se edhe Migjeni, për të gjallë të Fishtës, kishte aluduar veprën e Fishtës me metaforën „sorrat e smue-me”.³⁰⁶ Esteti i njohur Alfred Uçi thotë:

„Me elementet etnografiko-mitologjike nga këta shkrimtarë (Fishta, Koliqi e të afërt me ta, sqarim imi, B.K.) bëhej një lojë e hollë falsifikuese. Jeta e popullit ngushtohej prej tyre vetëm në disa zakone të vjetra, në paragjykimet prapanike arkaike, që e paraqisnin popullin punonjës të lidhur përjetësisht dhe instinktivisht pas këtyre zakone-

304 Ernest Koliqi, Fishta interpret i shpirtit shqiptar, fq. 21.

305 Historia e letërsisë shqiptare (1989), fq. 116.

306 Dr. Sadri Fetiu, Vepra e Migjenit dhe kritika e saj, IA, Prishtinë, 1984, fq. 70-71 dhe 76-77.

ve, të paaftë për të hyrë në rrugën e përparimit dhe të qytetërimit. Në emër, gjoja, të hulumtimit të veçanësive „etnike“, shkrimtarët reacionarë absolutizonin zakonet patriarkale, i paraqitnin si cilësi të përjetshme dhe të pandryshueshme të „racës shqiptare“, që përcilleshin në gjak nëpër shekuj dhe që nuk mund të mënjanoheshin. (...) Duke idealizuar dhe poetizuar zakonet dhe jetën patriarkale, ata ngriheshin kundër alternativës revolucionare. Ata thërrisnin në ndihmë gjith arsenalin e mitologjisë popullore, mitet dhe legjendat, nimfat dhe zanat, duke krijuar një tablo të rreme që fshihte kontradiktat themelore të shoqërisë shqiptare dhe errësonte rugëdaljen nga gjendja e mjeruar që sundonte në Shqipëri.”³⁰⁷

Ky gjykim i Alfred Uçit paraqet në mënyrë të përmbledhur qëndrimin e kritikës zyrtare shqiptare për veprën e Fishtës dhe dy akuzat kryesore që shtjellohen në citatin e mësipërm. Por, duhet veçuar faktin se përkundër akuzave të tilla ndaj temës së botës së malësorit shqiptar që e kishte futë në letërsi Fishta, kjo temë ndikoi letërsinë e mëvonshme dhe shkrimtarë të tjerë, piktorë etj., duke trajtuar këtë temë, natyrisht në rrethana të tjera.

Tema e konfliktit shqiptaro-sllav. *Eposi i Kreshnikëve* është ndër-tuar mbi një temë të gjerë: konflikti shqiptaro-sllav³⁰⁸, i cili në forma e në intensitet të ndryshëm ka zgjatur me shekuj. Në njërën anë janë

307 Alfred Uçi, *Mitologjia, folklori, letërsia*, Naim Frashëri, Tiranë, 1982, fq. 322-333.

308 Ky është përfundim i pranuar nga shkenca shqiptare. Maksimilian Lambertz në veprën e tij të njohur *Epika popullore shqiptare* thotë se këto këngë lëndën e kanë marrë nga luftërat sllavo-turke nga koha turke e parë. Ai shton se “ka ndërkaq shumë gjurmë në këto epe të shkurtëra, të cilat na dëshmojnë që këto këngë kanë lindur më përpara, që rrjedhin nga koha e dyndjes së sllavëve nëpër Danubin e poshtëm për në Ballkan, dhe e ruajnë ende kujtimin e luftërave të vjetra të ilirëve ose shqiptarëve kundër sllavëve, që u dyndën në kohën rreth vjetëve 700 gjer 800”.

heronjtë shqiptarë si Muji, Halili dhe shokët e tyre, kalorës e aventurierë, ndërsa në anën tjetër janë kapedanët, kralët, harambashët, banët e shokët e tyre, po ashtu kalorës e aventurierë. Të dytët sulmojnë tokat e të parëve, rrëmbejnë kullosat e bagëtinë, rrëmbejnë nganjëherë edhe vashat, ua djegin kullat, ndërsa të parët mbrojnë tokat e tyre dhe pasuritë e tyre, u hyjnë të dytëve nëpër qytete dhe u shkaktojnë dëme e u rrëmbejnë vashat e bukura e pasuritë e tyre. Në epikën historike tema e konfliktit shqiptaro-sllav trajtohet shumë më pak, kryesisht në këngët historike të shekullit XIX, në lidhje me Lidhjen e Prizrenit dhe në filimshekullin XX në lidhje me Kosovën. Edhe në letërsinë e shkruar deri në fillim të shekullit XX kjo temë nuk është trajtuar.

Fishta e merr këtë temë pikërisht prej epikës historike të fundshekullit XIX, nga cikli i këngëve për ruajtjen e territorit shqiptar. *Lahuta e Malcis* fillon me ciklin e këngëve të lidhura për bëmat e Oso Kukës, motiv i marrë nga epika historike e gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe përfundon, nëse lihen anash dy këngët e fundit: *Lufta e Ballkanit* dhe *Konferenca e Londonit*, të cilat janë një lloj epilogu i epit, me bëmat e Dedë Gjo' Lulit që luftoi trimërisht kundër sunduesve turq dhe armiqve sllavë. Në këtë mënyrë, janë dy tema që mbizotërojnë *Lahutën e Malcis*: lufta kundër sunduesve osmanë, e trajtuar fuqimisht në tërë letërsinë e romantizmit dhe më përpara, te rilindësit e parë, madje në shkrimet e diskursit akademik edhe nga autorët e vjetër të Veriut dhe tema e luftërave shekullore shqiptaro-sllave, e pa trajtuar më parë në letërsinë e shkruar dhe e sjellë në letërsinë e shkruar nga vetë Fishta. Gjithsesi

Cituar nga botimi në Çështje të folklorit shqiptar, ASH e RSH, Instituti i Kulturës Popullore, nr. 6, 1998, fq. 5.

Fishta këtu ka qenë origjinal, në marrëdhënie me traditën e shkruar letrare.

Edhe në lirikën patriotike shfaqet kjo temë e preferuar e Fishtës. Poezitë atdhetare *Nji gjamë desprimit!..., Surgite, mortui!* dhe *Mbi vorr t' A. Alois Paliq* janë të krijuara mbi temën e konfliktit shqiptaro-sllav. Poema dramatike *Jerina ase Mbretnesha e lulevet*, ani pse trajton një temë krejt lirike, është alegori për ngjarjet politike mbi bazën e konfliktit shqiptaro-sllav. Vetë poeti e thotë në parathënie të poemës dramatike se po e shkruante këtë poemë si përgjigje ndaj ish kryeministrit të Serbisë Vlladan Gjorgjeviq, i cili në një libër të tij diskreditonte shqiptarët si gjoja popull i paqytetëruar.³⁰⁹

Trajtimi kaq i gjerë i kësaj teme të madhe të historisë shqiptare, në shumë vepra e në shumë gjini letrare, është një dëshmi e fortë se hyrja e kësaj teme në *Lahutën e Malcis* nuk qe rastësi: krahas temës së luftës kundër sundimit osman, i cili kishte tronditur rëndë identitetin shqiptar, Fishta kishte zgjedhur temën e vjetër të luftërave shqiptaro-sllave, konflikt i cili kishte shpërfytyruar identitetin gjeografik të shqiptarëve, duke e rrudhur gjeografinë shqiptare nga të gjitha anët shekull pas shekulli.

Në veprën e Fishtës konflikti shqiptaro-sllav është i lidhur me luftërat për zotërim tokash dhe për dallimet e qytetërimit. Është meritë e Fishtës që e futi këtë temë hapur dhe pa dilema në letërsinë shqipe. Përshkrimi i luftërave shqiptaro-malazeze në *Lahutën e Malcis* tingëlton mjaft rrëqethës e trishtues dhe është prolog i shpërfytyrimit etnik, kulturor e gjeografik që do të bëjnë sllavët në tokat shqiptare të

309 Gjergj Fishta, *Dramatika / Jerina ase Mbretnesha e Luleve, Të kunoruemt, Parathanie*, fq. 197-198.

Toplicës që nga viti 1878 e deri te shpërfytyrimet në Kosovë në fillim dhe në fund të shekullit XX.

Motive të reja patriotike: motivi i dëshpërimit me atdheun dhe parodia, motivi i tradhtisë. Tema e atdheut është trajtuar gjerësisht te të gjithë poetët romantikë. Por, te të gjithë, me ndonjë përjashtim të vogël si te Pashko Vasa, ajo është trajtuar në diskursin himnizues, edhe si gjuhë dhe si ide. Himnizimi i atdheut, kjo ka qenë korniza për temën e atdheut në periudhën e Rilindjes Kombëtare, ku hyjnë edhe romantikët. Fishta është i pari poet shqiptar që sjell motive të tjera patriotike dhe diskurs tjetër gjuhësor, ideor e letrar, në trajtimin e këtyre motiveve patriotike. Me poezitë *Ditën e të shuemvet* dhe me poezinë 28 *Nanduer 1913* ai sjell zhgënjimin e njohur të heronjve me kryeveprat e bëra. Në të parën, *Ditën e të shuemvet*, poezia ndërtohet mbi dukjen e një varri të lënë e të harruar të një fatosi, i cili “Rrebtë tue luftue per Atme e per Liri/Shqypnis i u bane fli...”, në kundërshti me dukjen e një varri të zbukuruar e nën kujdesin e dikujt, në të cilin prehet një njeri i zakonshëm i cili „...Ky le mbi pupla/E rritë n’ar e n’mundash, mbas epshit lodhun“, për të përfunduar me betimin e poetit ndaj fatosave të atdheut se:

Oh po! se para zbardhet penda e korbit

E e bardha rreze dahet, po, prej diellit,

Se ju n’harresë u qet kjo Zana e eme.

Per ju do t’kndohet, po, m’Lahutë t’Malcis³¹⁰

Është rasti i parë, menjëherë mbas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, mbase ende pa u heshtur gëzimi e festa për pa-

310 Gjergj Fishta, *Lirika / Mrizi i Zanavet*, fq. 76.

varësinë, kur poeti krijon motivin e dëshpërimit për kujdesin e atdheut ndaj atyre që dhanë jetën për ta krijuar atë.³¹¹

Poezinë *Ditën e të shuemvet* poeti e shkroi më 2 nëntor 1913. Vetëm disa ditë më vonë, më 28 nëntor 1913 Fishta ka shkruar poezinë tjetër me të njëjtin diskurs poetik *28 Nanduer 1913*, në të cilën motivi i dëshpërimit ndaj atdheut të pakujdesshëm shndërrohet në parodi kulmore ndaj atyre shqiptarëve të cilët le që nuk kanë vizion për të ardhmen e shtetit të ri e të kombit, por edhe e nënçmojnë atë e luftën titanike të bërë për themelet e tij. Në këtë poezi Fishta ka shkruar disa prej vargjeve më të goditura e më sarkastike:

Oj Zanë, t'këndojm...t'vajtojm, deshta me thanun;

E sod, me 'i pecë t'kuqe

E me 'i orrl duem qi Shqyptarija e mjera

T'dalë vedit ndritë...³¹²

Nuk mund të merret me mend një sarkazëm i tillë në penën e Naim-it e të De Radës. I takon Fishtës merita e sjelljes në letërsinë shqipe të këtyre motiveve të reja patriotike dhe të këtij diskursi poetik.

Në fushën e tematikës shqiptare Fishta ka meritën edhe për sjelljen në letërsinë shqipe të temave të letërsisë antike helene. Para tij De Rada kishte shkruar një poemë me titullin *Odiseu* (1832, 1847)³¹³, mirëpo përmbajtja e saj nuk ka të bëjë me syzheun antik të Odisesë, me odisenë arbëresh, të mërguar e që pret të kthehet në atdheun e tij. Tematika është odiseane, por motivet dhe syzheu janë të tjera. Naim

311 Shih më gjerësisht te Bajram Kosumi, *Lirika e Fishtës*, fq. 46-50.

312 Gjergj Fishta, *Lirika / Mrizi i Zanavet*, fq. 78-79.

313 Jup Kastrati, *Studime për De Radën*, fq. 227.

Frashëri e njih shumë mirë letërsinë e vjetër helene dhe romake, në shkrimet e tij letrare e shkollore përmend shumë emra të letrarëve e të historianëve antikë, përmend shumë personazhe të letërsisë antike, disa madje duke i shqipëruar³¹⁴, përkthen këngën e parë të *Iliadës*, po Animi nuk ka shkruar letërsi me temë nga letërsia antike helene a romake. Ndërsa Fishta ka shkruar tragjedinë *Ifgenija n'Aulli* (1931) dhe tekstin e shkurtër dramatik *Odiseja* (1931), që të dyja me temë nga letërsia antike greke.

Fishta ka realizuar edhe një motiv tjetër të ri, në lidhje me atdheun: motivin e tradhtisë kombëtare. Në dramën *Juda Makabe* (1920), të ndërtuar mbi temën biblike të kryengritjes dhe luftës së paepur të Juda Makabeut për atdheun e tij, Fishta ka shtjelluar dy tema kryesore: luftën për atdhe dhe tradhtinë ndaj atdheut, të personifikuar me dy protagonistët e dramës, Juda Makabe dhe Alkimi. Për ndërtimin e figurës së tradhtarit, Sabri Hamiti thotë:

„...personazhi i tradhtarit Alkimi, i cili e shet kryengritjen për pushtet nën të huajin, është ndërtuar me kaq mjeshtëri sa ia tejkalon krijimit të heroit Makabe“.³¹⁵

Temën e tradhtisë, si akt individual apo kombëtar, e kanë trajtuar në veprat e tyre edhe romantikët, De Rada, Animi etj., por e kanë trajtuar anësisht, si shfaqje anësore, përmes një personazhi apo një episodi letrar, ndërsa Fishta ka shkruar një dramë ku njëra prej dy temave kryesore është pikërisht tema e tradhtisë ndaj atdheut.

314 Rexhep Qosja, Porosia e madhe, Botimet Toena, Tiranë, 2000, fq. 42.

315 Sabri Hamiti, Studime letrare, 242.

Tema e qytetarisë. Nëse lëmë anash temën e qytetarisë në qytet-et-kështjella të Mesjetës shqiptare të shtjelluara në veprat e De Radës, e të cilat si shtjellim mbesin gjithmonë si një vegim deradian, Fishta është i pari poet shqiptar që futi në letërsinë e shkruar temën e qytetarisë, pra jetën e shqiptarit në qytete. Ashtu siç kishte bërë me temën e malësorit dhe jetës së tij në *Lahutën e Malcis*, në epin komik *Palokë Cuca* (1922) Fishta ka shtjelluar gjerësisht dhe thellësisht jetën, idealët, vështirësitë, mendësinë, karakteret dhe marrëdhëniet shoqërore të qytetarit në Shqipërinë e dekadës së parë pas pavarësisë. Në të vërtetë epi zë një kohë më të gjerë, se ai fillon me gjyshin e Palokës, vazhdon me të atin dhe përfundon me fëmijërinë e vetë Palokës, por epi nuk është i përfunduar. Poeti ironizon e parodizon shfaqjet negative të shoqërisë qytetare, në mëngjesin e parë të lirisë, të atdheut e të kombit, të individëve e të grupeve të ndryshme shoqërore, të cilët të shkëputur nga e kaluara (jo krejt të ndarë), të pa rehatuar në të tashmen (po të përshtatur në përfitime) dhe pa vizion për të ardhmen (në vend të vizionit ata improvizojnë gjëra historike) humbin dhe zhvlerësojnë çdo kod e çdo parim të një shoqërie stabile dhe të një individi kreativ. Kështu, Fishta parodizon letërsinë shqipe e kritikën letrare, Komisinë Letrare në Tiranë, gjuhën letrare „mushkë“³¹⁶ të kësaj Komisie, politikën kulturore të qeverisë, politikanët, deputetët, ministrat, përfituesit financiarë në kurriz të luftërave në atdhe, mendësinë e koprracëve, martesat me miras, të cilat krijojnë drama familjare e urrejtje brenda familjare; institucionet e drejtësisë, të cilat ekzistojnë vetëm për të rrjepur qytetarin kur është në zgrip; pseudo intelektualët, ndikimet e shkollave të huaja, ndikimet e parave të huaja, emancipimin e shpifur

316 At Gjergj Fishta, *Anzat e Parnasit*, ASHAK, Prishtinë, 1990, fq. 138.

të gruas, qytetërimin e gruas të sapaordhur nga provinca, jetën e kotë të familjes qytetare, që jeton në kurriz të të parit të shtëpisë i cili punon dhe fiton, e si pasojë të gjithë të tjerët mund t'i trajtojë si robër, shterpësinë morale, karakterin e plogësht e të molepsur të individit etj.

Temën e qytetarisë, me diskursin satirik letrar, Fishta e prek edhe në vepra të tjera, si *Jaho Begu e Palokë Cuca* (1905), sidomos te *Gomari i Babatasit* (1923), po askund në tërësinë dhe në shkëlqimin e vet si në epin e vogël *Palokë Cuca*.

Temën e jetës qytetare do ta trajtojë, me diskursin satirik, edhe Kristo Floqi (1876-1949) në gjashtëmbëdhjetë komeditë e tij, të shkruara rreth viteve njëzet të shekullit XX.³¹⁷

Tema të moskuptimeve fetare brendashqiptare. Asnjë poet romantik nuk shtjellon tema të konflikteve fetare brendashqiptare. Në epikën popullore ka disa raste të konflikteve të izoluara të individëve apo të grupeve të komuniteteve fetare. Mirëpo, edhe në këto raste, thelbi i konfliktit nuk është vetë feja apo mos toleranca fetare, por motive të ndryshme politike, sociale, individuale etj. Në realitet, në historinë e re shqiptare ka pasur raste të konflikteve e të dhunës për motive fetare. Mjafton të përmendim dhunën poshtëruese dhe tragjike të udhëheqjes myslimane të Gjilanit (shqiptare dhe turke) nën prirjen e kajmekamit Maliq Bej Gjinollit dhe kadiut Tahir Efendiu dhe me ndihmën e Jashar Pashës të Prishtinës, ndaj familjeve katolike të Karadakut (katundet Stubëll, Binçë, Terziaj dhe Vërnakollë), të njohur më vonë nga historia

317 Jakup Mato, Rreth komedive të Kristo Floqit, në Letërsia si e tillë, Toena, 1996, fq. 373-377.

si „Martirët e Karadakut“, në vitin 1843-44.³¹⁸ Këngëtarët popullor si duket iu kanë shmangur këtyre temave e po kështu kanë bërë edhe romantikët. Romantikët kanë bërë thirrjet e njohura për unitet fetar, si njëri prej parakushteve edhe për unitet kombëtar, por asnjëri prej tyre nuk ka shtjelluar një konflikt fetar, si ka bërë, ta zëmë, Naim Frashëri me epin *Qerbelaja*, në të cilin trajton konfliktin midis shiitëve dhe sunitëve në luftën e Qerbelasë.

Në veprën e tij *Fishta* u bën jehonë thirrjeve të romantikëve për unitet fetar, por në dy raste, në të parin esencialisht e në të dytin vetëm skajshëm, trajton tema të konflikteve fetare. Rasti i dytë është dedikimi në poemën satirike *Nikolejda*, të cilën *Fishta* e ka shkruar më 1901, ndërsa dedikimin e përmendur e ka shkruar më 1926. Në këtë dedikim, duke folur me urrejtje për invazionin e Ahmet Zogut në atdheun e vet, i përkrahur nga Serbia, e me qëllim të rrëzimit të qeverisë demokratike të Nolit, *Fishta* e akuzon Zogun se:

“Xueren katolikët prej Asambleje e Qeverie
kombetare

318 Gaspër Gjini, *Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj*, Drita, Ferizaj, 1992, fq. 189-193. “Të gjithë të burgosurit i futën në pranga të rënda në duar dhe këmbë me një zinxhir të rëndë për mjedisi dhe të lidhur për një këmbë. Kjo ishte një peshë prej 40 okësh turke, afër 50 kilogramë. Me këtë peshë u nisën kah vendi i caktuar. Jashar pasha i Prishtinës, përndryshe farefis i Maliq Beut, i mbylli në një burg edhe më të rëndë. Përveç kësaj urdhëroi që në lokalet e burgut të lëshohet uji... Nga Prishtina të burgosurit i hodhën në Shkup, vazhdimisht të lidhur me pranga të rënda. Atje i vendosën në burgun zëkeq të Azmi Pashës. (...) Në ndërkohë arriti edhe Tatarit (korrier) nga Stambolli, i cili e solli përgjigjen e sulltanit. Mjerisht ajo ishte negative për laramanët dhe atë Antonin: ata të gjithë, së bashku me anëtarët e familjeve të tyre duhej detyrueshëm të dërgoheshin në Azi të Vogël. (...) Të internuarit e mbetur gjallë u liruan më 22 qershor të vitit 1844. me insistimin e ambasadorit francez, Porta u pajtua t'i kthente në atdhe me shpenzimet e shtetit. Në vendlindje u kthyen 79 dëshmitarë, ndërsa 88-të tjerë duke i përfshirë këtu edhe 10 foshnjat, e dëshmuar me gjak besnikërinë e vet ndaj Krishtit.”

shkaktuen vrasjen e Luigj Gurakuqit
 dëbuen e burgosën
 ipeshkvij, priftën, fretën, parinë katolike
 e
 fikën Atdhenë.....”³¹⁹

Nga ky dedikim krijohet përshtypja se Zogu në invazionin e vet paska pasur për qëllim shkatërrimin e fretërve katolikë e jo rrëzimin e qeverisë demokratike të Nolit dhe, natyrisht, të gjithë përkrahësve të tij, pra edhe të fretërve françeskanë, të cilët nuk kishin mirëkuptim ndaj politikave të Zogut!

Derisa ky dedikim edhe nuk mund të merret si tekst letrar, rasti i parë është esencial. Në Kangë XXVIII, *Dedë Gjo’ Luli*, episodi në vargjet 180-285, është i vetmi që paraqet një betejë të përgjakshme midis shqiptarëve katolikë (Malcija) dhe atyre myslimanë (Shkodra), të parët të udhëhequr nga ideale për krijimin e Shqipërisë së pavarur, të dytët të nxitur nga Bedri Pasha i Shkodrës për të ruajtur sundimin osman në Shqipëri, pra për të ruajtur interesat e tyre të ngushta.

N’at mbasdite n’ ”iqindi”
 Thrret “tellalli” sa ka n’krye:
 Kush asht turk bashibuzukë,
 Me njeshë armët e n’luftë me dalë,
 215. Malcis hovin me i a ndalë;
 Perse *dini* a në rrezik,
 Ke s’po ka Shkodra “nizamë”
 Kshtu tellalli. Trup në kamë
 I a kan ba nja dy mij vetë,

319 Gjergj Fishta, Satirika / Nikolejda, fq. 427.

220. Muamedan, e pa marrë dielli,

Vrap: thue kambëve u kan vu fletë:

Per ball t'luftes janë nisur filli.³²⁰

Edhe pse baza e konfliktit edhe në këtë episod nuk është mostoleranca fetare, por miqësia apo armiqësia ndaj Perandorisë Osmane në Shqipëri, megjithatë është hera e parë jo vetëm në *Lahutën e Malcis*, po edhe në letërsinë e shkruar shqipe që muhamedanët dhe katolikët shqiptarë ndahen në dy taborre ndërluftuese.

Në përfundim të këtij kapitulli mund të rezymojmë:

Fishta shtjelloi në veprën e tij tema të njohura e me ndikim që nga periudha e Rilindjes Kombëtare, të trajtuara fuqishëm nga romantikët, si tema të lidhura me idealin nacional. Fishta asnjëherë nuk do të shkëputet nga trajtimi në letërsi i idealit nacional, por në këtë trajtim ai do të sjellë edhe tema e motive të reja, të cilat bartin ide poetike të reja, si tema e dëshpërimit në atdhe, tema të degradimit kombëtar, fetar, politik e kulturor të inteligjencies shqiptare dhe të klasës së lartë, tema të politikës etj. Por, veprën e Fishtës do ta përshkojnë më së fuqishmi tri tema: tema e botës së malësorit shqiptar të Veriut, tema e konfliktit shqiptaro-sllav dhe tema nga bota qytetare shqiptare. Derisa për temën e tretë Fishtës i takon merita që e ka hapur, se ajo ka vazhduar të trajtohet me sukses nga autorë të mëvonshëm, për dy temat e para mund të thuhet se Fishta i ka hapur dhe i ka përfunduar, duke i vulosur me epin *Lahuta e Malcis*.

320 Gjergj Fishta, *Lahuta e Malcis*, Kangë XXVIII.

III. FORMAT POETIKE, FIGURACIONI POETIK DHE MODELI I SHKRIMIT

III. 1. Format poetike

Mbas lulëzimit të letërsisë, në të gjitha format e saj poetike, në periudhën e romantizmit, në historinë e formave poetike shqipe mund të flasim për larmi të bollshme. Poetët më në zë romantikë përdorën forma të shumta poetike të marra nga tradita të ndryshme letrare, duke qenë se ata njihnin shumë mirë traditat letrare antike helene e romake, traditën klasiciste dhe atë bashkëkohore romantike, traditën e lindjes turke e persiane etj.³²¹ Shumë prej tyre u mbështetën burimisht në traditën e letërsisë popullore, si Jul Variboba, De Rada, Gavrill Dara i Riu, Filip Shiroka etj. Kjo mbështetje në traditën nacionale nuk e përjash-tonte edhe mbështetjen në tradita të tjera të huaja.

Format poetike të De Radës janë të afërta me ato të letërsisë popullore, përderisa ai vetë konsideronte se poezia e tij është ose vazhdim i rapsodive popullore ose bijë e tyre. Çabej e përkufizon në mënyrë përgjithësuese formën poetike të poezisë së De Radës:

“Poezitë e tij ngjajnë sikur të ishin një vazhdim i kësaj poezie popullore, një plotësim, një mbushje e plasave që ky epos (siç e besonte ai për këto këngë) paraqiste pas mendimit të tij. Po t’i krahasojmë të dy poezitë njëri me tjetrin, na bie në sy gjasia e tyre formale: në të dyja shohim të njëjtin ritëm, janë të njëjtat vargje tetë-, shtatë-, gjashtë- dhe pesërrokëshe, të dy poezitë i përshkon e njëjta frymë epike-lirike; në

321 Rexhep Qosja, Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi I, shih kapitullin IV, “Erudicioni letrar, filozofik dhe shkencor”, fq. 82-98.

të dyja kallëzimi epik kalon nganjëherë në dialog dramatik, një dukje kjo që është karakteristike për poezinë popullore shqiptare. Edhe figurat e krahasimet që përdorë poeti janë sajuar në frymë të poezisë popullore.”³²²

Fishta shkruan *Lahutën e Malcis* në kolonë, pa e ndarë në strofa, sipas modelit të epikës popullore, por nuk do të bëjë kështu me epin e vogël *Palokë Cuca*, me njëmbëdhjetërokëshin e tij të ndarë në strofa tetëshe (stanca). Po ashtu *Lahutën e Malcis* do ta ndajë në këngë, të cilat kanë një farë mëvetësie, secila ka një temë më vete, po ato lidhen ndërmjet tyre me idenë themelore poetike dhe me kryetemat që trajton epi. Kjo ndarje në këngë është sipas modelit të *Eposit të Kreshnikëve*, për të cilin Fishta supozonte se mund të jenë pjesë të mbetura e të shkapërderdhura të një ciklusi të vjetër shqiptar.

Kështu kishte bërë më herët edhe De Rada, duke i ndarë poemat e veta në këngë të cilat vuanin nga diskontinuiteti, këngë të shkruara në monokolonë. De Rada kishte shtuar edhe pjesët subjektive që i quante Valle, sipas gjedhes së dramës antike helene, në të cilat opinioni i qytetarëve shprehej përmes poetit në formë të Valles. Naim Frashëri, në dy epet e tij, kishte shkruar në monokolonë, por këngët janë më të lidhura ndërmjet veti, sepse Animi i përmbahet një parimi: parimit të kronologjisë kohore të ngjarjeve për të cilat këndon.

Në poezinë e tij Fishta përdorë lloje të ndryshme të strofave:

strofën katërshe (poezia *Shqypnija*, me rimën ABAB; poezia *Shqypnis*, me rimën ABBA);

strofën pesëshe (poezia *Të kryqëzuemit*, me rimën ABABC)

322 Eqrem Çabej, *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit*, Çabej MÇM, Tiranë, 2002, fq. 97.

strofën gjashtëshe (poezia *Nji gjamë desprimit!...*, me rimën ABAB-CC; poezia *Të lemt e Zojës*, me rimën ABABCD)

strofën shtatëshe (poezia *Shqypnija e lirë*, me rimën ABABCCD; poezia *Meshtari i Malcis*, me rimën ABBACDD),

strofën tetëshe (poezia *Gjuha Shqype*, me rimën ABABCDCD),

strofën dhjetëshe, e përbërë nga bashkimi i dy strofave pesëshe (poezia *Engllit rojës*, me rimën ABABCDEDEC)

strofën alkaike (sipas poetit antik Alkeu, poezia *A. Anton M. Zanonit S.J*)³²³,

strofën safike (sipas poetes antike Sapfo), është përdorë në poezitë *Gurravet të Jordanit*, *Ngadhunjja e Kryqit*, *Të xanunit e pafaj të së Lumes Virgjinës Mri*, *Emni i Zojës* etj.

stancën (strofa e *Palokë Cucës*, me rimën e zakonshme për stancën ABABABCC).

Në përputhje me këto forma poetike, sipas gjedhes popullore, është edhe tetërrokëshi i Fishtës, i cili është këmbë e krye popullor në *Lahutën e Malcis* dhe në shumë poezi të tij lirike, ndërsa më pak është i përdorur te poezia satirike. Një varg tjetër të cilin Fishta e përdorë për mrekulli është njëmbëdhjetërrokëshi, si në poezitë *Nji lule vjeshtet*, *Ditën e të shuemvet*, *Nji gjamë desprimit!...*, *28 Nanduer 1913*, *Surgite, mortui!* etj. Duhet të veçohet njëmbëdhjetërrokëshi i Fishtës në epin e vogël *Palokë Cuca*, ku ai shkëlqen në tërë madhështinë e gjuhës shqipe. Fishta përdor edhe pesërrokëshin, si në poezitë satirike *Metamorphosis*,

323 Në komentet e tij për lirikën e Fishtës Viktor Volaj thotë se kjo strofë është përdorë për herë të parë në letërsinë shqipe. Dorëshkrimi i poezisë ka datën 2 qershor 1908. Shih: Gjergj Fishta, *Lirika / Mrizi i Zanavet, Rilindja*, 1997, fq. 169.

Jus Gentium, disa vargje nga *Nakdomonicipedija* (pjesa e dytë) etj. Fishta përdorë edhe shtatërokëshin e nëntërokëshin, por shumë rrallë.³²⁴

Nga tipet e poezisë Fishta shkruan më së shumti himnin, oden, elegjinë dhe sonetin. Nga himnet më të realizuara janë *Gjuha Shqype*, *Shqypnija*, *Hymni i Flamurit Kombtar* etj. Nga elegjitë më të realizuara janë *Nji gjamë desprimi!...*, *Surgite, mortui*, *28 Nanduer 1913* etj. Fishta ka shkruar tri sonete me motive fetare, *Shkodra Zojës*, *Zoja Shkodrës*, *Në të paren meshë të njëj meshtari të ri* dhe një sonet interesant, *Lum i forti!*, i strukturuar si dialog midis tre personave. Por, suksesin më të madh Fishta e mbërrin me oden e tij. Tri lirikat më të fuqishme të tij, njëherazi ndër lirikat më të mira në letërsinë shqipe, janë odet *Nji lule vjeshtet*, *Ditën e të shuëmvet* dhe *Gurravet të Jordanit*.

Format poetike të Fishtës, qoftë vargu, qoftë strofa apo tipi i lirikës që ai kultivon, karakterizohen nga një fakt: këto forma poetike janë klasiciste. Rregullat e traditës klasiciste kanë vulosur tërësisht këto forma poetike. Përveç tetërokëshit sipas gjedhes popullore, asgjë tjetër në këto forma poetike nuk është jashtë rregullave të klasicizmit. Lirika e Fishtës e përfshirë në *Mrizin e Zanavet* dhe në *Vallja e Parrizit* dhe pjesa më e madhe e poezisë satirike e përfshirë te *Anzat e Parnasit* janë vepra të plota klasiciste, në format e tyre poetike. Aty nuk ka asnjë sprovë risimtare, asnjë eksperiment. Romantiku dhe posromantiku Fishtë aty drynohet në format poetike klasiciste.

Studiuesi i vargut të huaj në poezinë shqipe, Hysni Hoxha, e cilëson lart aftësinë e Fishtës në vargëzim:

“Mjeshtri më i mirë i vargënit shqip, Gjergj Fishta, më tepër i njohur me veprën e tij të përmendur Lahuta e Malc’is (1931), përdor

324 Shih Bajram Kosumi, *Lirika e Fishtës*, fq. 135-138.

në mënyrë më të përkryer trajtat tradicionale të vargut dhe strofave, qofshin të huazuara, qofshin burimore.”³²⁵

Pikërisht në këtë pikë Fishta dallon thelbësisht nga romantikët, e sidomos nga Naim Frashëri. De Rada nuk kishte bërë sprovë risimtare, ama ai iu kishte përmbajtur formave të tij poetike të fillimit në *Këngët e Milosaos* dhe ai e kishte mbyllë veprën e tij pak a shumë brenda atyre formave poetike të fillimit, të cilat i kishte krijuar mbi gjedhen e poezisë popullore. Ndryshe nga De Rada, Naim Frashëri nuk ka fre në përdorimin e ndryshëm të vargjeve, në kombinimin e vargjeve, në përdorimin e strofave dhe kombinimin e tyre, në krijimin e formave të reja poetike etj. Rexhep Qosja ka dalluar njëzet lloje të ndryshme të vargut në poezinë e Naim Frashërit, mirëpo ai konstaton se për nga ritmi origjinal, edhe vargjet e një gjatësie mund të dallojnë nga njëri tjetri, prandaj:

“...larmia e tipave të vargjeve të Naim Frashërit sipas ndërtimit të tyre ritmik është shumë më e pasur se ajo që del nga pasqyra e sipërthënë.”³²⁶

Shumë strofa të Naim Frashërit duken me të vërtetë eksperimentale. Po të shikohet poezia *Dimëri dhe vera nga Vjersha për mësonjëtoret të para*³²⁷, aty, thjesht, nuk mund të gjesh një rregull sipas të cilit janë krijuar vargjet dhe strofat, sepse ato janë të ndryshme ndërmjet veti, sipas një projekti pa rregulla. Por, mund ta marrim një shembull më autoritativ: poemën e famshme *Bukurija*. Në këtë poemë Naimi do të përdorë vargje gjatësish të ndryshme, strofa të ndryshme, lidhje vargësh e strofash të ndryshme, njësi poetike të ndryshme, strofa

325 Hysni Hoxha, *Struktura e vargut shqip*, Rilindja, Prishtinë, 1973, fq. 77.

326 Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, fq. 428-430.

327 Naim Frashëri, *Vepra 2 / Vjersha për mësonjëtoret të para*, fq. 83.

të ndryshme brenda një njësie poetike etj. Nga ana e formës poetike duket një çrregullim i tërësishëm, po ky kombinim vargjesh e strofash të ndryshme, të cilat nga ana metrike e të formave poetike duket si çrregullim, funksionon për mrekulli, duke dhënë një prej poezive më të bukura në letërsinë shqipe.

Format poetike klasiciste të cilat i përdorë Fishta, duke futur këtu edhe vargun dhe llojet e tij, janë përdorë në letërsinë shqipe edhe përpara tij. Në letërsinë popullore shqiptare janë përdorë vargjet çifte gjashtë-, tetë- dhe dhjetërokëshe. Dihet fort mirë se vargjet teke, pesë-, shtatë-, nëntë- dhe njëmbëdhjetërokëshe kanë hyrë në letërsinë e shkruar shqipe nën ndikimin e letërsisë italiane.³²⁸

Tashmë ekziston një histori e tërë e njëmbëdhjetërokëshit, vargut më të famshëm të huaj që është natyralizuar në poezinë shqipe. E para poezi e shkruar në letërsinë shqipe, *Këngë e përshpirtëshme* e Lekë Matrënges është shkruar në njëmbëdhjetërokësh. Në këtë varg ka shkruar sibilat e tij edhe Pjetër Bogdani, e pas tyre edhe Zef Barçija, Pjetër Zarishi, Leonardo de Martino, Zef Serembe³²⁹ etj. Mbas një përdorimi kaq të gjerë dhe kaq të gjatë në kohë, Fishta nuk do ta ketë pasur të vështirë ta absorbojë njëmbëdhjetërokëshin.

Po kështu, tashmë ekziston një histori edhe për stancën me njëmbëdhjetërokësh, edhe pse kjo strofë në poezinë e re shqipe nuk përdoret më. Por, Bogdani ka shkruar poezinë *Krijimi i Rruzullimit* dhe poezitë-sibila të tij në këtë strofë dhe me këtë varg. Sabri Hamiti thotë:

328 Dhimitër S. Shuteriqi, *Metrika shqipe*, Prishtinë, 1968, fq. 89-90.

329 Hysni Hoxha, *Struktura e vargut shqip*, fq. 13 dhe 29-34.

“Në punë të ndërtimit të vargut, ato që zotërojnë në veprën e Bogdanit janë format e letërsisë së shkruar të huaj, si stanca dhe njëmbëdhjetërrokëshi dhe në këtë aspekt ai futi një përvojë që do të zhvillohet më vonë në letërsinë shqipe dhe kështu krijon nga ky autor figurën e krijuesit me kulturë letrare.”³³⁰

Duke qenë De Rada i njëtrajtshëm, duke qenë Naim Frashëri rishtar i formave poetike, eksperimentues i madh dhe sfidues i të gjitha mundësive që ofrojnë format poetike, Fishta mbetet i ndryrë në rregullat e rrepta të metrikës klasiciste e të formave poetike tradicionaliste evropiane, me përjashtim të epit *Lahuta e Malcis*, të cilin e shkroi sipas modelit të metrikës e të formës poetike të epikës popullore historike.

III. 2. Figuracioni poetik

Për të parë figurën poetike të Fishtës në një dritë të re është e udhës të bëhet një krahasim i saj në dy dimensione: krahasimi i parë ka të bëjë me elementet e përgjithshme të figurës së Fishtës dhe të romantikëve, e kjo do të thotë shqyrtim i burimit kulturor të figurës; krahasimi i dytë ka të bëjë me detajet e strukturës dhe të prosedeut të figurës, e kjo do të thotë vlerësim i detajeve të brendshme të një figure poetike.

Areali i figurës së Fishtës. Në historinë e letërsisë shqipe nuk është vështirë të identifikohen poetët dhe figuracioni i tyre bashkë me arealin që i përkasin ato, e kjo për shkak të zhvillimit historik të shqiptarëve deri te formimi i kombit, zhvillim ky mjaft i shkapërderdhur dhe pa një qendër politike e kulturore të veten. Kështu, ka ndodhur

330 Sabri Hamiti, Studime letrare, fq. 71.

fenomeni i zhvillimit të qarqeve letrare (Çabej)³³¹ dhe i rretheve më të vogla letrare (grupe letrare, të quajtura shpesh shkolla letrare, rryma letrare etj.)³³², mjaft të mbyllura në rrethin e vet. Këto qarqe e rrethe më të vogla tendonin kah një qendër e jashtme kulturore dhe letrare dhe kjo reflektohej mjaft shumë edhe në letërsinë e tyre. Ekziston një dallim i skajshëm midis autorëve të vjetër të Veriut dhe rrymës letrare të bejtexhinjve dhe ky dallim shumë lehtë mund të përkufizohet. Me Rilindjen Kombëtare shqiptarët krijojnë idealin nacional dhe ky ideal do të jetë strumbullari i të gjitha zhvillimeve përreth një shekull. Me romantizmin shqiptarët krijuan letërsinë kombëtare.

De Rada është i pari poet që krijoi një vepër, *Këngët e Milosaos* (1836), jo vetëm romantike, por edhe me rëndësi të madhe letrare e kombëtare. Mirëpo në veprën e tij, sa do me tematikë origjinale, De Rada trashëgoi arealin kulturor të krijimit të letërsisë, të figuracionit poetik etj. Në veprën e tij figuracioni poetik është kryesisht i sferës krishtere (ortodokse) dhe i sferës së letërsisë popullore. Heronjtë kanë emra krishterë, pastaj kisha, kryqi, Shën Mëria e Krishti shfaqen pothuajse në sfondin e çdo vargu poetik, të trashëguar nga Shqipëria bizantine e të bartur në një rreth të ri perëndimor katolik (Kalabria e Sicilia në Itali). De Rada e fillon këngën me një përcaktim kohor e fetar si kjo: “Ishte mbrëmje e Shën Mërisë”³³³

Naim Frashëri ka në figuracionin e tij elemente dhe tipare të fuqishme kombëtare, po gjithashtu elemente e tipare të arealit mysliman,

331 Dr. Eqrem Çabej, Studime gjuhësore, V, Rilindja, Prishtinë, 1975, fq. 135.

332 Ernest Koliqi shquan dy shkolla letrare në Shkodër: atë françeskane dhe jezuite (shih: E. Koliqi, Dy shkollat letrare shkodrane, Prishtinë, 1998). Mahmud Hysa ndan më vete aliamiadën shqiptare (shih: Prof. Dr. Mahmud Hysa, Hyrje në letërsinë shqiptare, ETMM të Kosovës, Prishtinë, 2000).

333 Jeronim De Rada, *Këngët e Milosaos*, fq. 27.

bektashi dhe të lindjes në përgjithësi. Ai jo vetëm ka shkruar epin *Qerbelaja*, me temë luftërat vëllavrasëse për motive fetare në Qerbela, apo edhe poezi lirike për Abas Alinë etj., por ka në gjithë veprën e tij shumë figura të arealit lindor, si mirësia, qiriri, flutura, bilbili, trëndafili, idetë panteiste të vdekje-ringjalljes etj. Duhet theksuar faktin se te Animi ka figura edhe të arealit krishter.

Ndërsa figuracioni i Fishtës është më tepër tradicional, në kuptimin kombëtar, dhe me elemente të arealit krishter (katolik). Me këtë ndërlidhje të figuracionit të dy arealeve Fishta ka krijuar arealin e tretë, atë që shfaqet me binomin e njohur Fe e Atdhe. Ky binom në veprën e Fishtës është simbol i arealit të ri shqiptaro-krishter. Figura e Fishtës, qoftë ajo me burim nga letërsia popullore, nga literatura shqipe apo ajo botërore, figura origjinale të Fishtës apo edhe figura fetare, të gjitha këto bashkërisht ngjizen në arealin e ri të figuracionit Fe e Atdhe.

Trajtimi i këtyre dallimeve midis tre poetëve të mëdhenj shqiptarë është shpënë deri në skajshmëri nga studiues të ndryshëm. Kështu bën Ernest Koliqi në dy studime të tij *Hymje në lirikën shqiptare* (1963) dhe *Tre poetët më të mëdhenj shqiptarë* (1961), duke shquar De Radën si “zani i kulluem i ortodoksisë shqiptare”³³⁴, motivi kryesor i “muslimanit Animi Frashëri” është “fluturimi mistik drejt bukurisë së krijimit, fluturim që synon bashkimin suprem me Zotin”³³⁵, ndërsa Fishta “përpiqet të kujdeset për impulset e fshehta e të shëndosha dhe të krijojë vlera shqiptare që t’i shkrijë mandej në sintezë harmonike me frymën perëndimore.”³³⁶ Mirëpo, edhe pas një gjykimi të tillë tendencioz, Koliqi i vë në një djep tre poetët e mëdhenj:

334 Ernest Koliqi, *Kritikë dhe estetikë*, fq. 34.

335 Ernest Koliqi, *Kritikë dhe estetikë*, fq. 35.

336 Ernest Koliqi, *Kritikë dhe estetikë*, fq. 37.

“Ortodoksi *De Rada*, muhamedani *Naim Frashëri* dhe katoliku *Gjergj Fishta* i bashkojnë valët e poezisë së tyre në një shtrat të përbashkët, në gjerësinë e kulluar, përzemërsisht të përputhura, ku pasqyrohet Shqipëria me minaret e saja ajrore, me këmbanaret e saj katolike dhe kupolat e saj bizantine”.³³⁷

Figura personale e Fishtës. Dimensioi tjetër krahasimtar i figurës së Fishtës parakupton një analizë kësaj figure, si në cilësi ashtu edhe në shtresat e saj dhe krahasimi i saj me poetët më të mëdhenj romantikë.

Figurat kryesore të Fishtës janë: krahasimi, hiperbola, antiteza, gradacioni, personifikimi, metafora dhe epiteti. Në studimin tonë për lirikën e Fishtës ne kemi shqyrtuar strukturën ndërtimore të krahasimit të Fishtës, të cilin ai origjinalisht e merr prej letërsisë popullore, por i jep origjinalitetin e vet duke e zgjeruar nga një krahasim i thjeshtë në një tablo të tërë strukturash të ndryshme krahasuese, për të përfunduar me një tekst epik, e të cilin e kemi shënjuar si **figurë e zgjeruar** apo si **digresion në figurë** (krahasim i zgjeruar, antitezë e zgjeruar, hiperbolë e zgjeruar etj.).³³⁸ Kështu, në poezinë *Ditën e të shuemvet*, dhjetë vargjet e para janë një krahasim i zgjeruar:

I kuj do t’jet njai vorr, mbi t’cillin mvaret
 Kunorë lulesh e blerët e qi madhnueshëm
 Zotnon mbi fang t’mjeruem, porsi shatorrja
 E njaj Tyrani zemer-gur, i cilli,
 5. Mbi shegj Persijet pa kujdes pështetun,
 Nder kandje t’prujtna të ksaj jete kndellet,

337 Ernest Koliqi, *Fishta interpret i shpirtit shqiptar*, fq. 94.

338 Bajram Kosumi, *Lirika e Fishtës*, fq. 109.

Mjesa besniku ushtari i tij nen t'randin

Hekur t'anmikut rrokullohet dekun

E zhytet n'gjak?...³³⁹

Që të shihet më mirë gjerësia dhe digresioni i kësaj figure, po e ndajmë në pjesët përbërëse:

1. rrëfimtari (Uni, autori)

2. vorri i stolisur me kunora lulesh të blerta, i një të riu të panjohur shqiptar

3. fang-i i mjeruem (tokë djerrë)

4. shatorri pers

5. tirani zemër-gur pers që rri mbi shëgj (qilim)

6. tirani bën jetë hedoniste (kandje t'prujtna)

7. ushtari besnik vritet për lirinë e atdheut (Persisë)

8. mënyra se si vdes ky ushtar

9. varri i harruar i luftëtarit shqiptar (në vijim të poezisë).

Në këtë figurë, krahasim të zgjeruar, ka krahasim pas krahasimi dhe metaforë pas metafore, ndërsa kuptimi poetik bartet që nga vargu i parë e deri te i fundit pa shkëputje. Kjo figurë krijon disa imazhe, apo edhe disa tablo, krejt të ndryshme apo edhe të kundërta midis tyre, por me një qëllim: krahason kurorat e një varri të rregulluar për mrekulli me diçka që krijon imazh të keq, të dhunshëm e të përzier me krim. Vazhdimi i poezisë me imazhin e varrit tjetër, atë të heroit shqiptar, e qartëson edhe më tepër pse Fishta ka krijuar këtë imazh të keq që në hyrje të poezisë.³⁴⁰

339 Gjergj Fishta, Lirika / Mrizi i Zanavet, fq. 61.

340 Shih Bajram Kosumi, Lirika e Fishtës, fq. 109.

Kjo shfaqje poetike, zgjerimi i figurës, e dashur për Fishtën është vërejtur qysh nga Eqrem Çabej:

“Poetit ia kish enda t’i zvargte të gjëra (krahasimet, plotësim imi, B. K.), të ndiqte fillin e nisur të krahasimit gjer në konsekuencat më të mbrëmë, jo vetëm, po nganjëherë ndërlikon brenda te një krahasim një krahasim të ri.”³⁴¹

Elementi dallues fishtian në të gjitha figurat e tij, jo vetëm në krahasim, është pikërisht ky zgjerim i figurës. Ai përdor një krahasim të thjeshtë, apo një antitezë a hiperbolë të thjeshtë, por i adhuron dhe është më i lartë kur e zgjeron figurën, duke i dhënë asaj më shumë se një kuptim. Kjo shfaqje nuk ndodhë vetëm me krahasimin, por edhe me hiperbolën, me gradacionin, me antitezën etj. Poeti shtjellon idenë poetike, duke e ngritur nga shkalla fillestare deri në kulm, brenda një figure-shtëpi, ku mund të gjallojnë figurat-dhoma.

Tipin e tillë të figurës së zgjeruar do ta quajmë *cilësore*, për ta dalluar nga figura e zgjeruar, e cila krijohet me shtimin numerik të të njëjtave elemente, të cilën do ta quajmë *sasiore*. Kështu në poezinë *Gjuha Shqype* kemi një fillim të gjatë krahasimesh të zgjeruara sasiore:

1. Porsi kanga e zogut t’veres,
Qi vallzon n’blerim të Prillit;
Porsi i ambli flladi i eres,
Qi lmon gjit e drandofillit:
Porsi vala e bregut t’detit,
Porsi gjama e rrfes zgjetare,
Porsi ushtima e nji termetit,
Njashtu a’ gjuha e jonë shqyptare.

341 Eqrem Çabej, Epika e Gjergj Fishtës, në JETA E RE, nr. 11-12, Prishtinë, 1990, fq. 1452.

2. Ah! po; a' e ambel fiala e sajë,

Porsi gjumi m'nji kerthi,

Porsi drita plot uzdajë,

Porsi gazi i pamashtri ³⁴²

Krahasimi i zgjeruar nuk është shpikje e Fishtës në letërsinë shqipe. Është përdorur edhe prej poetëve të tjerë të mëparshëm. E përdorë Naim Frashëri me mjeshtri të madhe.³⁴³ Por, te Fishta, për dallim, shfaqet modeli i zgjeruar, jo vetëm për krahasimin, por edhe për një numër tjetër të figurave, si gradacioni (i cili për nga natyra e vet është i zgjeruar), hiperbola e zgjeruar dhe antiteza e zgjeruar. Krijimi i figurës së zgjeruar, cilësore dhe sasiore, jo vetëm i krahasimit, por edhe i shumë figurave të tjera mund të konsiderohen tipe të figurës individuale të Fishtës³⁴⁴, në kuptimin që janë shumë dendur të përdorura dhe janë ndër pjesët më të realizuara të tekstit letrar. Me këtë figurë Fishta mbizotëron cilësisht krejt traditën letrare shqiptare.

Fishta e Naimi: hiperbola dhe litota. Një krahasim i mundshëm i Fishtës me traditën, këtu me Naim Frashërin, mund të bëhet përmes dy figurave më të theksuara poetike të dy poetëve. Për Fishtën kjo figurë është hiperbola, ndërsa për Naimin litota. Hiperbola dhe litota kryejnë funksione të kundërta në tekstin poetik: hiperbola rrit gjërat nga madhësia natyrore në madhësi të mbinatyrshme, ndërsa litota

342 Gjergj Fishta, *Lirika / Mrizi i Zanavet*, fq. 43-44.

343 Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, fq. 310-317.

344 Nocioni figurë individuale këtu është përdorur analogjikisht me nocionin simbol individual (privat, personal), të cilin e përdor Rene Velek, nocion tashmë i pranueshëm për të gjithë teoricienët e letërsisë. Shih R. Velek e O. Voren, *Teoria e letërsisë*, Rilindja, Prishtinë, 1982, fq. 281-282.

zvogëlon gjërat nga madhësia natyrshme në pjesë më të vogla. Nganjëherë kjo formë e zvogëlimit përdoret edhe për nënçmim.³⁴⁵

Sado Rexhep Qosja konstaton me të drejtë se përdorimi i zvogëlimeve nga Naimi nuk është aq i madh sa përdorimi i zmadhimeve,³⁴⁶ nga studimi që ai vetë u bën këtyre dy figurave të përdorura nga Naimi mund të shihet se përdorimi i zvogëlimit (litotës) është shumë më karakteristik sesa përdorimi i zmadhimit (hiperbolës). Kjo për arsye se hiperbola është një prej figurave kryesore të rrëfimit epik dhe Naimi edhe po të kishte dashur nuk do t'i ikte dot kësaj rregulle, prandaj detyrimisht e ka përdorë shumë. Por, hiperbola e tij është e zakonshme, figurë e rregullt epike. Ndërsa litota, me format e saja shqipe, është prodhim origjinal i Naim Frashërit në letërsinë shqipe. Ai mori mbaresat zvogëluese të gjuhës shqipe z, zë, th, thë dhe krijoi jo vetëm fjalë me kuptim të zvogëluar por edhe kuptime të pavarura të fjalëve bazë, si: zogth, mëmëz, bukurizë, vashëz, këmbëz, ngadalëzë etj. Sipas Qosjes, Naimi përdori zvogëlimin në emra, në mbiemra, në ndajfolje, në përemra etj.

“Sikundër mund të shihet prej këtyre shembujve Naim Frashëri e shtrin zvogëlimin gati në të gjitha trajtat e gramatikës.” (...)

“Megjithëse në gjuhën shqipe nuk dihet të jetë përdorur ashtu ndonjëherë, Naim Frashëri nuk ngurron ta përdorë me prapashtesë zvogëlimi edhe numërorin dy-dyth.”³⁴⁷

345 Zejnullah Rrahmani, *Arti i poezisë*, Faik Konica, Prishtinë, 2001, fq. 121.

346 Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, fq. 341. Me gjithë këtë konstatim, vetëm disa faqe më tutje, në fq. 350, Qosja rikonstaton:

„Prej shtjellimit të mësipërm shihet se zvogëlimet në krijimtarinë e Naim Frashërit janë mjet i shprehjes me shtrirje dhe ndikim po aq të madh sa edhe zmadhimet.“

347 Rexhep Qosja, *Porosia e madhe*, fq. 345.

Mund të përfundojmë se litota është figura më karakteristike për Naim Frashërin dhe kjo është në pajtim të plotë me misionin e veprës së tij letrare. Në gjithë veprën letrare të Naimit ai shprehë dashurinë, afërsinë, shoqërinë e miqësinë me njerëzit, me sendet e me natyrën. Litota, si figurë poetike dhe në pajtim me filozofinë e gjuhës shqipe, është në funksion të kësaj dashurie, afërsie e miqësie. Shqipëria e tij është Shqipërizë, pra diçka shumë më e afërt dhe më e dashur se Shqipëria. Ky është misioni i litotës (sipas misionit të letërsisë së Naim Frashërit), të cilit i nënshtrohet edhe sintaksa shqipe, qoftë edhe duke u deformuar. Qosja e vëren këtë fenomen:

“...krijimi i zvogëlimeve prej përemrave-si një dukuri gjuhësore, pothuaj, e panjohur në gjuhën shqipe-në vargjet e Naim Frashërit është një dukuri që duket e panatyrshme.”³⁴⁸

Me litotën Naimi krijon një botë më të vogël, pra edhe një Shqipëri më të vogël, në kuptimin e botës e të Shqipërisë më intime, më personale, ku njerëzit njihen dhe janë miq, jo vetëm te njerëzit, kjo harmoni shtrihet edhe në botën e sendeve e me natyrën, duke kaluar në fund edhe në botën e mistikës bektashiane. Por, ky është misioni i Naimit, i letërsisë së tij dhe i litotës së tij: të krijojë afërsinë midis njerëzve, afërsinë e njerëzve me sendet e me natyrën.

Te Fishta është ndryshe. Ai nuk përdorë kurrë litotën. Figura e tij karakteristike është hiperbola, e formësuar në shumë trajta e përmbajtje. Hiperbola ka një shtrirje të madhe në *Lahutën e Malcis*, në epin *Palokë Cuca* dhe kudo në shkrimet satirike, në lirikën patriotike dhe në atë fetare, në dramën lirike *Jerina ase Mbretnesha e lulevet* etj. Në

348 Rexhep Qosja, Porosia e madhe, fq. 343.

pajtim me natyrën e vet, hiperbola paraqet njerëzit, sendet, natyrën, shfaqjet... më të mëdha se në përmasat e tyre reale. Ky zmadhim mund të jetë në kuptimin pozitiv, po edhe negativ apo ironizues. Me këtë formë të zmadhuar bota e Fishtës, Shqipëria dhe njerëzit e saj janë më të mëdhenj, me përmasa pothuajse mbinatyrore, janë modele epike e mitike.

Hiperbola himnizuese:

Ushton mali, thonë, kur t'flase,
Dridhet fusha kah t'vikase;
E kah t'dredh të rrebtë taga'n,
Thue se rrfeja shkrepë per anë:³⁴⁹

Të dy trima, s'ke shka u thue;
Njani bishë, tjetri drangue.³⁵⁰

Kisht' kenë Shkjau, po, me tri zemra!³⁵¹

Hiperbola pezhorative:

E vrau Steva i Plevanacit,
Nji haram, ky, nji farë bracit,
M' e pasë rand toka me e bartun,
Veç se Kishë qi s'kishte qartun,
Se per tjetër mbi ket tokë
Gja pa ba s'la m't'huej as m'shokë:³⁵²

349 Gjergj Fishta, Lahuta e Malcis, Kangë IV, vargjet 13-16.

350 Gjergj Fishta, Lahuta e Malcis, Kangë XVIII, vargjet 286-287.

351 Gjergj Fishta, Lahuta e Malcis, Kangë III, vargu 238.

352 Gjergj Fishta, Lahuta e Malcis, Kangë XVIII, vargjet 108-113.

Hiperbola ironizuese:

Veç shka se, besa, sod me sod n'Shqypni
 S'asht punë e lehtë me shkruë as n'vjerrsha as n'prozë,
 Se ktu letrarët kanë bijtë si kpurdhat n'shi
 E ka 'i kritik e gjen ti per gjith shkozë.
 Jo, po; bakaj, hamaj, teneqexhi
 E ata der dje qi ndejen tue shitë bozë,
 Mjaft qi 'i kuslët' thijtë t'a kenë shtrembnue n'njanë sye,
 Se me kritika s't'lan me çue jo krye.³⁵³

Struktura ndërtimore e hiperbolës është e ngjashme te të gjitha gjinitë letrare dhe te të gjithë poetët. Përdorimi i hiperbolës në vetvete nuk e dallon Fishtën nga poetët të tjerë romantikë, edhe pse Fishta e përdorë më dendur se çdo poet tjetër. Përdorimi i hiperbolës e dallon Fishtën vetëm në marrëdhënie me litotën e Naim Frashërit. Deri sa Naimi krijonte imazhin e një bote më intime e më personale e këtë e arrinte duke i zvogëluar nocionet, sendet e natyrën përmes prapashtesave që në gjuhën shqipe parakuptojnë dashuri, afri e miqësi, Fishta krijonte imazhin e një bote dhe të një Shqipërie të përmasave gjigante, në të cilën botë luftohej tmerrësisht shumë për të mbijetuar dhe për të triumfuar ideali i lirisë, një botë e cila kishte kaluar epokën e ndjenjave e të emocioneve të dashurisë së litotave të Naimit dhe tash ballafaqohej me veprime për ta bërë realitet atë botë të imagjinuar nga Naimi. Për ta bërë atë realitet duhej guxim e duhej forcë dhe Fishta e krijon botën madhështore epike për këtë qëllim. Injac Zamputi në shkrimin *Kur flasim për të Mëdhaj...* (1943)³⁵⁴, duke sugjeruar që poetët e mëd-

353 Gjergj Fishta, *Satirika / Palokë Cuca*, Rilindja, 1997, Kangë e Parë, 4.

354 Injac Zamputi, *Kur flasim për të mëdhaj...*, në Leka, 1943, fq. 48-54, cituar nga Ibrahim Rugova, *Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983*, Faik Konica,

henj shqiptarë të respektohen, i sugjeron lexuesit këto kualifikime për Naimin e Fishtën: “Naimi i dashun, Fishta i Madhnueshëm...”. Ky kualifikim përlligjet vetëm përmes dy figurave poetike që shqyrtoam: litotës dhe hiperbolës.

Antiteza. Antiteza është figura më personale e Fishtës. Është figura më e përdorur në gjithë krijimtarinë e tij. Jo vetëm ka një shtrirje të gjerë, po ka edhe një strukturë të gjerë ndërtimore. Ajo nis nga antiteza e dy pjesëve pohuese e mohuese të shqipes, po dhe jo, dhe mbërrin deri te antitezat më të larta e më paradoksale. Antitezat e thjeshta ndërtohen me një strukturë fare të thjeshtë, të marrë nga ligjërimi i përditshëm i shqiptarit:

Jo, po, moj Zanë, kam da veti me veti (*Palokë Cuca*, kangë e parë, 3)

Jo qi po ka 'edhe 'i Komision Letrar (*Palokë Cuca*, kangë e parë, 3)

Jo, po pra: paska kenë shkruie (*Lahuta e Malcis*, Kangë XXII, vargu 93)

Kjo antitezë e thjeshtë nuk është ndërtuar mbi kundërshtinë e dy fjalëve a kuptimeve, si përkufizohet antiteza tradicionalisht që nga Aristoteli, por mbi kundërshtinë e pjesëve pohuese e mohuese, karakteristike për ligjërimin bisedor në sintaksën e shqipes. Këtë antitezë të thjeshtë Fishta e përdorë edhe në shkrimet publicistike, në shkrimet në prozë, qoftë të diskursit letrar apo të diskursit publicistik. Ja një shembull:

„Jo, po, as dielli pa nuk ka, as hana s’ka soditë, historija edhe nuk man në mend nji vepër kulturele më të madhnueshme se ajo, qi Kisha Katolike ishte tuj ndertue n’Europë.“³⁵⁵

Prishtinë, 2005, fq. 361.

355 Gjergj Fishta, Përndritje, fq. 198.

Antiteza e fundit në prozë dhe ndërtimi i kuptimeve mbi bazën e saj është i ngjashëm me vargjet e para të poezisë *Shqypnija*:

Edhe hana do ta dije,
Edhe dielli do t'ket pa,
Se per qark ksaj rrokullije,
Si Shqypnija 'i vend nuk ka!³⁵⁶

Një ndërtim tjetër i antitezës është kundërshtimi i dy kuptimeve a ideve me ndihmën e pjesëve pohuese e mohuese po dhe jo:

1. Jo, po: a s'desht djalli Shqypni?

Jo, po: a s'desht hasmi Shqyptarë?

Qe, pra, sod po ka Shqypni;

Qe, pra, sod po ka Shqyptarë.³⁵⁷

Në këtë lloj të antitezës kundërshtimi është i dyfishtë: kundërshtohen pjesëzat pohuese e mohuese dhe kundërshtohen kuptimet dhe idetë. Antiteza më e famshme e Fishtës është ajo që ndërtohet mbi kundërshtimin e skajshëm të kuptimit, të idesë dhe të fjalës:

Oj Zanë, t'këndojm...t'vajojm, deshta me thanun³⁵⁸

Oj Zanë, mi shekull sod per ty perflitet,

Se shum, me gjasë, po kisht' ti dokrra e fjalë³⁵⁹

Oj Zanë, t'këndojmë sod ma mirë se kurrnji hera;

356 Gjergj Fishta, *Lirika / Mrizi i Zanavet*, fq. 37.

357 Gjergj Fishta, *Lirika / Mrizi i Zanavet*, fq. 49.

358 Gjergj Fishta, *Lirika / Mrizi i Zanavet*, 1997, fq. 78.

359 Gjergj Fishta, *Satirika / Palokë Cuca, Kangë e Parë*, 1.

T'shporrmi pallavrash s'Skanderbeg Kastriotit:³⁶⁰

Po antiteza më komplekse e Fishtës është antiteza e cila ndërtohet mbi kundërshtimin e kuptimeve asociative të fjalës apo të idesë poetike, prandaj do ta quajmë **antiteza asociative**. Në këto antiteza të fuqishme ndodh procesi i kundërt me logjikën fillestare të antitezës. Do të marrim shembullin nga poezia *Nji lule vjeshtet*.

'I kryq dullijet,

Qi e pershpiirtshme nji dorë ta vu te kryeni,

Nder to ka hupë, as tjetër send trishtimin

E vorrit nuk t'a zbutë, posë va'it t'trishtueshem

Të hutit t'natës, qi neper curra t'malit

Dhimbshem në rreze t'hanës rrin tu gjimue!...³⁶¹

Kënga e hutit të natës është një ogur në gjithë letërsinë shqipe. Pothuajse mund të merret si një topos me këtë mesazh. Do të ishte në pajtim me simbolikën e vet përdorimi i këngës së hutit në funksion të ogurit. Fishta bën të kundërtën. Për të paraqitur një situatë edhe më të tmerrshme sesa mund ta pranojë mendja tradicionale e njeriut, ai e arrin këtë me antitezën e krijuar pikërisht me këngën e hutit në natën e frikshme. Porse, tash kënga e hutit nuk krijon ogur, por e zbut situatën e tmerrshme ekzistuese. Do të thotë, aq e tmerrshme është ajo situatë sa edhe kënga e dikurshme ogurzezë e hutit duket e ëmbël dhe e butë. Këto janë antitezat më të fuqishme të Fishtës.

Po këtë lloj të antitezës Fishta e përdorë dendur edhe në poezinë satirike:

Kish e t'kem si t'dal n'per Shkoder

360 Gjergj Fishta, Satirika, fq. 111.

361 Gjergj Fishta, Lirika / Mrizi i Zanavet, fq. 203.

Me një surle e me një lodër,
 T'shkoj tu' u ra për mall:
 Lum! E lum! pse Shqyptarija
 Ka marrë trokun kah liri
 Porsi pelë n'per zall.³⁶²

Në këtë antitezë figura poetike është krijuar mbi kundërshtitë e kup-timeve asociative të surlës e të tupanit, të cilat përdoren për ahengje e dafrunga, por jo edhe për himne të lirisë dhe në krahasimin “porsi pelë n'per zall”, i cili është frazeologji popullore e që tregon një gjendje anarkie, një punë pa kontroll, diçka pa fre, e të gjitha këto të kundërshtuara me veprimin e shqiptarëve për krijimin e lirisë.

Përveç antitezës personale Fishta përdorë shumë dëndur edhe antitezën e marrë nga letërsia popullore dhe nga të folurit popullor, sidomos në *Lahuta e Malcis*, si:

Drita duel, dielli s'ka le³⁶³
 Me e pas pre, gjak s'do t'kisht' ba³⁶⁴

III. 3. Modeli i shkrimit-çështje të gjinisë letrare

Fishta është i njohur më shumë për epin *Lahuta e Malcis*, mirëpo ka disa studiues që theksojnë satirën, si prodhimin e tij më të mirë letrar. Gjithashtu, Fishta është i njohur në qarqet kulturore edhe si polemist i fortë, njeri i pa kompromis në parimet e veta, njeri që ka shkruar një vepër të çmuar letrare, i nxitur nga një polemikë e vogël në lidhje me një çështje kulturore-fetare. Ky është Fishta i njohur më shumë, por ai ka shkruar edhe lirikën dhe dramën. Botimi komplet i veprës së Fishtës

362 Gjergj Fishta, Satirika, fq. 121.

363 Gjergj Fishta, *Lahuta e Malcis*, Kangë VIII, vargu 1.

364 Gjergj Fishta, *Lahuta e Malcis*, Kangë XV, vargu 145.

në Prishtinë është i ndarë në libra sipas gjinisë së shkrimit: *Lirika, Lahuta e Malcis* (epika), *Satirika dhe Dramatika*³⁶⁵, sipas ndarjes që i bën bibliografi i parë i plotë i Fishtës, Atë Benedikt Dema.³⁶⁶ Kjo ndarje për veprën letrare të Fishtës është kuptimplote, nëse lëmë anash shkrimet e tij të diskursit letrar kritik dhe estetik.

Edhe gjinia letrare e preferuar e Fishtës është tradicionale. Fishta nuk shkruan tregime, si disa nga bashkëkohësit e tij të mëvonshëm, të cilët në dekadën e dytë e të tretë të shekullit XX u afirmuan me tregimin, romanin etj. Epi nacional, epi satirik, drama, lirika patriotike dhe lirika fetare, këto janë gjini letrare tashmë jo vetëm të vjetra e tradicionale, por gjysma e tyre konsiderohen gjini të përfunduara letrare në kulturën evropiane. Fishta është pa dyshim poeti i fundit epik në Evropë që shkroi ep nacional apo edhe ep satirik. Ky status i gjinive letrare në letërsinë evropiane nuk është i njëjtë me statusin e tyre në historinë e letërsisë shqipe. Pas Fishtës, edhe në letërsinë shqipe askush nuk shkroi një ep nacional apo satirik. Krahasimi i modelit të shkrimit të Fishtës, që në thelb është çështje e gjinisë letrare, me modelet e shkrimit letrar në letërsinë shqipe, duke qenë pra se është një krahasim i gjinive e modeleve letrare të përmyllura, nuk pretendon të hapë një portë të re. Qëllimi i këtij studimi është të kuptojmë se pse Fishta përdori ato gjini letrare dhe ato modele shkrimi letrar që tashmë kishin përmyllur jetën e vet në letërsinë evropiane? Dhe, pyetja e dytë, se si

365 Botimi i veprës së Fishtës është përgatitur nga Dr. Sabri Hamiti, i ndarë në katër libra, në të cilët përfshihet pothuajse i tërë shkrimi letrar i Fishtës, por nuk janë përfshirë shkrime letrare të diskursit kritik e estetik dhe as shkrimet e tij të diskursit politik e social. Botimi i dytë, Rilindja, Prishtinë, 1997.

366 Në Bibliografinë e tij Atë Benedikt Dema bën këtë ndarje: I. Lirika, II. Epika, III. Dramatika, IV. Satirika, V. Agiografi, VI. Perkthime e ndjektime, VII-VIII. Prodhime në prozë, dy blej (shkrime sociologjike, polemika, ligjërata, Niscellanea.

arriti Fishta suksesin e pakontestueshëm në letërsinë shqipe, pikërisht me këto modele të përmyllura?

III. 3. a. Epika: tradita e epit në letërsinë shqipe

Tradita e epit të shkruar në letërsinë shqipe lidhet me periudhën e Rilindjes Kombëtare.

“Letërsia shqipe, thotë Shaban Sinani, është sunduar prej afro një shekulli prej kultit të epopesë. Shkrimtarët e mëdhenj rilindës e shihnin veten përgjegjës ndaj epopesë kombëtare.”³⁶⁷

Nuk është Fishta i pari poet shqiptar që provoi shkrimin e epit kombëtar dhe që provoi shkrimin e këtij epi në marrëdhënie të ngushtë me letërsinë popullore. Para tij De Rada kishte provuar, sipas modelit të poetit finlandez Elias Loennrot (1802-1884) dhe epit të tij *Kalevala* (Toka e Kalevalës, 1849), të ringjallte epin shqiptar me veprën e tij *Rapsodie d'un poema albanese* (Rapsodi të një poeme shqiptare, 1866).³⁶⁸ Pas disa veprave sipas frymës së *Këngëve të Milosaos* (1836) dhe *Rapsodi të një poeme shqiptare* (1866), si *Serafina Topia* (1839, 1843), e ndryshuar në *Një pasqyrë shtegtimi njerëzor* (1897), *Histori e Shqipërisë*, ose

367 Shaban Sinani, Mitologji në Eposin e Kreshnikëve, Argeta LMG, Tiranë, 2006, fq. 52

368 Po ashtu, në lidhje me Rapsodie d'un poema albanese, ende mbetet e hapur në shkencën shqiptare edhe një çështje: origjinaliteti i këtyre këngëve. Disa studiues të këtyre këngëve, duke filluar që nga Nikoll Jeni i Koronjëve, i cili shkroi parathënien për veprën e De Radës më 1865 e deri te Anton N. Berisha (në Qasje poetikës së letërsisë gojore shqipe) e marrin si të paluhatshme tezën se këto këngë janë popullore dhe janë mbledhë nga De Rada. Një grup tjetër studiuesish, duke filluar që nga indoevropianisti i njohur Gustav Meyer, i cili që nga fundi i shekullit XIX kishte provuar se këto këngë janë prodhime origjinale të De Radës, e deri te Shaban Sinani (në Mitologji në eposin e kreshnikëve), e marrin si të paluhatshme tezën se këto këngë janë prodhime origjinale, mbase sipas ndonjë modeli popullor, të cilat i kishte krijuar De Rada, e më pas, sipas modelit të tij edhe Gavril Dara i Riu e Vinçenc Dorsa, duke u munduar ta riprodhojnë epin e vjetër shqiptar të humbur nëpër kohë. Vetë Shaban Sinani në librin Mitologji në Eposin e Kreshnikëve në një vend mbron joorigjinalitetin e këtyre këngëve (fq. 10) e në një vend tjetër mbron origjinalitetin popullor të tyre (fq. 55).

*Shqipëria nga viti 1460 deri më 1485, ose Rrëfime të Arbrit (1847), De Rada i kishte hyrë punës në shkrimin e epit nacional Skënderbeu i pafat (1872-1884).³⁶⁹ Sado me vlera të mëdha letrare, De Rada nuk e kishte arritur qëllimin e dëshiruar, qoftë për mungesën e unitetit të duhur të veprës, qoftë për shkak të largësisë së madhe kohore dhe shkëputjes, rreth katërqind vjeçare, midis ngjarjeve e personazheve të epit dhe lexuesit të kohës së De Radës. Edhe poeti tjetër kombëtar shqiptar, Naim Frashëri, kishte provuar pa sukses të shkruante një ep kombëtar, *Istori e Skënderbeut* (1898), e i cili nuk e kishte arritur qëllimin e dëshiruar qoftë për shkak të mbamendjes së zbehur shqiptare për epokën e largët të Skënderbeut, qoftë për shkak të stilit lirik të ligjërimit të Naimit, qoftë edhe për shkak të strukturës së veprës, e treguar si një histori ngjarjesh të njëpasnjëshme e në lidhshmëri shkak-pasojë. Epoka e Skënderbeut, të cilën dëshiruan ta shtjellojnë në epe dy nga poetët më të mëdhenj shqiptarë, De Rada dhe Naimi, e në fillimet e veta letrare edhe Gjergj Fishta kishte menduar në këtë temë, ishte epoka e tkurrjes shqiptare nën sulmet e perandorisë më të fuqishme të kohës, Perandorisë Osmane dhe në thelb ishte një epokë luftërash të pandërprera për mbrojtje dhe mbijetesë. Pas vdekjes së Skënderbeut ky proces degradoi në dezintegrim e ri-identifikim të etnikumit dhe të territorit shqiptar. Ndërsa epoka në të cilën jetuan De Rada dhe Naimi kishte ideale të tjera: idealet e çlirimit të territorit shqiptar dhe të krijimit të kombit të lirë shqiptar. Kjo epokë e rilindjes kërkonte ideale dhe heronj letrarë që rilindnin si feniksë e jo ideale e heronj në rënie. Përveç kësaj, Skënderbeu ishte një luftëtar i krishterë që kishte idealin e luftës kundër një*

369 Jup Kastrati, Studime për De Radën, fq. 251.

“Me këtë vepër, poeti i vuri detyrë vetes të krijonte një epike për kohën e Skënderbeut, ku të pasqyroheshin tërë madhësitë e tërë vuajtjet e Shqipërisë”.

perandorie islame e kulturës së saj të papranueshme dhe ky ideal ishte thelbi i konfliktit të epokës së tij, ndërsa periudha e Rilindjes Kom-bëtare që e jetuan dhe e krijuan edhe dy poetët tanë, ishte periudha që kërkonte identitet të ri mbifetar e politik, periudha kur shqiptarët katolikë u bashkuan me ata ortodoks e me ata të besimit islam dhe iu vërsulën bashkërisht Perandorisë Osmane islame. Të gjitha këto fakte letrare dhe jashtëletrare bënë që edhe De Rada edhe Naimi të dështojnë në përpjekjet e tyre për të rikrijuar, përkatësisht për të shkruar, epin nacional shqiptar.

Një tjetër poet arbëresh, Zef Skiroi Plaku (1865-1927), një prej poetëve më të shquar të periudhës së fundit të romantizmit, autor i poemës lirike *Milo e Haidhe* (botim i parë 1887-1890 dhe botimi i fundit i autorit 1900-1907), një nga kryeveprat e letërsisë shqipe³⁷⁰, shkroi edhe dy epe: *Te dheu i huaj* (botim i parë 1900, botim i fundit 1940) dhe *Këthimi*, botim i parë më 1965.³⁷¹ Epi *Te dheu i huaj* është shkruar dhe përpunuar përafërsisht në të njëjtën kohë kur edhe Fishta e shkroi epin e vet *Lahuta e Malcis*. Ka dallime thelbësore midis botimit të parë të epit të Skiroit (1900) dhe botimit të fundit (1940). Në aspektin e formave poetike e të metrit Skiroi Plaku nuk ka arritur të lirohet nga gjedha e shkrimit deradian, e që burimisht është popullor, ndërsa në aspektin e syzheut epi i tij i ngjet *Këngës së sprasme të Balës të Darës së Riut*, të cilën vetë Skiroi Plaku e kishte botuar për herë të parë pjesë në revistën e tij *Arbri i Ri*, më 1887.³⁷² Sikurse me dy personazhet e Darës, që ru-

370 Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, Dukagjini, Pejë, 2001, fq. 469.

371 “Egzistenca e Këthimit ishte vënë re nga papas Gaetano Petrota, që më 1927 e përmend për herë të parë...”, tregon Matteo Mandala, i cili përgatiti për shtyp, transkriptoi dhe shkroi shkrimet hyrëse për veprat e Zef Skiroit. Shih te Zef Skiroi, *Vepra 3*, Faik Konica, Prishtinë, 2001, fq. 11.

372 Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, fq. 131-132.

aj në fillin e rrëfimit, Balës dhe Bijës së Lalës, mirëpo rrëfimi ndodhë shumë larg tyre në kohë e në hapësirë, edhe te Skiroi Plaku, biri dhe tata ruajnë fillin e rrëfimit për ngjarjet e largëta në kohë e në hapësirë. Risia e Skiroit Plakut në këtë ep është ndërthurja e ngjarjeve të vjetra me ato bashkëkohore dhe ndërthurja e heronjve të vjetër me heronjtë e ri. Skiroi Plaku merr heronjtë jo vetëm nga periudha e Skënderbeut, por edhe nga bashkëkohësit, nga trimat shqiptarë që kishin luftuar për lirinë e Shqipërisë në shekullin XIX dhe XX dhe kishin merita në bërjen e zhvillimin e shtetit shqiptar. Përmes këtyre heronjve dhe fatit të tyre poeti rikrijon historinë shqiptare që nga Skënderbeu e deri te luftërat e Mahmud Pashë Bushatliut në Mal të Zi. Edhe pse në dyer anësore, Skiroi Plaku e ka futur në letërsi temën e konfliktit shqiptaro-sllav, duke e trajtuar atë në gjerësi që nga legjendat, si lufta e Trimit Musa Shqiptarit dhe e Marko Kraveviçit e deri te Luftërat Ballkanike dhe pushtimi e ushtrisë serbe e malazeze të tokave shqiptare.

Ndryshe nga De Rada, nga Naimi dhe nga Skiroi Plaku, Fishta do të shkruajë veprën e vet *Lahuta e Malcis*, sipas një projekti origjinal. Ai do ta shkruajë veprën e vet mbështetur rrënjësisht në poetikën e poezisë epike shqiptare, por me tema e motive të reja dhe me personazhe të reja, të gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe fillim shekullit XX. Nga njëra anë ai po merrte strukturat ndërtuese të tekstit poetik të skali-tura për shekuj të tërë dhe brenda atyre strukturave zhvillonte ngjarje heroike nga aktualiteti heroik i krijimit të kombit shqiptar. Në të vërtetë, Fishta kishte zbuluar kodin e krijimit të epit kombëtar shqiptar, që do të ishte edhe art i fjalës dhe ide poetike mbi të cilën krijohej një komb. Shqiptarët janë popull tradicional, popull që jeton me kultin e vlerave tradicionale, e që në kohën e Fishtës ende e shihte botën sipas

parimeve epike të të jetuarit, por shqiptarët në atë kohë po bënë luftën më të vështirë të historisë së tyre, luftën për formimin e kombit të lirë, dallueshëm nga dy faktorë imponues: luftën kundër Perandorisë Osmane islame, edhe pse shumica e shqiptarëve ishin të besimit islam dhe shpëtimin e territorit etnik nga grabitqarët e rinj fqinjë ortodoks, edhe pse një pjesë e madhe e shqiptarëve ishin ortodoksë. Tradicionalizmi shqiptar dhe lufta e tyre për formimin e kombit të lirë ishin dy parimet themelore shqiptare, që kishin mbujtur dëshirat, vullnetin dhe jetën e përditshme të shqiptarit, gjatë tërë periudhës së Rilindjes Kombëtare e deri në formimin e shtetit të parë shqiptar, Shqipërisë, më 1912. Fishta, më mirë se çdo poet tjetër shqiptar i përdori këta dy faktorë për veprën e tij epike, duke e realizuar kështu vetëdijen historike, estetike dhe sociale të shqiptarëve.

Siç u tha edhe më sipër ekzistonte një ngjashmëri dhe një dallim midis De Radës dhe Fishtës në shkrimin e epit. Ngjashmëria është se që të dy kanë shkruar epin, me pretendimin e një epi kombëtar, prandaj që të dy shkruajnë epe të gjata e gjithëpërfshirëse dhe që të dy shkruajnë epet e tyre duke u mbështetur në modelet nga tradita popullore shqiptare: i pari, De Rada, pasi nuk e kishte arritur suksesin e dëshiruar me *Rapsodi të një poeme shqiptare*, shkroi epin *Skënderbeu i pafan* (1873), në të cilin punoi për katër dekada me radhë dhe të cilin e konsideronte kryeveprën e vet.³⁷³ I dyti, Fishta, shkroi epin *Lahuta e Malcis* (1905-1930), në të cilin punoi rreth katër dekada dhe të cilën, ai vetë por edhe historianët e letërsisë e konsiderojnë kryevepër të tij. Dallimi qëndron në temat që trajtojnë të dy poetët në epet e tyre dhe në poetikën që

373 Jup Kastrati, Studime për De Radën, fq. 250. Shih edhe Historia e letërsisë shqipe (1989), fq. 272.

ndjekin në punën e tyre. I pari, De Rada, trajton qëndresën heroike të shqiptarëve, nën udhëheqjen e Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti, kundër pushtimit osman të Shqipërisë, temë kjo jo shumë e freskët për shqiptarin e shekullit XIX; përveç disa heronjve të njohur historikë, heronjtë e tjerë të De Radës nuk nxitnin ndjenjat liridashëse të lexuesve të kohës, fundja, ata ishin heronj të një vendi që po pushtohej e po binte, të cilin do ta kanoste për pesë shekuj zhbërja, ndërsa De Rada besonte se me ata heronj do t'i ndezte zemrat e shqiptarëve të cilët në shekullin XIX e XX po luftonin për krijimin e kombit të ri e të lirë shqiptar. Vizioni dhe mesazhi i epeve të De Radës e të Naimit ishte retrospektiv: lufta heroike e shqiptarëve nën udhëheqjes e Skënderbeut kundër pushtuesve osmanë, e ndodhur katërqind vjet më parë. Në rastin më të mirë ky mesazh ishte alegorik: “Shqiptarë, e shikoni si kanë luftuar të parët tuaj kundër pushtuesit? E ju ç'bëni tash që s'luftoni?” Ndërsa vizioni dhe mesazhi i epit të Fishtës ishte perspektiv: lufto për ta krijuar lirinë, atdheun, fenë, kombin, të ardhmen. De Rada e shkruan veprën e tij me një stil epiko-lirik dhe siç e kanë gjykuar historianët e letërsisë, me shumë mangësi të tjera për të qenë një vepër unike epike.³⁷⁴ I dyti, Fishta, duke pasur shumë të qartë se synonte të shkruante epin nacional të shqiptarëve, ai u drejtua në thelbin e çështjes: mori temën e kësaj lufte për krijimin e kombit të ri e të lirë shqiptar dhe luftën e shqiptarëve në këtë proces kundër sllavëve (serbëve dhe malaziasve) dhe turqve osmanë. Heronjtë e tij ishin bashkëkohësit e tij, trima të anëve të ndryshme të Shqipërisë, që ishin dalluar në luftë

374 Historia e letërsisë shqipe (1989), fq. 280. Historianët e letërsisë e gjykojnë veprën për mungesë të unitetit strukturor të duhur për epin, mungesë të subjektit të veprës, mungesë të protagonistit etj. Të njëjtin vlerësim ndajnë pothuajse të gjithë studiuesit e tij.

me ndonjërin prej këtyre kundërshtarëve, sllavëve dhe turqve osmanë, trima të katundeve të lëna e të qyteteve, që kishin qenë në gjendje të vdisnin në luftë për të mbrojtur, qoftë edhe njërin prej virtyeteve që ata mendonin se e përbëjnë kombin e ri e të lirë shqiptar. Këta heronj ishin luftëtarë për idealet e rilindjes shqiptare dhe ndiznin zemrat e dëshirrat e të tjerëve për të vazhduar luftën e tyre. Me këtë temë dhe me këta heronj Fishta kishte zgjedhur brumin e vërtetë të epit të ardhshëm kombëtar shqiptar. Në poetikën krijuese Fishta u tregua edhe më i shkathët: ai mori modelin e poetikës së këngës së vjetër epike (*Eposi i Kreshnikëve*) dhe, natyrisht, modelin e poetikës së këngëve të reja epike popullore, të quajtura historike, të gjysmës së dytë të shekullit XIX, e të cilat këndoheshin për heronjtë dhe bëmat e tyre për krijimin e kombit të ri e të lirë shqiptar. Fishta po merrte për model strukturën ndërtimore të tekstit letrar e cila për shekuj me radhë ishte e njohur prej shqiptarit dhe mbi atë poetikë këngëtari popullor kishte krijuar, në dy periudha historike, kryevepra të letërsisë shqiptare: *Eposin e Kreshnikëve* dhe këngën historike.

Historia ka dëshmuar se Fishta kishte zgjedhur drejt.

III. 3. b. Satira: rruga fishtiane

Fishta dallon thelbësisht nga romantikët shqiptarë, përveç në prozedeur letrar dhe në trajtimin e gjinisë letrare, edhe në një çështje: në shkrimin e satirës. Romantikët shqiptarë nuk e kishin kultivuar satirën. Kjo për arsye se stili i tyre himnizues i ligjërimit letrar është në kundërshti të brendshme me diskursin satirik të shkrimit: ta himnizosh një shfaqje apo një personazh dhe ta përqeshësh njëkohësisht janë dy veprime të papajtueshme. Romantikët shqiptarë, edhe kur kanë

dashur të satirizojnë shfaqje e personazhe të ndryshme, e kanë bërë këtë në mënyrë shumë didaktike, përmes fabulave të tipit të Ezopit, La Fontenit etj., pra, duke folur për kafshët e duke aluduar për njerëzit, si ka bërë Naim Frashëri. Ndoshta i vetmi përjashtim nga ky gjykim është poeti shkodran Filip Shiroka (1859-1935), i cili krahas lirikës patriotike botoi në *Albania* të Faik Konicës, në vitet 1896-1903 edhe disa poezi satirike.³⁷⁵

Fishta e botoi në vitin 1907 veprën e tij të parë satirike *Anzat e Parnasit*, e para vepër satirike edhe në letërsinë shqipe.³⁷⁶ Andon Zako Çajupi (1866-1930) ka botuar disa shkrime satirike në librin e tij të parë *Baba Tomorri* (1902), si poezinë e njohur *Fshati im*, ndërsa vepra e rëndësishme satirike *Dhiat' e vjeter e chfacure*, e njohur me titullin *Baba Musa lakuriq*, një parodi prej 6000 vargjesh për ngjarjet e *Dhjatës së Vjetër*, u shkrua rreth viteve 1903-1905³⁷⁷, por nuk u botua për të gjallë të poetit. Çajupi do të shkruajë edhe dy komedi, *Pas vdekjes* dhe *Katërmëdhjetë vjeç dhëndër*, po sikur edhe *Baba Musa lakuriq*, do të botohen pas vdekjes së poetit, në dekadën e tretë të shekullit XX.³⁷⁸

Nuk mund të anashkalohen këtu edhe poezitë satirike të Anton Santorit (1819-1894). Ai ka shkruar disa dhjeta poezi satirike (31 vjersha me 1845 vargje), të përmbledhura në një vepër *Satira*, vepër kjo e pabotuar³⁷⁹ për të gjallë të autorit. Në satirat e tij Santori trajtoi tema e motive nga jeta e përditshme e arbëreshëve, si motive të varfërisë

375 Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, fq. 203.

376 Stefan Çapaliku, *Fishta satirik*, Universiteti i Shkodrës, Shkodër, 1995, fq. 49.

377 Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, fq. 259.

378 *Historia e letërsisë shqiptare* (1989), fq. 387.

379 Frangjisk Anton Santori, *Vepra 1*, Rilindja, Prishtinë, 1993, parathënie e Ka(r)mel Kandrevës e Gjovalin Shkurtajt, në pjesën *Satirat*, fq. 179. Veprën e pabotuar e zbuloi Karmel Kandeva në fshatin Shën Japëk të Qanës (Çerzeto).

e të lypësisë, motivin e egos së sëmurë, ngucakeqësinë, zanatçinjtë mashtrues, çuqurjarinë etj., tema e motive sociale e politike, si pseudo-demokratët etj. Poezitë janë të gjitha në strofa gjashtëshe, kryesisht në tetërrokësh dhe me rimën ABABCC. Por, duke qenë se edhe kjo vepër mbeti e pabotuar për të gjallë të autorit, për herë të parë u botua në vitin 1982 në *Studime filologjike*, nr. 1, 1982, fq. 173-208³⁸⁰, nuk mund të flitet për ndikimet e mundshme në historinë e letërsisë shqipe.

Kështu, vepra e Fishtës mbetet e para vepër satirike e botuar në letërsinë shqipe. Ky fakt ka një rëndësi të veçantë jo vetëm për Fishtën, por edhe për letërsinë shqipe: fillon periudha e një letërsie të artikuluar si zë i një vetëdije kritike dhe zë i protestës ndaj shoqërisë dhe shfaqjeve të ndryshme të saj. Ky model i shkrimit letrar që një ndarje e madhe nga përvoja romantike, por edhe nga përvoja letrare shqiptare në përgjithësi. Satirizimi i fenomeneve dhe i shoqërisë në kohën e De Radës e të Naimit do të ishte i pa marrë me mend. Fishta, bashkë me Çajupin i vënë themelet një gjinie, për më tepër edhe një modeli të ri letrar: satirës dhe mënyrës së shkrimit të saj.

Satira e Fishtës krijoi modelin në satirën shqiptare. Çfarë është kjo satirë?

Derisa himnin dhe ligjërimin lavdërues Fishta e rezervoi për malësorin dhe jetën e tij, temën e satirës ai e mori nga jeta qytetare shqiptare, nga koha kur në shoqërinë shqiptare ndodhte një proces i përgjithshëm i përkufizimit të identitetit kombëtar, social, politik, kulturor e fetar, pra pas formimit të shtetit shqiptar (1912). Për këtë proces të përkufizimit të përgjithshëm është e lidhur një pjesë e madhe e artit

380 Rexhep Qosja, Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi II, Rilindja, Prishtinë, 1984, fq. 199.

fishtian, por edhe një pjesë e shkrimit me diskurs publicistik. Fishta e definoi shqiptarin e asaj kohe, në shkrimin problematik *Arsim apo luftë kundra katoliqizmit në Shqypni?* (1923) si person „veshë në formë oksidentale një mentalitet thjesht oriental e aziatik“.³⁸¹ Pikërisht këtë shqiptar, i ndikuar nga mendësia orientale gjatë pesë shekujve të pushimit osman, i veshur me petkun perëndimor nga dëshira për t’u rikthyer në trungun e vjetër të familjes evropiane, mbas krijimit të shtetit shqiptar, këtë shqiptar me këtë kundërshti të thellë brenda vetes dhe në shoqëri Fishta e bën hero të satirës së vet. Ky shqiptar nuk mund të ishte malësori, sepse atje, në malësi, që të dy proceset, edhe ai i ndikimit oriental, edhe ai i përshtatjes evropiane pas krijimit të shtetit shqiptar, kishin depërtuar shumë pak dhe shumë më ngadalë. Mbishtresat e këtyre ndikimeve vëreheshin më shumë te shtresa e qytetarisë, e paragjykuar më shumë për ndikime, për shkak të karakterit kozmopolit të qytetit. Këtu qëndron arsyeja argumentuese pse Fishta trajtoi në satirën e vet temën qytetare dhe heronjtë qytetarë, trajtoi tema nga elita e shoqërisë. Në shkrimin publicistik *Tash qi asht ba Shqypnija duen perba Shqyptarët* (1930)³⁸² Fishta i vë përballë këto dy botë shqiptare: botën qytetare (heterogjene e proanadollake) dhe botën e malësorit (homogjene dhe puro shqiptare), duke sugjeruar këtë të dytën si bazë për përkufizimin e identitetit të ri shqiptar.

Me këtë temë të satirës Fishta krijoi modelin e satirës shqipe, i cili u bë ndikues shumë më tepër se, ta zëmë, modeli i satirizimit të Çajupit përmes motiveve alegorike biblike te *Baba Musa lakuriq*. Ali Asllani

381 [Gjergj Fishta], *Arsim, a po luftë kundra Katoliqizmit në Shqypni?*, HYLLI I DRITËS, 1923, nr. 7.

382 [Gjergj Fishta], *Tash qi asht ba Shqypnija duen perba Shqyptarët*, HYLLI I DRITËS, 1930, nr. 4.

(1884-1966), një satirik i mëvonshëm vlonjat do të shkruajë kryeveprën e tij *Hanko Halla* (1933)³⁸³ në oktavë njëmbëdhjetërokëshe, me një gjuhë e frazeologji mjaft popullore, me temë qytetare-moskuptimet e brezave të edukuar sipas frymës së vjetër orientale dhe frymës së re perëndimore. Forma poetike e veprës së Ali Asllanit dhe tema janë të përafëruara maksimalisht me satirën e Fishtës.

Epi satirik *Palokë Cuca*. Për epin satirik *Palokë Cuca* (1922) të Fishtës, me 1292 vargje, nuk mund të bëhet një shikim krahasues me traditën letrare shqiptare, sepse para Fishtës nuk ka edhe një vepër tjetër të këtij modeli letrar. Çështje e vërteta, A. Z. Çajupi ka shkruar epin *Dhiat' e vjeter e chfacure*, më e njohur me titullin *Baba Musa lakuriq*, e shkruar më 1903-1905, por e botuar shumë vjet pas *Palokë Cucës*. Edhe *Palokë Cucën* edhe *Baba Musa lakuriq* historianët e letërsisë i quajnë poema satirike³⁸⁴, por më drejt është të quhen epe satirike, për shkak të kuptimeve të ndryshme të nocionit poemë. Epi i Fishtës trajton tema qytetare të Shqipërisë së kohës pas shpalljes së pavarësisë, pra fatin e heroit *Palokë Cuca* dhe familjes së tij që nga gjyshi, përmes një syzheu kundërshtues: ngritja ekonomike e familjes dhe rënia morale e saj në të njëjtën periudhë. Ndërsa Çajupi trajton në mënyrë jokonvencionale tema biblike (mite e motive të Dhjatës së Vjetër) dhe temën shqiptare, duke krijuar një tekst poetik me dy syzhe paralele, ku

383 Botuar fillimisht në gazetën *Minerva*, në vazhdimë që nga numri 6 i vitit 1933, ndërsa si libër më vete në vitin 1942. Shih: Kajtaç Rrecaj, *Ali Asllani-jeta dhe vepra*, Vatra, Shkup, 2000, fq. 14.

384 Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, fq. 259; shih edhe *Historia e letërsisë shqipe* (1989), fq.387.

syzheu i dytë (tema shqiptare) është dytësor, me shkëputje dhe i ndërvarur nga syzheu i parë (tema biblike).

Palokë Cucën Fishta e ka shkruar në strofa tetëshe, me varg njëmbëdhjetërokësh. Në këtë ep Fishta kë realizuar përthekueshëm rrëfimin epik brenda njëmbëdhjetërokëshit në strofën tetëshe, e përdorur për herë të parë në shekullin XIV në epet evropiane. Në këtë strofë Ariosto (1474-1533) ka kënduar *Orlandin e tërbuar* (1516) dhe Tasso (1544-1595) *Jerusalem in çliruar* (1575). Edhe me këto forma poetike Fishta ka krijuar bazën e konfliktit satirik: me format poetike të epeve heroike, me vargun heroik dhe me strofën e njohur në të cilën janë kënduar bëmat madhështore të heronjve krishterë të romantikëve evropianë, Fishta këndon bëmat mjerane të heroit të vet komik Palokë Cuca.

Duke qenë se epi *Baba Musa lakuriq* i Çajupit është botuar shumë më vonë pas vdekjes së poetit, pavarësisht nga fakti se kur është shkruar, nuk mund të trajtohet si “traditë” letrare parafishtiane, kështu që edhe krahasimet e *Palokë Cucës* me të i përmbyllim vetëm me këto të dhëna sipërfaqësore, duke theksuar faktin se epi satirik *Palokë Cuca* nis një model të ri shkrimi në letërsinë shqipe, bashkë me *Baba Musa lakuriq* të Çajupit, pasohen më vonë nga Ali Asllani (1884-1966) dhe poema e tij *Hanko Halla* (1933), nga Shevqet Musaraj (1914-1986) dhe poema e tij *Epopeja e Ballit Kombëtar* (1944, botimi i plotësuar më 1948), edhe pse kjo e fundit më shumë i ngjan një pamfleti poetik.³⁸⁵

Fatkeqësisht Fishta nuk e ka përfunduar epin *Palokë Cuca*. Në strofën 3 ai thotë:

Kam da me kndue per t'kshtenë, per turq e shkje,

385 “Të gjitha këto i japin veprës së Musarajt tiparet e një pamfleti poetik.” Shih në: Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist, ASH e RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1978, fq. 37.

si Palokë Cuca leu, si rrnoj, si diq,
si per Aydhe guksoi, si u orvat per...fiq.³⁸⁶

Pavarësisht prej paralajmërimit se do të këndojë për jetën e Palokë Cucës, ashtu siç sugjeron edhe vetë titulli i epit, vepra këputet me shkuarjen e Palokës së vogël në shkollë. Nëse vazhdojmë deri te përfundimi mbi argumente logjike, pjesa e shkruar e epit paraqet vetëm fillimin e një projekti më të gjerë satirik të Fishtës, të cilin ai nuk e realizoi, edhe pse në fillimet e veta letrare ai besonte se do të bëhej i madh në satirë e jo në epin nacional. Por, në anën tjetër, sa do i papërfunduar, 1292 vargjet e tij paraqesin një letërsi kulmore satirike, jo vetëm në letërsinë shqipe, por edhe më gjerë.

Gomari i Babatasit: vepër polemiste apo roman në vargje? Fishta do të krijojë edhe një model të ri në letërsinë satirike: modelin e romanit në vargje, me *Gomarin e Babatasit* dhe *Viskun e Babatasit*.

Gomari i Babatasit (1923) dhe *Visku i Babatasit* (1924-1994) janë dy libra të Fishtës, të shkruar në kohë të njëjtë dhe të botuar në kohë të ndryshme. I pari, *Gomari i Babatasit* është shkruar dhe botuar në vitin 1923, jo me emrin e vet, por me pseudonimin Gegë Toska. Libri i dytë *Visku i Babatasit*, ka dy pjesë dhe është shkruar në vjeshtën e vitit 1924³⁸⁷ dhe botuar pas vdekjes së autorit.³⁸⁸

386 Gjergj Fishta, *Satirika / Palokë Cuca*, Kangë e parë, 3.

387 Stefan Çapaliku, *Fishta satirik*, fq. 94.

388 Botimi i parë është bërë nga HYLLI I DRITËS, Tiranë, 1994. Shumë më vonë Fishta shkruan:

“Pjesa e parë asht publikue në 1923, e mijsha e parë kje perpi në katër ditë. Pjesa e dytë, ma realiste tue kenë, per arsye urtijet, der më sot ende nuk asht botue...”

Shih: *Fishta, Estetikë dhe kritikë*, fq. 194.

Siç e kanë vërejtur edhe studiuesit, edhe pse janë dy tituj të dy librave, ata paraqesin një vepër. Edhe në *Bibliografinë* e Benedikt Demës, te pjesa 4. Vepra të pabotueme t'A. Gj. Fishtës, në numrin rendor 26 shkruan: Gomari i Babatasit. Pj. II e III (vetëm e fillueme). Kështu, duke qenë një vepër është e udhës që ajo të quhet *Gomari i Babatasit*, e përbërë prej tri pjesëve, pjesa e tretë është e papërfunduar. Është e udhës që edhe në botime të kihet parasysh ky fakt.

Çështja tjetër që duhet trajtuar ka të bëjë me zhanrin: a është vepra “poem dramatik” dhe „poem satyrik në trajtë dramatike“ (Fishta)³⁸⁹, “tekst i dramatizuar e jo tekst dramatik” (Hamiti)³⁹⁰ apo “satirë politike” (Plasari)³⁹¹, “poemë satirike...në formë dramatike” (Çapaliku)³⁹²? A përkon teksti letrar me shprehjen lirike, rrëfimin epik apo me dialogun dramatik? Apo është, sipas konceptit modern të shekullit XX një bashkëjetesë natyrash të ligjërimin, siç pretendon Plasari ta shpallë *Gomarin e Babatasit* kur flet për karakteret e personazheve dhe rrëfimin e esencave të tyre e jo të gjërave anësore?³⁹³ Apo kemi të bëjmë edhe këtu me „karakterin e vet të përzier gjinor“³⁹⁴, që është një karakteristikë për veprën dramatike të Fishtës?

Karakteret e personazheve të *Gomarit të Babatasit* nuk janë të tërësishtëm, ata janë skematikë, të paracaktuar për një vijë karakteri dhe

389 Në nëntitull të veprës së vet Fishta shkruan “Poem dramatik”; shih: Gjergj Fishta, *Satirika / Gomari i Babatasit*, Rilindja, Prishtinë, 1997, fq. 249. Ndërsa në një shkrim të mëvonshëm e shquan veprën e vet edhe si “poem satyrik në trajtë dramatike” (shih Fishta, *Estetikë dhe kritikë*, fq. 194).

390 Sabri Hamiti, *Studime letrare*, fq. 246.

391 Aurel Plasari, *Moderniteti i një satire klasike*, parathënie në Fishta, *Satirika*, Rilindja, 1997, fq. 16.

392 Stefan Çapaliku, *Fishta satirik*, fq. 77.

393 Aurel Plasari, *Moderniteti i një satire klasike*, fq. 19.

394 Sabri Hamiti, *Studime letrare*, fq. 239.

përfundojnë të tillë. Ata nuk kanë dy e më shumë cilësi: personazhi i Fishtës në këtë vepër ose është demagog, ose është servil, ose është mashtrues, ose turkoshak, ose është trutharë etj. Siç ka vënë re me të drejtë Plasari, kjo nuk e zhvlerëson satirën e Fishtës.³⁹⁵ Ky konstatim na çon te modeli satirik i Fishtës. Përqendrimi në një vijë karakteri, në një situatë apo në një karakter të njëanshëm dhe shndërrimi i këtij karakteri a situatë në bosht të veprës, ky është modeli krijues i Fishtës në satirë. Kjo, madje, e rrit vlerën e veprës, sepse teksti letrar përfundon jo vetëm si një satirë e zakonshme, por si parodi, si mohim absolut i së keqes, si përbuzje e përgjithshme, si sarkazmi më i lartë.

Karakterizimi i personazhit vetëm në një vijë karakteri është model krijues e jo dobësi e Fishtës. Ky model krijimi ia mundëson Fishtës mohimin e përgjithshëm që i bën të keqes. Fund e krye, satira e Fishtës mbërrinë këtë shkallë sarkazmi, mohimi e parodizimi të përgjithshëm.

Problemet me personazhet e Fishtës në *Gomarin e Babatasit* shfaqen në dy forma të tjera: ato janë personazhe të shpifura, që flasin shpesh gjëra të shpifura (të panatyrshme me karakterin e tyre) dhe, dy, ato janë nganjëherë në kundërshtim me natyrën e karaktereve të tyre. Në formën e parë, personazhet e *Gomarit të Babatasit* janë kukulla të autorit dhe jo karaktere, deklamojnë konceptet e autorit dhe si të tilla nuk ndihmojnë krijimin e një rrjedhe logjike në vepër. Kështu psh., le të parafrazojmë, derisa Ministria e Arsimit është fund e krye e zezë, sepse është e krijuar prej një ministri të zi, i cili ka punësuar farefis etj. etj., Drejtori A dhe Drejtori B, që janë pjesë e kësaj ministrie (madje janë aq të klishezuar saqë as emra nuk kanë; janë serikë: thjesht A dhe B!) mendojnë zi dhe flasin zi për ministrinë ku punojnë dhe për konceptet

395 Aurel Plasari, *Moderniteti i një satire klasike*, fq. 20.

politike për arsimin të asaj ministrie. Ata flasin kundër vetvetes, flasin dhe kuptohen mjaft mirë me Babatasin, që është personazh i kundërt i Ministrisë. Ndërsa, në formën e dytë, atëherë kur personazhet flasin gjëra që janë në kundërshtim me karakterin e tyre, edhe pse shfaqen më rrallë, megjulohet shkalla e sarkazmit dhe serioziteti i tij. Kështu, p.sh., kamerieri Koçua flet me të njëjtën gjuhë intelektuale si të Babatasos për qeverinë dhe ministrat. Ndoshta, shembulli më i mirë për formën e dytë është koncepti i Babatasit për mediat, i deklamuar në dy vende të ndryshme, që është në kundërshtim me të parin. Në rastin e parë, mediat për pushtetin diktatorial janë:

...i armë e fortë. Zotni,

Shtypi asht sod një artiljeri,

Qi, si puna e ban dishmi,

Rreh ma larg e ushton ma thekshim

Edhe rreposë fort ma termegshim

Se ç'do top e ç'do gopeder.

Jo, po, shtypi asht një kulsheder

Vetëm për Qevri autokrate.³⁹⁶

Ndërsa në rastin e dytë poeti i bën gazetarët krejt të pa dije:

Asht tuj shkruar çdo matrahul,

Çdo surrat-qerep krye-tul:

Nierz rrugaça e krejt batalla,

me dyë faqe porsisalla,

qi dbue jashtë prej shkollës fillore,³⁹⁷

396 Gjergj Fishta, Satirika / Gomari i Babatasit, fq. 312.

397 Gjergj Fishta, Satirika / Gomari i Babatasit, fq. 315.

Gomari i Babatasit nuk ka një koherencë as në format e ligjërimit. Shfaqet aty rrëfimi epik, shprehësia lirike dhe dialogu dramatik, por asnjëri nuk mbizotëron, për t'i dhënë veprës një formë themelore të gjinisë. Në prolog të veprës autori paralajmëron temën e veprës, metamorfozën e një gomari³⁹⁸, jep argumentet dhe kundërgargumentet për temën e tillë etj. dhe kështu paralajmëron një vepër epike satirike. Në pjesën e parë fillimi të duket si i një romani në vargje: dialogu midis Ministrisë dhe Babatasit. Shumë shpejt Fishta fillon manipulimin me personazhet për interes të koncepteve të veta dhe aty ma nuk ka rrëfim as veprim, nuk ka syzhe të një ngjarjeje a të një ndodhie, të një personazhi. Personazhet e Fishtës fillojnë të shpalosin koncepte programore të Fishtës në lidhje me politikën arsimore të Ministrisë së Arsimit dhe të parodizojnë me këto politika, duke i stigmatizuar si jo-qtetëruese. Teksti letrar, në këto raste, është deklamim i koncepteve, e që si formë ligjërimit afrohet me lirikën. Vetëm në pjesën e tretë të *Gomarit të Babatasit* fillon veprimi dhe ndodhin ngjarje, për t'u rishfaqur vetëm edhe një herë në fillimin e Aktit të dytë të *Viskut të Babatasit* (Neoshqiptarët).

Pavarësisht nga tema bosht e paralajmëruar (metamorfoza), ajo rri gjithmonë në prapaskenë dhe vepron si sfondi në pikturë. Në vepër flitet (deklamohet, shkoqitet, shprehet) për:

Laicitetin e rrejtshëm të pushtetit; të metat e shkollave laike shtetërore; qëllimet e këqija të qeverisë kundër shkollave fetare, në veçanti kundër shkollave katolike; fodullëku i qeveritarëve; demagogjia e qeveritarëve në emër të oksidentalizmit dhe orientalizmit; mendësia turkoshake; të kuptuarit e shtetit e pushtetit për interesa personale; patriotizmi i rre-

398 Motivin Fishta e merr prej Lucius Apuleus Metamorfoza ose Gomari i Artë.

jshëm (e motive të tjera në pjesën e parë), dhe: mentaliteti anadollak në pushtetin e Shqipërisë, mbizotërimi i interesave personale të demagogëve mbi interesat e përgjithshme të shoqërisë etj. (në pjesën e dytë).

Si rezultat apo pasojë e këtyre mendësive, ata që mbajnë anën e qeverisë shndërrohen në gomarë, ndërsa ata që kundërshtojnë qeverinë mbesin patriotë të ndershëm, si Babatasi. Ky është dënimi i poetit.

Por, ajo që është në interes tonin tashti, është fakti se asnjë prej këtyre motiveve nuk realizohet përmes personazheve, përmes ngjarjeve, përmes situatave apo karaktereve që zhvillohen. Realizimi ndodhë si shprehje e koncepteve, e bindjeve, e prirjeve e dëshirave, e ndjenjave... të poetit, i cili flet me gojën e personazheve. Kjo vepër ka një syzhe krejt të varfër (nuk është vepër pa syzhe) dhe mungesa e ngjarjeve, rrëfimeve dhe e karaktereve përmbushet me shkoqitje të koncepteve të ndryshme morale, fetare e sociale.

Në formën e vet letrare, vepra edhe pse ka tipare dramatike, epike e lirike, rri më afër formës së romanit të idesë në vargje. Edhe ky shënjim i fundit nuk i rri *Gomarit të Babatasit*. Edhe S. Çapaliku thotë se “forma epike sundon (...) si instrumente që ndërtojnë aksionin dhe konvencionet epike”³⁹⁹

Syzheu i varfër i *Gomarit të Babatasit* fillon me shkasin e botimit të dy artikujve në dy revista: *Rivista pedagogjike* dhe *Vllaznija*. Këta dy artikuj janë një kritikë dhe parodi për disa qëndrime të gazetës *Hylli i Dritës*, botuar prej fretërve françeskanë dhe ndaj një broshure në të cilën kundërshtohet politika e qeverisë për ndalimin e shkollave pri-

399 Stefan Çapaliku, *Fishta satirik*, fq. 148.

vate fetare në Shqipëri.⁴⁰⁰ Në këtë zinxhir kundërshtish zë fill tema e *Gomarit të Babatasit* dhe mbi këto ide zhvillohet krejt vepra.⁴⁰¹

Në një shkrim të mëhershëm *Arsim a po luftë kundra katoliçizmit?* (1923) Fishta kishte afishuar katërçipërisht kundërshtitë e veta ndaj vendimit të qeverisë së Shqipërisë për ndalimin e shkollave fetare private. Aty ai kishte gatuar tezat dhe kundërtezat e veta në polemikën e ashpër me qeverinë, të cilën nuk heziton ta akuzojë se po bënte një luftë kundër katolikëve të Shqipërisë dhe katolicizmit dhe se në emër të oksidentalizmit po luftonte parimet themelore të kulturës perëndimore nga bazat e kulturës e mendësisë orientale e turke, se vetëm kultura katolike në Shqipëri paraqet vazhdimësi të kulturës perëndimore, se vetëm katolikët kishin qenë brumi i luftërave kundër pushtimit osman e deri edhe te teza për ndarjen administrative, politike e fetare të Shqipërisë në kantone (kantoni katolik, ai mysliman dhe ai ortodoks).

Pa dashur të trajtojmë qëndrueshmërinë e këtyre argumenteve në aspektin historik, në aspektin letrar këto argumente janë bartur nga ky shkrim publicistik në veprën *Gomari i Babatasit*. Vepra është e mbrujtur fund e krye me shkoqitjen e këtyre argumenteve, vetëm se tash të thëna përmes gojës së personazheve kukulla të autorit. Kjo shkoqitje e këtyre argumenteve e përbën atë që quhet syzhe i veprës. Nga kjo,

400 Për këtë, shih artikujt publicistikë të Fishtës: *Kisha katolike ka trajtue kulturën oksidentale* (1923), *Arsim apo luftë kundra katoliçizmit në Shqipëri?* (1923), *Ipeshkvijt e Shqipërisë e çashtja e zgjedhjeve* (1923). Të gjitha të ribotuar në: *Fishta, Përndritje* (2000).

401 Për gjenezën e problemeve, moskuptimeve dhe koncepteve të ndryshme e të kundërta jashtëletrare, që kanë nxitur Fishtën të shkruajë *Gomarin e Babatasit* shih te Stefan Çapaliku, *Fishta satirik*, fq. 78-82 e tutje. Këtë temë Fishta nuk e mbyllë as me *Gomarin e Babatasit* e as në kohën kur ndodhin këto polemika. Dhjetë vjet më vonë, më 1933, ai do të shkruajë artikuj publicistikë mbi këtë temë dhe po me këto argumente e me këtë patos, si *Indipendenca morale e Shqipërisë, Lajçizmi në Prendim?* etj.

sa u tha për gjenezën e polemikës, që përbën brumin edhe të veprës *Gomari i Babatasit*, mund të përfundojmë se kjo polemikë e ashpër ishte vazhduar nga gazetat në libra dhe nga publicistika në letërsi. Si e tillë, vepra më drejt mund të quhet një vepër polemiste sesa një poemë dramatike apo edhe një roman i idesë në vargje. Përveç sa u thanë, në vepër ka edhe një varg fragmentesh të tjera që flasin në favor të këtij përfundimi. Janë disa detaje që nuk janë të denja për asnjë lloj të lirikës e as të një vepre letrare, po janë të denja për veprat polemiste. I tillë është detaji kur Babatasi, duke e akuzuar qeverinë për shpërdorim të parave të popullit, flet për një zotëri të emëruar bibliotekar në Këshillin Kombëtar, ia përmend rrogën sa e ka, e gjykon se vetëm quhet ekspert po nuk është i tillë dhe përfundon se në Këshill Kombëtar nuk gjen një libër për be e lëre më një bibliotekë⁴⁰², ose, Fishta, përmes Babatasit, polemizon me deputetin Kolë Thaçi.⁴⁰³ Edhe Sabri Hamiti e shquan dallimin e kësaj vepre nga një dramë e vërtetë apo nga një satirë e vërtetë, por për të njëjtat shkaqe që u përmendën deri më tash edhe e emëron “satirë me thekse militantizmi.”⁴⁰⁴

Pavarësisht nga dilema nseë është *Gomari i Babatasit* dhe *Visku i Babatasit* vepër satirike apo vepër polemiste, edhe me këtë vepër, por sidomos me veprat e tjera satirike, Fishta krijoi modelin e satirës në letërsinë shqipe. Ky model qëndron në format poetike (epi satirik dhe poema satirike, strofa tetëshe dhe njëmbëdhjetërrokëshi) dhe në tematikën e satirës (tema qytetare dhe satira politike). Dy bashkëkohës më të vonshëm të Fishtës që lanë emër në satirë janë Fan Noli (1882-1965),

402 Gjergj Fishta, *Satirika / Gomari i Babatasit*, fq. 289.

403 Gjergj Fishta, *Satirika / Gomari i Babatasit*, fq. 296-298.

404 Sabri Hamiti, *Studime letrare*, fq. 246.

i cili ndoqi modelin e Çajupit dhe Ali Asllani (1884-1966), i cili ndoqi modelin e Fishtës.

III. 3. c. Tekstet dramatike-dy modele të dy shkollave letrare

Duke përvetësuar nocionin e Sabri Hamitit „tekste dramatike“ për veprat dramatike të Fishtës, si nocion që dallon nga drama e vërtetë, qoftë për shkak të përzierjes së gjinive letrare në një shkrim letrar, qoftë për shkak të syzheut të varfër apo të tipit të ligjërimit⁴⁰⁵, mund të konstatohet fillimisht se Fishta me dramën e tij nuk i dha letërsisë shqipe vepra kulmore e as krijoi modele shkrimi. Si të tilla ato tekste kanë rol të rëndësishëm për të plotësuar mozaikun fishtian dhe për të hetuar lidhjet e Fishtës me traditat letrare, jo vetëm shqiptare, por edhe më gjerë. Dy tekstet e tij dramatike, tragjeditë *Juda Makabe* (1920) dhe *Ifigenija n'Aulli* (1931) janë dy veprat ku kthjellueshëm mund të dallohet ndikimi romantik dhe ndikimi klasicist në veprën e Fishtës.

Juda Makabe (shkruar më 1911-1914, botuar më 1920). Tragjedia *Juda Makabe* trajton temën e luftës për atdhe dhe temën e tradhtisë ndaj atdheut me motive e heronj të marrë prej *Biblës*. Juda Makabe është personazh biblik dhe historik, udhëheqës i hebrenjve në vitet 166-152 p. K. Në tragjedinë e Fishtës ai i prinë ushtrisë hebreje në luftë kundër asirëve, të udhëhequr nga Bakidi. Një nga prijësit hebrej, Alkimi, tradhton atdheun dhe lidh marrëveshje me asirët. Ushtria e Makabeut shkapërderdhet, ajo që mbetet lufton me këmbënguljen e Makabeut, derisa vriten deri te ushtari i fundit. Pikërisht mbi këtë luftë vetëmohuese të Makabeut dhe tradhtisë së Alkimit, Fishta i ndërton

405 Sabri Hamiti, Studime letrare, fq. 239.

idetë e veta poetike dhe mesazhet: himnizon Judën Makabe dhe ushtarët e tij trima dhe mallkon tradhtinë e Alkimit.

Tragjedia nuk ka syzhe të ndërtuar përmes veprimit të personazheve dhe konfliktit dramatik. Syzheu më tepër supozohet mbi bazë të faktit të njohur historik sesa që krijohet në tekstin letrar. Konflikti dramatik hetohet në tekstin letrar vetëm kah fundi i tragjedisë, atëherë kur mësohet tradhtia e Alkimit. Syzheu i tragjedisë më tepër zhvillohet si deklaram, vende-vende shumë i afërt me ligjërimin lirik. Tragjedinë e mbisundon bota e emocioneve. Heronjtë përdalohen mbi bazë të botës shpirtërore, kryesisht në dy grupe, në patriotë dhe në tradhtarë.

Vetë Fishta ka qenë i vetëdijshëm për këto mungesa të tragjedisë. Në një letër për Atë Pal Dodajn, dorëshkrim i vitit 1911, duke folur për tragjedinë ai thotë:

„Sod mbaroj aktin e parë, e megjithse nuk asht edhe aq me akcjon, siç shpresoj me ken ato n’vijim, në tansi mund t’pelqehet“.⁴⁰⁶

Tema biblike, motivi i luftës deri në flijim për atdheun në kundërshtim me tradhtinë ndaj atdheut, karakteret emocionale të heronjve, vargu tetërrokësh i përdorur shpesh, forma poetike e poezisë, të gjitha këto janë karakteristikat kryesore që e bëjnë këtë tragjedi me frymë thellësisht romantike dhe një vepër të pastër romantike.

Ifigenija n’Aulli (botuar në vazhdime më 1930 te *Hylli i Dritës*, ndërsa më vete më 1931). Tragjedia *Ifigenija n’Aulli* trajton temën e konfliktit midis interesit të shtetit (polisit) dhe individit, sipas modelit të Euripidit, me motivin e njohur të therorizimit të bijës

406 Gjergj Fishta, *Estetikë dhe kritikë*, fq. 201.

nga i ati për qëllime të shtetit. Kjo temë është e marrë prej tragjedisë së Euripidit me të njëjtin titull, i cili e kishte marrë nga mitologjia e vjetër helene. Te Fishta, sikurse te Euripidi, syzheu përqendrohet me therorizimin e Ifigenisë, akt të cilin e bën i ati Agamemnoni, për t'i shkuar mbarë fushata e pushtimit të Trojës. Fishta e përfundon syzheun në atë mënyrë që Ifigenija kur e kupton domosdoshmërinë e flijimit flijohet me vullnet, duke qenë e bindur se po bën një punë të rëndësishme për atdheun. Këtë veprim të Ifigenisë Fishta nuk arrin ta motivojë e ta argumentojë, por e bën artificialisht. Fishta e mbyllë tragjedinë pa e përfillur përfundimin që i jep Euripidi përmes *deus ex machina*, duke e zëvendësuar Ifigeninë me një dre. Te Fishta Ifigenija nisat kah thertorja, ku do të bëhet fli, e vetëdijshme se kështu po u shërben qëllimeve të atdheut.

Fishta e ndërton syzheun e tij mbi bazën tradicionale të konfliktit midis arsyes së shtetit (veprimi i Agamemnonit për ta flijuar të bijën) dhe arsyes së individit (vullneti i Ifigenisë për të jetuar), mbi të cilin konflikt triumfon arsyeja e shtetit (vetëdijesimi i Ifigenisë se përmes flijimit po i shërben qëllimeve të atdheut). Kjo bazë e konfliktit social e politik thjeshtësohet në tragjedinë e Fishtës në konflikt të nderit ndaj atdheut. Në tragjedi ka mundur të ndodhte një krim, vrasja e bijës nga i ati, por nuk ka ndodhur, sepse me vetëdijesimin e Ifigenisë për nevojat e atdheut, ajo sakrifkohet vullnetarisht. Edhe te Fishta, sikurse te Euripidi, ngadhënjimi i arsyes së shtetit mbi arsyen e individit është do-

mosdoshmëri, por që mund të rezultojë me vetëflim, apo edhe më keq-me krim dhe tragjedi.⁴⁰⁷

Për dallim nga shumica e teksteve dramatike të Fishtës, kjo tragjedi ka konflikt dramatik, ka syzhe të ndërtuar përmes vepërimit dhe deklamimit të heronjve dhe ka karaktere të motivuara. Situatat dramatike janë shumë më të artikuluar se në tekstet e tjera dramatike, siç janë vullneti i akejve për luftë dhe vullneti i Ifigenisë për të jetuar.

Tema nga mitet antike, tema kosmopolite, tema e konfliktit të arsyes së shtetit me arsyen e individit-temë kjo shumë e dashur për poetët e dramaturgët antikë helenë, motivi i therorizimit të së bijës nga i ati për nevoja të shtetit, vargu njëmbëdhjetërokësh i përdorur shpesh, të gjitha këto janë karakteristikat kryesore që e bëjnë këtë tragjedi me frymë thellësisht klasiciste dhe një vepër klasiciste.

Duke qenë *Juda Makabe* një tragjedi romantike dhe *Ifigenija n'Aulli* një tragjedi klasiciste, këto dy vepra nëse jo për tjetër, janë të rëndësishme për të parë shpirtin romantik dhe mendjen klasiciste të Fishtës se si kanë bashkëvepruar gjatë tërë harkut letrar të tij.

III. 3. d. Lirika

Duke qenë se Fishta nuk përfillë përfundimisht rregullat e gjinive letrare, lirikën e tij e gjejmë jo vetëm te lirika patriotike e *Mrizit të Zanavet* (1913), te lirika fetare e *Pika voëset* (1909) dhe

⁴⁰⁷ Një krahasim interesant mund të bëhet me këngën legjendare shqiptare për Rozafatin, ku për arsyen e shtetit duhet sakrifikuar individi dhe këtë sakrificë gruaja e pranon vullnetarisht.

Valles së Parrizit (1925), por edhe në shumë vepra të gjinive të tjera, si *Jerina, ase Mbretnesha e lulevet* (1941), në shumë tekste dramatike etj.⁴⁰⁸ Nga aspekti i formave poetike dhe nga aspekti i shkrimit si model letrar, me lirikën e tij Fishta nuk sjell asgjë të re në letërsinë shqipe. Ai dallon nga tradita në aspekte të tjera, si: shprehësia poetike e afërt me frazeologjinë popullore, stili individual poetik, nga sjellja e disa motiveve të reja patriotike në poezinë shqipe, kultivimi me shumë sukses i lirikës fetare etj.⁴⁰⁹ Duke qenë lirika, për nga natyra e saj, më e lidhur me autorin, më shprehëse e mendimeve e ndjenjave të tij personale, edhe lirika e Fishtës, sado e liruar nga subjektivizmi, përmban në vete të gjitha karakteristikat krijuese të Fishtës, si në format poetike, ashtu edhe në botën e temave e të ideve poetike. Lirika e Fishtës, në format poetike, është klasiciste, ndërsa në idetë poetike e në motive është tërësisht romantike. Pjesa më e madhe e lirikave të Fishtës janë të fazës së parë të krijimit të tij, kryesisht të para viteve të njëzeta. Por, ky ndikim i fuqishëm i dy rrymave letrare, klasicizmit dhe romantizmit, do të hetohen edhe në veprat e tij të mëvonshme, deri në fund të jetës së tij.

Ndikimi i fuqishëm klasicist dhe romantik te i njëjti poet duket një argument paradoksal, për më tepër edhe jo i saktë. Por, Fishta na e ka zgjidhur këtë pasaktësi: prej klasicistëve ai merr format poetike, ndërsa prej romantikëve merr idetë poetike. Pasaktësia humbet, por mbetet paradoksaliteti.

408 Lasgush Poradeci ka shkruar esenë e njohur Gjergj Fishta lirik, në të cilin heton lirizmin e Fishtës ajo vetëm në lirikë, por edhe në epikë. Shih në JETA E RE, nr. 11-12, Prishtinë, 1990, fq. 1546-1561.

409 Më gjerësisht lirikën e Fishtës e kam trajtuar në librin *Lirika e Fishtës* (2004).


III.3.e. Çështje të llojit të tekstit letrare

Krahasimi i idesë poetike dhe i figurës karakteristike të secilit prej tre poetëve më të mëdhenj të traditës, De Radës, Naimit dhe Fishtës i paraqet më së miri dallimet e tyre në tekstet letrare, të cilat derivojnë prej dy të parave:

Autori	Ideja poetike	Figura apo simboli karakteristik	Teksti poetik
De Rada	Shqipëria historike	Skënderbeu (simboli)	Ish mesditë edhe vallja, të hareshme, e pa kujdesje, si t'ish gjallë koha e pleqve, e gjet shtëpinë krenare të Gjonit të Kastriotëve. Mbi fron të pruar rrinte nusja, e bija e Aranitit, shqepzëngritur përmbi ballë, nga shkrepnin keqzat e gërshetat: Zonja e bujarisë s'Arbrit kryelartë e ndjente veten tek kujtonte se kish burrë Prijësin e kalorësve. Serafina Topia Libër i katërt, Kënga e parë
Naimi	Shpirti i shqiptarit	Shqipëriza (litota)	Kruj' o qytet i bekuar! Prite, prite Skënderbenë, Po vjen si pëllump i shkruar, Të shpëtonjë mëmëdhenë... Istori e Skënderbeut Kënga VI

Fishta	Shqipëria e madhërishme	Shqiptari kreshnik (hip-erbola)	<p>Aman, Zot! kur Osja mrrini Si re breshni kres s'njaj vrrini, Me tridhet e disa burra, E zateti neper curra, Se ç'kje ndezun flakë Vranina! Aty qiellë ma nuk u pa, Aty pushkë ma nuk u da;</p> <p>.....</p> <p>Porsi breshni vite plumja: Jitshin gjindja neper kneta, Neper kneta-e neper mreta Tue rektue per nana t'veta!</p> <p style="text-align: right;">Lahuta e Malcis Deka</p>
--------	-------------------------	---------------------------------	--

Ky krahasim i shfaqjeve të njëjta, nëpër shkallë të njëjta krahasuese, të tre autorëve të mëdhenj rezulton lidhjen e drejtpërdrejtë brenda një teksti poetik të idesë poetike, të figurës karakteristike dhe të stilit ligjërimit. E paraqitur grafikisht kjo lidhje do të dukej kështu:



Në këtë rast lidhja vjen nga njëshi te dyshi dhe nga njëshi e dyshi të treshi. Ekziston një lidhshmëri e fortë midis idesë poetike apo temës së tekstit poetik dhe figurës kryesore të një autori, dhe të dyja këto lidhen drejtpërdrejt me stilin ligjërimit apo me modelin e të njëjtit tekst poetik. Ne po shprehemi këtu me fjalën lidhje, ndërsa mund ta përdorim edhe fjalën varshmëri të lirë. Në fakt, te tre poetët e mëdhenj të romanizimit shqiptar kjo lidhje shprehet si varshmëri e lirë, pra dyshi është i varur nga njëshi, ndërsa treshi nga dyshi e njëshi.

Natyrisht, një lidhshmëri e tillë, apo një varshmëri e tillë e pastër poetike shfaqet vetëm te poetët e mëdhenj dhe jo te secili poet.

PËRFUNDIME

Në përdorimin e formave poetike dhe të vargut poetik Fishta është një prej poetëve më të pasur shqiptarë. Në këto forma poetike dhe në metrikë ai është klasikist i disiplinuar. Edhe në përdorimin e tetërrokëshit popullor shqiptar ai është klasikist i disiplinuar. Fishtën e kanë cilësuar me të drejtë mjeshtër të vargut. Ai, sidomos, shkëlqen me njëmbëdhjetërrokëshin satirik, si te otava rima e *Palokë Cucës*. Rrallë mund të gjendet në historinë e letërsisë shqipe një rrjedhë aq ritmike e rrëfimit epik, si në epin *Palokë Cuca*. Format e reja poetike, eksperimenti me vargje e me forma janë krejt të huaja për të. Ai dhe Naim Frashëri, i cili është eksperimentuesi më i madh nga poetët e traditës, janë dy botë tërësisht të ndryshme në këtë aspekt. Fishta është i afërt, për të mos thënë krejt i afërt me shkollën shkodrane të poezisë, të nisur që nga Leonardo de Martini, Pjetër Zarishi, Ndue Bytyçi, Kolë Thaçi etj. dhe të vazhduar edhe nga bashkëkohësit e Fishtës, si: Ndre Mjeda, Luigj Gurakuqi, Filip Shiroka etj.

Në figuracionin poetik Fishta shkëlqen me krahasimin, me antitezën, me metaforën dhe me epitelin. Në këtë studim nuk i kemi shqyrtuar të gjitha figurat poetike të Fishtës, po vetëm ato që e dallojnë atë apo e njëjtësojnë me traditën letrare shqiptare. Kështu, Fishta dallon për ndërtimin e fuqishëm të strukturave të gjera të krahasimit, të cilat i quajtmë krahasim i zgjeruar, ndërsa antiteza është figura më personale e Fishtës, e shndërruar gati në një model shkrimi. Hiperbola dhe antonimi i saj litota janë shqyrtuar

për të theksuar dy botët e ndryshme të Naimit e të Fishtës dhe misionin që kryen arti i tyre.

Në fushën e gjinive letrare Fishta është po ashtu klasicist: ai shkruan lirikën, epin, satirën dhe dramën. Edhe pse ai i ka njohur fare mirë rregullat klasiciste për gjinitë letrare, në shumë vepra të tij ai i përziën parimet themelore të gjinive letrare. Edhe vetë autori është i vetëdijshëm për këtë fakt, prandaj shumë vepra të tija ai i nëntitullon vetë, si poem dramatik, poem melodramatik etj. Në historinë e letërsisë shqipe Fishta mbetet nismëtar i satirës. Ai arrin me sukses të krijojë modelin e shkrimit të satirës, satirën qytetare dhe satirën politike, e cila do të ndikojë satirikët e mëvonshëm, drejt ose tërthorazi. Me epin *Lahuta e Malcis* Fishta nuk do të ndikojë poetët e mëvonshëm, por do ta përmbyllë një shekull përpjekjesh të poetëve të tjerë, si De Rada, Gavrill Dara i Riu, Naim Frashëri dhe Zef Skiroi, për të shkruar epin nacional shqiptar. Fishta është poeti i fundit në Evropë që shkroi epin nacional, një formë poetike kjo historike dhe për kohën kur Fishta e shkroi *Lahutën e Malcis*.

KREU I KATËRT

KONCEPTET ESTETIKE TË
FISHTËS DHE TRADITA
E MENDIMIT ESTETIK
SHQIPTAR

HYRJE E SHKURTËR PËR MENDIMIN ESTETIK SHQIPTAR

Është shumë i luhatshëm emërtimi „mendimi estetik shqiptar“ përpara shekullit XX. Jo vetëm për shkak të shfaqjes së vonshme të mendimit estetik në literaturën shqipe, por më tepër për shkak të mungesës së traktateve estetike të autorëve shqiptarë. Shqyrtimi i kategorive të estetikës ka filluar në kulturën evropiane me filozofët antikë grekë, pikërisht me Platonin e Aristotelin, por si disiplinë më vete është themeluar me filozofin gjerman A. G. Baumgarten (1714-1762), fillimisht në shkrimet *Disa gjëra në lidhje me poezinë* (1735) e pastaj në veprën kryesore të tij *Aesthetica* (1750).⁴¹⁰ Në historinë e literaturës shqipe Pjetër Bogdani i pari ka trajtuar disa çështje të estetikës.⁴¹¹ Traktati i parë “i mirëfilltë estetik shqiptar” është *Parime të estetikës* (1861) i De Radës⁴¹², edhe kjo e shkruar në italisht.⁴¹³ Sado shkrimtarë e filozofë shqiptarë kanë trajtuar pas De Radës çështje të ndryshme të estetikës, deri në gjysmën e dytë të shekullit XX nuk janë shkruar traktate origjinale estetike, pavarësisht se në gjysmën e parë të shekullit XX pati disa libra për çështje të ndryshme të teorisë së letërsisë, si *Vargnimi në gjuhën shqipe* (1906) i Luigj Gurakuqit, *Prisi në lamë të letraturës*

410 Gilbert-Kun, Istorija estetike, Kultura, Beograd, 1969, fq. 243.

411 Ibrahim Rugova, Vepra e Bogdanit, Rilindja, Prishtinë, 1990, fq. 112-122.

412 Jup Kastrati, Studime për De Radën, Gjonlekaj, NY, 2003, fq. 250.

413 Përkthyesi i këtij libri në shqip, Engjëll Sedaj, e vë në dyshim shkrimin italisht të librit, për shkak të njohjes së dobët të italishtes nga De Rada:

“Detyrë e studiuesve është ta konstatojnë se në çmasë është kjo trajtesë-skicim dhe a thua De Rada i shkroi këto parime të estetikës më parë në gjuhën shqipe.”

Shih: De Rada, Vepra 7, Rilindja, Prishtinë, 1988, fq. 256.

(1911) i Justin Rrotës, *Fillimet e stilistikës e të letërsisë së përgjithshme* (1930) të Aleksandër Xhuvanit e Kostaq Cipos etj.

Parime të estetikës e De Radës ka një rëndësi të veçantë pikërisht se është traktati i parë estetik shqiptar. Por studiuesit e De Radës kanë vënë re gjithnjë se libri nuk mund të përkufizohet saktësisht si traktat estetik, sepse „vepra nuk merret tërësisht me probleme estetike“⁴¹⁴, ndërsa Engjëll Sedaj e quan „trajtesë filozofike dhe teoriko-letrare“.⁴¹⁵ Kjo vjen për shkak të faktit se De Rada trajton në këtë libër edhe çështje të pastra filozofie (si: shpirti dhe mendja), çështje të politikës (si: partitë politike e demokracia), por edhe çështje të rëndësishme nga jeta e arbëreshëve (si: këngët popullore arbëreshe, roli i Kolegjit të Shën Adrianit etj.). Në anën tjetër, trajtesa nuk është e plotë në tërësinë e saj, jo vetëm për shkak të disa pjesëve që i mungojnë, por si koncept estetik nuk është i tërësishëm dhe i përfunduar. Rexhep Qosja sado thekson se *Parime të estetikës* përfaqëson estetikën dhe teorinë e Jeronim De Radës, vëren se:

„... estetika dhe teoria e Parimeve të estetikës nuk e mbulojnë plotësisht, herë- herë as përafërsisht, edhe poetikën e tij praktike: poetikën që mund të nxirret prej veprave të tij poetike në tërësi.“⁴¹⁶

Kjo do të thotë se ekziston një dallim midis koncepteve teorike dhe estetike mbi të cilat janë krijuar veprat e De Radës dhe atyre të cilat ai i ka shprehur në librin *Parime të Estetikës*. Ky dyshim, për mendimin tonë i drejtë i R. Qosjes, krijon bazën për të vënë në dyshim edhe origjinalitetin e pikëpamjeve estetike të De Radës: çështjet estetike që ai

414 Jup Kastrati, Studime për De Radën, fq. 250.

415 Jeronim De Rada, Vepra 7, fq. 255.

416 Rexhep Qosja, Historia e letërsisë shqiptare, Romantizmi II, Rilindja, Prishtinë, 1984, fq. 140.

i trajton në librin e tij, e që sipas Alberto Stratikoit (1863-1926) janë ligjërata të De Radës të mbajtura para studentëve të Kolegjit të Shën Adrianit⁴¹⁷, janë origjinale të tij apo janë eklektike?

Me gjithë këto mangësi të librit studiuesit e çmojnë vlerën e tij:

„Sot, ne mund të shtojmë se kjo është më e madhja vepër teorike në kulturën shqipe, deri në kohën e paraqitjes së saj.“⁴¹⁸

Në shqyrtimin e pikëpamjeve estetike në literaturën shqipe ky libër i De Radës është i pa anashkalueshëm.

Mbas De Radës është edhe një emër në historinë e mendimit kritik dhe estetik, i cili ka shndritë dhe vazhdon të shndrisë edhe sot letërsinë shqipe me thellësinë e gjykimit kritik: ai është Faik Konica (1875-1942). Edhe Faik Konica nuk ka shkruar një traktat estetike e as do të arrijë të krijojë një sistem estetik të vetin, por ka shkruar disa ese në të cilët ka vënë bazat e kritikës (moderne) shqipe dhe ka trajtuar çështje të estetikës. Siç thotë Sabri Hamiti, ai është themeluesi i kritikës shqipe:

“... kritiku i parë i shqipes, jo pse ky i pari shkroi kritika me vlerë për veprat shqipe dhe shfaqti ide për vepra dhe për autorë shqiptarë, që më vonë ose u zhvilluan më tej ose u kritikuan rëndë, po pse është i pari që kritikën letrare e shkroi me një vetëdije letrare, e përkufizoi si zhanër letrar dhe, më në fund, e përkufizoi funksionin e saj në kuadrin e zhvillimit të letërsisë kombëtare.”⁴¹⁹

Po ashtu, Sabri Hamiti e quan Konicën si eseisti i parë shqiptar.⁴²⁰ Ndërsa Aurel Plasari i atribuon Konicës edhe një shteg të ri:

417 Ibrahim Rugova, Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983, Faik Konica, Prishtinë, 2005, fq. 49-50.

418 Sabri Hamiti, Studime letrare, ASHAK, Prishtinë, 2003, fq. 85.

419 Sabri Hamiti, Studime letrare, fq. 287.

420 Sabri Hamiti, Studime letrare, fq. 299.

“Konica do të jetë (historikisht) edhe i pari mendimtar shqiptar që përhapë ide estetike bashkëkohore në kulturë përgjithësisht.”⁴²¹

Ky konstatim i Plasarit duhet të sqarohet, sepse është mendimi estetik i Bogdanit, sado i pjesshëm, megjithatë është nismëtar, është Bogdani autori i parë historik i mendimit estetik shqiptar, ndërsa Konica përhapës i “ideve estetike bashkëkohore”.

Në këtë kapitull ne do të shqyrtojmë pikëpamjet estetike të Gjergj Fishtës, duke i krahasuar ato me mendimin estetik të traditës, e në radhë të parë me mendimin estetik të Pjetër Bogdanit e të De Radës, si dhe me mendimin kritik të Faik Konicës, bashkëkohës i Fishtës.

421 Aurel Plasari, *Fishta meditant, parathënie në librin Fishta, Estetikë dhe Kritikë, Hylli i Dritës & Shtëpia e librit*, Tiranë, 1999, fq. 10.

I. SHKRIMI ESTETIK I FISHTËS

Fishta ka shkruar një trajtesë të shkurtër si traktat të tijin estetik, *Shinime estetike: Mbi natyrë t'Artit* (1933), të botuara në *Hyllin e Dritës*, nr. 1, fq. 8-12 dhe nr. 2, fq. 67-75. Në fund të pjesës së dytë shkruan “vijon”, mirëpo Fishta nuk ka shkruar vazhdimin e trajtesës. Ka edhe disa shkrime të tjera të Fishtës, qoftë të diskursit letrar apo të atij publicistik, e në të cilët ai trajton çështje të estetikës e të kritikës letrare. Do të dallojmë shkrimet:

*Pikësime estetike mbi zeje të fjalës*⁴²², nënshkruar me X, të cilin Ibrahim Rugova nuk e identifikon si shkrim të Fishtës, bile as nuk e vlerëson lart: “Edhe pse me titull pretencioz, autori nuk jep ndonjë ide interesante”⁴²³. Në bibliografinë *Vepra letrare e At Gjergj Fishtës* të Benedikt Demës nuk është ky shkrim i radhitur si shkrim i Fishtës. A. N. Berisha nuk e vë në dyshim autorësinë e Fishtës në këtë shkrim;⁴²⁴

*A janë t'zot Shqyptarët me u mbajtë shtet m'vedi?*⁴²⁵

*Nji atentat shurdhë*⁴²⁶

*Parathanie në Kanunin e Lekë Dukagjinit*⁴²⁷

*Vierrsha heroike shqiptare*⁴²⁸

*Federata “Vatra” e muzika*⁴²⁹

422 HYLLI I DRITËS, 1932, nr. 7-8, fq. 395-406

423 Ibrahim Rugova, Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983, fq. 346.

424 Anton N. Berisha, Vepër e qenies dhe e qenësisë sonë, Shpresa & Faik Konica, Prishtinë, 2003, fq. 55.

425 Botuar në HYLLI I DRITËS, 1913, nr. 3.

426 Botuar në HYLLI I DRITËS, 1930, nr. 12, fq. 641.

427 Botuar në HYLLI I DRITËS, 1933, nr. 4, fq. 153.

428 Botuar në HYLLI I DRITËS, 1935, nr. 4, fq. 142.

429 Botuar në HYLLI I DRITËS, 1923, nr. 3, fq. 138.

*Per një fjalë të pavend të Z. Mehdi Frashërit*⁴³⁰

*Hijeve të Parnasit*⁴³¹

Çështje të estetikës dhe të kritikës letrare hasim edhe në letrat private të Fishtës me At Pal Dodajn, me albanologun Norbert Jokël etj. Mirëpo, në të gjitha këto raste Fishta ka trajtuar vetëm shkarazi çështjet estetike, derisa në shkrimin *Shinime estetike*, sado i papërfunduar, ai mëton të shkruaj një traktat origjinal estetik, në të cilin do t'i paraqet konceptet e tij estetike. Themi ai mëton, sepse jo vetëm që shkrimi nuk është i përfunduar, por edhe si i tillë trajton vetëm disa aspekte të estetikës dhe jo gjerësisht fushën e estetikës. Kjo trajtesë e Fishtës ka pasur gjithnjë vlerësimin pozitiv të studiuesve. Sado Ibrahim Rugova as këtë trajtesë nuk e ka identifikuar si të Fishtës, për më tepër ai dyshon mos është i Dr. Kolë Prelës⁴³², e për këtë “mosidentifikim” të shkrimit të Fishtës Aurel Plasari shprehë habinë me I. Rugovën⁴³³, ai e vlerëson shumë lartë trajtesën:

“Njëri ndër punimet më të mira të kësaj natyre te Hylli i Dritës, kryesisht për konceptin tradicional të estetikës, të estetikës klasiciste. Po ashtu shkruan mirë dhe me terminologji të formuar për kohën.”⁴³⁴

Aurel Plasari e shtyn më tutje këtë vlerësim të I. Rugovës:

“Realizimin më të rëndësishëm në këtë fushë, jo vetëm për këtë periudhë por për krejt mendimin teorik-estetik të Fishtës dhe, ndosh-

430 Botuar në HYLLI I DRITËS, 1924, nr. 1. fq. 1.

431 Botuar në HYLLI I DRITËS, 1932, nr. 12. fq.626.

432 Ibrahim Rugova, Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983, fq. 351.

433 Aurel Plasari, Fishta meditants, në Fishta Estetikë dhe Kritikë, Hylli i Dritës dhe Shtëpia e Librit, Tiranë, 1999, fq. 18.

434 Ibrahim Rugova, Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983, fq. 349.

ta, edhe për traditën e mendimit estetik shqiptar e përbën Shinime estetike: Mbi natyrë t'artit (1933).”⁴³⁵

I.1. Konceptet estetike të Fishtës

Shkrimi estetik i Fishtës në përgjithësi dhe *Shinime estetike*, në veçanti, paraqesin pikëpamje të ndryshme të autorit për çështje të estetikës dhe të kritikës letrare. Edhe pse *Shinime estetike* duket se është konceptuar si një sistem unik mendimi për artin dhe natyrën e tij, shkrimi që sot kemi në dorë nuk është i tillë. Së pari shkrimi nuk është i përfunduar, së dyti në shkrim trajtohen disa çështje të estetikës, por jo estetika si një sistem dijes. Kështu kishte ndodhur më herët edhe me De Radën, sado ai kishte botuar një libër me titullin pretencioz *Parime të estetikës*, megjithatë, mendimi i tij është pikëpamje individuale për disa çështje të estetikës e jo sistem unik dijeje për estetikën. Shkrimi estetik i Fishtës paraqet mendime, koncepte e pikëpamje të Fishtës, vetjake ose tradicionale, për çështje të veçanta estetike, por ai nuk arriti kurrë të krijojë një sistem unik dijes për natyrën e artit, si mëtohet në pjesën e dytë të titullit të shkrimit. Por, edhe si të tilla, këto koncepte të Fishtës paraqesin interes, jo vetëm për historinë e mendimit estetik shqiptar, por edhe për dijen e sotme estetike shqiptare.

435 Aurel Plasari, *Fishta meditant, në Fishta Estetikë dhe Kritikë, Hylli i Dritës dhe Shtëpia e Librit*, Tiranë, 1999, fq. 17.

I.1.a. E bukura dhe e mira në natyrë⁴³⁶

Sendet në natyrë janë të bukura, ato janë të bukura sepse janë të pëlqyeshme (“shka pelqen, asht gjithmonë edhe të bukur”⁴³⁷); ato janë të trajtuara prej Shkasit të Parë, po duke qenë se janë në natyrë, e natyra është e kufizuar, edhe këto sende janë të kufizuara dhe nuk bartin në vete shkëlqimin e prototipit të tyre, Shkasit të Parë (“perfekcioni i pamasë gjindet vetun në Zotin”⁴³⁸); pra, bukuria e sendeve në natyrë është e kufizuar (“sendet të gjitha mund të jenë fort ma të mira e ma të bukura se janë në natyrë”⁴³⁹).

Ky është koncepti i Fishtës për të bukurën në natyrë, i cili është i afërt me konceptin estetik mesjetar krishter. Ndërsa marrëdhënia midis të bukurës dhe të mirës është koncept klasikist:

Parimi i Shkasit të Parë është trajtuar thelbësisht nga Plotini (204-270). Sipas tij Njëshi (shkasi i parë) ka krijuar natyrën përmes vizionit. Njëshi dhe vizioni i tij janë përkryeshmëria, burim dhe shëmbëllim i artit.⁴⁴⁰ Edhe pse Plotini askund nuk e përmend krishterimin, koncepti i tij për Njëshin dhe kërkimi i shpëtimit në bashkimin mistik të njeriut me Njëshin është shumë i afërt me krishterimin.⁴⁴¹

436 Për shkak të citimeve të shumta të shkrimit të Fishtës Shinime estetike: Mbi natyrë t'Artit, në këtë pjesë nuk do të përdorim modelin e përdorur deri më tash për fusnota. Do ta citojmë shkrimin e përmendur nga libri Fishta, Piksime estetike mbi artin e fjalës, përgatitur për botim dhe me një parathënie të A. N. Berishës, Shpresa, Prishtinë, 2003, fq. 130-156. Në citim do të përmendim vetëm titullin e shkrimit, kapitullin dhe faqen e këtij libri.

437 Gjergj Fishta, Shinime estetike ..., I, fq. 133.

438 Gjergj Fishta, Shinime estetike..., II, fq. 135.

439 Gjergj Fishta, Shinime estetike..., II, fq. 135.

440 Gilbert-Kun, Istorija estetike, Kultura, fq. 101-102.

441 Shih për afërsinë e neoplatonistëve me krishterimin në librin Rrëfimet të Shën Augustinit, Plejad, Tiranë, 2006, fq. 161-174.

“Ura lidhëse në mes të filozofisë së Shën Augustinit dhe filozofisë klasike do të jenë shkrimet e Plotinit.”⁴⁴²

Ndërsa më vonë, vetë Shën Augustini (354-430) ka thënë se Plotinit duhet t’i ndryshosh “vetëm disa fjalë” që ai të bëhet i krishterë.⁴⁴³ Dihet mirë se njëra prej këtyre fjalëve të ndryshuara është Njëshi i shndërruar në Zot. Koncepti i Fishtës për Shkasin e Parë vjen nga ky koncept i ndryshuar i Shën Augustinit. Po ashtu edhe koncepti i tij për bukurinë e kufizuar të sendeve në natyrë dhe bukurinë e pamasë të prototipave të Shkasit të Parë vjen prej Shën Augustinit, sikurse edhe vetë koncepti për intuitën, të cilën Fishta e quan Gen, vjen po prej Shën Augustinit, i cili thotë (në parafrazim):

Krejt çka ka krijuar Zoti e ka krijuar në shëmbëllim të vetin. Zoti është i bukur po edhe krijesat e tij janë të bukura. Por sendet nuk mund të jenë të bukura sa vetë Zoti. Bukuria e tyre është e kufizuar. Vepra e Zotit nuk është pasqyrë e tij, ajo është vetëm hije e tij, pasi që ajo ngushtohet nga materia e vrazhdë.⁴⁴⁴

Ky koncept i Shën Augustinit është tërësisht i krahasueshëm dhe i njëjtësuar me konceptin e mësipërm të Fishtës. Sipas këtij koncepti dallohen tri përmasa të së bukurës: e bukura absolute, ajo e Shkasit të Parë, të cilën njeriu mund ta paragjykojë si një vizion, por nuk mund ta shohë; e bukura në natyrën që është hije e së bukurës absolute (nuk

442 Samuel E. Stumpf, *Filozofia-historia dhe problemet*, Botimet Toena, Tiranë, fq. 120.

443 Samuel E. Stumpf, *Filozofia-historia dhe problemet*, fq. 120.

444 Gilbert-Kun, *Istoria estetike*, Kultura, fq. 127.

Në librin *Rrëfimet* [fq. 293], Shën Augustini shprehet kështu:

“Pra, ti i ke krijuar, ti që je i bukur, sepse të bukura janë gjërat; ti që je i mirë, sepse të mira janë gjërat; ti që ekziston, sepse ato ekzistojnë. Por, nuk ka gjëra të bukura, as të mira që ekzistojnë, ashtu si je ti, krijuesi i tyre; në krahasim me ty nuk janë të bukura, as të mira dhe as që ekzistojnë. Këto i dimë në sajën tënde, dhe dija jonë, në krahasim me tënden, është padije.”

është reflektim i saj) dhe kjo e bukur është e shkallës së ulët, sepse e ngushton materia; e bukura në art, që është prodhim i gjenit të njeriut dhe është më e vogël se e bukura absolute dhe më e madhe se e bukura në natyrë.

I.1.b. E Bukura dhe e Pëlqyeshmja.

Fishta të bukurit e nxjerr prej të pëlqyeshmit: “shka pelqen, asht gjithmonë edhe të bukur”⁴⁴⁵. Ky është koncept i Horacit (65-8 p. K.), i shprehur përmes formulës së njohur „dulce et utile“.

Pëlqimin e plotë do ta ketë ai që të dobishmen e gërsheton me të këndshmen,

duke argëtuar lexuesin po edhe duke e këshilluar.⁴⁴⁶

Arti krijon kënaqësi dhe i shërben një qëllimi moral. Shën Augustini thotë se ajo që na pëlqen në tokë e në qiell është e bukur.⁴⁴⁷ Ky rregull i Horacit është formula që rregullon marrëdhënien midis artit dhe utilitarizmit edhe në estetikën mesjetare.

I.1.c. E Bukura që ngjallitë artin.

Duke rezytuar mendimin e Fishtës për lindjen e artit, del se:

Kjo bukuri e sendeve nuk është bukuria prej të cilës ngjallitë arti; sendet në natyrë janë një jehonë e të bukurës perfekte, e që është e bukura që rrjedh nga prototipat e sendeve në vetë Zotin. Njeriu nuk mund ta shohë të bukurën perfekte (sepse të verbon sikur rrezja e diellit) por nuk kënaqet edhe me bukurinë e sendeve në natyrë, sepse ajo bukuri është e kufizuar e sendet mund të jenë edhe më të bukura.

445 Gjergj Fishta, *Shinime estetike...*, I, fq. 133.

446 Horaci, *Arti Poetik*, përkthyer prej Dr. Engjëll Sedaj, Buzuku, Prishtinë, fq. 55, vargjet 343-344.

447 Gilbert-Kun, *Istorija estetike*, fq. 116.

Prandaj njeriu krijon në mendjen e vet përfitimim për sendet; ky përfitim quhet Ide genjale; e Bukura rrjedh prej përfitimim apo prej Idesë genjale, dhe është e bukur më e madhe se ajo e sendeve në natyrë dhe më e vogël se të bukurit e sendeve prototipa që kanë ekzistuar vetëm në përfitimim e Zotit.⁴⁴⁸

Këto koncepte të Fishtës për të bukurit që krijon artin dhe për mënyrën se si krijohet të bukurit e artit janë një gërshetim i koncepteve të Shën Augustinit dhe të Hegelit. Koncepti i Hegelit (1710-1831) për të bukurën e kufizuar në natyrë, për të bukurit perfekt të materien e perëndishme janë të afërta me konceptet e Shën Augustinit. Fishta merr prej Hegelit Idenë gjeniale, që te Hegeli është Gjeniu krijues:

Gjeneraliteti është pasion natyror i lindur (...) që botës imagjinate dhe emocionale t'i japë formë.⁴⁴⁹

Duke kaluar nëpër trurin e gjenit (artistit), proza e realitetit dhe vrazhdësia e natyrës së pagdhundur fitojnë elasticitetin dhe harmoninë e shpirtit.⁴⁵⁰

I.1.d. Arti nuk është imitim.

Duke qenë se arti është prodhim i përfitimim të artistit (bukuria rrjedh, jo prej sendeve në natyrë, por prej një ideje të përfitueme në intuitën në mendje të artistit mbi sendin⁴⁵¹), e i cili përfitimim nxitet nga bukuria e sendeve në natyrë, por nuk kënaqet me të sepse frymëzohet prej të bukurës prototipe (përfitimim i Zotit), atëherë Fishta thotë se arti nuk është imitim i natyrës dhe as i traditës. Me këtë koncept Fishta bie në kundërshtim të plotë me teorinë klasiciste, sipas së cilës arti është

448 Fishta, Shinime estetike....

449 Gilbert-Kun, Istorija estetike, fq. 364.

450 Gilbert-Kun, Istorija estetike, fq. 361-362.

451 Gjergj Fishta, Shinime estetike..., V, 144.

mimezis, ashtu siç e kishte përkufizuar Aristoteli në Antikë dhe Boalo në Mesjetë. Platoni e kishte përkufizuar artin si frymëzim nga zotat, si një frymëzim i marrë, sepse poetët këndojnë për gjërat që nuk i kuptojnë, ndërsa Ciceroni i pari e kishte përdorë nocionin fantazi, për të mbërritur deri te Hegeli dhe Gjeniu krijues i tij, të cilin koncept e absorbonte Fishta. Duke qenë se arti është prodhim i mendjes së njeriut, ai është botë më vete, sipas Fishtës. Me postulatit se arti është prodhim i mendjes së njeriut Fishta njëjtësohet me konceptet romantike, sipas të cilave arti është prodhim subjektiv i mendjes së njeriut përmes Gjenit krijues.

I.1.e. Vepra artistike-botë më vete.

Duke ndarë të bukurit nga ajo e sendeve në natyrë dhe nga të bukurit prototip (Njëshi te Plotini, Zoti te Shën Augustini dhe Materja e perëndishme te Hegeli), Fishta krijoi mundësinë për teorinë e veprës artistike si botë më vete. Ky koncept i Fishtës për artin si botë më vete ka një origjinalitet të kufizuar dhe paraqet interes të madh për mendimin estetik shqiptar, qoftë për shkak të origjinalitetit apo për idenë moderne që përmban. Vepra artistike është botë më vete, më e lartë se ajo e sendeve në natyrë dhe më e ulët se ajo e krijimit prototip. Me këtë përfundim Fishta pranonte rolin dhe mundësinë e artit për ta ndryshuar natyrën. Ky koncept është shumë i vjetër dhe fillon me Platonin (428-427 p. K.). Platoni thotë se poezia e ndryshon, më drejt e shtrembëron realitetin, sepse ai imiton vetëm njërin anë të realitetit, të mirën, dhe nuk imiton anën tjetër, të keqen; po ashtu arti është së paku

dy hapa larg realitetit. Duke imituar vetëm njëri në të realitetit dhe duke qenë larg realitetit, arti shtrembëron realitetin.⁴⁵²

Në kufirin e fundit të Mesjetës, një estet, Filip Sidni, thotë se arti e ndryshon natyrën dhe poeti e ka atë të drejtë dhe atë mundësi për ta ndryshuar natyrën sepse atë mundësi ia ka dhënë Krijuesi i Natyrës, duke e bërë edhe këtë, artistin, krijues.⁴⁵³

Ndërsa Hegeli e përkufizon deri në fund botën më vete të artit:

Për këtë arsye ideali duhet të kërkohet në art e jo në natyrë. Sepse arti është natyra e ringjallur për herë të dytë, natyra e rilindur me zbulimet e gjeniut. Duke kaluar nëpër mendjen e poetit, proza e realitetit dhe vrazhdësia e natyrës së pagdhundur fitojnë elasticitetin dhe harmoninë e shpirtit.⁴⁵⁴

Nëpër këto koncepte, Fishta e quan punën e poetit *creatio*, d.t.th. krijim, prodhim, pra artisti është krijues, sikurse vetë Zoti, vetëm se në përmasa më të vogla. Ndërsa për veprën e artit thotë se është

“nji krijesë (*creatio*)...ajo asht dishka krejt m'vedi (*quid unicum*), nji *individuum* permbrenda rruzullimit, por qi nuk asht pjesë e rruzullimit....⁴⁵⁵

I.1.f. Teoria e dy Rruzullimeve.

Duke qenë se vepra e artit është botë më vete dhe artisti është krijues që prodhon, dhe që të dy së bashku ekzistojnë përbrenda një rruzullimi po që nuk janë pjesë e tij, atëherë Fishta përfundon me teorinë e dy Rruzullimeve: rruzullimi (bota) reale, natyra, kjo e krijuar prej

452 Platoni, Shteti, Libri III; shih edhe S. E. Stumpf, Filozofia-historia dhe problemet, Botimet Toena, Tiranë, fq.53-54.

453 Gilbert-Kun, Istorija estetike, fq. 158.

454 Gilbert-Kun, Istorija estetike, fq. 362.

455 Fishta, Shinime estetike..., I, 133.

Zotit, po që nuk është e përkryer dhe rruzullimi (bota) e krijuar nga artisti, që ekziston përbrenda rruzullimit të parë, por nuk është pjesë e tij (VII, 149). Fishta përdallon këto dy botë:

Ky rruzullim ideal, mandej, asht ma i haptë e ma i madhueshem se rruzullimi real; pse kah neper imaginacion mundet me da e me bashkue pjesët e gjymtyrët e do sendeve m'sende tjera, kshtu mrrinë me krijue *individuum* të ri në rruzullim të vet, per shembull: *hipogrifi* (kal me fletë) qi në rruzullim të dukshëm nuk ekziston aspak.⁴⁵⁶

Këto koncepte për rruzullimin ideal janë shumë të afërta me ato të Hegelit për të bukurën në art. Por, këtu mund të shohim një dritë të origjinalitetit të Fishtës i cili e ndan prerat botën ideale të artit nga bota reale, edhe pse ajo qenëson brenda saj. Diçka të ngjashme kishte deklaruar Filip Sidni (1554-1586), por ai botën e artit e quante më të mirë se bota e Zotit (bota reale e krijuar prej Zotit). Në të vërtetë, po ta vazhdojmë deri në fund konceptin e Fishtës për dy rruzullimet, edhe te koncepti i Fishtës shkohet në të njëjtin përfundim, sikurse edhe te Sidni, se bota e krijuar prej artistit është më e mirë se bota empirike e krijuar nga vetë zoti. Ky me të vërtetë është një përfundim tepër i guximshëm për një prelat, i cili tërë jetën e tij ia kishte kushtuar edhe çështjes së fesë krishtere.

Mirëpo, pavarësisht nga ndonjë ide origjinale, gjithë konceptet estetike të Fishtës janë të marrë prej filozofëve e estetëve të tjerë, si prej Platonit, Plotinit, po te Fishta kanë mbërritur në formën që u kishte dhënë esteti i parë i madh i krishterë Shën Augustini. Koncepte të tjera estetike Fishta i ka marrë prej Hegelit, që ishte krye esteti mbi të cilin u mbështetën teoricienët e romantizmit.

456 Fishta, *Shinime estetike...*, VII, 149.

Në konceptet e Fishtës dallohen qartë koncepte të estetikës klasice, koncepte të estetikës krishtere mesjetare, dhe koncepte të estetikës së re dhe romantike.⁴⁵⁷ Por, për herë të parë në mendimin estetik të një autori shqiptar dallohen qartë edhe konceptet origjinale estetike.

Duke i parë kështu konceptet estetike të Fishtës ne besojmë se këto koncepte janë shumë larg nga shqyrtimi i tyre si të pavarura dhe jashtë teorive të tjera tradicionale estetike, si propozon Aurel Plasari⁴⁵⁸ dhe shumë larg të shqyrtimit të tyre si koncepte origjinale estetike, siç propozon Kujtim M. Shala.⁴⁵⁹ Bile-bile, në vrapin për të shpallur teori origjinale estetike shqiptare, konkretisht të Fishtës, fakti që sjell Plasari, se si Fishta ia ka dërguar këto koncepte estetike një esteti anglez të specializuar në estetikë në Universitetin e Kembrixhit dhe se ai ia ka kthyer përgjigjen se bëhet fjalë për një teori të re estetike⁴⁶⁰, duket sa qesharak aq edhe vetë përbuzës, edhe pse shkruesi e ka përmendur si fakt lavdërues për Fishtën. Madje, në një letër për Atë Pal Dodajn, dorëshkrim i vitit 1910, Fishta flet për bashkim konceptesh të ndryshme estetike dhe letrare në veprën e vet:

457 Edhe studiuesi i letërsisë popullore A. N. Berisha konstaton eklektizmin e koncepteve estetike të Fishtës. Shih: A. N. Berisha, Pikësime estetike mbi artin e fjalës, Shpresa, Prishtinë, 2003, fq. 27.

458 Aurel Plasari thotë:

„I veçanësuar në hulumtime, edhe si objekt edhe si metodë, vendosja e lidhjeve të Fishtës mendimtar bëhet e vështirë. A thua se përfrimet, në vend që ta afrojnë, e largojnë, duke i uajsuar gjithë sa në mendimin e tij mund të ketë origjinale, pra të papërafreshme.“

Shih: Aurel Plasari, Fishta meditant, në Fishta, Estetikë dhe Kritikë, Hylli i Dritës dhe Shtëpia e Librit, Tiranë, 1999.

459 Ky studiues tendon edhe ta përkufizojë teorinë estetike të Fishtës, edhe pse vetë nuk e bën këtë. Shih: Kujtim M. Shala, Shinimet e Fishtës, AIKD, Prishtinë, 2002.

460 Aurel Plasari, Fishta meditant, në Fishta, Estetikë dhe Kritikë, Hylli i Dritës dhe Shtëpia e Librit, Tiranë, 1999, fq. 24.

„Kshilla qi m'jep, lidhun me formen e stilin qi duhet perdorë në kte pjesë të tretë (të *Lahutës së Malcis*, plotësim imi, B. K.), asht e drejtë. Me gjith kta, tue shfrytëzue të njajtën formë dhe tue ia bashkue stilin popullor atij klasik, do të perpiqem (...).“⁴⁶¹

Fishta këtu flet për bashkim të qëllimshëm të stilit klasicist me atë popullor, e këtë të fundit romantikët e kishin shndërruar në burimin kryesor për letërsinë e tyre.

461 Fishta, Estetikë dhe kritikë, Hylli i Dritës & Shtëpia e Librit, Tiranë, 1999, fq. 191.

II. KRAHASIME PËRGJITHËSUESE TË FISHTËS ME MENDIME TË TJERA ESTETIKE-KRITIKE

II.1. Krahasime përgjithësuese të Fishtës me Pjetër Bogdanin

Duke shqyrtuar veprën *Çeta e Profetëve* (1675-1685) të Pjetër Bogdanit (rreth 1630-1689), një vepër universale, Ibrahim Rugova ka përmbledhur disa mendime estetike të Bogdanit të dhëna në kontekste të ndryshme dhe këtyre koncepteve ua ka kushtuar një vend të rëndësishëm në veprën e tij *Vepra e Bogdanit* (1982). Rugova e kornizon mendimin estetik të Bogdanit në filozofinë dhe estetikën e Mesjetës:

“E bukura realizohet në planin ontologjik si esencë, si qenie e qenies më të lartë Zotit dhe si inkarnim i tij në qeniet dhe fenomenet e tjera në natyrë.”⁴⁶²

Ky koncept i të bukurit lidhet me etikën, sepse sipas konceptit mesjetar të krishter nuk ka të bukur pa etikë.

Këto koncepte të Bogdanit, sado të pasistemuara e anësore, i ka njohur Fishta. Konceptet e Fishtës përkojnë me këto të Bogdanit, jo vetëm për shkak të kontaktit me veprën e Bogdanit, por nga shkak se konceptet e të dyve kanë një burim: filozofinë dhe estetikën e Mesjetës, me epërsinë e Fishtës se ai i ka zhvilluar konceptet e tij edhe me gërshtimin e koncepteve estetike të Hegelit.

462 Ibrahim Rugova, *Vepra e Bogdanit*, fq. 113.

II.2. Krahasime përgjithësuese të Fishtës me Jeronim De Radën

Krahasimi i parë, i thellë, i koncepteve estetike të Fishtës në traditën letrare shqiptare duhet të bëhet detyrueshëm me konceptet estetike të De Radës, më së pakut për dy arsye: së pari De Rada është poeti i parë romantik shqiptar dhe njëri prej dy poetëve më të mëdhenj romantikë, së dyti për shkak se *Parimet e estetikës* (1861) i De Radës është traktati i parë estetik prej një autori shqiptar, edhe pse i shkruar në italisht.

Siç është vënë në dukje edhe nga studiuesit e tjerë, ka një dallim midis koncepteve teorike dhe estetike mbi të cilat janë krijuar veprat e De Radës dhe atyre të cilat ai i ka shprehur në librin *Parime të Estetikës*.⁴⁶³ Në shumë koncepte të tija të shtruarra në *Parime të Estetikës* De Rada flet si një klasikist. Në këtë nuk duam t'i klasifikojmë këto koncepte, por vetëm po i përmendim për krahasime të mëtejme. Kështu, për të Bukurën ai thotë se “gjendet kudo në botë, ai është i pakufijshëm”⁴⁶⁴, e që është koncept klasikist për të bukurën objektive. Po ashtu, ai e vë në lidhje të dobishmen me të bukurën afërsisht si klasikistët: “Pra, e dobishmja dhe të Bukurit janë dy burime të së Mirës njerëzore...”⁴⁶⁵, dhe vë në lidhje të pashkëputshme estetikën dhe etikën, përkatësisht të bukurit me qëllimin moral: “Kudo që është të Bukurit, aty gjithmonë gjendet edhe morali”⁴⁶⁶.

Në anën tjetër, De Rada shqyrton dhe mbarështon në *Parime të estetikës* shumë koncepte estetike dhe sidomos poetike të romantizmit. Kështu ai flet për atdheun dhe dashurinë ndaj tij si për një qëllim moral

463 Rexhep Qosja, Historia e letërsisë shqiptare, Romantizmi II, fq. 140.

464 De Rada, Vepra 7, Parime të estetikës, Rilindja, Prishtinë, 1988, fq. 154.

465 De Rada, Vepra 7, Parime të estetikës, fq. 155.

466 De Rada, Vepra 7, Parime të estetikës, fq. 159.

të artit, flet për arsimimin e qytetërimin e popujve, për Kolegjin e Shën Adrianit etj. Në veçanti, kur De Rada flet për këngët popullore shqiptare dhe bukurinë e paanë të tyre⁴⁶⁷ dhe për gjuhën popullore ai flet si një romantik i vërtetë, duke e ngritur gjuhën pothuajse në një kategori estetike:

“Duke përkujtuar këngën e vjetër popullore, në të cilën ruhen gjurmat e pavdekshme të jetës sonë vetanake, bindemi se në gjuhën shqipe jeton shpirti ynë”⁴⁶⁸.

Për dallim nga konceptet eklektike të shprehura në *Parime të Estetikës*, në veprën e tij letrare De Rada u përmbahet besnikërisht teorive dhe rregullave romantike të shkrimit. Letërsia e tij është fund e krye romantike: edhe në rregullat e shkrimit, edhe në frymën e përgjithshme, edhe në tematikën, motivet e në idetë poetike, edhe në figuracion etj.

Duhet të përmendet edhe fakti se në librin e De Radës ka edhe kundërshti mendimesh. Kështu, ai për të bukurit thotë se është kudo në natyrë (të bukurit objektiv), ndërsa në një vend tjetër thotë se „është lehtë të kuptosh se çdo gjë e bukur është, në të vërtetë, koncept i mendjes”⁴⁶⁹, (të bukurit subjektiv).

Duke përfunduar për konceptet estetike të De Radës mund të themi se dallimet midis veprës letrare të tij, të shkruar mbi parime e teori romantik, dhe veprës së tij estetike *Parime të estetikës*, në njërin anë dhe, gërshetimi i koncepteve të estetikës klasiciste e romantike, në anën tjetër, na bëjnë të besojmë se De Rada nuk pati jo vetëm një sistem të krijuar të mendimit estetik, por ai nuk pati edhe një sistem unik të

467 De Rada, Vepra 7, Parime të estetikës, fq. 180-184.

468 De Rada, Vepra 7, Parime të estetikës, fq. 208.

469 De Rada, Vepra 7, Parime të estetikës, fq. 159.

mendimit estetik. Prandaj, duhet të besojmë se konceptet estetike të De Radës janë gërshetime konceptesh të ndryshme të cilat nuk mund të paraqesin një sistem unik të mendimit estetik, por që mbizotërohen nga koncepte romantike. Edhe Ibrahim Rugova pak a shumë ka këtë përfundim:

„...vepra e De Radës Parime të estetikës (1861) ku kemi një platformë të interesimeve estetike romantike përgjithësisht.“⁴⁷⁰

Edhe Sabri Hamiti pak a shumë bën të njëjtin përfundim:

“Parime të estetikës, si vepër teorike e estetike, bashkon në vete, teorinë romantike mbi poezinë, të bazuar kryesisht në përvojën personale poetike dhe në estetikën personale të De Radës dhe etikën e krishterë...”⁴⁷¹

Mirëpo, Ibrahim Rugova sugjeron një qasje nga një kënd tjetër ndaj veprës së De Radës:

“Me këtë rast shprehim mendimin tonë se vepra e De Radës, duhet të kuptohet në metodë, e jo të kualifikohet si fragmentare e heterogjene, apo si përmbledhje pikëpamjesh të ndryshme sepse fushat e jetës dhe të filozofisë që i përdorë ai, metodologjikisht, mund të konsiderohen si argumente shkencore për të argumentuar filozofinë e tij të së Bukurës dhe të se Ndershmes.”⁴⁷²

Duke krahasuar konceptet estetike të Gjergj Fishtës me ato të De Radës mund të përfundojmë:

edhe De Rada edhe Fishta kanë shkruar traktate estetike, me qëllim të krijimit të një sistemi të tyre estetik;

470 Ibrahim Rugova, Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983, fq. 47.

471 Sabri Hamiti, Studime letrare, fq. 93.

472 Ibrahim Rugova, Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983, fq. 52-53.

edhe De Rada edhe Fishta nuk kanë një sistem të krijuar të mendimit estetik, por konceptet e tyre ngjajnë në absorbim të disa koncepteve e mendimeve estetike, shpeshherë të ndryshme midis tyre, e nganjëherë ngjajnë edhe në koncepte të kompiuara estetike;

derisa De Rada nuk ka arritur të krijojë një sistem unik të mendimit estetik, të pakundërshtueshëm në vetvete, Fishta gërsheton ato koncepte estetike që mund të gërshetohen: konceptet e Shën Augustinit e Tomë Akuinit me konceptet romantike të Hegelit;

edhe De Rada edhe Fishta në shqyrtimet e tyre estetike nisen nga kategoria kryesore estetike: të bukurit.

derisa De Rada kalon katërçipërisht kufijtë e estetikës së tij në veprën e tij letrare, duke shkruar vepra tërësisht romantike, Fishta u përmbahet parimeve të tij estetike dhe rregullave e teorive të shkrimit klasikist, duke gërshetuar edhe në letërsinë e tij parime e rregulla klasikiste dhe ato romantike: në format poetike, në metrikë dhe në gjinitë letrare Fishta është klasikist, ndërsa në tematikën, në motivet, në idetë poetike dhe në mesazhet poetike ai është edhe romantik edhe pasromantik;

edhe në lidhshmërinë e estetikës me shoqërinë e shtetin De Rada ka koncepte më moderne, të ndikuara nga Revolucioni Borgjez Francez, ndërsa Fishta ka koncepte mesjetare për një komb, koncepte teologjike për kombin.⁴⁷³

473 Ibrahim Rugova, Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983, fq. 342. Shih shkrimet publicistike të Fishtës: Perlumi i Perkohshmjes (HYLLI I DRITËS, nr. 1, 1913), Shteti e Besimi (Posta e Shqypnisë, nr. 19, 1916), Lajçizmi në Prendim? (HYLLI I DRITËS, nr. 9 dhe 10, 1933), Kisha Katolike ka trajtue kulturen oksidentale (HYLLI I DRITËS, nr. 4, 5, 6, 1923), Arsimit apo luftë kundra Katolikizmit në Shqypni? (HYLLI I DRITËS, nr. 7, 1923) etj.

II.3. Fishta dhe kritika letrare e Konicës

Me shkrimin e njohur *Kohëtore e letrave shqipe*⁴⁷⁴, një manifest i kritikës letrare shqipe, shkruar më 1906, Faik Konica (1875-1942) bëhet themeluesi i kritikës moderne letrare shqipe. Studiuesi i tij i parë i tërësishtëm, Sabri Hamit, në librin *Faik Konica: Jam unë* (1991) thotë:

„Faik Konica është quajtur edhe më përpara, kritiku i parë i shqipes, jo pse ky i pari shkroi kritika me vlerë për veprat shqipe dhe shfaqti ide për vepra dhe për autorë shqiptarë, që më vonë ose u zhvilluan më tej ose u kritikuan rëndë, po pse është i pari që kritikën letrare e shkroi me një vetëdije letrare, e përkufizoi si zhanër letrar dhe, më në fund, e përkufizoi funksionin e saj në kuadrin e zhvillimit të letërsisë kombëtare.“⁴⁷⁵

Përqasja e mendimit dhe e shkrimit kritik të Konicës me atë të Fishtës shkon jo në drejtim të përafrimit, por në drejtim të largimit. Sa më shumë ta përimitosh këtë përjasje aq më e madhe bëhet largësia midis dy autorëve tanë të mëdhenj, të cilët jetuan në të njëjtën kohë dhe jetuan të njëjtën kohë. Ky dallim vjen e bëhet edhe më i thellë, jo vetëm në mendimin kritik, por edhe në vlerësimin e veprave të ndryshme letrare, në veprat të cilave ata u referohen dhe për të cilat shkruajnë. Kështu, deri sa Fishta është i prirë kah klasikët grekë e romakë, Konica përkthen pjesë të epit indas *Kalidasa*, pjesë nga përrallat arabe *Një mijë e një net*. Derisa Fishta shkruan ode, elegji dhe himne, Konica shkruan tregime të shkurtra, proza poetike, ese. Derisa Fishta shkruan epin nacional, Konica sprovon romanin dhe kritikën letrare. Derisa Fishta

474 Shkrimi do të citohet sipas Faik Konica, *Vepra 1*, zgjedhur e përgatitur nga Nasho Jorgaqi, Botimet Dudaj, Tiranë, 2001, fq. 243-248.

475 Sabri Hamiti, *Studime letrare*, fq. 287.

angazhohet për një koncept teologjik për shtetin, Konica angazhohet për demokracinë parlamentare. Derisa Fishta shprehë shumë koncepte mesjetare për organizimin e shoqërisë e të shtetit, Konica është modern në të gjitha pikëpamjet sociale. Kështu, ndoshta fjalët modern për Konicën dhe tradicionalist për Fishtën shprehin më së miri dallimet midis këtyre dy kolosëve të letrave shqipe.

Konica është modern në kuptimin e plotë të fjalës në kritikën e tij:

Kritika është gjykim subjektiv, por i mbështetur në fakte konkrete. Kritika bëhet edhe vetë vepër letrare. Në metodologjinë e kritikës Konica mbështetet në përjasje, në krahasimin e vlerës së një vepre me vlerën e krejt kryeveprave të letërsisë botërore. Konica argumenton katërcipërisht se atdheu dhe letërsia janë dy gjëra. Ai ngre zërin, madje parodizon, kritikën e deriatëhershme himnizuese shqiptare.⁴⁷⁶

Në fund Konica e përkufizon kështu rolin e kritikës ndaj letërsisë:

„... se letrëtyra nuk mund të rritet pa një kritikë, e cila nga një anë gatitë këndonjësit për të kuptuar më mirë veprat, nga tjetër anë i bën shkronjësit të shkruajnë me më kujdes.“⁴⁷⁷

Edhe pse ka disa gjëra që i përafrojnë interesimet e Fishtës me ato të Konicës në çështje të kritikës, si: edukimi i lexuesit për letërsinë (Fishta, sikurse edhe Konica kritikon lexuesin për mosinteresim ndaj letërsisë⁴⁷⁸), sikurse Konica që kishte hapur një rubrikë të veçantë për prezantimin e librave shqip në revistën e tij *Albania*, duke hapur kështu derën për kritikën recensuese në letërsinë shqipe, edhe Fishta hapë një rubrikë të veçantë, të mbiqajtur Bibliografi në *Hyllin e Dritës*, me qëllim të prezantimit kritik të librave të letërsisë etj., janë katër çështje

476 Faik Konica, Vepra 1, fq. 243-248.

477 Faik Konica, Vepra 1, fq. 248.

478 Te Fishta, Estetikë dhe Kritikë, fq. 123.

themelore për mendimin kritik në të cilat dallimet midis Fishtës dhe Konicës janë të mëdha. Këto çështje janë: hapja e letërsisë shqipe ndaj letërsisë botërore, përmes metodës së përqasjes; dallimin midis ideve patriotike dhe letërsisë; kritika himnizuese dhe kritika vlerësuese dhe metoda studimore e kritikës, apo kritika moderne, si mohim i kritikës biografiste.

II.3.a. Metoda e gjykimit: hapja e letërsisë shqipe ndaj letërsisë botërore.

Duke folur për metodologjinë e kritikës me të cilën Konica do t'i qaset letërsisë në revistën e tij *Albania*, ai thotë se do të përqas veprat e autorëve të veçantë me ato që trajtohen në historinë e letërsisë botërore si kryevepra letrare. Edhe nëse kjo përqasje nuk bëhet e drejtpërdrejtë, ajo ekziston në vetëdijen e kritikut, sepse vetëdija e tij është e ndërtuar mbi vlerat letrare të atyre kryeveprave. Nuk ka dyshim se kjo është një qasje e re në kritikën letrare shqipe dhe qasje e re ndaj veprave e autorëve shqiptarë. Në këtë mënyrë Konica po e hapte letërsinë shqipe ndaj letërsisë botërore, duke i futur veprat e autorët shqiptarë në garë me kryeveprat botërore.

Me këtë metodë gjykimi për letërsinë shqipe, si pjesë e letërsisë botërore, Konica po e absorbonte metodologjinë e studimit historik të letërsisë në Evropë, të filluar me idetë e J. G. Herderit (1744-1803) dhe veprës së tij *Këngë popullore* (1778-1779) dhe të stabilizuar me esenë e T. S. Eliotit *Tradita dhe talenti individual* (1919).⁴⁷⁹

Vetëm një qasje e tillë mund ta bënte letërsinë shqipe pjesë integrale të letërsisë botërore. Deri atëherë autorët shqiptarë kishin krijuar

479 Zejnullah Rrahmani, Probleme të metodës në shkrimin historiko-letrar, në Letërsia si e tillë, Toena, Tiranë, 1996, fq. 17-22.

ekskluzivisht për lexuesin shqiptar. Qëllimi më i madh i tyre ishte të bëheshin poetë me famë kombëtare, çfarë e patën arritur padyshim romantikët De Rada e Naim Frashëri dhe pasromantiku Gjergj Fishta. Çështë e vërteta, De Rada kishte pasur një prirje për ta tejkaluar horizontin e letërsisë shqiptare, duke marrë fjalë lëvdate edhe nga Viktor Hygo (1802-1885)⁴⁸⁰, por e gjithë kjo pati mbetur në kuadër të nismës personale për ta bërë të njohur veprën e vet edhe në rrethe jashtëshqiptare.⁴⁸¹ Veprat e autorëve shqiptarë ishin çmuar nga lexuesi shqiptar, madje edhe në rrethe më të vogla, si është rasti me letërsinë pararomantike shqiptare në gjuhën shqipe. Marin Barleti (rreth 1460-1530) është i pari dhe deri në shekullin XX i fundit shkrimtar shqiptar që ka qenë njëkohësisht autoritet letrar në gjithë Evropën, por ai ka shkruar në latinisht e jo në shqip. Rrethi i lexuesve shqiptarë kishte filluar të kultivohej, e po ashtu edhe autorët shqiptarë. Konica thotë:

„Nuk u shtua shunmë numri i librave që dalin, as i këndonjësve; po cilësia e që të dyve u përmirësua.”⁴⁸²

Letërsia shqiptare, sipas Konicës, duhej të ballafaqohej në krahasim (përjasje) me vlerat më të larta të letërsisë botërore dhe vetëm atëherë ne do të krijojmë një vlerësim real për letërsinë shqiptare.

480 Viktor Hygo kështu e lavdëron poetin De Rada: „Kush dëshiron të shohë plotësimin e poezisë romantike moderne, të lexojë „Këngët e Milosaut“ të zotëri Jeronim De Radës“.

Shih: Jup Kastrati, Studime për De Radën, fq. 236 dhe fusnota 20, fq. 262.

481 Përveç me autorë të mëdhenj të Rilindjes Shqiptare, De Rada pati letërkëmbime me shumë albanologë të shquar evropianë, ndërsa pati fjalë miradije për veprën e tij nga poeti francez Alfons de Lamartin (1790-1869), nga Aleksandër Dyma Ati (1802-1870), nga poeti provansal Frederik Mistral (1830-1914), nga shumë poetë italianë etj. Që më 1856 vargje të De Radës janë përkthyer në gjermanisht nga H. K. G. Shtir. Shih: J. Kastrati, Studime për De Radën, fq. 301; Robert Elsie, Histori e letërsisë shqiptare, Dukagjini, Pejë, 2001, fq. 122.

482 Faik Konica, Vepra 1, fq. 243.

II. 3. b. Letërsia dhe Atdheu

Dallimi i letërsisë prej atdheut dhe i poetit prej patriotit është qasja tjetër moderne që e dallon Konicën nga tradita letrare shqiptare. Derisa Fishta vazhdon me traditën e vjetër të Renesancës italiane për artin si dije e filozofi⁴⁸³, duke e marrë shkrimtarin si “mendimtar e filozof”⁴⁸⁴, Konica shkëputë çdo lidhshmëri të poetit me profesionet dhe me fushat e tjera të dijes, si filozofia, etika etj. dhe e shkëputë poetin nga patrioti, poezinë nga atdheu, lidhje kjo tepër e fuqishme në gjithë letërsinë shqiptare, që nga fjalja e parë autoriale e shkrimtarit të parë shqiptar Gjon Buzukut:

“U Doni Gjoni, i biri i Bdek Buzukut, tue u kujtuom shumë herë se gluha jonë nukë kish gja të ndigluomë n së shkruomit shenjtë, n së dashunit së botësë sanë...”⁴⁸⁵

e deri te bashkëkohaniku më i ri i Konicës, Ernest Koliqi, i cili deklaroi:

„Shqipnija ma parë u krijue prej poetënvët në shpirt të Shqiptarvet me kangë qi ngjallshin afshin për liri e mandej u shugurue me gjak të deshmorvet të shtymun m’u ba flije prej atyne kangve.”⁴⁸⁶

Duke bërë këtë shkëputje që nuk është mohim i temës së atdheut në poezi, por vlerësim i poezisë në efektet artistike e jo në argumentimin patriotik, Konica hapë një shteg të ri në letërsinë shqipe për kritikën letrare, duke ripozicionuar edhe kritikën edhe letërsinë në rrjedhën moderne të letërsisë e të kritikës letrare botërore. Kjo shkëputje ka të

483 Gilbert-Kun, Istorija estetike, fq. 148-149.

484 Fishta, Estetikë dhe Kritikë, fq. 44, Letër At Pal Dodajt e vitit 1910.

485 Meshari i Gjon Buzukut, botim kritik, punuar nga Eqrem Çabej, pjesa e dytë, Universiteti Shtetëror i Tiranës, 1968, fq. 387.

486 Erenst Koliqi, Fishta interpret i shpirtit shqiptar, fq. 52.

bëjë në radhë të parë me kritikën. Jo vetëm në kulturën shqiptare, por pothuajse në gjithë kritikën evropiane deri te shkolla formaliste dhe strukturaliste, e të cilat sollën kritikën e tekstit letrar, kritika është kuptuar në lidhje të ngushtë me moralin, me filozofinë, me religjionin, me shoqërinë apo me vetë autorin e veprës. Në këtë prizëm kritika letrare shqiptare nuk është vonuar ndaj kritikës evropiane, ndërkaq koncepti i Konicës për shkëputjen e kritikës nga morali mund të vlerësohet edhe si anticipues.⁴⁸⁷

II. 3. c. Kritika himnizuese dhe kritika vlerësuese.

Konica mëton të ndërpresë edhe një traditë tjetër në kritikën letrare shqiptare, do të thosha, jo vetëm në kritikën letrare, por në letërsinë në përgjithësi: kritikën letrare himnizuese dhe stilin himnizues të letërsisë e të kritikës. Studiuesi i letërsisë Sabri Hamit, duke folur për himnizimin si prosede krijues te Naim Frashëri, thotë:

„Himnizimi si prosede krijues u duk në letërsinë shqipe, që te autorët e vjetër, në radhë të parë si himnizim i derivuar i Shkrimit të shenjtë. Në letërsinë e romantizmit dhe në letërsinë e Rilindjes, ky himnizim kaloi në një rrafsh të ri tematik dhe kishte të bënte përgjithësisht me rindërtimin poetik të një të kaluare kombëtare të lavdit e të madhështisë...“

Dhe më tej:

487 Umberto Eko thotë:

“Ka qytetërimi, i pari nga të gjithë qytetërimi anglosakson, ku-të paktën deri në ardhjen e New Criticism-it- biseda rreth veprave letrare ishte para së gjithash ishte bisedë morale”.

Shih te libri Për letërsinë, Dituria, 2007, fq. 159.

„Po letërsia shqipe nuk është liruar kurrë nga himnizimi si prosede krijues, sa herë është kënduar fati kombëtar, e kaluara e tij, etosi i tij, etnosi...”

Për të përfunduar:

„Himnizimi është i pranishëm dhe prodhor edhe në letërsinë bashkëkohore shqipe pa marrë parasysh se si prosede i tillë sot edhe nuk ka dhënë veprat më të mira, qofshin edhe nga pena e shkrimtarëve të mëdhenj.”⁴⁸⁸

Fishta njihet, si në kritikën letrare, në polemikë e ashtu edhe në poezinë e tij, si kritikues i rreptë i së keqes dhe lavdërues i madh i së mirës. Në kritikën letrare të tij mund të gjejmë edhe gjykime si ky:

„Se një ç’do Nazif O. Mamaqi të çohet e t’botojë poshtersi kso dore, qi poshtnojnë jo veç kombin shqypetar, por njerzimin mbarë...”⁴⁸⁹

Po në këtë mënyrë ligjërimit të tejkufishëm Fishta edhe i lavdëron veprat e poetët:

„Kto dit kam kndue „Gjermania“ të Heine-s. Kurrnji veper letrare nuk më ka ngjallë kaq ndiesi zilije, se sa ky poemth. I mrekullishem! Mundet me e perftyruie si nji shenjstore të mbushun plym me zgjeta t’barbarit...”⁴⁹⁰

Në të dy format e veta, edhe si gjykim negativ edhe si gjykim pozitiv, ky tip ligjërimit i Fishtës është himnizues dhe korrespondon katërçipërisht me ligjërimit himnizues tradicional shqiptar.

Këtë prosede krijues, sa i vjetër, aq i thellë në letërsinë shqipe, mëton ta ndërpresë Konica kur e quan tallje e jo himnizim.⁴⁹¹ Ai merr një

488 Sabri Hamiti, Studime letrare, fq. 159-160.

489 Fishta, Estetikë dhe Kritikë, fq.139.

490 Fishta, Estetikë dhe Kritikë, fq. 156, letër At P. Dodajt, 1908.

491 Faik Konica, Vepra 1, fq. 247.

shembull të këtyllë të kritikës himnizuese dhe thotë se nuk do të kishte mënyrë tjetër më të mirë për ta tallur një vepër letrare se sa ta vlerësoje himnizueshëm. Ai gjykon preras këtë rrjedhë:

“Lirizmi nuk ka punë me kritikën, edhe u lutem këndonjësve të gatiten për një kohëtoke më të ftohtë.”⁴⁹²

II. 3. d. Metoda e kritikës letrare-kritika moderne si mohim i kritikës biografiste

Derisa Fishta në konceptet e tij për metodën e kritikës letrare i përket kritikës biografiste të Ipolit Tenit (1828-1893), Konica kapërcen kornizën e autorit dhe kritikën e vlerëson vetëm si një gjykim për veprën letrare.

Fishta thotë:

“Tue njoftë autorin e një vepre, kritiku e ka ma leht mbasandej me dhanë një gjyq permi vlerë të veprës si mendim, si stil e mandej edhe si qellim. S’mundet me kenë qi shpirti i autorit-edhe me lesh në kjoftëmos ta lajë gjurmen e vet në vepër të tij.”⁴⁹³

Ndërsa Konica është krejt tjetër:

“Kritika është një gjykim, -një gjykim i vlerës së librave.”⁴⁹⁴

Asgjë më shumë dhe asgjë jashtë kësaj.

Ne këtu vetëm përmendëm sipërfaqësisht afërsitë e vogla midis Fishtës e Konicës, u ndalëm më përmbajtësisht te tri dallimet themelore, për të vënë re se, edhe pse bashkëkohanikë, të krijuar me idealet e Rilindjes Kombëtare shqiptare, Fishta e Konica janë dy botë të ndryshme

492 Faik Konica, Vepra 1, fq. 247.

493 Gjergj Fishta, Përndritje/publicistikë, fq. 287-288.

494 Faik Konica, Vepra 1, fq. 243.

letrare. Fishta vazhdon të mbetet edhe në kritikën letrare dhe në konceptet estetike nxënës gjenial i estetikës krishtere të Mesjetës, ndërsa Konica dishepull dhe paralajmërues i modernizmit shqiptar.⁴⁹⁵

495 Sabri Hamiti, Studime letrare, fq. 271. Ai thotë:
“Faiku është nismëtari i modernitetit shqiptar, që kërkon e zbaton një model të ri kulture shqiptare.”

PËRFUNDIME

Duke përfunduar shqyrtimin e shkurtër për konceptet estetike, poetike dhe kritike të Gjergj Fishtës, mund të gjykojmë:

Fishta hyn në radhën e shkrimtarëve të paktë shqiptarë të kohës së vet dhe të traditës që ka mëtuar të krijojë një traktat original estetik, të shkruar në shkrimin *Shinime estetike: mbi natyrë t'Artit* (1933). Ky shkrim i Fishtës dhe shumë mendime estetike të shfaqura në shkrime të diskurseve të ndryshme e në letra private, janë shumë të rëndësishme, jo vetëm për të kuptuar mendimin estetik dhe kritik letrar të poetit tonë, por edhe për studimin e mendimit estetik e kritik letrar shqiptar;

konceptet estetike të Fishtës nuk paraqesin një sistem unik dhe origjinal të mendimit estetik, sado ka disa studiues, të cilët nga dëshira të mira pretendojnë këtë shkallë të zhvillimit të mendimit estetik të Fishtës;

në konceptet estetike të Fishtës ai vazhdon mësimet estetike të Shën Augustinit, i cili nga ana e tij ishte i ndikuar thelbësisht nga esteti pagan Plotini, ndërsa e ndikoi fuqimisht filozofin dhe estetin krishter mesjetar Shën Thoma Akuinin (1225-1274)⁴⁹⁶, duke i përafëruar ato me disa mësimet të Renesancës italiane për botën e pavarur të veprës artistike e deri te mendimi estetik i Hegelit për gjenin krijues, për të

496 “Është thënë se Shën Thoma është për Shën Augustinin si Aristoteli për Platonin”, shih te Gilbert-Kun, *Istoria e estetikës*, fq. 121;

“Ai bashkoi në një sintezë të shkëlqyer pikëpamjet e filozofisë klasike dhe teologjisë së krishterë. Më saktë, Akuini “krishtëroi” filozofinë e Aristotelit”, shih te S. E. Stumpf, *Filozofia/historia dhe problemet*, fq. 165.

bukurën subjektive dhe për punën që bën poeti, rikrijimin, me të cilën afrohet apo imiton zotin që ka krijuar natyrën e kozmosin;

duke paraqitur koncepte të shkollave të ndryshme estetike, Fishta i ka harmonizuar (përkundër disa kundërshtive të vogla) në një tërësi kohezive në mënyrë origjinale, sado nuk mund të flasim për një sistem origjinal, siç pretendojnë Aurel Plasari, Kujtim M. Shala e ndonjë tjetër. Rëndësia e këtyre koncepteve qëndron në teorinë e dy Rruzullimeve, e që është ekzistimi i botës së pavarur të veprës letrare, e cila edhe pse është brenda botës reale, nuk është pjesë e botës reale. Kjo teori, e vjetër së pakut që nga Humanizmi dhe Renesanca evropiane (Filip Sidni) është shumë interesant për mendimin estetik dhe kritik letrar shqiptar, sepse e ndanë veprën letrare nga bota tjetër, arti shndërrohet në botë më vete, në qendër, veprimtari e përafërt me atë të zotit kur ka krijuar rruzullimin etj. Kjo teori, pra, është e rëndësishme, sepse vë artin e letërsinë në qendër të botës, e që si filozofi është botëkuptim i Hegelit, i cili për herë të parë në historinë e njerëzimit vuri estetikën dhe kuptimet estetike në themelin e filozofisë së vet, ndërsa si koncept estetik është romantik;

duke qenë tradicionalist edhe në konceptet estetike dhe në mendimin kritik Fishta rri afër poetëve të rrethit letrar shkodran, por rri larg De Radës e Naim Frashërit nga tradita dhe edhe më larg nga Faik Konica në bashkëkohësi.

FISHTA DHE LETËRSIA SHQIPTARE E TRADITËS

-PËRFUNDIMET E PËRGJITHSHME

Shqyrtimi krahasues i veprës së një poeti me gjithë traditën letrare të rrethit të tij kulturor shërben, së paku për tri arsye kryesore: së pari, për të parë se si ajo letërsi ka zhvilluar disa elemente deri te poeti që shqyrtohet, së dyti, për të parë më kthjellët vendin e atij poeti në tërësinë letrare të trungut të tij dhe së treti, për të parë ndikimet që ka bërë ai mbi poetët e tjerë. Në studimin tonë Fishta dhe letërsia shqiptare e traditës këtyre tri të priturve studimore mund t'u shtohet edhe një: njohja e vlerave të veprës së Fishtës.

Shqyrtimi krahasues i veprës së Fishtës me traditën letrare shqiptare e sjell në dritë të re jo vetëm veprën e Fishtës, por edhe shumë marrëdhënie letrare brenda shqiptare, zbulimi i të cilave krijon një pamje të re për zhvillimin në kontinuitet të letërsisë shqipe dhe të elementeve të veçanta të saj.

Nocioni krahasim në metodologjinë e punës është më i gjerë si qasje dhe krijon mundësi më të shumta sesa nocioni ndikim. Ne mund të bëjmë krahasime midis dy autorëve apo dy veprave letrare, pa folur për ndikime. Ndryshe është me nocionin ndikim. Vetëm pasi kemi folur për krahasime midis autorit A dhe atij B ne mund të flasim edhe për ndikime. Çështja komplikohet edhe më shumë, sepse ndikimet midis A dhe B nuk janë të thjeshta e lineare, edhe kur A kronologjikisht ka jetuar përpara B. Kështu, autorët tanë të vjetër të Veriut dhe Fishta kanë trajtuar mitin e gjuhës shqipe, por a është ndikuar Fishta prej tyre,

si është rendi kronologjik, apo nëpërmjet një autori të tretë, kjo është më vështirë të dihet. Duke folur për ndikimet letrare midis dy autorëve Umberto Eko thotë:

“Megjithatë, nuk mund të flasësh për konceptin e ndikimit në letërsi, në filozofi, dhe deri në kërkimet shkencore, po nuk vure në majë të trekëndëshit (A dhe B, plotësim imi, B. K.) një X. A të quajmë me këtë X kulturën, zinxhirin e ndikimeve të mëparshme? Për të qenë koherentë me ligjëratat tona të këtyre ditëve, le ta quajmë më mirë gjithësia e enciklopedisë. Duhet marrë në konsideratë ky X dhe kurrë më shumë se në rastin e Borgesit duhet marrë në konsideratë, meqë ashtu si Xhojsi, megjithëse në një mënyrë tjetër, ai e ka përdorur kulturën universale si mjet loje.”⁴⁹⁷

Eko i jep rëndësi të madhe këtij X, e që është një rreth më i gjerë ndikimesh të përgjithshme apo të veçanta e që ka lidhje si me A, ashtu edhe me B.

Njëjtë, sikurse Eko flet për marrëdhënien e tij me Borhesin e Xhojsin edhe në këtë punim ne kemi shkuar kah rezymimi në tri shkallë:

krahasimi i veprës së Fishtës me traditën letrare shqiptare, duke veçuar ngjashmëritë dhe ndryshimet;

përcaktimin e vijës së ndikimit tradita-Fishta, të shkallës së ndikimit (përkim, ngjashmëri, përpunim i mëtejshëm, marrje e drejtpërdrejtë etj.), duke pasur këtu parasysh gjithnjë rolin e X në trekëndëshin e Ekos. Si pasojë, shumë ndikime të Fishta vetëm janë evidentuar, por pa e kuptuar deri në fund sesi ato kanë ardhë deri te Fishta;

⁴⁹⁷ Umberto Eko, Për letërsinë, Dituria, 2007, fq. 118.

përkufizimi i veçantive letrare të Fishtës në marrëdhënie me traditën letrare shqiptare, si rezultat i krahasimit dhe ndaj letërsisë në përgjithësi.

Gjatë tërë shqyrtimit kam qenë para shumë pyetjeve e dilemave, disa prej të cilave i kam zgjidhur e disa nuk i kam zhvilluar deri në fund, për arsye të kufizimeve metodologjike. E vlerësoj të rëndësishme që edhe ato dilema të pa zgjidhura të jenë në një formë pjesë e këtij shqyrtimi, prandaj do t'i sjell në këtë pjesë rezymuese.

Dilema e parë ka të bëjë me marrëdhënien e Fishtës si autor ndaj veprës letrare: a është Fishta një poet, që shkruan poezi për krijimin e një kombi të lirë, apo një historian, që përshkruan luftën dhe psikologjinë e një kombi në formim e sipër? Përgjigja e parë do të mund të ishte pohuese për dy pyetjet, se Fishta ka qenë edhe poet edhe historian, por kjo të futë në një kurth. Pohimi i pyetjes së parë do ta lironte Fishtën nga akuzat e “ahistoricizmit” të tipit Të kritikës real-socialiste etj. (se Fishta ka shkruar gjëra të paqena apo të idealizuara, kështu e ka shtrembëruar realitetin), ndërsa mohimi i pyetjes së dytë do ta lironte atë nga akuzat për “ahistoricizmin” e tipit të Mehdi Frashërit etj. (se Avdyl Frashëri nuk ka pasur të veshur fustanellë në Lidhjen e Prizrenit, ashtu si paraqitet në Lahutën e Malcis).

Dilema e dytë ka të bëjë me marrëdhënien e veprës së Fishtës ndaj shoqërisë: a është vepra e Fishtës vepër realiste, që trajton idealet e shoqërisë shqiptare, apo një vepër jashtë kohës që trajton ideale të perënduara të shoqërisë shqiptare ose ideale që do të duhej të perëndonin?

Dilema e tretë ka të bëjë me marrëdhënien e Fishtës dhe veprës së tij me rrethin shoqëror: a është Fishta poeti kombëtar shqiptar apo një

poet provincialist? Fishta është akuzuar si poet provincialist, por me veprën e tij ai është poeti që këndoi botën shqiptare në tërësinë e saj më mirë se asnjë poet tjetër shqiptar.

Dilema e katërt lidhet me rolin e Fishtës në lëvrimin e gjuhës shqipe dhe të gjuhës poetike në veçanti. A pati dobi lexuesi dhe letërsia shqipe nga gjuha nëndialektore e Fishtës? Në njërën anë themi se pati dobi nga fjalësi origjinal shqip, por në anën tjetër kjo e ka ngarkuar negativisht komunikimin e veprës me lexuesin.

Dilema e radhës, jo e fundit, ka të bëjë me metodologjinë e studimit tonë: a është studimi ynë shqyrtim i vlerave letrare të Fishtës në dritën e të njëjtave nga tradita letrare shqiptare apo krahasim i vlerave dhe i parimeve themelore letrare të Fishtës me ato të traditës letrare shqiptare?

Por, pyetja qendrore e këtij shqyrtimi, pavarësisht nga këto dilema, mund të thjeshtësohet kështu: si e absorboi Fishta traditën letrare shqiptare dhe sa e ndikoi ky absorbim veprën e tij autoriale? Kjo është pyetja e parë që ka qëndruar gjatë tërë kohës mbi studimet fishtiane. Nuk ka as edhe një studiues të Fishtës të mos ketë përkur, qoftë edhe shkarazi, këtë temë. Shqyrtimi ynë Fishta dhe letërsia shqiptare e traditës ka sjellë disa përgjigje thelbësore.

Ndikimi i fuqishëm i autorëve të vjetër të Veriut. Përgjigja e parë thelbësore është ndikimi i fuqishëm i autorëve tanë të vjetër të Veriut te shumë autorë të mëvonshëm në letërsinë shqipe. Historia e letërsisë shqipe nuk ka pasur një përgjigje të duhur deri më tash në këtë çështje. Përmenden fakte përgjithësuëse, si është për shembull dashuria e madhe e Lasgush Poradecit për Pjetër Bogdanin (1630-1689) dhe Cuneus

Prophetarum (1675-1685) e tij, por nuk janë shqyrtuar dhe nuk janë hetuar ndikimet e drejtpërdrejta të autorëve të vjetër te pasardhësit. Krahasimi i veprës së Fishtës me letërsinë filobiblike është mbresëlënëse: Fishta, jo vetëm që ka njohur veprën e Bogdanit e të Budit, por ai është ndikuar prej tyre në disa drejtime: ndikime të sferës estetike-etike, ndikime të koncepteve krijuese dhe të ideve letrare e poetike dhe ndikime tekstore-letrare.

Nga ky mbushullim ndikimesh duhet veçuar mitin letrar për gjuhën shqipe, i filluar nga shkrimtari i parë shqiptar Buzuku, ndikim që ka prekur pothuajse të gjithë poetët shqiptarë të të gjitha periudhave letrare. Po ashtu, kthimi i Fishtës dhe i shkrimtarëve proklasicistë shkodranë te fjalësi i autorëve të vjetër të Veriut dhe përdorimi i atij fjalësi në veprat e tyre origjinale dëshmon fuqishëm ndikimin që kanë pasur baballarët e letërsisë shqipe. Ndikimet hetohen edhe në vetë tekstin letrar, si është njëmbëdhjetërokëshi i Bogdanit dhe ai i Fishtës, figura e Zanës te Budi dhe roli i madh i Zanës te Fishta, motivi i vdekjes në dy poezitë e Budit dhe në dy poezitë e Fishtës etj.

Në historitë e letërsisë shqipe gjithnjë është lënë një zbrazëti midis letërsisë së autorëve të vjetër të Veriut dhe letërsisë nacionale shqiptare, të cilën zbrazëti historianët kanë provuar ta mbufatin me poezinë e bejtexhinjve apo me iluminizmin. Shqyrtimi i veprës së Fishtës, në këtë marrëdhënie, është dëshmia më e fortë se ekziston një lidhje ndikimi midis kësaj letërsie dhe autorëve të shekullit XIX e XX. Nuk ka një ndarje apo një zbrazëti midis këtyre dy letërsive. Letërsia filobiblike e autorëve të vjetër të Veriut jo vetëm ka vazhduar të mësohet nëpër shkollat katolike shqiptare gjatë gjithë kohës, por ajo është absorbuar

edhe prej krijuesve dhe ka qenë e pëlleshme në ndikimin e vet te autorët e mëvonshëm.

Një entitet letrar. Duke shqyrtuar marrëdhëniet e veprës së Fishtës me rrethin e letrarëve françeskanë e jezuitë të Shkodrës në fundshekullin XIX dhe fillimshkullin XX, në një rën, si dhe duke shqyrtuar ndikimet që ka pësuar Fishta nga këto rrethe letrarësh, qofshin shqiptarë apo të huaj, në tjetrën anë, kemi ardhur në përfundim se ekziston një rreth i gjerë i letrarëve, që kanë orbituar rreth Shkodrës dhe kishës katolike shqiptare në shekullin XIX dhe në fillim të shekullit XX dhe letërsia e tyre ka shumë më tepër elemente të njëjta e të afërta me veten sesa me çdo drejtim a shkollë tjetër letrare shqiptare, prandaj si e tillë edhe duhet të trajtohet, pra si entitet letrar më vete. Historianët e letërsisë shqipe e kanë hetuar këtë mëvetësi të kësaj letërsie, por asnjëherë nuk e kanë trajtuar si të tillë e as nuk i kanë dhënë një emër të qëndrueshëm. Ne e kemi shënjuar këtë entitet si shkollë proklasike shkodrane dhe ky nocion ka dy përparësi: së pari shënjon afërsinë teorike të këtyre rretheve letrare me klasicizmin, pa e identifikuar tërësisht me të, duke lënë kështu derën hapur edhe për marrëdhëniet e saj me drejtime të tjera, si romantizmi dhe, së dyti eliminon një varg nocionesh të tjera, si shkolla françeskane, shkolla jezuite, shkolla katolike etj., të përdorura nga historianë të ndryshëm të letërsisë.

Kjo letërsi qëndron midis letërsisë filobiblike dhe letërsisë së romantizmit, në kuptimin e parimeve e elementeve letrare e jo në kohë. Ajo përmban në vete elemente të të dy këtyre letërsive, mirëpo në formën dhe në rregullat poetike, e herë herë edhe në idetë poetike, ajo është klasiciste.

Fishta është në lidhje me këtë rreth letrarësh nga një anë. Ai është ndikuar prej këtij rrethi në parime të përgjithshme letrare, si shkrimi i letërsisë fetare, poezia satirike, marrëdhënia me letërsinë popullore dhe me letërsinë e autorëve të vjetër të Veriut, parimi etik Atme e Fe, i cili është boshti moral i veprës së Fishtës etj. Fishta nuk është ndikuar prej këtij rrethi letrarësh edhe në tekstin letrar, që do të thotë se ndikimi i këtij rrethi të Fishta nuk qe shumë i fuqishëm, sepse ky rreth nuk kishte prodhuar vepra letrare madhore. Por, disa parime të përgjithshme letrare, që lidheshin me kulturën, me fenë, me racën, me qasjen ndaj letërsisë dhe rolit të saj në shoqëri etj., gjithsesi e kanë ndikuar Fishtën.

Universalizmi dhe sintetizmi i Fishtës, De Radës dhe i Bogdanit. Një ndikim tjetër i letërsisë filobliblike të Veriut të Fishta është edhe konceptimi i veprës letrare nga vetë autori i saj. Këtu mund të vërtetohet një lidhje të fuqishme të drejtpërdrejtë midis Bogdanit dhe Fishtës. Vepra e Bogdanit, qoftë si tërësi, qoftë vetëm një pjesë e saj, në thelbin e vet është universale dhe sintetizuese. Stanca e Bogdanit, e quajtur Krijimi i Rruzullimit, ka vetëm tetë vargje njëmbëdhjetërrokëshe, por është universale sepse flet për krijimin e rruzullimit dhe sintetizuese, sepse përfshin gjithë procesin e krijimit të rruzullimit brenda atyre tetë vargjeve. Edhe vetë vepra e Bogdanit *Cuneus Prophetarum* (1675-1685) është universale, sepse përfshin materie të gjithanshme letrare, shkencore, fetare, morale etj. dhe është sintetizuese, sepse bashkon në një tërësi të mrekullueshme dijet dhe vizionin për temat që shqyrton.

Mbas Bogdanit, por pandikueshëm nga ai, De Rada është universalist dhe sintetizues i letërsisë. Është universalit, sepse me veprën e mad-

he të tij paraqet një shekull shqiptar, me synimin për të rikrijuar botën shqiptare paraosmane, ndërsa është sintetizues, sepse në këtë vepër ai integroi gjithë trashëgiminë letrare shqiptare që njihej prej tij.

Fishta është universalisti dhe sintetizuesi i tretë i madh në traditën letrare shqiptare. Ai u ndikua më shumë nga Bogdani sesa nga De Rada. Ai e ka konceptuar Lahutën e Malcis njëlloj si Bogdani veprën e tij. Lahuta e Malcis është vepër universale, sepse përfshin fatin e përgjithshëm të një kombi, historinë dhe vizionin e tij dhe, është sintetizuese, sepse përfshinë gjithë historinë, kulturën, moralin, besimin, gjuhën, mitet dhe traditën e atij kombi. Edhe po ta kishim ftuar vetë Fishtën të na tregonte se cila është risia e veprës së tij, e paparë, qoftë në sferën e ideve poetike, përkatësisht në sferën e tematikës, formave poetike, vargut, figurës, strukturës ndërtimore, personazhit etj., ai nuk do të kishte mundur të përmend qoftë edhe një element. Roli i Fishtës në letërsinë e vet është te fakti se ai i ka rivendosur elementet e mëhershme, sipas një vlerësimi të tij në një rend të ri, duke krijuar kështu botën e tij letrare. Kështu, Fishtën me të drejtë mund ta quajmë një arkivist të letërsisë shqipe.

Kjo qasje konceptuale ndaj veprës letrare i bën Bogdanin, De Radën dhe Fishtën universalistët dhe sintetizuesit më të mëdhenj në letërsinë tradicionale shqiptare.

Klasicizmi dhe romantizmi i Fishtës. Në përdorimin e formave poetike dhe të vargut poetik Fishta është një prej poetëve më të pasur shqiptarë. Në këto forma poetike dhe në metrikë ai është klasikist i disiplinuar. Edhe në përdorimin e tetërrokëshit popullor shqiptar ai është klasikist i disiplinuar. Fishtën e kanë cilësuar me të drejtë

mjeshtët të vargut. Ai shkëlqen, sidomos, me njëmbëdhjetërokëshin satirik, si te otava rima e Palokë Cucës. Nuk mund të gjendet në historinë e letërsisë shqipe edhe një rrjedhë aq ritmike e rrefimit epik, si në epin Palokë Cuca. Në fushën e gjinive letrare Fishta është po ashtu klasikist: ai shkruan lirikën, epin, satirën dhe dramën, katër zhanret e preferuara të klasikistëve. Ndryshe nga ajo që do të mund të pritej prej një klasikisti të tillë të disiplinuar, në idetë poetike, Fishta është romantik: ai i kthehet letërsisë popullore, gegnishtes nëndialektore, miteve letrare romantike dhe koncepteve letrare të romantikëve, gjëra këto krejt të kundërta me parimet klasikiste. Kjo botë e përbashkët klasikiste dhe romantike te Fishta qenëson në gjithë veprën e tij. Shembuj edhe më të dukshëm janë dramat Ifigenija n'Aulli, një tragjedi tërësisht klasikiste, në temë dhe në idetë poetike dhe Juda Makabe, një tragjedi tërësisht romantike, në temë dhe në idetë poetike. I njëjti fenomen letrar mund të shihet edhe brenda një vepre të tij, si p.sh. te drama lirike Jerina, ase Mbretnesha e lulevet.

Sado që duket kontradiktore, format klasikiste dhe idetë romantike janë harmonizuar në veprën e Fishtës, duke e nxjerrë kështu veprën e tij një hap jashtë kufijve të klasicizmit dhe të romantizmit, e kështu ajo ka marrë vullën e mëvetësisë letrare.

Tradicionalisti (Fishta) dhe risimtari (Naimi). Fishta shkruan brenda formave tradicionale të letërsisë dhe të shkrimit letrar, qoftë në format poetike, qoftë në metrikë dhe në temat letrare. Ai ka sjellë në letërsinë shqipe tema të reja (si konflikti shekullor shqiptaro-sllav), por format e reja poetike, eksperimenti me vargje e me forma janë krejt të huaja për të. I vetmi eksperiment i Fishtës është marrëdhënia e tij e veçantë

me letërsinë popullore, përkatësisht marrja e teksteve popullore dhe trupëzimi i tyre në Lahutë të Malcis, por edhe ky eksperiment i tij nuk është tërësisht origjinal. Në anën tjetër, poeti romantik Naim Frashëri, një brez njerëzor më i vjetër se Fishta, është eksperimentuesi më i madh i traditës letrare shqiptare. Fishta dhe Naimi janë dy botë tërësisht të ndryshme në këtë aspekt. Derisa Naimi, vetëm brenda një poezie përdorë forma të ndryshme poetike, vargje të ndryshëm metrikë, ritëm të ndryshëm poetik etj., Fishta vende-vende e rrezikon lexueshmërinë e tekstit poetik për hir të rregullave të metrikës. Figurativisht, Naimi mund të simbolizohet me shpërthimin e burbuqes, ndërsa Fishta me punën e bletës. Naimi sjell në letërsinë shqipe gjithçka të re: prej vargut e deri te format poetike e idetë poetike. Fishta sjell përkryeshmërinë e formave e të ideve të mëhershme poetike dhe të temave të mëhershme letrare.

Çështje të prurjeve të Fishtës. Historianët e letërsisë duke studiuar autorët veç e veç gjithmonë mëtojnë të japin përgjigjen në pyetjen se çka i sjell një autor i caktuar hapësirës së tij letrare e kulturore. Edhe vepra e Fishtës është shqyrtuar në marrëdhënie me këtë pyetje. Fishta sjell në letërsinë shqipe:

ligjërimin e pastër epik (jo vetëm në Lahutën e Malcis, në Palokë Cucën dhe poezitë tjera epike, por edhe në lirikë e në dramë);

ode kulmore;

i jep shpirt shqiptari njëmbëdhjetërrokëshit;

krijon ligjërimin satirik;

sjell tema të reja (bota e malësorit shqiptar, lufta shqiptaro-sllave, tema e qytetarisë etj.);

ligjërimin kundërshtues etj.,

por, me gjithë këto risi, Fishta nuk është poet risimtar, nuk është eksperimentues si Naimi. Si kemi dëshmuar, ai është tradicionalist në çështje të formave poetike, të figuracionit, të trajtave të ligjërimin, të ideve poetike etj. Ai është, poende, universalist dhe sintetizues i vlerave të mëparshme letrare. Çdo vepër e tij, çdo pjesë e veprës së tij është sintezë e vlerave të mëparshme. Të qenët risimtar apo tradicionalist, origjinal apo sintetizues në letërsi nuk e paragjykon vlerën letrare të veprës së një autori, jo vetëm në letërsi po në të gjitha fushat humaniste. Kurrë nuk është dhënë një gjykim përfundimtar për epërsinë ndaj njëri tjetrit të risimtarit e origjinalistit Platon dhe të tradicionalistit, universalistit e sintetizuesit Aristotel. Por, pavarësisht nga prurjet e reja në letërsinë shqipe, prurja më e madhe e Fishtës sintheza e një epoke të tërë të epikës popullore me idealet e një shekulli themeltar për historinë shqiptare.

Bota shqiptare (Fishta) dhe shpirti shqiptar (Naimi). Fishta, si universalist dhe sintetizues i madh në letërsinë shqipe, natyrisht që me veprën e tij ka paraqitur tërësinë e botës shqiptare. Ai nuk lëshohet në ndjenjat, mendimet e emocionet e pafundme të personazhit. Personazhi dhe karakteri i tij shërben vetëm për të paraqitur fatin e kolektivitetit, në këtë rast të etnikumit. Gjithçka që është e përgjithshme, që ka të bëjë me etnikumin, si gjuha, mitet, besimet, nacioni, feja, idealet, shteti etj., janë më të rëndësishme se klithmat, se mendimet, se dëshirat e se travajat e personazhit. Prandaj vepra e Fishtës më shumë i ngjan një historie të përgjithshme shqiptare apo një enciklopedie të përgjithshme shqiptare, apo një bible shqiptare, sesa thjesht një poezi, një drame apo një epi. Sikurse De Rada më herët, vetëm se në kahe

tjetër, në drejtim të së ardhmes, Fishta ka synuar që me veprën e tij të paraqesë botën e vërtetë shqiptare, ose atë që do të duhej të ishte si model për botën shqiptare. Ndryshe nga Fishta, kryepoeti tjetër shqiptar, Naim Frashëri, fokusohet edhe në ndjenjat më intime të personazhit, në dëshirat, në dhimbjet, në dashuritë etj., pra në gjithë atë që ka të bëjë me botën e brendshme të personazhit, me shpirtin e shqiptarit. Naimi edhe kur shkruan për botën e jashtme shqiptare, si për natyrën, bujqësinë dhe bagëtinë e shqiptarëve, ai përsëri preokupohet me pashirrrmat e qengjit të larguar nga kopeja. Këto dy prirje letrare, të dy poetëve tanë të mëdhenj, duken shprehimisht përmes dy figurave: hiperbolës dhe litotës. Hiperbola është figura më karakteristike e Fishtës dhe ajo shpreh gjërat më të mëdha sesa janë në përmasat reale, shpreh madhështinë dhe botën e madhe shqiptare. Litota është figura më karakteristike e Naimit dhe ajo shpreh gjërat më të vogla se në përmasat reale të tyre, shprehë botën e brendshme shqiptare, botën e brendshme të individit, shpreh shpirtin shqiptar.

Babai i satirës. Në historinë e letërsisë shqipe Fishta, bashkë me A. Z. Cajupin, mbeten etërit e satirës. Fishta e boton më 1907 veprën satirike *Anzat e Parnasit*, e para e tillë në letërsinë shqipe. Duhet të theksohet se satira e tij është një element më shumë që e dallon Fishtën nga romantikët. Përveç se është zëfillës i satirës Fishta arrin me sukses të krijojë modelet e shkrimit të satirës: satirën qytetare dhe satirën politike, të cilat do të ndikojnë satirikët e mëvonshëm, drejt ose tërthorazi. Me epin *Lahuta e Malcis* Fishta nuk do të ndikojë poetët e mëvonshëm, por do ta përmbyllë një shekull përpjekjesh të poetëve të tjerë, si *De Rada*, *Gavrill Dara i Riu*, *Naim Frashëri* dhe *Zef Skiroi*, për të shkruar

epin nacional shqiptar. Fishta është poeti i fundit në Evropë që shkroi epin nacional, një formë poetike kjo historike dhe për vetë kohën kur Fishta e shkroi Lahutën e Malcis. Atë që nuk e arriti me kryeveprën e tij, ndikimin e poetëve pasardhës, Fishta e arrin me satirën e tij. Epin komik Palokë Cuca duhet ta gjykojmë përjetë si një vepër të papërfunduar, përndryshe në asnjë vepër tjetër nuk shfaqet mjeshtëria poetike e Fishtës si këtu.

Fishta i pavarur. Përkufizimi i veprës së Fishtës nga aspekti i drejtimeve apo shkollave letrare ka qenë për të gjithë studiuesit e tij jo vetëm një sfidë po edhe një kurth përrallor. Studiuesit kanë provuar ta lidhin Fishtën me këtë apo atë shkollë a drejtim letrar. Ai është shumë i afërt me klasicistët evropianë, por është i afërt edhe me romantikët, ndërsa Boalo dhe Hygo janë dy botë të ndryshme. Ai shkruan drama klasiciste si Ifigenija n'Aulli por edhe drama romantike si Juda Makabe. Ai shkruan ode për vdekjen, si lirika Nji lule vjeshtet, por edhe himne të flakta patriotike. Ai shkruan epin kombëtar Lahuta e Malcis, por edhe epin komik Palokë Cuca. Ai shkruan për mitet romantike shqiptare, por me vargun klasicist dhe me metrikën klasiciste. Ai ndikohet prej Budit e Bogdanit, merr guximshëm tekste letrare nga letërsia popullore, kundërshtohet me romantikët, rikrijon boshtin moral të veprës së vet përmes traditës popullore “Ndera e t’Parëve” dhe përmes traditës françeskane “Atme e Fe”. Ai proklamoi, në njërën anë, konceptet estetike të Plotinit, të ardhura deri te ai përmes filozofëve kristianë Shën Augustini dhe Toma Akuini, ndërsa, në anën tjetër, vjen në përfundimin romantik se bota e krijuar prej artistit është më e mirë se bota

materiale e krijuar prej vet Zotit. Ai shkruan mijëra vargje fetare, e në anën tjetër ndërton një botë të tërë mitesh shqiptare parakrishtere.

Një Fishtë të tillë nuk mund ta lidhësh për këtë drejtim apo për atë shkollë letrare, për këtë teori apo atë koncept estetik. Nëse nisemi nga metodologjia skolastike për ta lidhur Fishtën me çdo kusht me ndonjë drejtim letrar, atëherë do të krijojmë mundësinë e gabimeve të mëdha. Duhet nisur nga faktet empirike, pra nga vetë vepra e Fishtës për të ardhur në një përfundim teorik dhe estetik. Fishta ka elemente të njëjta apo të ngjashme edhe me klasicistët, edhe me romantikët; merr prej letërsisë së vjetër shqiptare, edhe prej letërsisë popullore; ka shumë parime letrare, shumë ide e motive letrare të ngjashme me romantikët, por ka shumë të tilla me të cilat kundërshtohet me romantikët. A është e gjithë kjo një dëshmi e fortë se Fishta është origjinal, ai është botë letrare më vete, se ai është i pavarur në letërsinë e tij? Po. Vepra e Fishtës është botë letrare më vete dhe parimet që përcaktojnë këtë mëvetësi letrare nuk kanë të bëjnë vetëm me atë që quhet “origjinalitet i poetit” që më tepër, përkojnë me shfaqje të veçanta letrare. Si çdo entitet letrar, ai ka marrë shumë prej të gjithëve, por ka arritur të krijojë universin e tij letrar, në të cilin vetë është zoti, krijuesi. Fishta nuk mund të lidhet vetëm me një ndikim letrar. Ai ka sintetizuar gjithë përvojën letrare shqiptare, këtë apo atë drejtim letrar, këtë apo atë rreth letrar dhe përvojën letrare popullore. Ai sado që ka shkruar për konceptet e tij estetike nuk ka arritur të krijojë një sistem estetik i cili do të përlligjete veprën e tij letrare. Ai ka arritur në një përfundim më ndryshe: ka shkruar veprën letrare dhe kjo vepër letrare buron dhe përlligj konceptet e tij estetike. Në këtë kuptim, Fishta është njëri prej klasikëve më të

mëdhenj të letërsisë shqipe. Ai ka krijuar rregullat për letërsinë e vet dhe vepra e tij funksionon përkryeshëm brenda këtyre rregullave.

Çështje të kundërshtive fishtiane. Fishta është i njohur si poet i kundërshtive:

ai shkruan epin kombëtar në fillim të shekullit XX, atëherë kur epi si gjini letrare i takonte historisë;

ai shkruan poezinë sipas metrikës klasiciste, por temat dhe idetë poetike i ka thellësisht romantike;

ai merr nga epika popullore struktura të tëra tekstore, këngë të tëra, po përsëri është original në epin e tij;

ai shkruan epin nacional Lahutën e Malcis, ku e krijon një Shqipëri të madhërishtme, e njëkohësisht shkruan epin satirik Palokë Cuca, në të cilin e përqesh po këtë Shqipëri.

në jetë ai është prift, ndërsa në letërsinë e vet fut tema, motive, figura dhe personazhe pagane;

në shkrimet e diskursit politik e social ai jo vetëm nuk është tolerant në çështje të fesë, po ende është radikal, ndërsa në letërsinë e tij ai është mbrojtësi më i madh i shqiptarizmit si ideologji mbi çdo ideologji e fe.

Ai shkruan kryeveprën e tij me tema të luftës së shqiptarëve kundër pushtuesit osman, ndërsa merr medalje nga sulltani osman.

Shumë vargje të poezisë së tij, por edhe në prozën e diskursit publicistik, fillojnë me pjesët mohuese e pohuese “jo, po”, ndërsa është bërë i famshëm vargu kundërshtues Oj Zanë, t’këndojm...t’vajojm deshta me thanun.

Vargu i kundërshtive fishtiane nuk përfundon me kaq. Tash mund të shtrohet pyetja: a është Fishta, nga aspekti letrar poet i kundërshtive dhe i paradokseve?

Cili është kuptimi i kundërshtive midis klasicizmit dhe romantizmit në letërsinë shqipe? Cili është funksioni i arealit kulturor e social të epitetit antik dhe atij klasicist për letërsinë shqipe? Për të gjitha këto pyetje dhe shumë të tjera ne nuk mund të japim përgjigje origjinale, por vetëm përgjigje të mësura nga librat e historive të letërsisë evropiane. Letërsia shqipe, sa do të jetë e ndikuar nga letërsitë evropiane, deri edhe te fakti që është pjesë e trungut letrar evropian, ajo nuk ka ecë në rrugën që e përcaktojnë poetikat e ndryshme evropiane. Letërsia shqipe nuk i ka shumë nga këto kundërshti, sepse zhvillimi i saj ka ecë në një rrugë origjinale. Nëse për letërsinë italiane periudha epike përfundon me Tason në shekullin XVI, për letërsinë shqipe periudha epike nuk ka qenë e përfunduar deri te Fishta. Nëse në letërsinë franceze poetika romantike e Hygos është kundërshtuar deri në detaje me poetikën klasiciste të Boalos, në letërsinë shqipe të shekullit XIX kanë bashkëjetuar së pakut katër drejtime e shkolla letrare: iluminizmi + klasicizmi + romantizmi + simbolizmi. Nëse në letërsitë evropiane mendimi krishter ka mundur çdo koncept tjetër fetar, çdo ide tjetër pagane, në letërsinë shqiptare janë zhvilluar bujshëm deri në gjysmën e dytë të shekullit XX kulte parakrishtere, në njërën dhe, është zhvilluar deri në mbizotërim të çdo ideologjie tjetër kulti etnik, i njohur si Kulti i t'Parve (gjaku, gjuha dhe tradita), në anën tjetër.

Nëse Fishta në veprën e tij është edhe klasicist edhe romantik, nëse shkruan epin nacional në fillim të shekullit XX, nëse madhëron dhe përqesh Shqipërinë, nëse është prift dhe shkruan për tema pagane, të

gjitha këto kundërshti dhe paradokse janë zhvillime origjinale të letërsisë dhe të kulturës shqiptare, ndërsa Fishta i ka bartur edhe në veprën e tij. Këto kundërshti e paradokse nuk e shëmtojnë Fishtën, por dëshmojnë se ai është poet original shqiptar dhe jo poet libresk e rob i kësaj apo asaj poetike.

Çështje të trashëgimisë fishtiane. A është e rrezikuar sot vepra e Fishtës?

Po. Jo më nga trysnitë politike, por nga vetvetja. Vështirësitë e leximit dhe të kuptimit e rrezikojnë veprën e Fishtës. Qysh në lindje të saj kjo vepër është ballafaquar me këtë problem. Asnjë studiues apo lexues i tij nuk e ka të qartë pse Fishta ka shkruar në një të folme dialektore që krijon vështirësi kuptimi! Një poet tjetër i madh shqiptar, Asdreni, ankohet se vështirë po e kuptonte Lahutën e Malcis. Aktori i njohur Reshat Arbana më pati thënë se Fishta është më i mirë kur recitohet se sa kur lexohet.

A mund të zgjidhet ky problem? A mund të bëhet një redaktim gjuhësor i veprës së Fishtës? A mund të lexohet më lehtë dhe të përjetohet më thellë lirika e Fishtës apo Lahuta e Malcis, për shembull, nga nxënësit e shkollave të mesme apo nga studentët, pas një redaktimi gjuhësor? A është, fundja, legjitim një redaktim gjuhësor i një vepre poetike? Këto pyetje nuk kanë sot përgjigje, mbeten të hapura dhe për diskutim, por nuk duhet të injorohen.

Në përmbyllje të këtij shqyrtimi ne veçuan përfundimet më interesante, më të domosdoshme dhe të panjohura deri më tash. Mirëpo, është më se e sigurt se nuk kemi arritur t'i zbulojmë të gjitha lidhjet e

veprës së Fishtës me traditën letrare shqiptare. Edhe në të ardhmen mbetet të vazhdohen shqyrtimet në këtë drejtim. Është interesant një shqyrtim i tillë midis Fishtës dhe bashkëkohësve të tij. Vetëm pas një shqyrtimi të tillë shterues të marrëdhënieve të poetëve të mëdhenj shqiptarë me traditën letrare shqiptare dhe botërore mund të shkruhet një histori më e plotë dhe më e saktë e letërsisë shqipe.

[Prishtinë, 2008]

BIBLIOGRAFIA KRYESORE E FISHTËS E KONSULTUAR PËR KËTË PUNIM

FISHTA, GJERGJ, *Vepra*, katër vëllime, përgatiti për shtyp Dr. Sabri Hamiti, Rilindja, Prishtinë, 1997

LAHUTA E MALCIS

Dr. Anton Nikë Berisha, *Vepër e qenësisë së botës dhe shpirtit shqiptar*, fq. VII-XXXVI;

P. Danjel Gjeçaj, *Paraqitje*, fq. XXXVII-XLII;

At Pashk Bardhi O. F. M., *Si xuni fill Lahuta e Malcis*, fq. XLIII-XLVI;

Lahuta e Malcis, sipas botimit të vitit 1958, Romë, fq. 1-703.

LIRIKA

Dr. Sabri Hamiti, *Lirika e Fishtës*, fq. 7-26;

Viktor Volaj, *Parathanje*, fq. 27-32;

Mrizi i Zanavet, sipas botimit të vitit 1941, Shkoder, fq. 35-216;

Vallja e Parrizit, sipas botimit të vitit 1941, Shkoder;

Viktor Volaj O. F. M., *Parathanje*, fq. 219, fq. 217-362);

Benedikt Dema, *Bibliografi / Vepra letrare e At Gjergj Fishtës*, fq. 365-392.

SATIRIKA

Dr. Aurel Plasari, *Modernitetii një satire klasike*, fq. 7-28;

Anzat e Parnasit, sipas botimit të vitit 1942, Shkoder, fq. 29-249;

Gomari i Babatasit, sipas botimit të vitit 1942, Shkoder, fq. 249-330;

Visku i Babatasit, sipas botimit të vitit 1994, Tiranë, fq. 331-423;

Nikolejda, fq. 425-469;

Krijime të tjera, fq. 471-500.

DRAMATIKA

Dr. Sabri Hamiti, *Dramatika e Fishtës*, fq. 7-25;

Juda Makabe, sipas botimit të vitit 1942, Shkoder, fq. 27-69;

Odiseja, sipas botimit të vitit 1931, Shkoder, fq. 71-86;

Ifigenija n'Aulli, sipas botimit të vitit 1931, Shkoder, fq. 87-118;

Shqyptari i gjytetnuem, sipas botimit të vitit 1931, Shkoder, fq. 119-142;

Shqiptarja e qytetnueme, sipas botimit të vitit 1994, Tiranë, fq. 143-193;

Jerina ase mbretnesha e luleve, sipas botimit të vitit 1941, fq. 195-261;

Barit e Betlemit, sipas botimit të vitit 1925, fq. 263-325;

Sh'Françesku i Asizit, sipas botimit të vitit 1925, fq. 327-415;

Sh. Luigji Gonzaga, sipas botimit të vitit 1927, Shkoder, fq. 417-492.

FISHTA, GJERGJ, *Lahuta e Malsisë*, botim i Salih Kabashit, pa datë dhe pa vend të botimit

FISHTA, ATË GJERGJ, *Vallja e parrizit*, (parathënien dhe komentet Don Pren Kola), Kuvendi Françeskan, Gjakovë, 1995

FISHTA, ATË GJERGJ, *Juda Makabe*, Rilindja, Prishtinë, 1994

- FISHTA, GJERGJ, *Mrizi i Zanavet*, Lumi, Lubljanë, 1990
- FISHTA, GJERGJ, *Hajrija*, Faik Konica, Prishtinë, 2000
- FISHTA, GJERGJ, *Hajrija*, Jeta e Re, nr. 2-3, Prishtinë, 1999
- FISHTA, AT GJERGJ, *Anzat e Parnasit*, ASHAK, Prishtinë, 1990
- FISHTA, GJERGJ, *Estetikë dhe kritikë*, (antologji e përgatitur nga Persida Asllani), Hylli i dritës dhe Shtëpia e librit, (pa datë dhe pa vend të botimit)
- FISHTA, GJERGJ, *Piksime estetike mbi artin e fjalës*, (antologji e shkrimeve estetike të Fishtës, përgatitur dhe përcjellë me një parathënie nga Anton Nikë Berisha), Shpresa, Prishtinë, 2003
- FISHTA, GJERGJ, *Përndritje, publicistikë*, (përmbledhje e shkrimeve publicistike, të redaktuara nga Ilir Nikolla), Lajmëtari 2000, Tiranë, 2000
- FISHTA O. F. M, P. GJERGJ, *Prozodi latine*, HYLLI I DRITËS, 1923, nr. 2, 3, 7.
- FISHTA O. F. M, P. GJERGJ, *Vjerrsha heroike shqyptare*, në HYLLI I DRITËS, 1935, nr. 4.
- FISHTA, GJERGJ, *Letër Pal Dodajt*, HYLLI I DRITËS, numër i posaçëm, Tiranë, 1996.
- FISHTA, GJERGJ, *Per një fjalë të pavend të Z. Mehdi Frashërit*, HYLLI I DRITËS, 1924, nr. 1.
- P. GJERGJ FISHTA O. F. M, *Rivista e shtypit*, “Vjerrsha heroike shqyptare”, HYLLI I DRITËS, 1935, nr. 3.
- [GJERGJ FISHTA], (pa autor), *Trazimet e Dhetorit*, HYLLI I DRITËS, 1922, nr. I.
- [GJERGJ FISHTA], (pa autor), *Federata “vatra” e Muzika*, HYLLI I DRITËS, 1923, nr. 3.

[GJERGJ FISHTA], (pa autor), *Kisha Katolike ka trajtue kulturen okcidentale*, HYLLI I DRITËS, 1923, nr. 4, 5, 6. (shkrim i Fishtës).

[GJERGJ FISHTA], (pa autor), *Arsim, a po luftë kundra Katoliqizmit në Shqypni?*, HYLLI I DRITËS, 1923, nr. 7. (në vend të autorit shkrimi është nënshkruar me DREJTIMI, e që ka kuptimin e Redaksisë, shkrimit të drejtuesve të revistës).

[GJERGJ FISHTA], Criticus, *Valët e Vijosës-prej Nazif O., Mamaçit* (1923), HYLLI I DRITËS, 1923, nr.8.

[GJERGJ FISHTA], (pa autor), *Tash qi ashrt ba Shqypnija duen per-ba shqyptarët*, HYLLI I DRITËS, 1930, nr. 4.

[GJERGJ FISHTA], (pa autor), *Nji atentat shurdhë*, HYLLI I DRITËS, 1930, nr. 12.

[GJERGJ FISHTA], (pa autor), *Leter e hapun z. Hilë Mosit*, HYLLI I DRITËS, 1932, nr. 12.

[GJERGJ FISHTA], autori: X., *Piksime Estetike mbi zeje të fjales*, HYLLI I DRITËS, 1932, nr. 7-8.

[GJERGJ FISHTA], autor: -a. *Shinime estetike.- Mbi natyrë t'Artit*, HYLLI I DRITËS, 1933, nr. 1, 2.

[FISHTA, GJERGJ], *Hijeve të Parnasit*, HYLLI I DRITËS, 1932, nr. 12.

[FISHTA, GJERGJ], *Parathanie*, në *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, te HYLLI I DRITËS, 1933, nr. 4.

LITERATURA

“Meshari” i Gjon Buzukut I-II, botim kritik, punuar nga EQREM ÇABEJ, Universiteti Shtetëror i Tiranës, 1968.

ALIÇKAJ, DR. XHAVIT, *Lahuta e Malcisë e Gjergj Fishtës*, Faik Konica, Prishtinë, 2000.

ANGELA CIRRINCIONE, *Hymje*, në At Bernardin Palaj, *Vepra*, Botimet Françeskane, Shkodër, 2005.

ARDIAN MARASHI, *Konsiderata mbi gjuhën artistike të Fishtës*, në HYLLI I DRITËS, numër i posaçëm, Tiranë, 1996.

ARISTOTELI, *Poetika*, Rilindja, Prishtinë.

ASLLANI, ALI, *Vepra 1, (Poezi I, Hanko Halla)*, zgjedhi dhe përgatiti për shtyp Mr. Kajtaz Rrecaj, Rilindja, Prishtinë, 1984.

BALA, VEHBI, *Gjergj Fishta-jeta dhe vepra*, Ombra GVG, Tiranë, 1998.

BASHOTA, DR. SALI, *Kuteli prozator, poet, kritik*, Rilindja, Prishtinë, 1999.

BEKER, MIROSLAV, *Povijest knjizevnih teorija*, SNL, Zagreb, 1979.

BEKER, MIROSLAV, *Suvremene knjizevne teorije*, SNL, Zagreb, 1986.

BERISHA, ANTON, *Përkime poetike*, Rilindja, Prishtinë, 1978.

BERISHA, ANTON NIKË, *Piksime estetike mbi artin e fjalës*, Shpresa, Prishtinë, 2003.

BERISHA, ANTON NIKË, *Qasje poetikës së letërsisë gojore shqipe*, Rilindja, Prishtinë, 1998.

BERISHA, ANTON NIKË, *Vepër e qenies dhe e qenësisë sonë*, Shpresa & Faik Konica, Prishtinë, 2003.

BERISHA, ANTON, *Epika gojore shqiptare dhe epika e shkruar e Gjergj Fishtës*, GJURMIME ALBANOLOGJIKE (folklor dhe etnologji), Instituti Albanologjik i Prishtinës, nr. 20, 1990.

BERISHA, ANTON, *M. Lambertzi për Gjergj Fishtën si Homeri Shqiptar*, GJURMIME ALBANOLOGJIKE (folklor dhe etnologji), Instituti Albanologjik i Prishtinës, nr. 22, 1992.

PARRY, MILMAN, *Biseda e Salih Uglaninit me M. Parry rreth këndimit në shqip e në boshnjakisht*, Pllaka nr. 654, Pllaka nr. 906, 908, 909, 910, 911, 912, 913, 914, Transkripti i N. Vujnoviqit për të njëjtat, 16 nëntor 1934, në WWW.chs.harvard.edu/mpc/

BLANCHUS, FRANCISCUS, *Dictionarium latino-epiroticum*, Me parathënie nga Mario Roques, botim anastatik, Çabej, Tiranë, 2006.

BOGDANI, PJETËR, *Çeta e Profetëve*, transliteruar në gjuhën e sotme shqipe, përkthimet dhe parathënien nga Dr. Engjull Sedaj, Rilindja, botim anastatik, Prishtinë, 1989.

BUDA, ALEKS, *Eposi dhe historia jonë*, GJURMIME ALBANOLOGJIKE (folklor dhe etnologji), Instituti Albanologjik i Prishtinës, nr. 23, 1993.

BUDI, *Poezi 1618-1621*, parathënia, tejskrimi dhe komentet nga Rexhep Ismajli, Rilindja, Prishtinë, 1986.

ÇABEJ, DR. EQREM, *Për gjenezën e literaturës shqipe*, në *Studime gjuhësore V*, Rilindja, Prishtinë, 1975.

ÇABEJ, DR. EQREM, *Studime gjuhësore V (Gjuhë-Folklor-Letërsi-Diskutime)*, Rilindja, Prishtinë, 1975.

ÇABEJ, DR. EQREM, *Studime gjuhësore VI, (Gjon Buzuku dhe gjuha e tij)*, Rilindja, Prishtinë, 1977.

ÇABEJ, EQREM, *Romantizmi në Europë lindore e juglindore dhe në literaturën shqipe, në Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes*, Çabej Eqrem MÇM, 2002

ÇABEJ, EQREM, *Epika e Gjergj Fishtës*, JETA E RE, nr. 11-12, Prishtinë, 1990 (numër kushtuar Fishtës).

ÇABEJ, EQREM, *Shqiptarët midis Perëndimit dhe Lindjes*, Çabej MÇM, Tiranë, 2002.

ÇAJUPI, A. Z., *Baba Musë Lakuriq*, Rilindja, Prishtinë, 1983.

ÇAKOLLI, MR. FEHMI, *Kodi Biblik në letërsinë shqiptare 1462-1947*, Tenda, Prishtinë, 2003

CAMAJ, MARTIN, *Shëndrrimi e përpunimi i thanjeve popullore në Lahutën e Malcis*, JETA E RE, nr. 11-12, Prishtinë, 1990 (numër kushtuar Fishtës).

ÇAPALIKU, DR. ALFRED, *Parathëniet e Fishtës*, AT GJERGJ FISH-TA/ KOMB-LETËRSI-GJUHË, Universiteti i Shkodrës, 1997.

ÇAPALIKU, STEFAN, *Fishta satirik*, Universiteti i Shkodrës, 1995.

ÇETTA, ANTON, *Kërkime folklorike*, Rilindja, Prishtinë, 1981.

ÇOBANI, TONIN, *Fishtologji*, Enti Botues "Gjergj Fishta", Tiranë, 2006.

ÇOBANI, TONIN, *Miti dhe antimiti fishtjan*, Enti Botues Lisitan, 1999, (pa vend të botimit).

ÇOBANI, TONIN, *Pjetër Zarishi dhe Krijimi i Rruzullimit*, Botimet Toena, Tiranë, 2007

ÇOBANI, TONIN, *Princi i përfolur Lekë Dukagjini*, monografi, Enti Botues Lisitan & Toena, Tiranë, 2003.

CORDIGNANO S. J., P. FULV, “Kangë kreshnikësh” në *Shqypnin e Verit*, në HYLLI I DRITËS, 1941, nr. 1-2 dhe nr. 3-5.

CORDIGNANO S. J., P. FULV, *Vasha nëpopen kombtare të popullit shqypnar: Tringa e Malcis*, në HYLLI I DRITËS, 1939, nr. 11-12 dhe 1940, nr. 1-2.

ÇUBELIQ, TVRTKO, *Knjizevni leksikon*, Zagreb, 1972.

CURTIUS, ERNST R., *Evropska knjizevnost i latinsko srednjovekovlje*, MH, Zagreb, 1971.

DARA I RIU, GAVRILL, *Vepra, Poezi & Kënga e sprasme e Balës*, përkthyer dhe përshtatur nga Prof. Asist. Klara Kodra, Argeta LMG, Tiranë, 2006.

DE MARTINI, ATË LEONARD, *Harpa Arbnore*, transkriptimi Anton Nikë Berisha, Shpresa & Faik Konica, Prishtinë, 2002.

DE RADA, JERONIM, *Vepra 2, Serafina Topia, Skanderbeku i pafan*, përshtatur në gjuhën e sotme nga Andrea Varfi, Rilindja, Prishtinë, 1988.

DE RADA, JERONIM, *Vepra 3, Këngët e Milosaos*, përshtatur në gjuhën e sotme nga Dhimitër S. Shuteriqi, Rilindja, Prishtinë, 1988.

DE RADA, JERONIM, *Vepra 5, Rapsodi të një poeme shqiptare*, transliteruar e përgatitur për shtyp nga Anton Çetta e Anton Berisha, Rilindja, Prishtinë, 1983.

DE RADA, JERONIM, *Vepra 6, Skanderbeku i pafan*, përshtatur në gjuhën e sotme nga Jup Kastrati, Rilindja, Prishtinë, 1988.

DE RADA, JERONIM, *Vepra 7, Parime të estetikës* (përkthyer nga Engjëll Sedaj), *Autobiografia 1898-1899* (përkthyer nga Jup Kastrati),

Publicistika dhe letërkëmbimi (përkthyer nga Jup Kastrati) etj., Rilindja, Prishtinë, 1988.

DELA ROKA, ROBERTO MAROCO, *Kombi dhe feja në Shqipëri 1920-1944*, përkthyer nga Luan Omari, Elena Gjika, Tiranë, pa vit botimi.

DEMA, BENEDIKT, *Shtypi françeskan në Shqipëri*, HYLLI I DRITËS, 1940, nr. 12; 1941, nr. 3-5 dhe 6-8.

DEMIRAJ, BARDHYL, *Gjon Nikollë Kazazi dhe „Doktrina“ e tij*, ASHAK, Prishtinë, 2006.

DIBRA, MIASER, *Përkime të këngëve popullore epike dhe “Lahutës së Malcisë” së Gjergj Fishtës*, ÇËSHTJE TË FOLKLORIT SHQIPTAR, ASH e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, nr. 9, 2006.

DOÇI, PAL, *Historia në poezinë e Fishtës*, HYLLI I DRITËS, numër i posaçëm, Tiranë, 1996.

DUKA-GJINI, PAL, *Gjergj Fishta / Jeta dhe veprat*, Provinça Françeskane Shqiptare, 1992 (pa vend të botimit).

ECO, UMBERTO, *Për letërsinë*, Dituria, Tiranë, 2007.

ELSIE, ROBERT, *Introduction*, në *Gjergj Fishta, The Highland Lute/The Albanian National Epic*, I. B. Tauris & Co. Ltd., London, 2005.

ELSIE, ROBERT, *A Dictionary of Albanian Religion, Mythology, and Folk Culture*, Hurst & Company, London, 2001.

ELSIE, ROBERT, *Historia e letërsisë shqiptare*, përkthyer nga Abdu-rrahim Myftiu, Dukagjini, Pejë, 2001.

Epska tradicija Boshnjaka, Udruženje “Bosna”, Frederiksberg, Danska, 2000.

FETIU, DR. SEFEDIN, *Vepra e Migjenit dhe kritika e saj*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1984.

FISHTA O. F. M., P. ANTONIN, *Skanderbegu e Françeskajt*, HYLLI I DRITËS, 1930, nr. 7-8.

FRASHËRI, NAIM, Vepra 1, *Bagëti e Bujqësija, Lulet e verësë etj*, zgjodhi dhe i përgatiti për shtyp Rexhep Qosja, botim i dytë i plotësuar, Rilindja, Prishtinë, 1986.

FRASHËRI, NAIM, Vepra 2, *Vjersha për mësonjëtoret të para etj.*, zgjodhi dhe i përgatiti për shtyp Rexhep Qosja, Rilindja, Prishtinë, 1978.

FRASHËRI, NAIM, Vepra 3, *Histori e Skënderbeut*, zgjodhi dhe i përgatiti për shtyp Rexhep Qosja, Rilindja, Prishtinë, 1978.

FRASHËRI, NAIM, Vepra 4, *Qerbelaja*, zgjodhi dhe i përgatiti për shtyp Rexhep Qosja, Rilindja, Prishtinë, 1978.

FRASHËRI, SAMI, Vepra 2, *Shqipëria ç'ka qenë, çështë e çdo të bëhetë?*, Rilindja, Prishtinë, 1978.

GEGAJ O. F. M., P. ATANAZ, *Veper arsimore e Françeskajvet në Shqypni në shekullin XVII*, HYLLI I DRITËS, 1932, nr. 3.

GILBERT-KUN, *Istorija estetike*, Kultura, Beograd, 1969.

GJEÇAJ, PATER DANIEL, *Frati shqiptar*, në *Simpoziumi Fishta dhe Françeskanët*, Botimet Françeskane, 2003, fq. 18.

GJEÇOVI, SHTJEFËN, *Vepra 3, 4*, pëgatitur për shtyp nga Ramiz Kelmendi e Fahredin Gunga, Rilindja, Prishtinë, 1985.

GJEÇOVI-KRYEZIU, Shtjefën, *Agimi i gjytetnis*, në Gjeçovi, *Vepra 2*, pëgatitur për shtyp nga Ramiz Kelmendi e Fahredin Gunga, Rilindja, Prishtinë 1985.

GJINI, GASPER, *Ipeshkvia Shkup-Prizren nëpër shekuj*, Drita, Ferizaj, 1992.

GJOKA, BEHAR, *Poetika e Budit*, Albas, Tiranë-Tetovë, 2002.

Grup autorësh, *Çështje të folklorit shqiptar*, nr. 2 dhe nr. 3 (materiale të simpoziumit Epika heroike shqiptare, mbajtur më 20-22 tetor 1983), ASHSH, IP, Tiranë, 1986.

HAMITI, SABRI, *Faik Konica: jam unë*, Rilindja, Prishtinë, 1991.

HAMITI, SABRI, *Letërsia filobiblrike / Letërsia romantike*, Vepra letrare 7, Faik Konica, Prishtinë, 2002.

HAMITI, SABRI, *Letërsia moderne*, Vepra letrare 8, Faik Konica, Prishtinë, 2002.

HAMITI, SABRI, *Studime letrare*, Akademia e Shkenacave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë, 2003.

HAMITI, SABRI, *Tematologjia*, Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës, Prishtinë, 2005.

HAMITI, SABRI, *Vetëdija letrare*, Rilindja, Prishtinë, 1989.

HAXHIHASANI, QAMIL, *Gjergj Elez Alia (gjeneza, zhvillimi, tipologjia)*, ÇËSHTJE TË FOLKLORIT SHQIPTAR, ASH e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, nr. 5, 1997.

HAXHIHASANI, QEMAL, *Mendësi zotëruese në ciklin e kreshnikëve*, GJURMIME ALBANOLOGJIKE (folklor dhe etnologji), Instituti Albanologjik i Prishtinës, nr. 21, 1991.

HAXHIHASANI, QEMAL, *Një cikël i epikës shqiptare të shekullit XV dhe rrezatimi i tij ballkanik*, GJURMIME ALBANOLOGJIKE (folklor dhe etnologji), Instituti Albanologjik i Prishtinës, nr. 20, 1990.

HESIOD, *Postanak bogova/Homerove himne*, me një parathënie dhe komente të Dr. Branimir Gllaviqic, Veselin Maslesa, Sarajevo, 1975.

HORACI, *Arti Poetik*, përkthyer prej Dr. Engjëll Sedaj, Buzuku, Prishtinë, 2000.

HOXHA, DR. FATBARDHA, *Mitologji në poemën Lahuta e Malcis*, AT GJERGJ FISHTA/ KOMB-LETËRSI-GJUHË, Universiteti i Shkodrës, 1997.

HOXHA, DR. SAFET, *Çështje të marrëdhënieve të Fishtës me disa poetë kroato-dalmatinë e boshnjakë*, në *At Gjergj Fishta/Komb-Letërsi-Gjuhë*, Universiteti L. G. i Shkodrës, 1997.

HOXHA, DR. SAFET, *Çështje të marrëdhënieve të Fishtës me disa poetë kroato-dalmatinë e boshnjakë*, AT GJERGJ FISHTA/ KOMB-LETËRSI-GJUHË, Universiteti i Shkodrës, 1997.

HOXHA, HYSNI, *Cikli i Kreshnikëve dhe Lahuta e Malcis*, JETA E RE, nr. 11-12, Prishtinë, 1990 (numër kushtuar Fishtës).

HOXHA, HYSNI, *Struktura e vargut shqip*, Rilindja, Prishtinë, 1973.

HYSA, PROF. DR. MAHMUD, *Hyrje në letërsinë shqiptare*, Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore i Kosovës, Universiteti i Prishtinës, 2000.

ISMAJLI, REXHEP, *Tekste të vjetra*, Dukagjini, Pejë, 2000.

JAKU, PJETËR, *Fjalori fishtian*, Kuvendi, Lezhë, 2000.

JAKU, PJETËR, *Vlerat letrare në Lahutën e Malcis të Gjergj Fishtës*, Kuvendi, Lezhë, 2000.

JEFFERSON ANN, ROBEY DAVID, *Teoria letrare moderne/Një paraqitje krahasuese*, Albas, 2004.

KADARE, ISMAIL, *Autobiografia e popullit në vargje*, Onufri, Tiranë, 2002.

KALOÇI, DASHNOR, "Fjalim i panjohur i Aleksandër Xhuvanit në varrimin e Fishtës", në *Gazeta Shqiptare*, 15.12.2002 dhe WWW.shkoder.net/al/fishta4.htm

KAMSI, KOLË, *Vepra poetike e Fishtës dhe kritika*, JETA E RE, nr. 11-12, Prishtinë, 1990 (numër kushtuar Fishtës).

KAMSI, WILY, *Shkrimtarët katolikë shqiptarë, në vështrimin e albanologut anglez Stuart E. Man*, në *Gazeta* 55, 28 Mars 2004.

KASTRATI, JUP, *Studime për De Radën*, Gjonlekaj Publishing Co, New York, 2003.

KOLGJINI, TAHIR, *Shpalime rreth Lahutës (Shpalon disa fjalë shqipe të përdoruna në "Lahuta e Malcis")*, Istanbul, 1969.

KOLIQUI, ERNEST, *Dy shkollat letrare shkodrane*, (shkruar më 1954-1961); Kisha e Shën Ndoit, Prishtinë, 1998; (botim i parë, i përgatitur nga Hasan Hasani).

KOLIQUI, ERNEST, *Fishta interpret i shpirtit shqiptar*, Kuvendi Françeskan, Gjakovë, 1997 (përgatitur për shtyp nga Hasan Hasani).

KOLIQUI, ERNEST, *Kritikë dhe estetikë*, (përgatitur nga Stefan Çapaliku), Apollonia, Tiranë, 1999.

KOLIQUI, ERNEST, *Qytetnimi Shqiptar*, HYLLI I DRITËS, 1932, nr. 1.

KONICA, FAIK, *Vepra 1*, zgjedhur e përgatitur nga Nasho Jorgaqi, Botimet Dudaj, Tiranë, 2001.

KOSUMI, BAJRAM, *Lirika e Fishtës*, Botimet Toena, Tiranë, 2004.

KOSUMI, BAJRAM, *Vinçenc Prennushi dhe poezia popullore*, në *Jeta e re*, nr. 4, 2000, Prishtinë.

KOSUMI, BAJRAM, *Pikëpamjet teorike të Vinçenc Prennushit për letërsinë popullore*, në *Fjala*, nr. 4, 1997.

KOTORRI, DR. PETRIT, *Dy letra të pabotuara të At Gjergj Fishtës për albanologun e shquar austriak, Norbert Jokli*, AT GJERGJ FISHTA/KOMB-LETËRSI-GJUHË, Universiteti i Shkodrës, 1997.

KRASNIQI, DR. MILAZIM, *Soneti në poezinë shqipe*, PEN Qendra e Kosovës, 2005.

KURTI O. F. M, P. DONAT, *Vepra Kulturele e Elementit Katolik në Shqypni*, HYLLI I DRITËS, 1933, nr. 5-6.

LAMBERTZ, MAKSIMILIAN, *Disa mendime për Fishtën dhe veprën e tij*, JETA E RE, nr. 11-12, Prishtinë, 1990 (numër kushtuar Fishtës).

LAMBERTZ, MAKSIMILIAN, *Epika popullore shqiptare*, botim te Çështje të folklorit shqiptar (botimi origjinal: Die Volksepik der Albaner, Leipzig, 1958, 184 p.), përkthyer nga Eqrem Çabej, ASHRSH, Instituti i Kulturës Popullore, nr. 6, 1998.

LAMBERTZ, MAXIMILIAN, *Die Homerische Frage und des Albanische Grossepos*, në *Jeta e re*, nr. 11-12, 1990.

MALAJ, VINÇENC, *Kontributi i Françeskanëve në letërsinë shqipe*, në *Letërsia si e tillë*, ASHSH, Toena, 1996.

MANDALA, MATTEO, *Gjurmime filologjike/ Për letërsinë e vjetër arbëreshe*, Çabej, Tiranë, 2006.

MARKU, RUDOLF, *Fishta, interpret i genit shqiptar*, HYLLI I DRITËS, numër i posaçëm, Tiranë, 1996.

MATO, JAKUP, *Rreth komedive të Kristo Floqit*, në *Letërsia si e tillë*, Toena, 1996.

MEHMETI, ENVER, *Lahuta e Malcis dhe eposi popullor*, JETA E RE, nr. 11-12, Prishtinë, 1990 (numër kushtuar Fishtës).

MELETINSKI, E. M., *Poetika mita*, Nolit, Beograd, pa vit botimi.

Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, vëllimi I, Universiteti i Tiranës, Inst. i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë, 1971 (përmbledhje artikujsh nga shtypi, përgatitur nga Zihni Haskaj).

Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, vëlimi II, Akademia e Shkencave e RPSH, Inst. i Historisë, Tiranë, 1976 (përmbledhje artikujsh nga shtypi, përgatitur nga Zihni Haskaj).

MIRDITA, ZEF, *Krishtenizmi ndër shqiptarë*, Drita & Misioni Katolik Shqiptar në Zagreb, Prizren-Zagreb, 1998.

MUHAMETAJ, ENVER, *Vështrim mbi mendimin letrar dhe estetik shqiptar të periudhës 1912-1944*, në *Letërsia si e tillë*, Toena, Tiranë, 1996, fq. 113-123.

NDOJA, MARK, *Kritika klasike dhe leksione greko romake*, Arbëria, Tiranë, 2003.

NEZIRI, ZYMER UJKAN, *Studime për folklorin I*, IA i Prishtinës, Prishtinë, 2006.

NEZIRI, ZYMER, *Po hapet dosja H në Universitetin e Harvardit*, Kultura popullore, nr. 1-2, Tiranë, 2003.

NOLI, F.S., *Albumi*, Rilindja, 1968.

NORWICH, JOHN JULIUS, *Bizanti-shkëlqimi dhe rënia e një perandorie 330-1453*, UEGEN, 2005.

P. P. NJEGOSH, *Kunora e maleve*, Rilindja, Prishtinë, 1973.

PANAJOTI, JORGO, *Eposi shqiptar i kreshnikëve*, GJURMIME ALBANOLOGJIKE (folklor dhe etnologji), Instituti Albanologjik i Prishtinës, nr. 33-34, 2003-2004.

PAVLICIC, PAVAO, *Epsko pjesnistvo*, në *Uvod u knjizevnost*, përgatitur nga Z. Skreb/A. Stamac, Globus, Zagreb, 1986.

PLASARI, AUREL, *Fishta i dashuruari*, botim i autorit, Tiranë, 1996.

PLASARI, AUREL, *Fishta meditants*, parathënie në librin *Fishta, Estetikë dhe Kritikë*, HYLLI I DRITËS & Shtëpia e librit, Tiranë, 1999.

PLASARI, AUREL, *Gjergj Fishta dhe historia e letërsisë*, në *Hylli i Dritës*, numër i posaqëm, Tiranë, 1996.

PLASARI, AUREL, *Moderniteti i një satire klasike*, parathënie në Gjergj Fishta, *Satirika*, Rilindja, Prishtinë, 1997.

PLATONI, *Shteti*, Rilindja, Prishtinë.

PLLANA, SHEFQET, *Këngët mitologjike dhe legjendare*, ÇËSHTJE TË FOLKLORIT SHQIPTAR, ASH e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, nr. 9, 2006.

PORADECI, LLASGUSH, *Gjergj Fishta lirik*, JETA E RE, nr. 11-12, Prishtinë, 1990.

PRENNUSHI, VINÇENC, *Kangë popullore gegnishte*, Botime Françeskane, Shkodër, 2005 (botimi i parë në Sarajevo, 1911).

PRIFTI, PETER, *The Catholic Clergy and Albanian Literature*, versioni elektronik.

QAUSHI, TEFIK, *Fjalor i estetikës*, Ombra GVG, Tiranë, 2005.

QOSJA, REXHEP, *Asdreni*, botim i dytë, Rilindja, 1987.

QOSJA, REXHEP, *Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi I*, Rilindja, Prishtinë, 1984.

QOSJA, REXHEP, *Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi II*, Rilindja, Prishtinë, 1984.

QOSJA, REXHEP, *Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi III*, Rilindja, Prishtinë, 1986.

QOSJA, REXHEP, *Porosia e madhe*, Botimet Toena, Tiranë, 2000.

QOSJA, REXHEP, *Tri mënyra të shkrimit shqip*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, 2004.

RADOVANI-DE ANGELIIS, FRITZ, *Një monument nën dhe*, Zagreb, 2004.

RESULI, NAMIK, *Gjergj Fishta dhe gjuha shqipe*, te JETA E RE, nr. 11-12, 1990.

RESULI, PROF. DR. KAPLLAN, *Fishta dhe të tjerët*, Naum Veqilharxhi, Tiranë, 2001.

RIZA, SELMAN, “*Historiku e kritika e trajtimeve të dertanishme të nyjave të shqipes nga gramatikanët përshkrues*”, (në botimin *Vepra 4 të S. Rizës*, ASHAK, 2004).

RIZA, SELMAN, *Krestomaci*, (në botimin *Vepra 4 të S. Rizës*, ASHAK, 2004).

RIZA, SELMAN, *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe* (në botimin *Vepra 4 të S. Rizës*, ASHAK, 2004).

Rizah Bllaca I, II, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1997 (përmbledhje këngësh popullore të kënduara nga rapsodi Riza Bllaca, përgatitur për shtyp nga Dr. Rrustem Berisha, Dr. Sadri Fetiu dhe Mr. Jahir Ahmeti).

RIZAJ, DR. SKENDER, *Dukagjini (1202-1462), Sanxhaku i Dukagjinit (1462-1846) dhe Sanxhaku i Pejës (1881-1912)*, në *Vjetar XXII-XXVIII*, Arkivi Kombëtar i Kosovës, 2002.

RRAHMANI, ZEJNULLAH, *Arti i poezisë*, Faik Konica, Prishtinë, 2001.

RRAHMANI, ZEJNULLAH, *Probleme të metodës në shkrimin historiko-letrar*, në *Letërsia si e tillë*, Toena, Tiranë, 1996.

RUGOVA, IBRAHIM, *Kahe dhe premisa të kritikës letrare shqiptare 1504-1983*, Faik Konica, Prishtinë, 2005.

RUGOVA, IBRAHIM, *Vepra e Bogdanit 1675-1685*, Rilindja, Prishtinë, 1990.

SADRI, FETIU, *Evropa në këngët popullore të Rilindjes Kombëtare*, GJURMIME ALBANOLOGJIKE (folklor dhe etnologji), Instituti Albanologjik i Prishtinës, nr. 23, 1993.

SAMUEL ENOCH STUMPE, *Filozofia, historia dhe problemet*, Botimet Toena, Tiranë, pa vit botimi.

SANTORI, FRANGJISK ANTON, *Vepra 1*, përgatiti për botim Fahredin Gunga, me një parathënie të gjatë të Andrea Varfit, Rilindja, Prishtinë, 1993.

SCHMITT, OLIVER JENS, *Arbëria venedike 1392-1479*, K&B, Tiranë, 2007.

SEDAJ, ENGJËLL, *Etnokultura në peshojë*, intervista dhe polemika, Buzuku, Prishtinë, 2001.

SEDAJ, ENGJËLL, *Shënim i përkthyesit*, në Jeronim de Rada, *Parime të estetikës*, Rilindja, Prishtinë, 1988.

SHALA, DEMUSH, *Këngë popullore legjendare*, ETMM, Prishtinë, pa vit botimi.

SHALA, KUJTIM M., *Shinimet e Fishtës*, AIKD, Prishtinë, 2000.

SHËN AUGUSTINI, *Rrëfimet*, Plejad, Tiranë, 2006.

SHOQNIA ILLYRICUM, *Simpoziumi Fishta dhe Françeskanët*, Botime Françeskane, 2003.

SHUFLAJ, MILAN, *Serbët dhe Shqiptarët*, Botimet Toena, Tiranë, 2004.

SHUTERIQI, DHIMITËR S., *Tekstet shqipe dhe shkrimi i shqipes në vitet 879-1800*, ASHSH, Tiranë, 2005.

SHUTERIQI, DHIMITËR, *Metrika shqipe*, Prishtinë, 1968 (botim i parë në Tiranë 1947).

SHUTERIQI, MEDIHA/ ANDONI, DHIMITËR, *Veprimtaria antikombëtare e klerit katolik të Shqipërisë në shërbim të fashizmit italian*, në *Studime historike*, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, nr. 2, 1968 (revistë).

SINANI, SHABAN, *Mitologji në Eposin e Kreshnikëve*, Argeta LMG, Tiranë, 2006.

SINANI, SHABAN, *Ura dhe kështjella*, Argeta LMG, Tiranë, 2006.

SIRDANI O. F. M., ATË MARIN, *Françeskanët në Shqypni dhe shqyptarët katolikë në lamë t'atdhetarisë*, zgjodhi dhe përgatiti Anton Nikë Berisha, Shpresa, Prishtinë, 2002.

SIRDANI O. F. M., ATË MARIN, *Shqyptarët e hartet*, HYLLI I DRITËS, 1921, nr. 4, 7; 1922, nr. 2, 4, 11, 12; 1923, nr. 5.

SIRDANI O. F. M., P. MARIN, *Kontributi i elementit katolik shqyptar në lamë t'atdhetaris që prej kohve të vjetra deri në kohën e Turqve të Ri*, HYLLI I DRITËS, 1933, nr. 7-8.

SIRDANI, P. MARIN, *Nji rival i Skanderbegut*, HYLLI I DRITËS, 1932, nr. 7-8, 9, 12.

SIRDANI, ATË MARIN, *Ndriçime të historisë, të kulturës dhe të artit shqiptar*, (zgjodhi dhe përgatiti për shtyp Anton Nikë Berisha), Shpresa, Prishtinë, 2002,

SKENDI, STAVRO, *Zgjimi kombëtar shqiptar*, Phoenix, 2000.

SKIROI, ZEF, *Vepra 2, Lirika të shpërndara etj.*, Faik Konica, Prishtinë, 2001.

SKIROI, ZEF, *Vepra 2, Te dheu i huaj etj.*, Faik Konica, Prishtinë, 2001

SKIROI, ZEF, *Vepra 3, Këthimi etj.*, Faik Konica, Prishtinë, 2001

SKREB, Z./STAMAC, A., *Uvod u knjizevnost/teorija, metodologija*, Globus, Zagreb, 1986.

SOPI, IMZOT MARK, *Koncilet Ekumenike*, Drita, Prizren, 2000.

STUMPF, S. E., *Filozofia-historia dhe problemet*, Botimet Toena, Tiranë.

TAIPI, KASEM, *Këngë popullore Shkodrane*, ASHSH-IKP, Tiranë, 1998 (botimi i parë në tri vëllime, Tiranë, 1933)

TIRTA, MARK, *Mitologjia ndër shqiptarë*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2004.

TIRTA, MARK, *Tradita popullore në vizionin poetik të Fishtës*, HYL-LI I DRITËS, numër i posaçëm, Tiranë, 1996.

TODOROV, TZVETAN, *Poetika e prozës*, Panteon-Shtëpia e Librit, Tiranë, 2000.

UÇI, ALFRED, *Estetika e groteskut/Grotesku në letërsinë Shqipe*, libri IV, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2001.

UÇI, ALFRED, *Mitologjia, folklori, letërsia*, Naim Frashëri, Tiranë, 1982.

UÇI, ALFRED, *Pesë të mëdhenjtë e letërsisë shqipe në optikën e një rileximi*, Vatra, Shkup, Tiranë, 2003.

VASA, PASHKO, *Vepra 1*, përgatitur për shtyp nga Fahredin Gunga, Rilindja, 1989.

VELEK-VOREN, *Teoria e letërsisë*, Rilindja, Prishtinë, 1982.

VINCA, AGIM, *Kurs i teorive letrare*, Libri Shkollor, Prishtinë, 2002.
Visaret e Kombit I (KARL GURAKUQI e FILIP FISHTA), Rilindja, Prishtinë, 1996 (botimi i parë në Tiranë 1937).

Visaret e Kombit II (BERNARDIN PALAJ e DONAT KURTI), Botimet Françeskane, Shkodër, 2005 (botimi i parë në Tiranë 1937).

Visaret e Kombit IV, Shtëpia Botonjëse “Kristo Luarasi”, Tiranë, 1939.

ZARISHI, PJETËR, *Vjerrsha të pabotueme të t’Ëmzot P. Zarishit / Krijimi i Rruzullimit* (tingëllima III, IV, V, VI), HYLLI I DRITËS, 1936, nr.10.

ZARISHI, PJETËR, *Vjerrsha të pabotueme të t’Ëmzot P. Zarishit / Krijimi i Rruzullimit* (tingëllima VII, VIII, IX, X, XI), HYLLI I DRITËS, 1936, nr. 11.

WAJLDER LEIN, ROUZ, *Majat e Shalës* (përkthyer nga Avni Spahiu), Rilindja, Prishtinë, 1997.

XHIKU, ALI, *Duke lexuar letërsinë e traditës*, Dituria, Tiranë, 2003.

XHOLI, ZIJA, *Pesë mendimtarët më të vjetër të kulturës sonë kombëtare*, ASHSH, 2003.

YAMAMOTO, KAZUHIKO, *The Etikal structure of Kanun and cultural implications/Struktura etike e Kanunit dhe nënkuptimet e saj kulturore*, Printed in the United States of America, March, 2005. Përkthyer dhe përgatitur për botim nga Dr. Selahedin A. Velaj.

ZAMPUTI, INJAC, *Fishta, koha njeriu vepra*, Pasqyra, Tiranë, 1993.

ZEJNULLAHU, ADEM, *Figura e Oso Kukës në këngët popullore dhe në Lahutën e Malcis të Gjergj Fishtës*, GJURMIME ALBANOLOGJIKE (folklor dhe etnologji), Instituti Albanologjik i Prishtinës, nr. 26, 1996.

ZHEJI, GJERGJ, *Bazat e vargëzimit shqiptar*, Rilindja, Prishtinë, 1990.

ZHEJI, GJERGJ, *Elemente të vargëzimit në Lahutën e Malcis*, HYLLI I DRITËS, numër i posaçëm, Tiranë, 1996.

ZHEJI, GJERGJ, *Vëzhgime metrike*, Rilindja, Prishtinë, 1981.

Aa. Nn., *Historia e letërsisë shqiptare*, Rilindja, Prishtinë, 1989 (sipas botimit të ASH të RPS të Shqipërisë, 1983).

Aa. Nn., *Historinë e Popullit Shqiptar, I-II*, ASHSH, Instituti i Historisë, Botimet Toena, Tiranë 2002.

Aa. Nn., *Recnik knjizevnih termina*, Nolit, Beograd, 1992.

Aa.Nn., *Letërsia si e tillë, probleme të vlerësimit të trashëgimisë sonë letrare* (akte të Konferencës shkencore në Tiranë, organizuar nga Akademia e Shkencave dhe Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, më 28-29 mars 1996), Toena, Tiranë, 1996.

Aa. Nn., *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist*, ASH e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhës dhe i Letërsisë, Tiranë, 1978.

IKU, *Recnik knjizevnih termina*, Nolit, Beograd, 1992.

Këngë popullore të Rilindjes Kombëtare, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1978.

Balada dhe legjenda, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 1974.

Koleksioni i HYLLIT TË DRITËS i hulumtuar në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës

Numri i parë i HYLLIT TË DRITËS doli në tetor 1913. Ende pa u mbushë një vjet, në korrik 1914 revista ndalohej prej administratës ndërkombëtare të Shkodrës, për shkak të artikullit “Nji komedi e pandershme e XX qindvjetë” të Gjergj Fishtës. Periudha e dytë e daljes së revistës fillon në maj 1921 dhe përfundon në dhjetor 1924. Periudha e tretë e daljes fillon në janar 1930 dhe zgjatë deri në përfundim të Luftës së Dytë Botërore.

Mbas shumë dekada heshtjeje të dhunshme, më 1993 me nismën dhe nën drejtimin e Aurel Plasarit rifillon botimi i revistës HYLLIT TË DRITËS.

HYLLI I DRITËS, 1921, nr. 1.

1. Poezia e Mjedes “Lissus”, fq. 22-27.

HYLLI I DRITËS, 1921, nr. 2.

1. Rubrika “Bibliografi”, recensionin *Shqiptarët e të Drejtat e tynel* Fjala e Emzot Luigj Bumçi, mbajtur në Universitetin Katolik të Parisit, fq. 96.

2. P. Gjergj Fishta O. F. M., *Shqypnija e lirë (28 Nanduer 1921)*, fq. 70-73.

HYLLI I DRITËS, 1921, nr. 4.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M., *Kuvendi i Berlinit*, fq. 165-170.

2. (pa autor), *Shqiptarët e hartet*, fq. 170-179.

HYLLI I DRITËS, 1921, nr. 5.

1. (pa autor), *Mentaliteti i Shqypnis s'Mesme*, fq. 193-198.

2. Rubrika "Bibliografi", recension, *Juda Makabe* (1920).

3. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Ali Pasha i Guciës*, fq. 214-221.

HYLLI I DRITËS, 1921, nr. 6.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Lidhja e Prizrendit*, fq. 264-270.

HYLLI I DRITËS, 1921, nr. 7.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Lidhja e Prizrendit / Nji epizod i të tretit ble të "Lahutës së Malcis"*, fq. 264-270.

HYLLI I DRITËS, 1921, nr. 7.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Lidhja e Prizrendit / Nji epizod i të tretit ble të "Lahutës së Malcis"*, fq. 352-356.

2. (pa autor), *Shqiptarët e hartet*, fq. 339-344.

HYLLI I DRITËS, 1922, nr. I.

1. (pa autor), *Trazimet e Dhetorit*, fq. 1-7.

HYLLI I DRITËS, 1922, nr. II.

1. (pa autor), *Papa Benedikti XV*, fq. 49-57.

2. (pa autor), *Shqyptarët e hartet*, fq. 58-64.

HYLLI I DRITËS, 1922, nr. III.

HYLLI I DRITËS, 1922, nr. IV.

1. P. Marin Sirdani, *Shqyptarët e hartet*, fq. 178-186.

HYLLI I DRITËS, 1922, nr. V.

HYLLI I DRITËS, 1922, nr. VI.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Kulshedra/ (Nji epizod i të tretit ble të "Lahutës së Malcis")*, fq. 271-282.

HYLLI I DRITËS, 1922, nr. VII.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Kulshedra/ (Nji epizod i të tretit ble të "Lahutës së Malcis")*, fq. 324-331.

HYLLI I DRITËS, 1922, nr. VIII.

HYLLI I DRITËS, 1922, nr. IX.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Lugati / Nji epizod i të tretit ble të "Lahutës së Malcis"*, fq. 433-442.

HYLLI I DRITËS, 1922, nr. X.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Deka e Burrnija*, fq. 481-483.

Vërejtje: në këtë numër mungojnë dy shkrime, që duket mirë se janë prerë dhe hequr prej revistës. Dy shkrimet janë: P. Gjergj Fishta O. F. M, *Deka e Burrnija*, fq. 481-483, dhe *Nji dokument*, fq. 476. Por, Biblioteka kombëtare e ka edhe një ekzemplar tjetër të këtij numri dhe aty janë dy njësitë.

HYLLI I DRITËS, 1922, nr. XI.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Dervish Pasha / Nji epizod i të tretit ble të "Lahutës së Malcis"*, fq.528-534.

2. A. Marin Sirdani, *Shqiptarët e hartet VI*, fq. 539-546.

HYLLI I DRITËS, 1922, nr. XII.

1. A. Marin Sirdani, *Shqiptarët e hartet*, fq. 568-578.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Dervish Pasha / Nji epizod i të tretit ble të "Lahutës së Malcis"*, fq. 579-587.

HYLLI I DRITËS, 1923, nr. 1.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Cubat / Nji epizod prej vepret "Lahutës së Malcis"*, fq. 23-32.

HYLLI I DRITËS, 1923, nr. 2.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Prozodi latine*, fq. 71-75.

HYLLI I DRITËS, 1923, nr. 3.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Prozodi latine*, fq. 118-121.

2. (pa autor), *Federata "vatra" e Muzika*, fq. 138-144.

HYLLI I DRITËS, 1923, nr. 4.

1. (pa autor), *Kisha Katolike ka trajtue kulturen okcidentale*, fq. 145-153.

HYLLI I DRITËS, 1923, nr. 5.

1. (pa autor), *Kisha Katolike ka trajtue kulturen okcidentale*, fq. 194-200.

2. P. Marin Sirdani, *Shqiptarët e hartet*, fq. 219-223.

HYLLI I DRITËS, 1923, nr. 6.

1. (pa autor), *Kisha Katolike ka trajtue kulturen okcidentale*, fq. 252-256.

HYLLI I DRITËS, 1923, nr. 7.

1. (pa autor), *Arsim, a po luftë kundra Katoliqizmit në Shqypni?*, fq. 299.

(në vend të autorit shkrimi është nënshkruar me DREJTIMI, e që ka kuptimin e Redaksisë, shkrimit të drejtuesve të revistës).

2. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Prozodi latine*, fq. 318-320.

HYLLI I DRITËS, 1923, nr.8.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Mehmet Ali Pasha / Nji epizod prej veprët "Lahuta e Malcis"*, fq. 361-373.

2. Rubrika "Bibliografi", recensionin *Valët e Vijosës-prej Nazif O., Mamaçit* (1923), fq. 380-383. Autori: Criticus.

HYLLI I DRITËS, 1930, nr. 1.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Lahuta e Malcis (Te Ura e Sutjeskës)*, fq. 19-30.

HYLLI I DRITËS, 1930, nr. 2.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Lahuta e Malcis (Te Ura e Sutjeskës)*, fq. 91-105.

HYLLI I DRITËS, 1930, nr. 3.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Lahuta e Malcis (Pater Gjoni)*.

HYLLI I DRITËS, 1930, nr. 4.

1. (pa autor), *Tash qi ashrt ba Shqypnija duen perba shqyptarët*, fq. 185-195.

2. P. Antonin Fishta O. F. M., *Ma i pari Frat në Shqypni*, fq. 209-217.

3. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Lahuta e Malcis (Pater Gjoni)*, fq. 218-226.

HYLLI I DRITËS, 1930, nr. 5.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Lahuta e Malcis (Në Qafë-Hardhi)*, fq. 276-286.

HYLLI I DRITËS, 1930, nr. 6.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Lahuta e Malcis (Në Qafë-Hardhi)*, fq. 327-336.

HYLLI I DRITËS, 1930, nr. 7-8.

1. P. Antonin Fishta, *Skanderbegu e Françeskajt*, fq. 366-376.

2. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Lahuta e Malcis (Lekët)*, fq. 389-401.

HYLLI I DRITËS, 1930, nr. 9.

1. (pa autor), *Lmashku i hyperkultures në Shqypni*, fq. 457-468.

2. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Ifigenija n'Aulli, Tragedi per Institute Femnore të Shqypnis*.

HYLLI I DRITËS, 1930, nr. 10.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Ifigenija n'Aulli, Tragedi per Institute Femnore të Shqypnis*, fq. 561-568.

HYLLI I DRITËS, 1930, nr. 11.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Ifigenija n'Aulli, Tragedi per Institute Femnore të Shqypnis*, fq. 614-621.

HYLLI I DRITËS, 1930, nr. 12.

1. (pa autor), *Nji atentat shurdhë*, fq. 641-649.

2. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Lahuta e Malcis (Lekët)*, fq. 658-667.

HYLLI I DRITËS, 1932, nr. 1.

1. (pa autor), *Qytetnimi Shqiptar*, fq. 1-4.

HYLLI I DRITËS, 1932, nr. 2.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Nji udhtim në Turki të Re*, fq. 87-97.

HYLLI I DRITËS, 1932, nr. 3.

1. P. Atanaz Gegaj O. F. M, *Veper arsimore e Françeskajvet në Shqypni në shekullin XVII*, fq. 135-138.

2. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Nji udhtim në Turki të Re*, fq. 145-154.

HYLLI I DRITËS, 1932, nr. 4.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Nji udhtim në Turki të Re*, fq. 203-208.

HYLLI I DRITËS, 1932, nr. 5.

HYLLI I DRITËS, 1932, nr. 6.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Nji udhtim në Turki të Re*, fq. 303-310.

HYLLI I DRITËS, 1932, nr. 7-8.

1. P. Marin Sirdani O. F. M, *Nji Rival i Skanderbegut*, fq. 385-395.

2. *Piksime Estetike mbi zeje të fjales*, fq. 395-406, autori: X.

3. (pa autor), *Shqypnija Katolike në vjetë 1671*, fq. 410-424.

HYLLI I DRITËS, 1932, nr. 9.

1. (pa autor), *Atme e Shtet në kuptimin Katolik*, fq. 433-436.
2. P. Marin Sirdani O. F. M, *Nji Rival i Skanderbegut*, fq. 437-443.

HYLLI I DRITËS, 1932, nr. 10.

1. (pa autor), *Rrymw tw reja arsimore*.

HYLLI I DRITËS, 1932, nr. 11.

HYLLI I DRITËS, 1932, nr. 12.

1. (pa autor), *Leter e hapun z. Hilë Mosit*, fq. 593-610.
2. P. Marin Sirdani O. F. M, *Nji Rival i Skanderbegut*.
3. (pa autor), *Hijeve të Parnasit*, fq. 626-633.
4. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Nji udhtim në Turki të Re*, fq. 642-646.

HYLLI I DRITËS, 1933, nr. 1.

1. *Shinime estetike.- Mbi natyrë t'Artit*, fq. 8-12, autor: -a.
2. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Nji udhtim në Turki të Re*, fq. 45-52.

HYLLI I DRITËS, 1933, nr. 2.

1. *Shinime estetike.- Mbi natyrë t'Artit*, fq. 67-75, autor: -a.
2. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Lahuta e Malcis-Gusija/Natë kobi*, fq. 76-85.

HYLLI I DRITËS, 1933, nr. 3.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Lahuta e Malcis-Gusija/Natë kobi*, fq. 123-131.

HYLLI I DRITËS, 1933, nr. 4.

1. (pa autor), *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, fq. 153-163.

HYLLI I DRITËS, 1933, nr. 5-6.

1. P. Donat Kurti O. F. M, *Vepra Kulture e Elementit Katolik në Shqypni*, fq. 234-261.

2. Rivista e shtypit / *Indipendenca morale e Shqypnis*, fq. 288-304, autor: Criticus.

HYLLI I DRITËS, 1933, nr. 7-8.

1. (pa autor), *Lajçizmi në prenim?*, fq. 305-309.

2. P. Marin Sirdani, *Kontributi i elementit katolik shqyptar në lamë t'Atdhetaris që prej kohve të vjetra deri në kohën e Turqve të Ri*, fq. 327-351.

HYLLI I DRITËS, 1933, nr. 9-10.

HYLLI I DRITËS, 1933, nr.11.

1. P. Antonin Fishta O. F. M., *Njizetepesë vjetori i Kongresit të Monastirit 1908-1933*, fq. 519-524.

HYLLI I DRITËS, 1933, nr. 12.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Lahuta e Malcis (Lufta e Ballkanit 1912-1913)*.

HYLLI I DRITËS, 1934, nr. 1.

1. P. Marin Sirdani, *Kontributi i elementit katolik shqyptar në lamë t'Atdhetaris që prej kohve të vjetra deri në kohën e Turqve të Ri*, fq. 32-41.

HYLLI I DRITËS, 1934, nr. 2.

HYLLI I DRITËS, 1934, nr. 3.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Lahuta e Malcis. -Tringa*, fq. 116-139.

HYLLI I DRITËS, 1934, nr. 4.

HYLLI I DRITËS, 1934, nr. 5.

HYLLI I DRITËS, 1934, nr. 6.

1. P. Anton Harapi O. F. M., *Idealogi shqyptare*, fq. 265-272.

HYLLI I DRITËS, 1934, nr. 7-8.

1. P. Anton Harapi O. F. M., *Nji fyshek qorr*, fq. 313-321.

2. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Ke tbanat e Curr Ules-Lahuta e Malcis*, fq. 346-361.

HYLLI I DRITËS, 1934, nr. 9-10.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Zana e Vizitorit-Lahuta e Malcis*, fq. 414-427.

HYLLI I DRITËS, 1934, nr. 11.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Zana e Vizitorit-Lahuta e Malcis*, fq. 516-528.

HYLLI I DRITËS, 1934, nr. 12.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Zana e Vizitorit-Lahuta e Malcis*, fq. 572-588.

HYLLI I DRITËS, 1935, nr. 1.

HYLLI I DRITËS, 1935, nr. 2.

HYLLI I DRITËS, 1935, nr. 3.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Rivista e shtypit, "Vjerrsha heroike shqyptare"*, fq. 142-152.

HYLLI I DRITËS, 1935, nr. 4.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Gjaku i marrun- (Lahuta e Malcis)*, fq. 207-218.

HYLLI I DRITËS, 1935, nr. 4.

1. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Gjaku i marrun- (Lahuta e Malcis)*, fq. 245-252.

HYLLI I DRITËS, 1935, nr. 5.

HYLLI I DRITËS, 1935, nr. 6.

HYLLI I DRITËS, 1935, nr. 7-8.

HYLLI I DRITËS, 1935, nr. 9.

HYLLI I DRITËS, 1935, nr. 10.

1. *Shka duem na katolikët*, fq. 473-482

(pa autor, por është artikulli hyrës i revistës, që nënkupton se është i redaksisë, ose ka përkrahjen e saj)

HYLLI I DRITËS, 1935, nr. 11.

HYLLI I DRITËS, 1935, nr. 12.

HYLLI I DRITËS, 1936, nr. 1.

HYLLI I DRITËS, 1936, nr. 2.

1. (pa autor), *Për historin e alfabetit shqip*; autori sjell si shembull poezinë e Leonardo de Martinos *Vaj i hapses*, që është përkthim i poezisë *Il lamento della prigioniera* të Tommaso Grossit.

HYLLI I DRITËS, 1936, nr. 3.

HYLLI I DRITËS, 1936, nr. 4.

HYLLI I DRITËS, 1936, nr. 5.

HYLLI I DRITËS, 1936, nr. 6.

HYLLI I DRITËS, 1936, nr. 7-8.

1. (pa autor), *Turgut Pasha në "Lahutë të Malcis"*, marrë nga revista "Shkndija"; fusnotë e gjatë skjaruese me autor: Sh. R.

Vërejte: është teksti parë kritik për *Lahutën e Malcis* i botuar në HD.

HYLLI I DRITËS, 1936, nr. 9.

1. *Vjerrsha të pabotueme të t'Ëmz. P. Zarishit / 1. Të vërteta morale (a t'amshueme) 2. Krijimi i Rruzullimit* (tingëllima I, II), fq. 430-433.

HYLLI I DRITËS, 1936, nr.10.

1. *Vjerrsha të pabotueme të t'Ëmzot P. Zarishit / Krijimi i Rruzullimit* (tingëllima III, IV, V, VI), fq. 488-491.

HYLLI I DRITËS, 1936, nr. 11.

1. *Vjerrsha të pabotueme të t'Ëmzot P. Zarishit / Krijimi i Rruzullimit* (tingëllima VII, VIII, IX, X, XI), fq. 548-552.

HYLLI I DRITËS, 1936, nr. 12.

1. K. Prennushi, *Kuvendi i Gjuhadolit*, fq. 578-585.

HYLLI I DRITËS, 1937, nr. 1.

1. D. Aleksander Sirdani, *Fрати shqiptar*, fq. 41-42.

HYLLI I DRITËS, 1937, nr. 2-3.

1. (pa autor), *Fizjonomija e komit*, fq. 65-71; edhe pse s'ka autor, botohet në hyrje të revistës, që dtth. se është i editorit ose gëzon përkrahjen e editorit.

HYLLI I DRITËS, 1937, nr. 4.

HYLLI I DRITËS, 1937, nr. 5.

HYLLI I DRITËS, 1937, nr. 6.

HYLLI I DRITËS, 1937, nr. 7-8.

1. D. Nikoll Kimeza, *Hetime mbi vjetesrinë e rrjedhen e Derës Gjomarkaj e të Mirditës*, fq. 345-349.

2. D. Aleksander Sirdani, *Lauta Bridashe/Pater Ndou*, fq. 373-374.

3. (pa autor), *Para kujtimit të dhet dishmorve t'Atdheut në Gushtin e 1912*, fq. 375-381.

HYLLI I DRITËS, 1937, nr. 9-10.

1. Kolë Bib Mirakaj, *Kryengritja e Pukës rreth vjetit 1912*, fq. 459-468.

HYLLI I DRITËS, 1937, nr. 11.

1. P. Klement Miraj O. F. M., famullitar në Laç e Kurbin, *Kontributi i krahinës së Kurbinit në çashtjen kombtare*, fq. 561-564.

HYLLI I DRITËS, 1937, nr. 12.

1. P. Rrok Gurashi O. F. M., famullitar i Shalës, *Dukagjini per liri t'Atdheut*, fq. 569-576.

2. p. p., *Kryengritja e Zadrimes*, fq. 577-588.

3. *Kangët popullore në lvizje te Dukagjinit*, fq. 594-602.

HYLLI I DRITËS, 1938, nr. 1.

HYLLI I DRITËS, 1938, nr. 2-3.

HYLLI I DRITËS, 1938, nr. 4.

1.F. Fishta, *Si këndon Kosova?*, fq. 169-179.

Vërejtje: Është një motërzim i *Këngës për Luftën e Kosovës më 1389*, e kënduar në Prilep, Kosovë, nga këngëtari Hasan Dema-çufiqeviq, kënga ka 279 vargje.

HYLLI I DRITËS, 1938, nr. 5.

HYLLI I DRITËS, 1938, nr. 6.

HYLLI I DRITËS, 1938, nr. 7-8.

HYLLI I DRITËS, 1938, nr. 9.

HYLLI I DRITËS, 1938, nr. 10.

HYLLI I DRITËS, 1938, nr. 11.

HYLLI I DRITËS, 1938, nr. 12.

1. Dr. Eqrem çabej, *Për gjenezën e literaturës shqipe*, fq. 647-661.

HYLLI I DRITËS, 1939, nr. 1.

1. Dr. Eqrem çabej, *Për gjenezën e literaturës shqipe*, fq. 8-15.

HYLLI I DRITËS, 1939, nr. 2.

1. Dr. Eqrem çabej, *Për gjenezën e literaturës shqipe*, fq. 84-93.

HYLLI I DRITËS, 1939, nr. 3.

1. Dr. Eqrem çabej, *Për gjenezën e literaturës shqipe*, fq. 149-180.

2. Gegë Toska, *Gomari i Babatasit/pjesa e dytë, akti II, Neoshqiptarët*, fq. 181-193.

HYLLI I DRITËS, 1939, nr. 4.

HYLLI I DRITËS, 1939, nr. 5.

HYLLI I DRITËS, 1939, nr. 6.

HYLLI I DRITËS, 1939, nr. 7-8.

HYLLI I DRITËS, 1939, nr. 9-10.

HYLLI I DRITËS, 1939, nr. 11-12.

1. P. Fulv Cordignano, *Vasha nëpopen kombtare të popullit shqyptar: Tringa e Malcis*, fq. 518-538.

HYLLI I DRITËS, 1940, nr. 1-2.

1. P. Fulv Cordignano S. J., *Vasha nëpopen kombtare të popullit shqyptar: Tringa e Malcis*, fq. 11-27.

HYLLI I DRITËS, 1940, nr. 3-4.

HYLLI I DRITËS, 1940, nr. 5-6.

HYLLI I DRITËS, 1940, nr. 7-9.

1. *Telegrami përshëndetës i Viktor Emanuelit III për P. Gjergj Fishta*
O. F. M., fq. 297.

2. Gegë Toska, *Jerina a se mbretnesha e lulevet*, fq. 313-332.

HYLLI I DRITËS, 1940, nr. 10-11.

1. Gegë Toska, *Jerina a se mbretnesha e lulevet*, fq. 438-464.

HYLLI I DRITËS, 1940, nr. 12.

1. A. Gjergj Fishta O. F. M., *Meshtari i Malcis, vjershë*, fq. 557-560.

2. P. Benedikt Dema, *Shtypi françeskan në Shqypni*, fq. 605-626.

3. Në këtë numër mbizotërojnë urime, telegrame, letra e shkrime me rastin e 700 vjetorit të veprimit të françeskanëve në Shqipëri 1240-1940.

4. Në këtë numër botohet edhe një poezi në italisht me titull *San Francesco d'Assisi in Albania*, pa autor. Në fusnotë rdaksia jep sqarimin: “kjo vjerrshë u botue pikë së parit në vjetën 1896 prej P. Lorenc Mihaçeviq në perkohshmen “*Missioni Francescane*” (anno II, fasc. IV). Thotë se e xuer prej njaj dorshkrimit të vjeter (...) të nji Françeskani Shqyptar.”

HYLLI I DRITËS, 1941, nr. 1-2.

Disa faqe (po jo krejt numri!) i kushtohet vdekjes së Gjergj Fishtës.

HYLLI I DRITËS, 1939, nr. 3-5.

1. P. Fulv Cordignano, “*Kangë Kreshnikësh*” në *Shqypnin e Verit*, fq. 147-154.

2. P. Benedikt Dema, *Shtypi françeskan në Shqypni*, fq. 191-210.

3. P. Gjergj Fishta O. F. M, *Lahuta e Malcis/Canto XIII*, perkthye nga Ëmz. Jul Bonatti, fq. 211-218; editori bën shënimin se po paraqesin të parin përkthim në italisht të një kënge të Fishtës.

4. *Prej dorshkrimesh S'A. Gjergj Fishtës/ A. Gj. Fishta-A. Anton M. Zanonit S. J./tue e nxitë të vijojë perkëthimin e Eklogeve të Virgjilit*, fq. 222-223.

HYLLI I DRITËS, 1941, nr. 6-8.

1. *Eccellenza P. Giorgio Fishta O. F. M., Accademico d'Italia, Lahuta e Malcis / ad Il Liuto della Montagna / Canto V / La Morte*, perkthye prej Ëmz. Jul Bonatti, fq. 288-301.

2. P. Benedikt Dema, *Shtypi françeskan në Shqypni*, fq. 302-310.

HYLLI I DRITËS, 1941, nr. 9-10.

HYLLI I DRITËS, 1941, nr. 11-12.

HYLLI I DRITËS, 1943, nr. 9-12.

HYLLI I DRITËS, 1944, nr. 2.

GJERGJ FISHTA (1871-1940)

PASQYRË KRONOLOGJIKE E JETËS DHE VEPRËS SË FISHTËS

deri në vitin 1996

1871

- (23 tetor) Në fshatin Fishtë të Zadrimës lindi Gjergj Fishta, prej atit Ndoka i Simon Ndocit dhe ëmës Prenda e Lazër Kaçit. U pagëzua me emrin Zef nga poeti italiano-shqiptar Leonard de Martino (1830-1923), i cili në atë kohë shërbente si misionar françeskan në Kuvendin Fratnor në Troshan.

1877

- Filloi mësimet në një seminar françeskan të Shkodrës.

1880

- Vazhdoi mësimet në Kolegjin e porsahapur Françeskan të Kuvendit Fratnor të Troshanit, nën drejtimin e Atë Marianit nga Palmanova dhe Atë Giampiero nga Bergamo. Në këtë periudhë do të jetë ndikuar pashlyeshëm nga Leonard De Martino dhe shkrimet e tij poetike.

- Në këtë kohë sëmuret nga zemra dhe e dërgojnë për shërim në Raguzë (Dubrovnik).

1886

- Shtatë studentë të Kolegjit të Troshanit, midis të cilëve edhe Gjergj Fishta pesëmbëdhjetë vjeçar, caktohen të shkojnë për studime të larta jashtë vendit. Kështu, Gjergj Fishta e kryen vitin e provës në manastirin e Guca Gora-s afër Travnikut. Në këtë manastir, sipas zakonit, Zefi i Ndok Simon Ndocit ndërron emrin në Gjergj Fishta. Më pastaj, studimet për filozofi Fishta i ndoqi në Kuvendin Sutiska, ndërsa ato për teologji në Kuvendin Livno, të gjitha këto shkolla françeskane në Bosnjë e Hercegovinë.

1892

- Shkroi poezinë e parë *Al valente poeta, signor Silvio Kranjçeviç* (1892), shkruar në italisht, e të cilën ia kushtonte poetit lirik kroat Kranjçeviç Silvije Strahimir (1865-1908), të cilin e kishte bërë mik të ngushtë.

- Përkthen pjesë nga *Fausti* i Goethes (sipas Zef Pllumit).

1893

- Fishta përfundon studimet dhe kthehet në Shqipëri.

1894

- (25 shkurt, ditë e diel) Fishta tha meshën e parë në Kishën e Troshanit, ku u emërua edhe mësues i Kolegjit.

1895

- Nga ky vit është fletorja me poezitë e para origjinale të Fishtës (të pabotuara). Benedikt Dema në *Bibliogtrafinë* e tij i quan “Ushtrimet e para poetike” (sipas Zef Pllumit).

1899

- Fishta u caktua famullitar në Gomsiqe, në Abacinë e Mirditës. Këtu Fishta u njoh me jetën e vërtetë malësore shqiptare, të trashëguar me shekuj e të pandryshuar as nga pushtimi i gjatë osman.

- Bashkëthemelon shoqërinë letrare *Bashkimi*, e udhëhequr nga Imzot Preng Doçi (1846-1917).

1899-1900

- Fishta boton në *Albania* të Faik Konicës (1875-1942) poezi origjinale dhe “kangë malcorisht”, këto të fundit të afërta me këngët e mëvonshme të tij të *Lahutës së Malcis*.

1900

- Fillon të botojë poezi në revistën famëmadhe *Albania* të Faik Konicës. Ky vit shënon pikënisjen e vërtetë letrare të Fishtës.

1902

- Atë Gjergj Fishta u dërgua në Rapshë të Hotit si famullitar. Aty ai njohu Marash Ucin (1810-1914), luftëtar shqiptar me përvojë të gjatë, që kishte baritur dhe lundruar gjithë botën, dhe që kishte luajtur një rol të madh në luftërat e shqiptarëve kundër pushtimit të tokave shqiptare nga Mali i Zi në vitet 1879-1880 dhe në kryengritjen shqiptare kundër sundesve osmanë në vitin 1910. Ky njeri e fascinoi Fishtën, dhe ky njeri do të bëhet njëri prej heronjve kryesor në epin e më pastajmë të Fishtës *Lahuta e Malcis* (1905-1937).

- Emërohet drejtor i shkollës fratnore françeskane të Shkodrës, e themeluar më 1861.

- Emërohet sekretar i përgjithshëm i Misionit Françeskan në Shqipëri

1905

- Botoi, pa emrin e vet, pesë këngët e para të *Lahutës së Maltsiis/Kangë popullore* (Zadër). Përfshinë këngët: 1. Marash Uci, 2. Besa e lidhme, 3. Kushtrimi, 4. Lufta, 5. Kasneci.

- Botoi *Vierrsha t'pershpierteshme* (Shkodër), lirika fetare të përkthyer e të përshtatura në shqip.

1907

- Botoi, pa emrin e vet, bleun e dytë të *Lahutës së Maltsiis/Kangë popullore* (Zadër). Përfshinë këngët: 1. Çeta, 2. Cubat, 3. Kuvendi i Cetinës, 4. Deka.

- Botoi broshurën *Komisija e Kleri katolik* (Shkodër).

- Botoi, pa emrin e vet, *Anzat e Parnasit* (Sarajevë), poezi satirike.

1908

- Shoqëria Bashkimi botoi *Fjalori i rii i shqypes*, me një fond prej 11.000 fjalëve, e ku njëri prej autorëve qe edhe Fishta.

- Fishta mori pjesë në Kongresin e Manastirit, si përfaqësues i shoqërisë *Bashkimi*. Ai u zgjodh kryetar i komisionit që do të vendoste se cili alfabet do të përdorej në gjuhën shqipe. Në këtë kohë Fishta krijoi famën e vet ndër të gjithë shqiptarët, jo vetëm si poet epik e satirik, por edhe si dijetar, orator e patriot.

1909

- Botoi librin e lirikave fetare *Pika voëset* (Zader).

- Fishta shkroi sipas gjedhes së melodramës në prozë të A. Ughe-tit-t tekstin dramatik *Sh'Françesku i Asizit* dhe e shfaqti në „n'ane teatrore t'Shkolles Fretnore n'Shkoder, n'rasë t'shendvjetes shtatqindore t'themelimit t'Urdhnit Françeskan...“.⁴⁹⁸

498 Gjergj Fishta, Estetikë dhe Kritikë, Hylli i Dritës & Shtëpia e librit, Tiranë, 1999.

1911

- Arqipeshkvi i Shkodrës dhe Klubi Shkodran Gjuha Shqype i dhurojnë Fishtës një **Kunorë Lari n'argjend**, për veprën e tij poetike.

- Fishta shfaqti melodramën *Shqyptari i gjytetnuem*, në përvjetorin e pesëdhjetë të Shkollës Françeskane të Shkodrës.

- Sulltani osman e dekoron me nderimin **Mearif** për shërbime paqe e humanizmi.

1912

- Botoi melodramën *Vllaznija: Sh'Françesku i Azisit* (Shkodër), shkruar më 1909.

- *Lahuta e Malcis*, botim i dytë i bleut të parë (Shkodër).

- *Lahuta e Malcis*, botim i dytë i bleut të dytë (Shkodër).

- Dekorohet me **Ritterkreuz** nga Perandori austro-hungarez, për merita në zhvillimin e kulturës e të përparimit për popullin e tij.

- Në vitet e bujshme të formimit të shtetit shqiptar ai qe në Shkodër. Edhe gjatë rrethimit të Shkodrës nga forcat e Malit të Zi dhe pushtimit të tij nga malazezët qe aty (tetor 1912-prill 1913).

1913

- Mbas humbjes së forcave malazeze (14 maj 1913), Fishta ngriti në Kishën e Gjuhadolit në Shkodër flamurin shqiptar (12 qershor).

- *Mrizi i zanavet* (Shkodër), poezi patriotike.

- *Lahuta e Malcis*, botim i tretë i bleut të parë (Shkodër).

- *Lahuta e Malcis*, botim i tretë i bleut të dytë (Shkodër).

- Fishta nxori numrin e parë të revistës *Hylli i Dritës*, e cila pati një rol të rëndësishëm në jetën kulturore e letrare shqiptare dhe doli, me disa përjashtime deri në vitin 1944.

1913. Fishta boton shkrimin e njohur *A janë t'zot Shqyptarët me u mbajtë shtet m'vedi?* (HD, nr. 3)

1914

- Koloneli anglez G. Philips, i cili asokohe administronte Shkodrën në emër të Fuqive të Mëdha, e dënon Fishtën me mërgim në Maltë për 20 muaj, për shkak të artikullit *Nji komedi e pandershme e të XX qind-vjetë* (HD, nr. 10). Fishta largohet fshehtas nga Shkodra dhe qëndron në Gomsiqe, në Mirditë e në Troshan, që ishin jashtë juridiksionit të Shkodrës, deri në mars 1916.

1916

- Fishta botoi gazetën politike e kulturore shkodrane *Posta e Shqypnisë*, e cila dilte dy herë në javë (dhjetor).

- Fishta ngriti në Shkodër, me donacione austro-hungareze, Shtypshkronjën Françeskane, e cila do të shndërrohet në një vatër të madhe të botimit të teksteve shqipe.

- Fishta qe anëtar i *Komisisë Letrare* (1916-1918), i cili ishte krijuar me nismën dhe nën mbrojtjen e autoriteteve austro-hungareze, për të vendosur për përdorimin e gjuhës zyrtare shqipe.

1918

- Qyteti i Beratit i dërgon një **Pendë prej arit**, për punën e tij kombëtare e letrare.

1919

- Morri pjesë, si sekretar i Delegacionit të Shqipërisë në Konferencën e Paqes në Versajë (Versailles, Francë), e cila u mbajt nga shkurti 1919-deri në maj 1920. Gjatë udhëtimit për në Francë Fishta dhe Imzot Luigj Bumçi ndalen në Romë dhe patën audiencë te Papa Benedikti XV. Fishta e shkroi fjalimin (sipas Pal Duka-Gjinit) që në Universite-

tin Katolik të Parisit do ta mbajë udhëheqësi i Dërgatës shqiptare, z. Bumçi. Kjo fjalë është botuar më vonë, më 1920, si broshurë më vete, në Shkodër, me titull *Shqyptarët e të drejtat e tyne* dhe me autor Imzot Luigj Bumçin.

1920

- Tragjedia *Juda Makabe* (Shkodër).

1921

- E shoqëron Atë Pal Dodajn, Provincial i Françeskanëve të Shqipërisë, në udhëtimin në Romë. Kanë audiencë te Papa Benedikti XV (pranverë).

- (6 qershor)⁴⁹⁹. Fishta zgjidhet deputet i Shkodrës në Parlamentin e parë demokratik shqiptar. Zgjidhet nënkryetar i Parlamentit Shqiptar, pas dorëheqjes së nënkryetarit të parë Hoxha Kadriu.⁵⁰⁰

- Fishta themelon dhe bëhet drejtori i parë i gjimnazit të porsahapur klasik ILLURICUM (punoj 1921-1947, me ndërprerje).

- Boton më vete artikullin *Shqypnija e lirë* (shih Katalogun e Bibliotekës së Krist Maloki-t, BKUK, fq. 14).

1922

- Shkruan epin komik *Palokë Cuca*.

- (8 mars). Udhëton në Nju Jork e Vashington D. C., takon disa senatorë dhe lobon për njohjen diplomatike të shtetit shqiptar nga SHBA-të.

499 Sipas shënimeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, zgjedhjet e përmendura janë mbajtur më 5 prill 1921 dhe parlamenti është konstituuar më 20 prill 1921. Shih: Republika e Shqipërisë/ Kuvendi, Ligjvënësit shqiptarë 1920-2005, Tiranë, 2005.

500 Pal Duka-Gjini, Gjergj Fishta / Jeta dhe veprat, Provinça Françeskane Shqiptare, 1992, fq. 117.

1923

- *Lahuta e Malcis* (Shkodër), botim i katërt i bleut të dytë. Përfshin këngët: 1. Cubat, 2. Oso Kuka, 3. Preja, 4. Vranina, 5. Deka.

- Poema dramatike *Gomari i Babatasit* dhe *Visku i Babatasit* (kjo e dyta botuar post mortum, 1994).

- Tragjedia *Juda Makabe* (Shkodër), botim i dytë.

- Fishta boton shkrimet polemiste për çështje të fesë, të arsimit e të shtetit: *Kisha katolike ka trajtue kuluren oksidentale* (HD, nr. 4, 5, 6), në të cilin Fishta shprehë koncepte të tij për shtetin e marrëdhënien e tij me fenë kristiane; *Arsim, apo luftë kundra katoliqizmit në Shqypni* (HD, nr. 7), në të cilin trajton teza për riorganizimin kantonal mbi baza fetare të Shqipërisë.

1924

- *Mrizi i zanavet* (Shkodër), botim i dytë, i plotësuar.

- Në kohën e Revolucionit Demokratik të Fan Nolit (1923-1924) Fishta mbajti anën e Revolucionit dhe iu kundërvu Ahmet Zogut, mbretit të mëvonshëm shqiptar.

- Mbas dështimit të Revolucionit, dhe marrjes së dhunshme të pushtetit nga Ahmet Zogu, Fishta emigroi në Itali. U kthye në atdhe pasi Zogu kishte siguruar kurorën mbretërore.

- Fishta botoi shkrimin e njohur politiko-social *Trazimet e qershorit 1924* (HD, nr. 5,6).

1925

- Botoi *Vallja e Parrizit*, përmbledhje dhe zgjedhje e lirikës së tij fetare nga vetë Fishta.

- Boton melodramën *Barit e Betlemit*, si pjesë e *Valles së Parrizit*, e cila qe shfaqur në Shkollën Françeskane në tetor 1917 dhe qe botuar

pjesërisht në periodikët katolikë. Melodrama është shkruar sipas modelit të dramaturgut italian A. F. S. Rondina, S. J.⁵⁰¹

- Papa Piu XI e dekoron me çmimin **Al Merito**.

1927

- Boton melodramën *Sh' Luigj Gonzaga* (Shkodër).

- Boton poemën *Shna Ndou i Padues* (Shkodër), haxhiografi.

1928

- *Anzat e Parnasit* (Shkodër), botim i dytë, me emrin e autorit.

1929

- Boton tekstin dramatik *Shqyptarja e gjytetnueme* (Shkodër).

1929-1930

- Fishta inçizoi në pllakë gramafoni, me zërin e vet, dy këngë të *Lahutës së Malcis*: Vranina dhe Te Kisha e Shnjonit (sipas Zef Pllumit)

1930

- *Lahuta e Malcis*, botim i pestë i bleut të dytë (Shkodër).

- Bëhet anëtar i Shoqatës Ndërkombëtare të Poetëve, me seli në Nju Jork.

- Fishta boton shkrimin e njohur *Nji atentat shurdhë* (HD, nr. 12).

1931.

- *Lahuta e Malcis* (Shkodër), ble i tretë. Përfshinë këngët: 2. Kuvendi i Berlinit, 2. Ali Pasha i Gucisë, 3. Lidhja e Prizerendit, 4. Mehmet Ali Pasha, 5. Lugati.

- *Mrizi i zanavet* (Shkodër), botim i tretë, i ndryshuar.

- Botoi dramën *Odisea* dhe tragjedinë *Ifigenija n'Aulli* (Shkodër).

- Komedia *I ligu për mend* (Shkodër), përshtatje në shqip e komedisë së Molierit.

501 Pal Duka-Gjini, Gjergj Fishta..., fq. 211.

1932.

- *Lahuta e Malcis*, botim i gjashtë i bleut të dytë (Shkodër).

- *Lahuta e Malcis*, botim i katërt i bleut të parë (Shkodër).

- Parathanja e vepres *Poetët e mëdhenj t'Italis t'Ernest Koliqit* (Tiranë)

1930-1932

- Fishta mori pjesë në Konferencat Ballkanike: në Athinë (1930), në Sofje (1931), në Bukuresht (1932).

1932

- Fishta boton të HD trajtesën teorike letrare *Pikësime estetike mbi zeje të fjalës* (HD nr. 7-8, fq. 395-406).

1933

- Fishta botoi te HD trajtesën eseistike *Shinime estetike: mbi natyrë t'Artit* (HD, nr. 1, fq. 8-12 dhe nr. 2, fq. 67-75).

- Në këtë kohë Fishta hyn në polemikë më poetin shqiptar Hil Mosi (1885-1933) dhe me shumë të tjerë rreth tij, e i cili në këtë kohë ishte ministër i arsimit i Shqipërisë, për çështje të shkollave fetare në Shqipëri.

- (23 prill). Pas mbylljes së shkollave fetare në Shqipëri Fishta migroi dy vjet jashtë vendit (Itali), mjaft i zhgënjyer me të gjitha zhvillimet në Shqipëri. Më 25 prill mbyllet shkolla françeskane në Shkodër. Fishta i mbledh nxënësit në oborrin e shkollës dhe u thotë: „Bij të dashun, ç'me sot shkoni nder shtëpija tueja e në shkolla të shtetit, mbasi Shqipnija nuk po e don ma veprën tonë! Por ani: Shqipnia rrhoftë edhe pa ne!”⁵⁰²

1934

502 Pal Duka-Gjini, Gjergj Fishta..., fq. 147.

- Fishta boton broshurën *Grindje me klerin*, një polemikë me z. Ismet Toto dhe broshurën e tij me të njëjtin emër (Ismet Tota, *Grindje me klerin*, Tiranë, 1934).

1935

- Emërohet Provincial i Françeskanëve të Shqipërisë.

1937

- Botoi të plotë e të përfunduar *Lahutën e Malcis*, EPIKA, Shkodër (botim i parë i plotë).

1939

- (7 prill) Italia fashiste pushtoi Shqipërinë dhe kjo paraqet edhe për Fishtën një moment kritik, sepse ai nuk e kundërshtoi hapur pushtimin, ashtu si pritej prej një poeti kombëtar, çfarë ai cilësohej në atë kohë.

- (3 qershor) Fishta bëhet anëtar i rregullt i Akademisë Italiane të Shkencave e të Arteve. Udhëton në Itali ku mban ligjërata në institucione të rëndësishme, sipas rregullit të Akademisë së Italisë. Pranohet në audiencë edhe nga Papa Piu XII.

1940.

- Zgjidhet anëtar i Institutit të Studimeve Shqiptare (Tiranë).

- Botoi dramën lirike *Jerina ase mbretnesha e lulevet*.

- (10 dhjetor) sëmuret rëndë. Mbledh miqtë e tij dhe përshëndetet.

“Jam tue dekë i qetë, përse në tanë jetën teme kam punue në të drejtë e pa hile per Fe e per Atdhe...”⁵⁰³

- (30 dhjetor) Gjergj Fishta vdes në Shkodër. Varroset në Kishën Françeskane në Shkodër.

503 Pal Duka-Gjini, Gjergj Fishta..., fq. 161.

1941

- *Mrizi i Zanavet* (Shkodër). Botim i katërt postum, komentuar prej Atë Viktor Volajt.

- *Vallja e Parrizit* (Shkodër). Botim i dytë postum, i ndryshuar, përmban edhe lirika fetare nga libri *Vierrsha të pershpiertshme* (1905).

1942

- *Anzat e Parnasit* (Shkodër), botim i tretë postum.

1944

- Pushteti komunist ia heq kurorat dhe kryqin nga varri.

1958

- *Lahuta e Malcis*, botim i dytë, me argumente të çdo kënge, me komente dhe me numërim të vargjeve nga P. Danjel Gjeçaj, Romë.

1967

- Pushteti komunist ia nxjerr eshtrat nga varri dhe sipas dëshmitarëve ia hedh në lumin Dri.

- Pushteti komunist e heq emrin dhe veprën e Fishtës nga shkollat, nga librat shkollorë, nga manualët e letërsisë e të historisë.

1990

- Revista letrare e Prishtinës *Jeta e re* i kushtoi një numër voluminoz jetës dhe veprës së Gjergj Fishtës, nr. 11-12, duke thyer kështu pengesat e ndalesat gati gjysmë shekullore për botimin e veprës së Fishtës dhe për përmendjen publike të emrit e të veprës së tij. Numrin e përgatitën Anton N. Berisha dhe Beqir Musliu.

- (28 dhjetor). “Një grup dashamirësh të Poetit” (Aurel Plasari, Skender Buçpapaj, Rudolf Marku, Ndreka Luca dhe Jorgo Bllaci) organizojnë në sallën e Lidhjes së Shkrimtarëve e të Artistëve në Tiranë

pesëdhjetëvjetorin e vdekjes së poetit. Salla nuk i zuri të gjithë ata që dëshironin të ishin brenda.

- Sali Kabashi botoi në Lubjanë *Mrizin e Zanavet*.

- Botohet *Lahuta e Malcis*, botim i katërt, pa vend botimi, pa vit botimi; në mbështjellës të librit, nën një biografi të shkurtër të Fishtës nënshkruhet Sali Kabashi.

- (30 dhjetor) Revista letrare *Drita* botoi ligjëratën e Skender Buçpapajt në përvjetorin e pesëdhjetë të vdekjes së Fishtës me titullin *Njëri nga sovranët e letrave tona*.

1991

- (janar) Gazeta *Rilindja Demokratike* botoi ligjëratën e Aurel Plasarit me titull *Gjergj Fishta dhe historia e letërsisë*, të mbajtur në përvjetorin e pesëdhjetë të vdekjes së poetit.

1993

- Me nismën dhe nën drejtimin e Aurel Plasarit rifillon botimi i revistës *Hylli i Dritës*.

1995

- (13 nëntor). Në udhëheqjen e një Grupi punues u bë hulumtimi i varrit të Gjergj Fishtës. Nuk u gjetën eshtrat e tij, por u gjetën disa mbetje të eshtrave të tij dhe mbetje të tjera nga mjetet e varrimit.

1996

- Në Prishtinë, nën përkujdesjen e Sabri Hamitit, Rilindja botoi kompletin e parë të veprës së Fishtës në katër libra:

I. LIRIKA (*Mrizi i Zanavet, Vallja e Parrizit, Bibliografia e Benedikt Demës*)

II. EPIKA (*Lahuta e Malcis*)

III. SATIRIKA (*Anzat e Parnasit, Gomari i Babatasit, Visku i Babatasit, Nikolejda, krijime të tjera*)

IV. DRAMATIKA (*Juda Makabe, Odisea, Ifigenija n'Aulli, Shqiptari i gjytetnuem, Shqiptarja e qytetnueme, Jerina ase Mbretnesha e lulevet, Barit e Betlemit, Sh'Françesku i Asizit, Sh'Luigji Gonzaga*).

1996

- (28-29 dhjetor). U bë rivarrimi ceremonial i mbetjeve të Gjergj Fishtës në Shkodër.

(Footnotes)

1 Gjergj Fishta, *Lahuta e Malcis*.

2 Naim Frashëri, *Veptra 3 / Histori e Skënderbeut*, Rilindja, Prishtinë, 1978, fq. 15.

SHËNIME PËR AUTORIN

Bajram Kosumi [1960, Tuxhec të Dardanës] është politikan dhe veprimtar i lëvizjes në Kosovë, shkrimtar dhe profesor në disa universitete. Ka doktoruar në letërsi, në Universitetin e Prishtinës [2008].

Në mars të vitit 1981 Kosumi qe një nga liderët e revolucionit studentor, për çka gjykata komuniste jugosllave e dënonte me 15 vjet burg. Në fund të vitit 1990 e përfshinë amnistia e përgjithshme dhe lirohet nga burgu. Menjëherë pas burgut fillon botimin e poezisë nga burgu, të tija dhe të miqve të tij.

Pas burgut punon si publicist dhe gjatë disa vjetëve do të botojë qindra shkrime të ndryshme politike, publicistike e eseistike, përmes të cilave do të artikulojë konceptin e tij politik dhe do të krijojë profilin prej politikani e intelektual.

Në vitet që pasojnë, nga 1994 e tutje, do të luajë rol të rëndësishëm në politikën e Kosovës: zgjidhet kryetar i Partisë Parlamentare të Kosovës (1993), është anëtar i Delegacionit të Kosovës në Konferencën e Rambujesë dhe të Parisit (1999), është Ministër i Informimit Publik në Qeverinë e Përkohshme të Kosovës (1999), është bashkëthemelues i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (2000), në katër legjislatura është deputet i Kuvendit të Kosovës (1992, në Kuvendin e penguar të Kosovës, dhe në legjislaturat 2001-2004, 2004-2007 dhe 2007- 2010), është Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (2004) dhe do të bëhet Kryeministër i Kosovës (mars 2005-mars 2006).

Ai është baba i katër fëmijëve dhe jeton në Prishtinë.

Përveç shkrimeve publicistike, Kosumi ka publikuar një mori shkrimesh shkencore, ka marrë pjesë në shumë konferenca shkencore dhe politike.

Libra të botuar:

- KOSUMI, B., Koncept për subpolitikën, Zgjimi, Ferizaj, 1995.
- KOSUMI, B., Fjalor i Barbarëve, Brezi 81, Prishtinë, 2000 [botim i dytë 2009; ISBN 978 9951 424 22 6].
- KOSUMI, B., Koncept për mendimin e ri politik, Brezi 81, Prishtinë, 2001.
- KOSUMI, B., Lirika e Fishtës, Botimet TOENA, Tiranë, 2004. [ISBN 99927 1 9214]
- KOSUMI, B., Një vit vendimtar, Botimet TOENA, Tiranë, 2006. [ISBN 99943-1-178-6]
- KOSUMI, B., Letërsia nga burgu-kapitull më vete në letërsinë shqipe, Botimet TOENA, Tiranë, 2006. [ISBN 99943-1-187-5]
- KOSUMI, B., Fishta dhe tradita letrare shqiptare, Brezi '81, Prishtinë, 2012. [ISBN 978 9951 424 394]

Libra të botuar në bashkautorësi:

- Ngjarjet në Kosovë nuk janë kundërrevolucion, [HYSENI, H., SHEMSIU, Z., KOSUMI, B., LAJÇI, A., KOCI, G.], pa botues, Zvicër, 1986.
- Libri i Lirisë, [AVDYLI, M., SYLA, I., HYSENI, H., JANUZAJ, J., KOSUMI, B.], përgatitur nga M. AVDYLI e B. KOSUMI , ZËRI, Prishtinë, 1992.
- Letra nga burgu / Libri i censuruar, përgatitur nga M. AVDYLI e B. KOSUMI, Brezi 81, Prishtinë, 2004. [ISBN 9951-424-04-X]

PËRMBAJTJA

H Y R J E.....	3
Kreu i parë.....	9
FISHTA DHE AUTORËT E VJETËR TË VERIUT.....	9
I. RRETHANAT E LINDJES SË LETËRSISË SË SHKRUAR SHQIPE	11
II. NDIKIMET E SHKRIMTARËVE TË VJETËR TË VERIUT NË VEPRËN E FISHTËS.....	34
PËRFUNDIME	66
Kreu i dytë	69
FISHTA DHE SHKOLLA PROKLASIKE SHKODRANE.....	69
I. LETËRSIA E VJETËR E VERIUT DHE FRANÇESKANËT	71
II. FISHTA DHE SHKOLLA PROKLASIKE SHKODRANE (MARRJET).....	78
III. FISHTA DHE PASUESIT	112
PËRFUNDIME	116
Kreu i tretë.....	119
FISHTA DHE ROMANTIZMI.....	119
SHQYRTIM HYRËS.....	121
I. MISIONI I LETËRSISË.....	125
II. TEMATIKA DHE MOTIVET.....	154
III. FORMAT POETIKE, FIGURACIONI POETIK DHE MODELI I SHKRIMIT.....	183
PËRFUNDIME	233

Kreu i katërt	235
KONCEPTET ESTETIKE TË FISHTËS DHE TRADITA E MENDIMIT ESTETIK SHQIPTAR.....	235
<i>HYRJE E SHKURTËR PËR MENDIMIN ESTETIK SHQIPTAR.....</i>	237
<i>I. SHKRIMI ESTETIK I FISHTËS.....</i>	241
<i>II. KRAHASIME PËRGJITHËSUESE TË FISHTËS ME MENDIME TË TJERA ESTETIKE-KRITIKE.....</i>	253
<i>PËRFUNDIME.....</i>	267
<i>FISHTA DHE LETËRSIA SHQIPTARE E TRADITËS.....</i>	269
BIBLIOGRAFIA KRYESORE E FISHTËS E KONSULTUAR PËR KËTË PUNIM.....	287
LITERATURA	291
<i>Koleksioni i HYLLIT TË DRITËS i hulumtuar në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës.....</i>	309
GJERGJ FISHTA (1871-1940)	324
<i>PASQYRË KRONOLOGJIKE E JETËS DHE VEPRËS SË FISHTËS.....</i>	324
Shënime për autorin.....	339

ISBN 978-9951-641-34-0



9 789951 641340 >